

KISHA E JEZU KRISHTIT E SHENJTORËVE TË DITËVE TË MËVONSHME • NËNTOR 2012

Liahona



Fjalime në Konferencën e Përgjithshme

Ulet Niveli i Moshës
së Kërkuar për
Misionarët Kohëplotë

U Njoftuan Dy Tempuj
të Rinj

Paraqitet Programi
i Ri Mësimor për Rininë



© WALTER RANE, NUK LEJOHET KOPIMI

They Were All Filled [Të Gjithë u Ngopën], nga Walter Rane

“Pastaj [Jezusi] mori pesë bukët dhe dy peshqit, i ngriti sytë nga qielli, i bekoi; i theu bukët dhe ua dha dishepujve të vet, që t’ua shpërndanin atyre; ua ndau gjithashtu dy peshqit të gjithëve.

Të gjithë hëngrën sa u ngopën” (Marku 6:41–42).

“Dhe ata që hëngrën ishin rreth pesë mijë burra, pa i numëruar gratë dhe fëmijët” (Mateu 14:21).

SESIONI I PARADITES TË SË SHITUNËS

- 4 Mirësevini në Konferencë
Presidenti Tomas S. Monson
- 6 A Ndiheni Kështu Tani?
Plaku Kuentin L. Kuk
- 10 Unë e Di Këtë. Unë e Jetoj Këtë.
Unë e Dua Këtë.
En M. Dib
- 12 Dhuratë e Papërshkrueshme
nga Perëndia
Plaku Krejg C. Kristensen
- 15 "Sepse Unë Jetoj, Edhe Ju do të Jeton!"
Plaku Shein M. Bouen
- 18 Pyetni Misionarët! Ata
Mund t'Ju Ndihmojnë!
Plaku Rasëll M. Nelson
- 21 Lidhur me Keqardhjet dhe Vendimet
Presidenti Diter F. Uhtdorf

SESIONI I PASDITES TË SË SHITUNËS

- 25 Mbështetja e Drejtuesve të Kishës
Presidenti Henri B. Ajring
- 26 Të Bëhemi Prindër të Mirë
Plaku L. Tom Peri
- 29 Përfshihuni me Zell
Plaku M. Rasëll Ballard
- 32 "Eja tek Unë, O Ti Shtëpi e Izraelit"
Plaku Leri Eko Houk
- 34 Çfarë do të Japë Njeriu si
Shkëmbim të Shpirtit të Vetë?
Plaku Robert C. Gei
- 37 Standardi i Tempullit
Plaku Skot D. Uaiting
- 39 Prova e Besimit Tuaj
Plaku Nil L. Andersen
- 43 Mbroni Fëmijët
Plaku Dallin H. Ouks

SESIONI I PRIFTËRISË

- 47 Vëllezër, Ne Kemi Punë për të Bërë
Plaku D. Tod Kristoferson
- 51 Ji Trim me Guxim, Fuqi dhe Energji
Peshkopi Geri E. Stivenson
- 54 Hapini Sytë për Vetën Tuaj
Plaku Entoni D. Perkins
- 57 Gëzimi i Priftërisë
Presidenti Diter F. Uhtdorf
- 60 Ndihmojini të Vënë Qëllime të Larta
Presidenti Henri B. Ajring
- 68 Shihini të Tjerët ashtu siç
Mund të Bëhen
Presidenti Tomas S. Monson

SESIONI I PARADITES TË SË DIELËS

- 72 Ku Është Tenda?
Presidenti Henri B. Ajring
- 75 Shlyerja
Presidenti Bojd K. Paker
- 78 Së Pari Vëzhgoni, Pastaj Shërbeni
Linda K. Barton
- 81 Të Mësuarit me Zemër
Plaku Uolter F. Gonzáles
- 83 Urdhërimi i Parë i Madh
Plaku Xhefri R. Holland
- 86 Merrni Parasysh Bekimet
Presidenti Tomas S. Monson

SESIONI I PASDITES TË SË DIELËS

- 90 Të Qenit më Shumë i
Krishterë si Krishti
Plaku Robert D. Hejls
- 93 Gëzimi i Shëlbimit të të Vdekurve
Plaku Riçard G. Skot
- 96 Një Hap më Pranë Shpëtimtarit
Rasëll T. Osguthorp
- 99 Me Anë të Besimit të Gjitha
Gjërat Plotësohen
Plaku Markus B. Nash
- 101 Duke u Bërë Dishepull i Vërtetë
Plaku Daniel L. Xhonson
- 104 Bekimet e Sakramentit
Plaku Don R. Klark
- 106 Të Kthyer në Besim te Zoti
Plaku Dejvid A. Bednar
- 110 Perëndia me Ju Qoftë
kur Prapë të Takohemi
*Presidenti Tomas S.
Monson*

MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E SHOQATËS SË NDIHMËS

- 111 A Është Besimi në Shlyerjen e Jezu
Krishtit i Shkruar në Zemrat Tona?
Linda K. Barton
- 115 Plotësisht të Vetëdijshme për
Detyrat Tona
Karol M. Stivens
- 118 Zoti nuk Ju ka Harruar Juve
Linda S. Rius
- 121 Kujdestarja
Presidenti Henri B. Ajring
- 64 Autoritetet e Përgjithshme të Kishës
së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të
Ditëve të Mëvonshme
- 125 Treguesi i Ngjarjeve në Konferencë
- 126 Lajme të Kishës
- 128 Presidentat e Përgjithshme të
Organizatave Ndihmëse



Përmbledhje për Konferencën e Përgjithshme Gjysmëvjetoare të 182-të

SESIONI I PËRGJITHSHËM I PARADITES TË SË SHTUNËS, 6 TETOR 2012

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson. Drejtimi: Presidenti Henri B. Ajring. Lutja e hapjes: Plaku Kevin R. Dankan. Lutja e mbylljes: Plaku Huan A. Uceda. Muzika nga Kori i Tabernakullit; Mak Uilberg dhe Rajën Mërri, drejtues; Klei Kristiansen dhe Riçard Eliot, në organo: "Glory to God on High" ["Lavdi Perëndisë Lart"], *Hymns*, nr. 67; "Sa i Fortë Një Themel", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 6, përshtatur nga Wilberg, bot. Oxford; "Lord, I Would Follow Thee" ["Zot, Unë do të të Ndjek Ty"], *Hymns*, nr. 220; "Të Falemi, Zot, për Profetin", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 36; "I Will Follow God's Plan" ["Do të Ndjek Planin e Perëndisë"], *Children's Songbook*, 164, përshtatur nga Hofheins, i pabotuar; "Tani Le të Gëzojmë", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 32, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar.

SESIONI I PËRGJITHSHËM I PASDITES TË SË SHTUNËS, 6 TETOR 2012

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson. Drejtimi: Presidenti Diter F. Uhtdorf. Lutja e hapjes: Plaku Gerit W. Gong. Lutja e mbylljes: Plaku Hoze L. Alonso. Muzika nga një kor i përzier rinie nga Benion dhe Telorsvill, Juta; Lia Tarrant, drejtuese, Linda Margets dhe Boni Gudlajf, në organo: "Arise, O Glorious Zion" ["Ngrihu, O Sion i Lavdishëm"], *Hymns*, nr. 407; "Fëmi i Per'ndisë Jam", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 58, përshtatur nga Perry, i pabotuar; "Punës Le t'i Vihemi", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 10; "On This Day of Joy and Gladness" ["Në këtë Ditë Gazmendi dhe Hareje"], *Hymns*, nr. 64, përshtatur nga Huff, i pabotuar.

SESIONI I PRIFTËRISË I MBRËMJES TË SË SHTUNËS, 6 TETOR 2012

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson. Drejtimi: Presidenti Diter F. Uhtdorf. Lutja e hapjes: Plaku Xhei E. Xhensen. Lutja e mbylljes: Plaku Patrik Kiëron. Muzika nga një kor i Priftërisë Melkizedeke nga Ogdeni; Juta, Stifën P. Skank dhe Derek Fërç, drejtues; Endriu Ansuorth, në organo: "Praise to the Lord, the Almighty" ["Lavdi Zotit, të Plotfuqishmit"], *Hymns*, nr. 72; "Love One Another" ["Doni Njëri-Tjetrin"], *Hymns*, nr. 308, përshtatur nga Furch, i pabotuar; "Guide Us,

O Thou Great Jehovah" ["Na Udhëhiq, O Ti Jehova i Madh"], *Hymns*, nr. 83; "Hope of Israel" ["Shpresë e Izraelit"], *Hymns*, nr. 259, përshtatur nga Schank, i pabotuar.

SESIONI I PËRGJITHSHËM I PARADITES TË SË DIELËS, 7 TETOR 2012

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson. Drejtimi: Presidenti Diter F. Uhtdorf. Lutja e hapjes: Plaku Marlin K. Xhensen. Lutja e mbylljes: Plaku Keith R. Eduards. Muzika nga Kori i Tabernakullit; Mak Uilberg, drejtues; Riçard Eliot dhe Endriu Ansuorth, në organo: "Oh Say, What Is Truth?" ["E Vërteta Çfarë Është?"] *Hymns*, nr. 272; "The Morning Breaks" ["Shkrep Mëngjesi"], *Hymns*, nr. 1, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar; "Does the Journey Seem Long?" ["I Gjatë Udhëtimi a Duket?"] *Hymns*, nr. 127, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar (Shane Warby, solist); "Called to Serve" ["Thirrur na Kanë"], *Hymns*, nr. 249; "If the Savior Stood Beside Me" ["Nëse Shpëtimtari Pranë më Qëndron"], CSMP nga Sally DeFord, përshtatur nga Cardon, i pabotuar; "If the Way Be Full of Trial, Weary Not" ["Nëse Udhë është Plot me Sprova, Mos u Lësho"], *Songs of Zion* (1912), nr. 158, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar.

SESIONI I PËRGJITHSHËM I PASDITES TË SË DIELËS, 7 TETOR 2012

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson. Drejtimi: Presidenti Henri B. Ajring. Lutja e hapjes: Plaku Oktaviano Tenorio. Lutja e mbylljes: Plaku Leri W. Gibons. Muzika nga Kori i Tabernakullit; Mak Uilberg dhe Rajën Mërri, drejtues; Boni Gudlajf dhe Linda Margets, në organo: "The Day Dawn Is Breaking" ["Dita Po Agon"], *Hymns*, nr. 52, përshtatur nga Murphy, i pabotuar; "Lutjen a e The?" *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 48, përshtatur nga Wilberg, bot. Jackman; "Rejoice, the Lord Is King" ["Gëzohuni, Zoti Është Mbret"], *Hymns*, nr. 66; "Per'ndia me Ju Qoft' kur Prap' t'Tak'emi", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 40, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar.

Mbledhja e Përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës, e Mbrëmjes të Së Shtunës, 29 Shtator 2012

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson. Drejtimi: Linda K. Barton. Lutja e hapjes:

Maria Tores. Lutja e mbylljes: Melinda Barou. Muzika nga një kor i motrave të reja në moshë madhore beqare nga Kunjet e TRMMB të Solt-Lejk Bonavillit, Solt-Lejk Hollëdeit dhe Murrei të Jutas; Emili Uadlei, drejtuese; Linda Margets në organo: "Punës Le t'i Vihemi", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 10; potpuri "He Sent His Son" ["Ai Dërgoi Birin e Tij"], *Children's Songbook*, f. 34, dhe "I'm Trying to Be Like Jesus" ["Po Përpiqem t'Jem si Jezusi"], *Children's Songbook*, f. 78, përshtatur nga Sally DeFord, i pabotuar; "Qëndroj Plot Habi", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 22; "Çdo Or' Më Duhesh Ti", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 12, përshtatur nga Beebe, bot. Larice.

MUNDËSOHEN BISEDAT E KONFERENCËS

Për të gjetur biseda të konferencës së përgjithshme në shumë gjuhë, vizitoni faqen conference.lds.org. Pastaj përzgjidhni një nga gjuhët. Përgjithësisht, brenda dy muajve pas konferencës, regjistrime zanore mundësohen në qendrat e shpërndarjes.

MESAZHET E MËSIMIT TË SHTËPISË DHE TË VIZITËS MËSIMORE

Për mesazhet e mëimit të shtëpisë dhe të vizitës mësimore, ju lutemi zgjidhni atë fjalim që u përgjigjet më mirë nevojave të atyre që vizitoni.

NË KOPERTINË

Përpara: Fotografi nga Derek Israelsen.
Prapa: Fotografia nga Leslie Nilsson.

FOTOGRAFIMI I KONFERENCËS

Pamjet nga konferenca e përgjithshme në Solt-Lejk-Siti u morën nga Craig Dimond, Welden C. Andersen, John Luke, Matthew Reier, Cody Bell, Leslie Nilsson, Weston Colton, Sarah Jenson, Derek Israelsen, Scott Davis, Kristy Jordan, Randy Collier, Lloyd Eldredge dhe Cara Call; në Botsvanë nga John Huntsman; në Brazil nga Francisco Flávio Dias Carneiro; në Estoni nga Amanda Robinson; në Greqi nga David L. Mower; në Itali nga Christopher Dean; në Meksikë nga Carlos Israel Gutierrez Robles; në Mozambik nga Daniel Osborn; në Poloni nga Lois Jensen; në Skoci nga John J. Graham; në Spanjë nga Antoni García Corrius; dhe në Tajvan nga Danny Chan La.

NËNTOR 2012 VËLLIMI 14 NR. 4

LIAHONA 10491 101

Revista ndërkombëtare zyrtare e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Presidencia e Parë: Tomas S. Monson, Henri B. Ajring, Diter F. Uhtdorf

Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve: Bojd K. Paker, L. Tom Perri, Rasëll M. Nelson, Dallin H. Ouks, M. Rasëll Ballard, Riçard G. Skot, Robert D. Hejls, Xhefri R. Holland, Dejvid A. Bednar, Kuentin L. Kuk, D. Tod Kristoferson, Nil L. Andersen

Botues: Craig A. Cardon

Këshilltarë: Shayne M. Bowen, Bradley D. Foster, Christoffel Golden Jr., Anthony D. Perkins

Drejtor Administrimi: David T. Warner

Drejtor i Mbështetjes së Familjes dhe Anëtarë: Vincent A. Vaughn

Drejtor i Revistave të Kishës: Allan R. Loyborg

Administrues i Punëve: Garff Cannon

Redaktor Administrimi: R. Val Johnson

Ndihmësredaktor Administrimi: LaRene Porter Gaunt

Ndihmës i Botimeve: Mellissa Zenteno

Grupi i Shkrimit dhe i Redaktimit: Susan Barrett, Ryan Carr, David Dickson, David A. Edwards, Matthew D. Flitton, Mindy Raye Friedman, Hikari Loftus, Lia McClanahan, Michael R. Morris, Richard M. Romney, Paul VanDenBerghe, Julia Woodbury

Drejtor Administrimi i Artit: J. Scott Knudsen

Drejtor Arti: Tadd R. Peterson

Grupi i Dizajnimit: Jeanette Andrews, Fay P. Andrus, C. Kimball Bott, Thomas Child, Kerry Lynn C. Herrin, Colleen Hinckley, Eric P. Johnsen, Scott M. Mooy, Brad Teare

Bashkërendues i Pronës Intelektuale:

Collette Nebeker Aune

Administrimi i Prodhimit: Jane Ann Peters

Grupi i Prodhimit: Connie Bowthorpe Bridge, Howard G. Brown, Julie Burdett, Bryan W. Gygi, Kathleen Howard, Denise Kirby, Ginny J. Nilson, Gayle Tate Rafferty

Përgatitja për Shtyp: Jeff L. Martin

Drejtor i Prodhimit: Craig K. Sedgwick

Drejtor i Shpërndarjes: Evan Larsen

Mbikëqyrës i Përkthimit Shqip: Attila Böröcz

Për pajtimet dhe për çmimet jashtë Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë, ju lutemi të lidheni me qendrën tuaj vendore të shpërndarjes të Kishës ose me udhëheqësin e lagjes apo degës.

Paraqitini dorëshkrimet dhe pyetjet në internet në liahona.lds.org; nëpërmjet postës elektronike liahona@ldschurch.org; ose nëpërmjet postës në Liahona, Rm. 2420, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150-0024, USA.

Liahona (një term nga Libri i Mormonit, që do të thotë "busull" apo "drejtues") botohet në anglisht, armenisht, bislamisht, bullgarisht, çekisht, danisht, estonisht, fixhisht, finlandisht, frëngjisht, greqisht, gjermanisht, holandisht, hungarisht, indonezisht, islandisht, italisht, japonisht, kamboxhisht, kinezisht, kiribatisht, koreanisht, kroatisht, letonisht, lituanisht, malagasisht, marshallisht, mongolisht, norvegjisht, polonisht, portugalisht, rumanisht, ronisht, samoaisht, sebuanisht, slovenisht, spanjisht, suedisht, shqip, tagalogisht, tahitisht, taisht, tongaisht, ukrainisht, uduisht dhe vietnamsisht. (Periodiciteti ndryshon sipas gjuhës.)

© 2012 nga Intellectual Reserve, Inc. I rezervohen të gjitha të drejtat. Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Lënda e shkruar dhe ajo figurative e *Liahonës* mund të kopjohet për ta përdorur me raste në kishë ose në shtëpi, jo për tregti. Lënda figurative nuk mund të kopjohet nëse ajo shoqërohet me kufizime të shënimi i meritave për punën artistike. Çështjet e së drejtës së autorit duhet të adresohen te: Intellectual Property Office, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150, USA; adresa elektronike: cor-intellectualproperty@ldschurch.org.

For Readers in the United States and Canada:

November 2012 Vol. 14 No. 4. LIAHONA (USPS 311-480) Albanian (ISSN 1521-4753), is published four times a year (April, May, October and November) by The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150. USA subscription price is \$3.00 per year; Canada, \$3.60 plus applicable taxes. Periodicals Postage Paid at Salt Lake City, Utah. Sixty days' notice required for change of address. Include address label from a recent issue; old and new address *must* be included. Send USA and Canadian subscriptions to Salt Lake Distribution Center at address below. Subscription help line: 1-800-537-5971. Credit card orders (Visa, MasterCard, American Express) may be taken by phone. (Canada Poste Information: Publication Agreement #40017431)

POSTMASTER: Send address changes to Salt Lake Distribution Center, Church Magazines, PO Box 26368, Salt Lake City, UT 84126-0368.



TREGUESI I FOLËSVE

Ajring, Henri B., 60, 72, 121
Andersen, Nil L., 39
Ballard, M. Rasëll, 29
Barton, Linda K., 78, 111
Bednar, Dejvid A., 106
Bouen, Shein M., 15
Dib, En M., 10
Eko Houk, Leri, 32
Gei, Robert C., 34
González, Uolter F., 81
Hejls, Robert D., 90
Holland, Xhefri R., 83
Klark, Don R., 104
Kristensen, Krejg C., 12
Kristoferson, D. Tod, 47
Kuk, Kuentin L., 6
Monson, Tomas S., 4, 68, 86, 110
Nash, Markus B., 99
Nelson, Rasëll M., 18
Osguthorp, Rasëll T., 96
Ouks, Dallin H., 43
Paker, Bojd K., 75
Peri, L. Tom, 26
Perkins, Entoni D., 54
Rivs, Linda S., 118
Skot, Riçard G., 93
Stivens, Karol M., 115
Stivenson, Geri E., 51
Uaiting, Skot D., 37
Uhtdorf, Diter F., 21, 57
Xhonson, Daniel L., 101

TREGUESI TEMATIK

Aktivizimi, 68
Besëlidhjet, 54
Besimi, 39, 72, 99, 111
Besnikëria, 83
Bindja, 101
Dashuria, 10, 78, 83, 118
Dashuria hyjnore, 121
Dëlirësia, 6, 39
Dëshmia, 68, 106
Detyra, 115
Dishepullimi, 21, 29, 78, 83, 90, 101
Familja, 26, 43, 54
Fatqeqësia, 39, 110, 115
Fëmijët, 15, 43
Fryma e Shenjtë, 12, 81, 99
Frymëzimi, 86
Gëzimi, 21, 57
Guximi, 51, 68
Historia familjare, 93
Jezu Krishti, 15, 18, 75, 99, 111, 118
Krishterimi, 90
Kthimi në besim, 6, 54, 81, 96, 106
Libri i Mormonit, 32
Liria e zgjedhjes, 51
Lutja, 86
Martesa, 26, 43, 47

Mësimdhënia, 18, 96
Mirënjohja, 110
Pendimi, 34, 75
Përkushtimi, 51
Përparësitë, 21
Përlulesia, 34, 72
Pornografia, 6
Priftëria, 47, 51, 54, 57
Puna, 29
Puna misionare, 4, 18
Punësimi, 47
Ringjallja, 15
Rinia, 60
Rivendosja, 18
Sakramenti, 104
Sakrifika, 34
Standardet, 37
Shërbimi, 12, 29, 57, 72, 78, 101, 110, 115, 121
Shërimi, 81
Shlyerja, 6, 75, 104, 111
Shoqata e Ndihmës, 111, 115, 121
Shpresa, 15
Shtëpia e Izraelit, 32
Talentet, 60
Të mësuarit, 10, 96
Tempujt, 4, 12, 37, 93
Vdekja, 15
Zbulesa, 60



Nga Presidenti Tomas S. Monson

Mirësevini në Konferencë

I dëgjofshim me vëmendje mesazhet . . . , që të mund të ndiejmë Shpirtin e Zotit dhe të marrim njohurinë që Ai do të dëshironte për ne.

Me aq sa mund të shoh, çdo ndenjese është e zënë – përveç pak atyre atje pas. Ka vend për përmirësim. Kjo do të ishte një mirësjellje për ata që mund të jenë pak vonë, për shkak të trafikut, që të gjejnë një ndenjese të lirë kur të vijnë.

Kjo është një ditë e shkëlqyer – ditë konference. Kemi dëgjuar një kor të bukur që këndoi muzikë të mrekullueshme. Çdo herë që dëgjoj korin, ose dëgjoj organon, ose dëgjoj pianon, mendoj për nënën time, që tha: “Gëzohem për të gjithë njohjen që të është dhënë, të gjitha diplomat që ke marrë dhe të gjithë punën që

ke bërë. Më vjen keq vetëm për një gjë, që nuk vazhdove të luash në piano.” Faleminderit Nënë. Do të doja ta kisha bërë.

Sa mirë është, vëllezërit dhe motrat e mia, t’ju urojmë mirëseardhjen në Konferencën e Përgjithshme Gjysmë-vjetore të 182-të të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Qëkur u takuam gjashtë muaj të shkuar, tre tempuj të rinj janë përkushtuar dhe një tempull është ripërkushtuar. Në maj, qe privilegji im të përkushtoja Tempullin e bukur të Kansas-Sitit në Misuri dhe të merrja pjesë në festimin kulturor që e shoqëroi atë. Do ta përmend atë festim me më shumë hollësi në fjalën time nesër në mëngjes.

Në qershor, Presidenti Diter F. Uhtdorf përkushtoi tempullin e shumëpritur në Manaus të Brazilit dhe, nga fillimi i shtatorit, Presidenti Henri B. Ajring ripërkushtoi tempullin e saporinovuar në Buenos-Ajres të Argjentinës, një tempull

që kam pasur privilegjin ta përkushtoj afërsisht 27 vite më parë. Vetëm dy javë më parë, Presidenti Bojd K. Paker përkushtoi Tempullin e dashur të Brigam-Sitit në qytetin ku ai u lind e u rrit.

Siç kam thënë më parë, asnjë godinë e ndërtuar për Kishën nuk është më e rëndësishme se një tempull dhe kemi kënaqësinë të kemi 139 tempuj në funksionim në mbarë botën, me 27 të tjerë të njoftuar ose në ndërtim. Ne jemi mirënjohës për këto ndërtesa të shenjta dhe për bekimet që ato sjellin në jetën tonë.

Këtë mëngjes, kam kënaqësinë të njoftoj dy tempuj të tjerë, të cilët, në muajt dhe vitet e ardhshëm do të ndërtohen në vendet e mëposhtme: Tukson në Arizona; dhe Arekipa në Peru. Hollësitë në lidhje me këta tempuj do të jepen në të ardhmen, ndërsa sigurohen lejet dhe miratimet e domosdoshme.

Vëllezër dhe motra, tani i drejtohem një tjetër çështjeje – dhe pikërisht, shërbimit misionar.

Prej disa kohësh, Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve i kanë lejuar të rinjtë nga disa vende që të shërbejnë në moshën 18-vjeçare, kur janë të denjë, të aftë, kanë marrë diplomën e shkollës së mesme dhe kanë shprehur një dëshirë të sinqertë për të shërbyer. Kjo ka qenë një politikë e posaçme sipas vendeve dhe ka lejuar mijëra të rinj që të shërbejnë në misione të nderuara dhe gjithashtu të përmbushin detyrimet e kërkuara ushtarake dhe mundësitë arsimore.

Përvoja jonë me këta misionarë 18-vjeçarë ka qenë pozitive. Presidentët e tyre të misioneve raportojnë se ata janë të bindur, besnikë, të pjekur dhe shërbejnë po me aq kompetencë sa dhe misionarët më të rritur që shërbejnë në të njëjtat misione.





Besnikëria, bindja dhe pjekuria e tyre na ka bërë të dëshirojmë të njëjtën mundësi për shërbim më të hershëm misionar për të gjithë të rinjtë, pavarësisht nga vendi prej nga vijnë.

Kam kënaqësinë të njoftoj se, duke hyrë në fuqi menjëherë, të gjithë të rinjtë e denjë e të aftë, që kanë marrë diplomën e shkollës së mesme ose të barasvlerëshmen e saj, pavarësisht vendit ku jetojnë, do të kenë mundësinë të rekomandohen për shërbim misionar duke filluar nga mosha 18 vjeç në vend të moshës 19 vjeç. Nuk po sugjeroj se të gjithë të rinjtë do të – ose duhet të – shërbejnë në këtë moshë më të hershme. Më saktësisht, bazuar në rrethanat vetjake, si dhe në varësi nga një përcaktim nga udhëheqësit e priftërisë, kjo mundësi tani është e disponueshme.

Ndërsa kemi medituuar plot lutje për moshën në të cilën të rinjtë mund të fillojnë shërbimin e tyre misionar, kemi marrë parasysh gjithashtu edhe moshën në të cilën një e re mund të shërbejë. Sot, kam kënaqësinë të njoftoj se të rejtat e afta e të denja, që kanë dëshirë të shërbejnë, mund të rekomandohen për shërbim misionar duke filluar nga mosha 19 vjeçe në vend të moshës 21 vjeçe.

Ne pohojmë se puna misionare është një detyrë priftërie – dhe i nxisim të gjithë të rinjtë që janë të denjë dhe që janë të aftë fizikisht dhe mendërisht, që t'i përgjigjen thirrjes për të shërbyer. Shumë të reja shërbejnë gjithashtu, por ato nuk janë nën të njëjtin urdhër për të shërbyer si të rinjtë. Megjithatë, ne i sigurojmë motrat e reja të Kishës se ato japin

kontribute të çmuara si misionare dhe ne e mirëpresim shërbimin e tyre.

Neve vazhdojnë të na duhen shumë më tepër çifte në moshë. Si ta lejojnë rrethanat tuaja, kur ju lind e drejta për të dalë në pension dhe si t'jua lejojë shëndeti, unë ju nxis të viheni në dispozicion për shërbim misionar kohëplotë. Si bashkëshorti edhe bashkëshortja, do të kenë gëzim më të madh kur së bashku u shërbejnë fëmijëve të Atit tonë.

Tani vëllezërit e motrat e mia, i dëgjofshim me vëmendje mesazhet që do të na paraqiten gjatë dy ditëve të ardhshme, që të mund të ndiejmë Shpirtin e Zotit dhe të marrim njohurinë që Ai do të dëshironte për ne. Unë lutem që kjo të jetë përvoja jonë, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Plaku Kuentin L. Kuk,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

A Ndiheni Kështu Tani?

Disa në Kishë besojnë se nuk mund t'i përgjigjen pyetjes së Almës me një "po" kumbuese. Ata nuk "ndihen kështu tani".

Presidenti Monson, ne të duam, të respektojmë dhe të mbështesim! Ky njoftim kuptimplotë historikisht në lidhje me shërbimin misionar, është frymëzues. Mund ta kujtoj emocionin në 1960-ën kur mosha për të rinjtë që po shërbenin u ul nga 20 vjeç në 19. Unë mbërrita në misionin britanik si një 20-vjeçar i sapothirur. I pari 19-vjeçar në misionin tonë ishte Plaku Xhefri R. Holland, një shtim i pabesueshëm. Ai mbushte 20 vjeç për disa muaj. Pastaj, gjatë vitit arritën shumë më tepër 19-vjeçarë. Ata qenë misionarë të bindur e besnikë dhe puna përparoi. Kam besim se një korje edhe më e madhe do të arrihet tani, ndërsa misionarë të drejtë e të zotuar përmbushin urdhërimin e Shpëtimtarit që të predikojnë ungjillin e Tij.

Sipas pikëpamjes sime, ju pjesëtarë të brezit të ri jeni më të përgatitur se cilido brez i mëparshëm. Dituria juaj për shkrimet e shenja është veçanërisht mbresëlënëse. Megjithatë, sfida që has brezi juaj ndërsa përgatiteni për shërbim, janë të ngjashme me ato të hasura nga të gjithë anëtarët e Kishës. Jemi të gjithë të vetëdijshëm se kultura në pjesën më të madhe të botës nuk të çon te drejtësia ose zotimi shpirtëror. Përgjatë historisë, udhëheqësit i kanë paralajmëruar njerëzit dhe u kanë mësuar pendimin.

Në Librin e Mormonit, Alma i Riu që kaq i shqetësuar rreth padrejtësisë dhe mungesës së zotimit sa që dha dorëheqjen si kryegjykatës, si udhëheqës i popullit të Nefit dhe i përqendroi të gjitha përpjekjet e tij tek thirrja e tij profetike.¹

Në një nga vargjet më të thella prej të gjitha shkrimeve të shenja, Alma shpall: "Në qoftë se keni provuar një ndryshim të zemrës dhe në qoftë se ju keni ndier të këndonit këngën e dashurisë shëlbuese, unë do t'ju pyesja, a ndiheni kështu tani?"²

Udhëheqësit vendorë përfaqësojnë raportojnë se kur shihen si një e tërë,

anëtarët e Kishës, veçanërisht të rinjtë tanë, nuk kanë qenë kurrë më të fortë. Por ata pothuajse gjithnjë ngrënë dy shqetësime: Së pari, sfidën e padrejtësisë së shtuar në botë dhe së dyti, plogështinë dhe mungesën e përkushtimit të disa anëtarëve. Ata kërkojnë këshillë rreth mënyrës se si t'i ndihmojnë anëtarët ta ndjekin Shpëtimtarin dhe të arrijnë një kthim të thellë e të përhershëm në besim.

Kjo pyetje: "A ndiheni kështu tani?" kumbon nëpër shekuj. Me gjithçka që kemi marrë në këtë periudhë ungjillore – duke përfshirë Rivendosjen e plotësisë së ungjillit të Jezu Krishtit, derdhja me bollëk e dhuratave shpirtërore dhe bekimet e padiskutueshme të qiellit – sfida e Almës nuk ka qenë kurrë me e rëndësishme.

Shpejt pasi Ezra Taft Benson u thirr si Apostull në 1943-ën, Presidenti Xhorxh Albert Smith³ e këshilloi: "Misioni yt është që . . . ta paralajmërosh popullin . . . në mënyrën më të dashur të mundshme se pendimi do të jetë i vetmi ilaç për të gjitha sëmundjet e kësaj bote".⁴ Kur u bë kjo deklaratë, ne qemë në mes të konfliktit të Luftës II Botërore.



Sot shthurja morale është përshkallëzuar. Një shkrimtar i njohur së fundmi tha: "Të gjithë e dinë se kultura është helmuese dhe askush nuk pret që ajo të ndryshojë".⁵ Portretizimi i vazhdueshëm i dhunës dhe i imoralitetit në muzikë, në industrinë e argëtimit, në art dhe në media të tjera në kulturën e kohëve të sotme është i pashembullt. Kjo u përshkrua në një mënyrë të jashtëzakonshme nga teolog shumë i respektuar baptist kur ai deklaroi: "Është dëmtuar sistemi imunitar shpirtëror i një qytetërimi të tërë".⁶

Nuk është për t'u habitur që disa në Kishë besojnë se nuk mund t'i përgjigjen pyetjes së Almës me një "po" kumbuese. Ata nuk "ndihen kështu tani". Ata ndiejnë se janë në një thatësi shpirtërore. Të tjerët janë të zemëruar, të lënduar ose të zhgënjyer. Nëse këto përshkrime vlejnë për ju⁷ është e rëndësishme që të përcaktoni përse nuk mund të ndiheni kështu tani.

Shumë njerëz që janë në thatësi shpirtërore dhe kanë mungesë zotimi, nuk janë përfshirë domosdoshmërisht në mëkate apo shkelje të mëdha, por kanë bërë zgjedhje jo të mençura. Disa i mbajnë besëlidhjet e tyre të shenjta vetëm me raste. Të tjerë e kalojnë pjesën më të madhe të kohës së tyre duke u kushtuar një pjesë të mirë të kohës dhe të energjisë tyre çështjeve më pak të rëndësishme. Disa lejojnë që besnikëria e tyre ndaj ungjillit të Jezu Krishtit t'u dobësohet nga pikëpamje të vrullshme kulturore apo politike. Disa janë zhytur në materiale nga interneti që i mbivlerësojnë, i ekzagjerojnë dhe në disa raste i shpikin të metat e udhëheqësve të hershëm të Kishës. Ata mund të arrijnë në përfundime jo të sakta që mund të ndikojnë te dëshmia. Cilido që i ka bërë këto zgjedhje mund të pendohet dhe të përtërihet shpirtërisht.

Zhytja në shkrimet e shenjta është thelbësore për ushqyerjen shpirtërore.⁸ Fjala e Perëndisë frymëzon zotim dhe vepron si një balsam shërues për ndjenjat e lëndimit, zemërimit apo zhgënjimit.⁹ Kur zotimi ynë zbehet për çfarëdo arsye, një pjesë e zgjidhjes është pendimi.¹⁰ Zotimi dhe pendimi janë të lidhur ngushtë.

C. S. Luis, shkrimtari i palodhur e i matur i krishterë, e trajtoi fuqishëm këtë çështje. Ai hodhi pretendimin se krishtërimi u thotë njerëzve që të pendohen dhe u premtonte falje; por krishtërimi nuk u flet atyre serisa ata ta dinë dhe ta ndiejnë se kanë nevojë për falje. Ai pohoi: "Kur je i sëmure, do ta dëgjosh mjekun".¹¹

Profeti Jozef vuri në dukje se përpara pagëzimit, ju mund të jeni në një tokë asnjëses mes së mirës dhe së keqes. Por "kur u bashkove me këtë Kishë, ti zgjedhe t'i shërbeje Perëndisë. Kur e bërë atë, ti le tokën asnjëses dhe nuk mund të kthehesh më kurrë në të." Këshilla e tij është që ne të mos e braktisim kurrë Mësuesin.¹²

Alma thekson se nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit, "krahët e mëshirës janë shtrirë" drejt atyre që pendohen.¹³ Më pas ai bën pyetje zhbiruese dhe të rëndësishme të tilla si: A jemi të përgatitur për t'u takuar me Perëndinë? A po e mbajmë veten të pafaj? Të gjithë ne duhet t'i peshojmë këto pyetje. Përvoja vetjake e Almës e dështimit në ndjekjen e të atit të tij besnik dhe më pas marrja e një kuptueshmërie dramatike rreth faktit se sa shumë kishte nevojë për faljen dhe se çfarë deshte të thoshte të këndoje këngën e dashurisë shëlbuese është e fuqishme dhe bindëse.

Ndërkohë që çdo gjë që e zbehet zotimin është për t'u marrë në konsideratë, dy sfida të ndërlidhura kulturore janë sa të zakonshme aq edhe domethënëse. E para është sjellja e

ashpër, dhuna dhe abuzimi në familje. E dyta është imoraliteti seksual dhe mendimet e papastra. Këto shpesh i paraprijnë dhe janë shkaku i zgjedhjes për të qenë më pak të zotuar.

Mënyra se si i trajtojmë ata që kemi më afër është me rëndësi të jashtëzakonshme. Dhuna, abuzimi, mungesa e qytetarisë dhe mungesa e respektit në shtëpi nuk janë të pranueshme – nuk janë të pranueshme për të rriturit dhe nuk janë të pranueshme për brezin që po rritet. Babai im nuk qe aktiv në Kishë, por qe një shembull shumë i mirë, veçanërisht në mënyrën si e trajtonte nënën time. Ai e kishte zakon të thoshte: "Perëndia do t'i quajë burrat përgjegjës për çdo lot që kanë bërë që gratë e tyre të derdhin". Po i njëjti koncept përforcohet te "Familja: Një Proklamata drejtuar Botës". Aty thuhet: "[Ata] që abuzojnë me bashkëshorten ose fëmijët . . . do të qëndrojnë një ditë përgjegjës përpara Perëndisë".¹⁴ Pavarësisht nga kultura në të cilën rritemi dhe nga fakti nëse prindërit kanë abuzuar me ne apo jo, ne nuk duhet të dhunojmë fizikisht, emocionalisht apo gojarisht askënd tjetër.¹⁵

Nuk ka qenë kurrë më e rëndësishme nevoja për qytetari në shoqëri Themeli i mirësjelljes dhe i qytetarisë nis në shtëpitë tona. Nuk është befasuese që sjellja e përgjithshme e njerëzve ka marrë të tatëpjetën në të njëjtën kohë me shkatërrimin e familjeve. Familja është themeli i dashurisë dhe i ruajtjes së shpirtmërisë. Familja nxit një atmosferë ku mund të lulëzojë bindja ndaj fesë. Me të vërtetë që "kudo ka veç bukuri kur n'sh'pi ka dashuri".¹⁶

Imoraliteti seksual dhe mendimet e papastra shkelin standardin e vendosur nga Shpëtimtari.¹⁷ Ne jemi paralajmëruar që në fillim të kësaj periudhe unguillorë se imoraliteti seksual do të



ishite ndoshta sfida më e madhe.¹⁸ Një sjellje e tillë, pa pendim, do të shkaktojë thatësi të shpirtërore dhe humbje të zotimit. Filmata, televizori dhe interneti shpesh përçojnë mesazhe dhe pamje të dëmshme. Nga Presidenti Diter F. Uhtdorf dhe unë, qemë së fundmi në një fshat në xhunglën e Amazonës dhe pamë antena satelitore madhe edhe në disa prej kasolleve të vogla e të ndërtuara thjesht. Ne u gëzuam për informimin e mrekullueshëm që gjendej në këtë zonë të largët. Ne gjithashtu e pranuan se nuk ka praktikisht asnjë vend në tokë që nuk mund të preket nga pamje epshore, imorale dhe seksualisht nxitëse. Kjo është një nga arsytet përse pornografia është bërë një problem kaq i rëndë në kohën tonë.

Kohët e fundit pata një bisedë kuptimplote me një mbajtës 15-vjeçar të priftërisë Aarone. Ai më ndihmoi të kuptoja se sa e lehtë është në këtë epokë të internetit që të rinjtë të gjenden përpara pamjesh të papastra e madje edhe pornografike pothuajse pa dashje. Ai vuri në dukje se për shumicën e parimeve që Kisha jep mësim, ka të paktën një farë miratimi nga shoqëria në përgjithësi se shkelja e këtyre parimeve mund të ketë efekte

shkatërruese mbi shëndetin dhe mirëqenien. Ai përmendi tymosjen e cigareve, përdorimin e drogës dhe konsumimin e alkoolit nga të rinjtë. Por ai vuri re se nuk ka një thirrje ankuese të përgjithshme po aq të rëndësishme e madje as një paralajmërim të madh nga shoqëria në përgjithësi rreth pornografisë apo imoralitetit.

Vëllezër dhe motra të mia të dashura, analiza e këtij të riu është e saktë. Cila është përgjigjja? Për vite profetët dhe apostuj kanë dhënë mësim për rëndësinë e respektimit të fesë në shtëpi.¹⁹

Prindër, kanë kaluar ditët kur pjesëmarrja aktive dhe e rregullt në mbledhjet e programet e Kishës, megjithëse përsëri thelbësore, mund të përmbushet përgjegjësinë tuaj të shenjtë për t'i mësuar fëmijët tuaj që të bëjnë jetë të moralshme e të drejtë dhe të ecin me drejtësi përpara Zotit. Me njoftimin e Presidentit Monson këtë mëngjes, është thelbësore që kjo të përmbushet me besnikëri në shtëpitë tona, të cilat janë vende strehimi ku sundojnë mirësjellja, falja, e vërteta dhe drejtësia. Prindërit duhet të kenë guxim që të vendosin kufij ose ta mbikëqyrin qasjen në internet, televizion, filma dhe muzikë. Prindërit duhet të kenë guxim të thonë jo, të mbrojnë të vërtetën dhe të japin dëshmi të fuqishme. Fëmijët tuaj duhet ta dinë se ju keni besim te Shpëtimtarit, se e doni Atin Qiellor dhe i mbështesni udhëheqësit e Kishës. Pjekuria shpirtërore duhet të lulëzojë në shtëpitë tona. Është shpresa ime që askush të mos largohet nga kjo konferencë pa e kuptuar se këto probleme morale të kohës sonë duhen trajtuar në familje. Peshkopët, udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse duhet t'i mbështesin familjet dhe të sigurohen që po jepen mësim parimet shpirtërore. Mësuesit e shtëpisë dhe mësueset vizitore duhet

të japin ndihmë, veçanërisht me fëmijët e prindërve beqarë.

I riu që përmenda, më pyeti me zell nëse Apostujt e dinin se sa herët në jetë duhet të fillojnë mësimet dhe mbrojtja kundër pornografisë dhe mendimeve të papastra. Ai pohoi fuqishëm se në disa zona nuk është tepër herët të fillojnë që përpara se fëmijët të mbarojnë Filloren.

Të rinjtë që janë gjendur përpara pamjeve imorale në një moshë tepër të hershme janë të tmerruar se mund të jenë tashmë të pakualifikuar për shërbimin misionar dhe për besëlidhjet e shenjta. Si rrjedhim, besimi i tyre mund të pakësohet dukshëm. Unë dëshiroj t'u siguroj ju të rinjve, ashtu siç jepet mësim, se nëpërmjet pendimit ju mund të kualifikoheni për të gjitha bekimet e qiellit.²⁰ Rreth kësaj vërtitet e gjithë Shlyerja e Shpëtimtarit. Ju lutem, flisni me prindërit tuaj ose me një këshillues të besuar dhe këshillohuni me peshkopin tuaj.

Kur vjen puna te të qenit të moralshëm, disa të rritur besojnë se zbatimi i një projekti të vetëm të rëndësishëm humanitar apo i një parimi të vetëm e asgjëson nevojën për të ndjekur mësimet e Shpëtimtarit. Ata i thonë vetes se shkelja seksuale është "një mëkat i parëndësishëm . . . [nëse jam] . . . një njeri dashamirës dhe bamirës".²¹ Një mënyrë e tillë të menduari është sheshit mashtrim i vetes. Disa të rinj më vënë në dijeni se në kulturën tonë të tanishme nuk është "në modë" që të përpiqesh më tepër seç duhet në shumë fusha, përfshirë të jetuarit në përputhje strikte me parime të drejta.²² Ju lutem të mos bini në këtë grackë.

Në pagëzim ne premtojmë të marrim mbi vete "emrin e Jezu Krishtit duke pasur *vendosmëri[në]* për t'i shërbyer atij deri në fund".²³ Një besëlidhje e tillë kërkon përpjekje të guximshme, zotim dhe integritet moral nëse duam

të vazhdojmë ta këndojmë dashurinë shëlbuese dhe të mbetemi të kthyer me të vërtetë në besim.

Një shembull nga historia, i zotimit për të qenë të fortë dhe të patundur për të gjitha epokat, u portretizua nga një lojtar olimpik britanik që konkuroi në Lojërat Olimpikë në 1924-ën në Paris të Francës.

Erik Lidëll ishte i biri i një misionari skocez që shërbeu në Kishë dhe i një burri të përkushtuar ndaj fesë. Ai e tërboi trupën udhëheqëse britanike të Lojërave Olimpikë duke mos pranuar, edhe nën një presion të jashtëzakonshëm që të vraponte në një garë paraprake prej 100 metrash të mbajtur të dielën. Përfundimisht ai fitoi garën prej 400 metrash. Shembulli i Lidëllit që nuk pranoi të vraponte të dielën qe veçanërisht frymëzues.

Përshkrimet dhe përkujtimet në nder të tij kanë përmendur fjalët frymëzuese të Isaias: “Por ata që shpresojnë te Zoti fitojnë forca të reja, ngrihen me krahë si shqiponja, vrapojnë pa u lodhur dhe ecin pa u lodhur”.²⁴

Sjellja e admirueshme e Lidëllit pati shumë ndikim te vendimi i djalit tonë më të vogël për të mos marrë pjesë në sportet e së dielës çfarë ishte më e rëndësishme, për ta veçuar veten nga sjellja e padrejtë dhe e botës. Ai përdori citimin nga Isaia për kontributin e tij te vjetari shkollor. Erik Lidëlli la një shembull të fuqishëm vendosmërie dhe zotimi ndaj një parimi.

Teksa rinia jonë ndjek këshillën e Presidentit Monson duke u përgatitur për të shërbyer në mision dhe teksta ne të gjithë i jetojmë parimet që Shpëtimtari dha mësim dhe përgatitimi [që] të takohe[m] me Perëndinë,²⁵ ne fitojmë një garë shumë më të rëndësishme.²⁶ Ne do të kemi Frymën e Shenjtë si udhërrëfyesin tonë për drejtim shpirtëror. Për cilindo, jeta e të

cilit nuk është në rregull, mbani mend, nuk është kurrë tepër vonë për ta bërë Shlyerjen e Shpëtimtarit themelin e besimit dhe jetës sonë.²⁷

Me fjalët e Isaias: “edhe sikur mëkatet tuaja të ishin të kuqe flakë, do të bëhen të bardha si bora, edhe sikur të ishin të kuqe të purpur, do të bëhen si leshi.”²⁸

Është lutja ime e sinqertë që secili prej nesh do të ndër marrë çfarëdo veprimi të nevojshëm për të ndier Shpirtin *tani* në mënyrë që të *mund* ta këndojmë me gjithë zemër këngën e dashurisë shëlbuese. Unë dëshmoj për fuqinë e Shlyerjes së Shpëtimtarit, në emër të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Alma 4:15–19.
2. Alma 5:26.
3. Xhorxh Albert Smithi në atë kohë ishte Presidenti i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. Ai do të bëhej Presidenti i Kishës më 21 maj 1945. (Shih *Deseret News 2012 Church Almanac* [2012], f. 98.)
4. George Albert Smith, në Sheri L. Dew, *Ezra Taft Benson: A Biography* (1987), f. 184.
5. Peggy Noonan, “The Dark Night Rises,” *Wall Street Journal*, korrik 28–29, 2012, A17.
6. Dr. R. Albert Mohler i Riu, president, Seminari Teologjik Baptist i Jugut, paraqitje ndaj udhëheqësve fetarë, qyteti i Nju-Jorkut, 5 shtator 2012.
7. Shih 2 Nefi 2:27.
8. Shih Gjoni 5:39; Amosi 8:11; shih edhe James E. Faust, “A Personal Relationship with the Savior,” *Ensign*, nëntor 1976, f. 58–59.
9. Shih Alma 31:5.
10. Shih Alma 36:23–26.
11. C. S. Lewis, *Mere Christianity* (1952), f. 31–32. Luis qe bashkëprofesor për letërsinë angleze në Universitetin e Oksfordit dhe më pas drejtues në katedrën e anglishtes mesjetare dhe rilindase në Universitetin e Kembrixhit.
12. Shih *Teachings of Presidents of the Church: Jozef Smith* (2007), f. 345–346; shih edhe Zbulesa 3:15–16.
13. Alma 5:33.
14. “Familja: Një Proklamata Drejtuar Botës”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.
15. Shih Richard G. Scott, “Removing Barriers to Happiness,” *Ensign*, maj 1998, f. 85–87. Disa norma kulturore janë në kundërshtim me mësimet e Shpëtimtarit dhe mund të

na çojnë në rrugë të gabuar. Kur qeshë në Paqësorin jugor, takova një burrë që kishte qenë kërkues në Kishë për vite. Ai raportoi se qe prekur thellësisht kur një udhëheqës i Kishës dha mësim në një konferencë për priftërinë: “Duart me të cilat më parë e kishit zakon t’i godisnit fëmijët tuaj duhen përdorur për t’i bekuar fëmijët tuaj”. Ai mori mësimet me misionarët, u pagëzua dhe ka qenë një udhëheqës i shkëlqyer.

16. “Dashuri në Shtëpi”, *Himne dhe Këngë të fëmijëve*, f. 44.
17. Shih Alma 39.
18. Shih Ezra Taft Benson, “Cleansing the Inner Vessel,” *Ensign*, maj 1986, f. 4.
19. Presidenti Gordon B. Hinkli paraqiti dokumentin “Familja: Një Proklamata Drejtuar Botës” në mbledhjen e përgjithshme të Shoqatës së Ndihmës në shtator të 1995-ës. Presidenti Tomas S. Monson kryesoi ndryshimin e kapitullit të parë të *Handbook 2: Administering the Church* (2010), “Families in the Church in God’s Plan” [Manualit 2: Administrimi i Kishës (2010), “Familjet në Kishë në Planin e Perëndisë”].
20. Shih Alma 13:27–30; 41:11–15.
21. Ross Douthat, *Bad Religion: How We Became a Nation of Heretics* (2012), 238; shih edhe Alma 39:5.
22. Mos e lejoni një kulturë që është e mbushur me dhunë dhe imoralitet dhe që është e rrezikshme për ata që i jetojnë parimet që dha mësim Shpëtimtari, që ta shqetësojnë besimin tuaj. Ashtu sikurse shkroi butësisht poeti Uordsuorth, “Ushqeje [mendjen] me mendime të admirueshme, që as gojë e liga, as gjykimet e nxituara, as përqeshjet e parespektueshme të egoistëve . . . të mos ta mposhtin kurrë . . . e as ta shqetësojnë besimin [tuaj] plot gaz” (“Lines Composed a Few Miles above Tintern Abbey”, në *The Oxford Book of English Verse*, red. Christopher Ricks (1999), f. 346).
23. Moroni 6:3; theksimi i shtuar; shih edhe Mosia 18:13.
24. Isaia 40:31; shih Robert L. Backman, “Day of Delight,” *New Era*, qershor 1993, 48–49.
25. Shih Alma 34:32.
26. Shih 1 Korintasve 9:24–27.
27. Shih Helamani 5:12. Oliver Uendell Holms i Vjetri këshilloi: “Më duket se gjëja e mrekullueshme në këtë botë është jo dhe aq se ku po qëndrojmë, se sa në ç’drejtim po lëvizim: Për të shkuar në portin e qiellit, ndonjëherë duhet të lundrojmë me erën dhe ndonjëherë kundër saj, – por ne duhet të lundrojmë dhe jo të na marrë rrjedha, jo të qëndrojmë pa lëvizur në ankorim” (*The Autocrat of the Breakfast-Table* [1858], f. 105).
28. Isaia 1:18.



Nga En M. Dib,

Këshilltare e Dytë në Presidencën e Përgjithshme të Të Rejave

Unë e Di Këtë. Unë e Jetoj Këtë. Unë e Dua Këtë.

Ne jemi pasues të Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit. Një kthim i tillë në besim dhe besim në vetvete është rezultati i një përpjekjeje të zellshme dhe të qëllimshme. Është individual. Është proces që kryhet gjatë të gjithë jetës.

Unë frymëzohem nga shembujt që jepen prej anëtarëve të drejtë të Kishës, përfshirë rininë fisnike. Ju shihni me kurajë drejt Shpëtimtarit. Ju jeni besnikë, të bindur dhe të dëlirë. Bekimet që merrni për shkak të mirësisë suaj, ndikojnë jo vetëm në jetën tuaj por gjithashtu dhe në jetën time si dhe në jetën e shumë të tjerëve në mënyra të thella por shpesh të panjohura.

Disa vite më parë, isha në radhë për të blerë diçka te ushqimorja e lagjes sime. Para meje qëndronte një vajzë e re, afërsisht 15 vjeçe. Ajo duke e sigurt në vetvete dhe e lumtur. Vura re bluzën me mëngë të shkurtra të saj dhe nuk mund të qëndroja pa i folur. Unë fillova: “Ti nuk je nga ky shtet, apo jo?”

Ajo u çudit nga pyetja ime dhe u përgjigj: “Po, nuk jam. Jam nga Kolorado. Nga e kuptove ti?”

Unë shpjegova: “Për shkak të bluzës tënde”. E bëra hamendësimin tim

të saktë pasi lexova fjalët në bluzën e saj: “Unë Jam Mormone. Po ti a je?”

Unë vazhdova: “Duhet të të them se më bëri përshtypje siguria jote për t’u dalluar dhe për të veshur një deklaram kaq të guximshëm. Unë shoh një dallim te ti dhe do të dëshiroja që çdo e re dhe çdo anëtar i Kishës të mund të kishte të njëjtën bindje dhe të njëjtën siguri.” Pasi mbaruam blerjet, u përshëndetëm dhe u ndamë.

Megjithatë, për ditë dhe javë pas këtij çasti të rastit e të rëndomtë, e gjeta veten duke menduar seriozisht për këtë takim. Vrisja mendjen se si kjo e re nga Kolorado arriti të zotëronte një siguri të tillë në identitetin e saj si anëtare e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Nuk mund të mos e vrisja mendjen se çfarë fraze kuptimplote do të zgjidhja në mënyrë të figurshme, që ta kisha të shtypur te bluza ime, që të pasqyronte besimin dhe dëshminë time. Në mendjen time, mora parasysh shumë

thënie të mundshme. Përfundimisht, mendova një deklaratë ideale që do ta vishja me krenari: “Unë jam Mormone. Unë e di këtë. Unë e jetoj këtë. Unë e dua këtë.”

Sot dëshiroj ta përqendroj fjalën time rreth kësaj deklaratë të guximshme dhe plot shpresë.

Pjesa e parë e deklaratës është një deklaram me vetëbesim, pa shfaqësim: “Unë jam Mormone”. Pikërisht si vajza e re që takova te ushqimorja, nuk kishte frikë t’ia tregonte botës se ajo ishte anëtare e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, unë shpresoj se ne kurrë nuk do të kemi frikë ose ngurrim që ta pranojmë: “Unë jam Mormon”. Ne duhet të kemi besim në vetvete, ashtu siç kishte Apostulli Pali kur shpalli: “Në fakt unë nuk kam turp për ungjillin e Krishtit, sepse ai është fuqia e Perëndisë për shpëtimin e cilitdo që beson”.¹ Si anëtarë, ne jemi pasues të Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit. Një kthim i tillë në besim dhe besim në vetvete është rezultati i një përpjekjeje të zellshme dhe të qëllimshme. Është individual. Është proces që kryhet gjatë të gjithë jetës.

Pjesa tjetër e deklaramit pohon: “Unë e di këtë”. Në botën e sotme ka një mori aktivitete, çështjesh dhe interesash që konkurrojnë për çdo minutë të vëmendjes sonë. Me kaq shumë gjëra që na tërheqin vëmendjen, a kemi forcë, disiplinë dhe zotim që të mbetemi të përqendruar në atë çfarë ka më shumë rëndësi? A jemi gjithashtu aq të ditur për të vërtetat e ungjillit saç jemi në studimet, karrierat, hobitë, sportet tona, apo mesazhet në celular dhe në Twitter? A kërkojmë aktivisht t’i gjejmë përgjigjet për pyetjet tona duke u ushqyer me bollëk me shkrimet e shenjta dhe mësimet e profetëve? A kërkojmë pohimin e Shpirtit?

Rëndësia e fitimit të diturisë është një parim i përjetshëm. Profeti Jozef Smith “e donte diturinë për fuqinë që rrjedh nga përdorimi i drejtë i saj”². Ai tha: “Dituria është e nevojshme për jetën dhe perëndishmërinë. . . . Dëgjoni, të gjithë ju vëllezër, këtë çelës të madhërishtë: dituria është fuqia e Perëndisë për shpëtimin.”³

E gjithë e vërteta dhe dituria është e rëndësishme, por midis shpërqendrimëve të vazhdueshme të jetës sonë të përditshme, ne duhet t’i kushtojmë vëmendje veçanërisht rritjes së diturisë sonë të ungjillit, që të mund të kuptojmë se si t’i zbatojmë parimet e ungjillit në jetën tonë⁴. Kur dituria jonë për ungjillin rritet, ne do të fillojmë të ndiejmë siguri në dëshmitë tona dhe do të jemi në gjendje të pohojmë: “Unë e di këtë”.

Pastaj është deklarata: “Unë e jetoj këtë”. Shkrimet e shenjta na mësojnë se duhet të jemi “bërës të fjalës dhe jo vetëm dëgjues”⁵. Ne e jetojmë ungjillin dhe bëhemi “bërës të fjalës” duke ushtruar besim, duke qenë të bindur, duke u shërbyer të tjerëve me dashuri dhe duke ndjekur shembullin e Shpëtimtarit. Ne veprojmë me integritet moral dhe bëjmë atë që e dimë se është e drejtë “në të gjitha kohërat dhe në të gjitha gjërat dhe në të gjitha vendet”⁶, pavarësisht se kush mund të jetë duke vështruar ose jo.

Në gjendjen tonë në vdekshmëri, askush nuk është i përsosur. Madje dhe në përpjekjet tona më të zellshme për të jetuar ungjillin, të gjithë ne do të bëjmë gabime dhe të gjithë ne do të mëkatojmë. Çfarë sigurimi ngushëlloes është që të dish se, nëpërmjet sakrificës shëlbuese të Shpëtimtarit, ne mund të marrim falje dhe të bëhemi të pastër sërisht. Ky proces i pendimit të vërtetë dhe faljes forcon dëshminë tonë dhe vendosmërinë tonë për t’iu bindur urdhërimeve të Zotit dhe për



ta jetuar jetën tonë sipas standardeve të ungjillit.

Kur mendoj për frazën: “Unë e jetoj këtë”, më kujtohet një e vajzë e re që kam takuar, që quhet Karigan. Ajo shkroi: “Kam qenë anëtare e Kishës për pak më shumë se një vit. . . . Për mua, kur po kërkoja, një shenjë se kjo ishte Kisha e vërtetë erdhi sepse ndieva që më në fund gjeta një kishë që jepte mësim për thjeshtësinë dhe standardet. E kam parë me vetë sytë e mi se çfarë u ndodh njerëzve kur shpërfillin urdhërimet dhe zgjedhin shtegun e gabuar. E ndava mendjen, shumë kohë më parë, që të jetoj standarde të larta morale. . . . Ndiheva kaq e bekuar që kam gjetur të vërtetën dhe jam pagëzuar. Jam kaq e lumtur.”⁷

Fraza përfundimtare në deklarin tim shpallës është: “Unë e dua këtë”. Fitimi i diturisë për ungjillin e Jezu Krishtit dhe të jetuarit me zell i parimeve të ungjillit në jetën tonë të përditshme bën që shumë anëtarë të Kishës të thërassin me entuziazëm: “Unë e dua ungjillin!”

Kjo ndjenjë vjen kur ndiejmë Frymën e Shenjtë që na dëshmon se ne jemi fëmijë të Atit tonë Qiellor, se Ai kujtohet për ne dhe se jemi në shtegun e drejtë. Dashuria jonë për ungjillin rritet kur përjetojmë dashurinë e Atit tonë në Qiell dhe paqen e premtuar nga Shpëtimtari kur i tregojmë Atij se jemi të gatshëm t’i bindemi dhe ta pasojmë Atë.

Në kohë të ndryshme në jetën tonë, qoftë nëse jemi të sapokthyer në besim në Kishë apo anëtarë gjatë gjithë jetës, mund të shohim se ky entuziazëm kumbues është venitur. Nganjëherë kjo ndodh kur kohët janë sfiduese dhe na duhet të ushtrojmë durim. Nganjëherë ndodh në kulmin e mirëqenies dhe bollëkut tonë. Kurdoherë që e kam këtë ndjenjë, e di se duhet t’i ripërqendroj përpjekjet e mia për rritjen e diturisë sime për ungjillin dhe për të jetuarit e parimeve të ungjillit më plotësisht në jetën time.

Një nga parimet e ungjillit më efikase por nganjëherë të vështira për t’i zbatuar, është përlulësia dhe nënshtrimi ndaj vullnetit të Perëndisë. Në lutjen e Krishtit në Kopshtin e Gjetsemanit, Ai i shprehu Atit: “Mos u bëftë vullneti im, por yt”⁸. Kjo duhet të jetë lutja jonë po ashtu. Shumë herë, pikërisht në këto çaste të çeta e plot lutje, ne ndihemi të rrethuar nga dashuria e Atit Qiellor dhe ato ndjenja të gëzueshme e të dashura përtërihen.

Në një mbledhje të udhëheqëseve të Të Rejave në Juxhin të Oregonit, pata privilegjin të takoja dhe të bisedoja me motrën Kami Vilberger. Historia që më tregoi motra Vilberger, ishte një dëshmi e fuqisë dhe bekimeve prej të diturit, të jetuarit dhe të dashurit të ungjillit prej një të reje.

E bija 19-vjeçare e motrës Vilberg, Bruku, kishte vdekur në mënyrë tragjike disa vite më parë, kur ishte në pushimet verore pas vitit të saj të parë në

universitet. Motra Vilberg kujtoi: “Ishte një kohë e vështirë dhe brengosëse për familjen tonë. Megjithatë, Bruku na kishte dhënë një dhuratë të madhe. Ne nuk e dalluam këtë kur ajo po rritej, por për çdo vit dhe çast të jetës së saj të shkurtër, Bruku na kishte dhënë dhuratën më të madhe që një bijë mund t’u japë prindërve të saj. Bruku ishte një bijë e drejtë e Perëndisë. . . . Për shkak të kësaj dhurate dhe veçanërisht për shkak të fuqisë mundësuese të Shlyerjes, unë kam pasur forcën, ngushëllimin dhe paqen e premtuar prej Shpëtimtarit. Nuk kam dyshim se ku është Bruku tani dhe mezi pres ribashkimin tonë të dashur.”⁹

Unë kam një dëshmi për planin e madh të lumturisë së përgjithshme të Atit tonë Qiellor. Unë e di se Ai na njuh dhe na do. Unë e di se Ai na dërgoi një profet, Presidentin Tomas S. Monson, që të na japë kurajë dhe të na ndihmojë të udhëhiqemi sërish tek Ai. Unë lutem që secili prej nesh do të bëjë përpjekje që të jetë në gjendje të deklarojë me besim në vetvete: “Unë jam Mormon. Unë e di këtë. Unë e jetoj këtë. Unë e dua këtë.” Unë i them këto gjëra përlësisht në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

Shënim: Për studim të mëtejshëm, rekomandoj të lexohet *Alma 32 dhe biseda e Plakut Dallin H. Oaks: “The Challenge to Become”* [“Sfida për t’u Bërë”] (Liahona, janar 2001, f. 40-43; Ensign, nëntor 2000, f. 32-34).

SHËNIME

1. Romakëve 1:16.
2. George Q. Cannon, në *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 277.
3. *Mësimet: Jozef Smith*, f. 281; shih edhe Martha Jane Knowlton Coray, fletore shënimesh, Church History Library, Salt Lake City.
4. Shih përvojën për vlerën e dijes, numër 1, *Të Rejat Përparimi Personal* (broshurë, 2009), f. 38.
5. Jakobit [Bibla] 1:22.
6. Mosia 18:9.
7. Letërkëmbim vetjak.
8. Lluca 22:42.
9. Letërkëmbim vetjak.



Nga Plaku Krejg C. Kristensen,
i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve

Dhuratë e Papërs shkrueshme nga Perëndia

Fryma e Shenjtë bashkëvepron në unitet të përsosur me Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin, duke përmbushur shumë role të rëndësishme dhe përgjegjësi të dallueshme.

Në vitin 1994, Presidenti Hauard W. Hanter i ftoi të gjithë anëtarët e Kishës që “ta vendosnin tempullin . . . si simbolin e madh të anëtarësisë [sonë]”¹. Më vonë, po atë vit, u përfundua ndërtimi i Tempullit të Bauntifullit në Juta. Si shumë të tjerë, ne ishim plot dëshirë për ta çuar familjen tonë të re te shtëpia e hapur përpara përkushtimit. Ne punuam me këmbëngulje për t’i përgatitur fëmijët tanë të hynin në tempull, duke u lutur me zell që të mund të kishin një përvojë shpirtërore në mënyrë që tempulli të bëhej qëllim kryesor në jetën e tyre.

Teksa ecnim me nderim nëpër tempull, u gjenda duke admiruar arkitekturën madhështore, punimet e përfunduara elegante, dritën që shndriste nga dritaret e larta dhe shumë prej pikturave frymëzuese. Çdo aspekt i kësaj ndërtese të shenjtë qe vërtet i goditur.

Duke hyrë në dhomën çelestiale, papritmas kuptova se biri ynë më i

vogël, Beni gjashtë vjeçar, po kapej pas këmbës time. Ai dukej jo i qetë – ndoshta edhe pak i shqetësuar.

“Çfarë nuk shkon, Bir?” i pëshpërita.

“Babi”, u përgjigj, “çfarë po ndodh këtu? Kurrë më parë nuk jam ndier kështu.”

Duke e kuptuar se kishte të ngjarë që kjo të ishte hera e parë që djali ynë i vogël e ndiente ndikimin e Frymës së Shenjtë në një mënyrë kaq të fuqishme, u gjuhëzova mbi dysheme pranë tij. Ndërsa vizitorë të tjerë ecnin rreth nesh, unë dhe Beni kaluam disa minuta, krah për krah, duke mësuar së bashku rreth Frymës së Shenjtë. U çudita se me sa lehtësi qemë në gjendje të diskutonim mbi ndjenjat e tij të shenjta. Teksa folëm, u bë e qartë se ajo që qe më frymëzuesja për Benin nuk ishte ajo që *pa* por ajo që *ndieu* – jo bukuria fizike përreth nesh por zëri i qetë e i ulët i Shpirtit të Perëndisë brenda zemrës së tij. I tregova atë që kisha mësuar nga përvojat e mia vetjake, teksa mrekullimi i tij fëmijëror

rizgjoi edhe në mua një ndjenjë të thellë mirënjohjeje për këtë dhuratë të papërshkrueshme nga Perëndia – dhuratën e Frymës së Shenjtë².

Kush Është Fryma e Shenjtë?

Fryma e Shenjtë është anëtar i tretë i Kreut-Perëndi dhe, si i tillë, ashtu si Perëndia Ati dhe Jezu Krishti, Ai i di mendimet tona dhe qëllimet e zemrës sonë.³ Fryma e Shenjtë na do dhe dëshiron që të jemi të lumtur. Meqënëse i di sfidat që hasim, Ai mund të na drejtojë e mësojë të gjitha gjërat që duhet të bëjmë për t'u kthyer e jetuar edhe një herë me Atin tonë Qiellor.⁴

Ndryshe nga Ati Qiellor dhe Jezu Krishti, që kanë trupa të përlëvduar prej mishi e kockash, Fryma e Shenjtë është një personazh i shpirtit që i flet shpirttrave tanë përmes ndjenjave e përshtypjeve.⁵ Duke qenë qenie shpirtërore, Ai ka përgjegjësinë unike e të qenit mjete përmes të cilit merret zbulesa personale. Në shkrimet e shenjtja, Fryma e Shenjtë shpesh quhet Shpirti i Shenjtë, Fryma e Zotit, Shpirti i Shenjtë i Premtimit ose thjesht Fryma.⁶

Cili Është Misioni i Frymës së Shenjtë?

Fryma e Shenjtë bashkëvepron në unitet të përsosur me Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin, duke përmbushur shumë role të rëndësishme dhe përgjegjësi të dallueshme. Qëllimi primar i Frymës së Shenjtë është që të japë dëshmi për Perëndinë Atin dhe për Birin e Tij, Jezu Krishtin,⁷ dhe që të na mësojë të vërtetën e të gjitha gjërave.⁸ Një dëshmi e sigurt nga Fryma e Shenjtë përçon shumë më tepër siguri sesa një dëshmi nga çfarëdo burimi tjetër. Presidenti Jozef Filding Smith dha mësim se “kur Shpirti i Perëndisë i flet shpirtit të njeriut, Ai ka fuqi ta komunikojë të vërtetën me një forcë e kuptueshmëri më të madhe [madje dhe] sesa e vërteta që mund



të komunikohet nga takimi i drejtpërdrejtë edhe me qenie qiellore”⁹.

Fryma e Shenjtë njihet edhe si Ngushëlluesi¹⁰. Gjatë periudhave të shqetësimit apo dëshpërimit ose thjesht kur kemi nevojë të dimë që Perëndia është pranë, Fryma e Shenjtë mund të ngrejë moralisht shpirtin tonë, të na japë shpresë dhe të na mësojë “gjërat paqësore të mbretërisë”¹¹, duke na ndihmuar që të ndiejmë “paq[en] e Perëndisë, që ia tejkalon çdo zgjuarësi”¹².

Disa vite më parë kur rrethi ynë familjar u mblodh për një darkë pushimesh, babai im filloi të luante lojëra me shumë prej nipërve e mbesave të tij. Befas dhe pa paralajmërim, ai u rrëzua dhe shpejt ndërroi jetë. Kjo ngjarje e papritur mund të kishte qenë shkatërrimtare, veçanërisht për nipërit e mbesat e tij, që ngrinin pyetje të cilat janë të vështira t’u përgjigjesh. Megjithatë, si i mblodhëm fëmijët tanë rreth vetes, teksa u lutëm dhe lexuam fjalët e profetëve të Librit të Mormonit rreth qëllimit të jetës, Fryma e Shenjtë e ngushëlloi secilin prej nesh personalisht. Në mënyra që janë të vështira të përshkruhen me fjalë, përgjigjet që kërkuaam erdhën qartësisht në zemrën

tonë. Ne ndiem një paqe atë ditë, që vërtet e tejkalonte të kuptuarin tonë, ende dëshmimi nga Fryma e Shenjtë që i sigurt, i pamohueshëm dhe i vërtetë.

Fryma e Shenjtë është mësues dhe zbulues.¹³ Teksa studiojmë, meditojmë e lutemi rreth të vërtetave të ungjillit, Fryma e Shenjtë ndriçon mendjen tonë dhe gjallëron të kuptuarin tonë.¹⁴ Ai bën që e vërteta të ngulitet në mënyrë të pashlyeshme në shpirtin tonë dhe mund të bëjë që të ndodhë një ndryshim i madh në zemrën tonë. Ndërsa i ndajmë këto të vërteta me familjen tonë, me anëtarët e tjerë të Kishës dhe me miqtë e fqinjët në komunitetin tonë, Fryma e Shenjtë bëhet edhe mësuesi i tyre, pasi Ai e çon mesazhin e ungjillit “në zemrat e fëmijëve të njerëzve”¹⁵.

Fryma e Shenjtë na frymëzon që t’u gjendemi të tjerëve duke u shërbyer. Për mua, shembujt më të gjallë të të dëgjuarit të nxitjeve të Frymës së Shenjtë në shërbim të të tjerëve vijnë nga jeta dhe shërbesa e Presidentit Tomas S. Monson, i cili tha: “Kam mësuar se, gjatë përmbushjes së përgjegjësive tona, kur ia vëmë veshin një nxitjeje të qetë dhe veprojmë në përputhje me të pa u



shkrimin e shenjtë, “është shpirti i zbulësës”¹⁹.

Çfarë Do Të Thotë të Marrësh Dhuratën e Frymës së Shenjtë?

Kur po i jepja mësim djalit tonë gjashtë vjeçar, Benit, mendova që qe me rëndësi t’i shpjegoja dallimin mes asaj që po ndiente, që qe ndikimi i Frymës së Shenjtë, dhe dhuratës së Frymës së Shenjtë, që do ta merrte pas pagëzimit. Para pagëzimit, të gjithë kërkuesit e ndershëm e të sinqertë të së vërtetës mund të ndiejnë ndikimin e Frymës së Shenjtë hera herës. Mirëpo, mundësia për të marrë shoqërimin e vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë dhe *plotësinë* e të gjitha bekimeve të lidhura me Të janë të disponueshme vetëm për anëtarët e denjë e të pagëzuar, të cilët e marrin dhuratën e Frymës së Shenjtë me anë të vënies së duarve nga ata që mbajnë autoritetin e priftërisë së Perëndisë.

Përmes dhuratës së Frymës së Shenjtë, ne marrim aftësi shtesë dhe dhurata shpirtërore, më shumë zbulësë e mbrojtje, udhëheqje e drejtim të vazhdueshëm dhe bekimet e premtuara të shenjtërimin e ekzaltimit në mbretërinë çelestiale. Të gjitha këto bekime jepen si rrjedhojë e dëshirës sonë vetjake për t’i marrë ato dhe vijnë teksa e vëmë jetën tonë në përputhje me vullnetin e Perëndisë dhe kërkojmë drejtimin e Tij të vazhdueshëm.

Kur mendoj rreth përvojës sime me Benin në Tempullin e Bauntifullit në Juta, kam shumë ndjenja e përshtypje të ëmbla. Një kujtim i kthjellët është se teksa qeshë përfshirë nga madhështia e asaj që po shihja, një fëmijë i vogël pranë meje po kuptonte ndjenjat e fuqishme në zemrën e tij. Me anën e një kujtuesi të ëmbël, unë u ftova jo vetëm të ndaloja e të gjuhëzohesha por edhe t’ia vija veshin thirrjes së Shpëtimtarit për t’u bërë si një fëmijë

vonuar, Ati ynë Qiellor do t’i drejtojë hapat tanë e do ta bekojë jetën tonë dhe jetën e të tjerëve. Nuk di ndonjë përvojë më të ëmbël ose ndjenjë më të çmuar sesa të bindurit ndaj një nxitjeje për të zbuluar në fund të fundit që Zoti i është përgjigjur lutjes së një njeriu tjetër përmes jush.”¹⁶

Po ndaj vetëm një përvojë të dhembshur. Kur Presidenti Monson po shërbente si peshkop, ai mori vesh se një anëtare e lagjes së tij, Meri Uatson, qe në spital. Kur shkoi ta vizitonte, mësoi se ajo po qëndronte në një dhomë të madhe me disa paciente të tjera. Kur iu qas motrës Uatson, vuri re se pacientja në shtratin fqinj mbuloi kokën me shpejtësi.

Pasi Presidenti Monson e kishte vizituar motrën Uatson dhe i kishte dhënë një bekim priftërie, i dha dorën, tha mirupafshim dhe u përgatit që të largohej. Në atë kohë ndodhi një gjë e thjeshtë por mahnitëse. Tani do citoj nga vetë kujtimet e Presidentit Monson lidhur me këtë përvojë:

“Nuk mund të largohesha nga ajo. Dukej sikur një dorë e padukshme [po më] qëndronte mbi shpatull dhe ndieva brenda shpirtit sikur po dëgjoja këto fjalë: ‘Shko te krevati pranë ku zonja trupvogël mbuloi fytyrën kur hyre’. Unë e bëra këtë. . .

Iu afrova anës së krevatit të pacientes tjetër, e preka lehtë në shpatull dhe me kujdes tërhoqa çarçafin që mbulonte fytyrën e saj. Dhe çfarë vura

re! Edhe ajo qe anëtare e lagjes sime. Nuk e dija që ishte e shtruar në spital. Emri i saj qe Kethlin Mek-Ki. Kur sytë e saj ndeshën të mitë, ajo thirri mes lotësh: ‘Oh, peshkop, kur hytë nga ajo derë, ndieva që kishe ardhur të më takoje mua dhe të më bekoje në përgjigje të lutjeve të mia. Po lumturohesha përbrenda duke menduar që ju e dinit se isha këtu, por kur ndaluar tek krevati tjetër, zemra më theri dhe e dija se nuk kishit ardhur të më takonit mua.’

I thashë [motrës] Mek-Ki: ‘Nuk ka rëndësi që nuk e dija se ishit këtu. Megjithatë, ka rëndësi që Ati ynë Qiellor e dinte, dhe se ishit lutur në heshtje për një bekim priftërie. Ishte Ai që më nxiti të ndërhyja në privatsinë tuaj.’¹⁷

Si Na Flet Fryma e Shenjtë?

Ne të gjithë kemi përvoja me Frymën e Shenjtë, megjithëse jo gjithmonë mund t’i kuptojmë ato. Kur mendimet e frymëzuara na vijnë në mendje, ne e dimë që janë të vërteta prej ndjenjave shpirtërore që hyjnë në zemrën tonë. Presidenti Bojd K. Paker ka dhënë mësim: “Fryma e Shenjtë flet me një zë që më shumë *e ndieni* sesa *e dëgjoni*. . . Kur flasim për ‘dëgjimin’ e pëshpëritjeve të Shpirtit, më shpesh përshkruhet një nxitje shpirtërore duke thënë: ‘Unë pata një ndjesi. . .’”¹⁸ Është përmes këtyre ndjenjave të shenjtë nga Fryma e Shenjtë që arrijmë të dimë se çfarë do të donte Perëndia që ne të bënim, pasi ky, siç thuhet në

i vogël – i përlur, i bindur dhe i gatshëm të dëgjojë zërin e qetë e të ulët të Shpirtit të Tij.

Jap dëshmi për realitetin e gjallë dhe misionin hyjnor të Frymës së Shenjtë dhe se nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë ne mund të dimë të vërtetën e të gjitha gjërave. Dëshmoj se dhurata e Frymës së Shenjtë është dhurata e çmuar dhe e papërshkrueshme e Atit Qiellor ndaj të gjithë atyre që vijnë te Biri i Tij, pagëzohen në emrin e Tij dhe marrin Frymën e Shenjtë përmes konfirmimit në Kishën e Tij. Për këto të vërteta të shenja unë jap dëshmi personale në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Howard W. Hunter, në Jay M. Todd, "President Howard W. Hunter: Fourteenth President of the Church", *Ensign*, korrik 1994, f. 5; shih edhe Howard W. Hunter, "The Great Symbol of Our Membership", *Tambuli*, nëntor 1994, f. 3.
2. Shih Doktrina e Besëlidhje 121:26.
3. Shih Alma 12:7; 18:16–18; Doktrina e Besëlidhje 6:15–16.
4. Shih 2 Nefi 32:5.
5. Shih Doktrina e Besëlidhje 130:22.
6. Shih Lluca 4:1, 18; 11:13; Gjoni 1:33; Efesianëve 1:13; Doktrina e Besëlidhje 88:3.
7. Shih 2 Nefi 31:18; 3 Nefi 28:11; Doktrina e Besëlidhje 20:27.
8. Shih Moroni 10:5.
9. Joseph Fielding Smith, *Doctrines of Salvation*, përmb. Bruce R. McConkie, 3 vëll. (1954–1956), 1:47–48.
10. Shih Gjoni 14:26; Doktrina e Besëlidhje 35:19.
11. Doktrina e Besëlidhje 36:2.
12. Filipianëve 4:7.
13. Shih Lluca 12:12; 1 Korintasve 2:13; Doktrina e Besëlidhje 50:13–22; *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 136–137.
14. Shih Doktrina e Besëlidhje 11:13.
15. 2 Nefi 33:1.
16. Thomas S. Monson, "Peace, Be Still", *Liahona*, nëntor 2002, f. 55.
17. Shih Thomas S. Monson, "Christ at Bethesda's Pool", *Ensign*, nëntor 1996, f. 18–19.
18. Boyd K. Packer, "Personal Revelation: The Gift, the Test, and the Promise", *Liahona*, qershor 1997, f. 10.
19. Doktrina e Besëlidhje 8:3; shih edhe vargun 2.



Nga Plaku Shein M. Bouen,
i Të Shtatëdhjetëve

"Sepse Unë Jetoj, Edhe Ju do të Jetoni"

Për shkak të Tij, madje Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit, ato ndjenja pikëllimi, vetmie e dëshpërimi një ditë do të përpihen në një plotësi gëzimi.

Kur po shërbenim si misionarë të rinj në Kili, unë dhe shoku im i misionit takuam në degë një familje të përbërë nga shtatë anëtarë. Mamaja merrte pjesë në kishë çdo javë me fëmijët e saj. Ne menduam se ata ishin anëtarë të Kishës për një kohë të gjatë. Pas disa javësh mësuam se ata nuk ishin pagëzuar.

Menjëherë u lidhëm me familjen dhe i kërkuam nëse mund të shkonim te shtëpia e tyre dhe t'u jepnim mësim. Babai nuk ishte i interesuar të mësonte rreth ungjillit, por nuk kishte kundërshtim që të mësonim familjen e tij.

Motra Ramirez përparoi shpejt gjatë mësimet. Ajo qe plot dëshirë për të mësuar të gjithë doktrinën që ne jepnim mësim. Një mbrëmje, teksa po diskutonim për pagëzimin e foshnjave, dhamë mësim se fëmijët e vegjël janë të pafajshëm dhe nuk kanë nevojë të pagëzohen. Ne e ftuam që të lexonte te libri i Moronit:

"Vër re, unë të them që këtë gjë duhet t'u mësosh – pendim dhe pagëzim për ata që janë të përgjegjshëm dhe që mund të bëjnë mëkat; po, mësoju prindërve se ata duhet të pendohen dhe të pagëzohen, dhe të përlur,

sikurse fëmijët e tyre të vegjël dhe të gjithë ata do të shpëtohen me fëmijët e tyre të vegjël.

Dhe se fëmijët e tyre të vegjël nuk kanë nevojë për pendim, as për pagëzim. Vër re, pagëzimi është për pendimin, që të plotësohen urdhërimet për heqjen e mëkateve.

Por fëmijët e vegjël janë gjallë në Krisht, madje që nga krijimi i botës; përndryshe Perëndia do të ishte një Perëndi paragjykses dhe gjithashtu një Perëndi i ndryshueshëm dhe i njëanshëm me njerëzit; pasi, sa fëmijë të vegjël kanë vdekur pa pagëzim!"¹

Pasi lexoi këtë shkrim të shenjtë, motra Ramirez filloi të ngashërehej. Unë dhe shoku im i misionit u hutuam. Unë pyeta: "Motra Ramirez, mos kemi thënë ose bërë diçka që të ka lënduar?"

Ajo tha: "Oh jo, Plak [Elder], nuk keni bërë asgjë të gabuar. Gjashtë vjet më parë linda një djalë. Ai vdiq përpara se të mund ta pagëzonim. Prifti ynë na tha se, meqë nuk ishte pagëzuar, ai, për gjithë përjetësinë, do të qëndronte në limbo, [vendin ku shkojnë shpirtat e të papagëzuarve pas vdekjes sipas fesë katolike].

Për gjashtë vjet e kam mbartur këtë dhembje dhe faj. Dhe duke lexuar këtë shkrim të shenjtë, e di me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë se është i vërtetë. Kam ndier të më hiqet një barrë e rëndë nga vetja, dhe këta janë lot gëzimi.”

M'u kujtuan mësimet e profetit Jozef Smith, që na mësoi këtë doktrinë ngushëlluese: “Zoti merr shumë me vete, madje në foshnjëri, që ata të mund t'i shpëtojnë zilisë së njeriut dhe dhembjeve e të ligave të kësaj bote të tashme; ata qenë tepër të pastër, tepër të dashur, që të jetonin në tokë; prandaj, nëse gjykohet si duhet, në vend që të mbajmë zi, ne kemi arsye të gëzojmë pasi ata janë çliruar nga e liga dhe ne do t'i kemi ata përsëri së shpejti”².

Pasi vuajti një hidhërim e dhembje thujse të padurueshme për gjashtë vjet, doktrina e vërtetë, e zbuluar nga një Atë i dashur në Qiell përmes profetit të gjallë, i solli të ëmblën paqe kësaj gruaje të munduar. Është e panevojshme të thuhet se motra Ramirez dhe fëmijët e saj që ishin tetë vjeç e sipër u pagëzuan.

Më kujtohet që i shkrova familjes sime duke u shprehur mirënjohjen që ndieva në zemër për dijeninë e kësaj dhe aq shumë të vërtetave të tjera të qarta e të çmueshme të ungjillit të rivendosur të Jezu Krishtit. Kurrë nuk



e kisha përfytyruar se si ky parim i vërtetë e i mrekullueshëm do të më prekte në vitet e ardhshme dhe do të rezultonte të ishte balsami im i Galaadit.

Do të doja t'u flisja atyre që kanë humbur një fëmijë dhe kanë bërë pyetjen: “Përse mua?” ose madje keni vënë në pikëpyetje vetë besimin tuaj te Ati i dashur në Qiell. Lutja ime është që, me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë, të mund të sjellë ca shpresë, paqe dhe kuptueshmëri. Dëshira ime është që të jem një mjet për të bërë të kthehet besimi juaj në Atin tonë të dashur në Qiell, që i di të gjitha gjërat dhe na lejon të provojmë sfida në mënyrë që të arrijmë ta njohim e ta duam Atë dhe të kuptojmë që pa Të nuk kemi asgjë.

Më 4 shkurt 1990, u lind djali ynë i tretë apo fëmija i gjashtë. E quajtëm Tajson. Ai qe një djalë i vogël e i bukur dhe familja e mirëpriti me zemër të hapur e krahë të hapura. Vëllezërit e motrat e tij qenë shumë krenare për të. Ne të gjithë menduam se qe djali i vogël më i përsosur që kishte lindur ndonjëherë.

Kur qe tetë muajsh, Tajsoni kapërdiu një copë shkumës që e kishte gjetur mbi tapet. Shkumësi ngeci në fytyrën e Tajsonit dhe ai ndaloi së marri frymë. Vëllai i tij më i madh e solli Tajsonin sipër, duke thirrur me furi: “Bebja nuk merr frymë, bebja nuk merr frymë”. Ne filluam t'i aplikonim ringjalljen zemër-mushkëri dhe telefonuam 911 [urgjencën].

Personeli i ndihmës së parë erdhi dhe e çuan Tajsonin me ngut në spital. Në dhomën e pritjes ne vijuam me lutje të zjarrta teksa i përgjroheshim Perëndisë për një mrekulli. Pas një periudhe që u duk e gjatë sa një jetë, doktoresha hyri në dhomë dhe tha: “Më vjen shumë keq. Nuk ka asgjë më shumë që mund të bëjmë. Mund të qëndroni këtu aq kohë sa t'ju duket e nevojshme.” Pastaj ajo u largua.

Kur hymë në dhomën ku gjendej i shtrirë Tajsoni, ne pamë topthin tonë të vogël të gëzimit të pajetë. Dukej si të kishte një shkëlqim çelstial përreth trupit të tij të vogël. Ai qe aq rrezatues dhe i dëlirë.

Në atë çast dukej sikur kuptimi i jetës sonë kishte marrë fund. Si mund të ktheheshim te fëmijët e tjerë dhe të përpiqeshim në një farë mënyre t'u shpjegojmë se Tajsoni nuk do të vinte në shtëpi?

Do të flas në njëjës teksa rrëfej pjesën e mbetur të kësaj përvoje. Bashkëshortja ime engjëllore dhe unë e përjetuam bashkë këtë sfidë, por nuk ndihem i aftë që të shpreh ndjenjat e një nëne dhe as nuk do të përpiqesha ta bëja këtë.

Është e pamundur të përshkruaj trazimin e ndjenjave që kisha në atë çast në jetën time. Shumicën e kohës ndihesha sikur isha në një ëndërr të keqe e se do të zgjohesha shpejt dhe ky makth i tmerrshëm do të mbaronte. Nuk fjeta për shumë net. Shpesh natën endesha nga një dhomë te tjetra, duke u siguruar që fëmijët tanë të tjerë ishin të gjithë të sigurt.

Ndjenjat e fajit ma dërrmonin shpirtin. Ndihesha tepër fajtor. Nga kjo ndihesha i papastër. Unë isha babai i tij; duhet të kisha bërë më shumë për ta mbrojtur. Sikur vetëm të kisha bërë diçka. Ndonjëherë edhe sot, 22 vjet më vonë, ato ndjenja fillojnë të hyjnë ngadalë në zemrën time dhe më duhet t'i largoj shpejt pasi mund të jenë shkatërrimtare.

Afro një muaj pasi vdiq Tajsoni, pata një intervistë me Plakun Din L. Larsen. Ai kaloi kohë duke më dëgjuar dhe unë do të jem gjithmonë mirënjohës për këshillën dhe dashurinë e tij. Ai tha: “Nuk mendoj se Zoti dëshiron që ti të dënosh veten për vdekjen e djalit tënd të vogël”. Unë ndieva dashurinë e Atit tim Qielor

përmes një prej mjeteve që kishte zgjedhur Ai.

Gjithsesi, mendimet dërrmuese vazhduan të më pushtonin mendjen, dhe shpejt fillova të ndieja zemërim. “Kjo nuk është e drejtë! Si mundi të ma bënte këtë Perëndia? Përse mua? Çfarë bëra për ta merituar këtë?” Ndihesha madje i zemëruar me njerëzit që thjesht po përpiqeshin të na ngushëllonin. Më kujtohen miqtë duke më thënë: “E di se si ndihesh”. Unë do të mendoja me vete: “Ti nuk ja ke idenë se si ndihem. Vetëm më lini të qetë.” Shpejt zbulova që edhe keqardhja për veten mund të jetë shumë ligështuese. Më vinte turp nga vetja që kisha mendime jo të mira për miqtë e dashur që thjesht po përpiqeshin të ndihmonin.

Teksa ndieva të më gërryenin faji, zemërimi dhe keqardhja për veten, u luta që zemra ime të mund të ndryshonte. Përmes shumë përvojash të shenjta vetjake, Zoti më dha një zemër të re dhe megjithëse ende ndihesha i vetmuar dhe plot dhembje, tërë perspektiva ime ndryshoi. M’u dha njohuria që nuk më kishin vjedhur, por përkundrazi një bekim i madh më priste nëse do të tregoja besnikëri.

Jeta ime filloi të ndryshonte dhe qeshë në gjendje të shihja përpara me shpresë, sesa të shihja prapa me dëshpërim. Dëshmoj se kjo jetë nuk është fundi. Bota e shpitrave është e vërtetë. Mësimet e profetëve në lidhje me jetën pas vdekjes janë të vërteta. Kjo jetë është thjesht një hap i përkohshëm përpara në rrugën e kthimit tonë për te Ati ynë Qiellor.

Tajsoni ka mbetur pjesë shumë e rëndësishme e familjes sonë. Gjatë viteve ka qenë e mrekullueshme të shihje mëshirën dhe mirësinë e një Ati të dashur në Qiell, që i ka lejuar familjes sonë të ndiente në mënyra tepër të dukshme ndikimin e Tajsonit. Dëshmoj se veli është i hollë. Të njëjtat ndjenja



të besnikërisë, dashurisë dhe unitetit familjar nuk mbarojnë kur të dashurit tanë kalojnë nga kjo jetë në anën tjetër; përkundrazi, ato ndjenja rriten.

Ndonjëherë njerëzit do të pyesnin: “Sa kohë t’u desh për ta kaluar?” E vërteta është se asnjëherë nuk do ta kaloni plotësisht derisa të jeni përsëri bashkë me të dashurit tuaj të larguar nga kjo jetë. Unë kurrë nuk do ta kem plotësinë e gëzimit derisa të ribashkohemi mëngjesin e Ringjalljes së Parë.

“Sepse njeriu është shpirt. Elementet janë të përjetshëm dhe shpirti dhe elementet, të lidhur në mënyrë të pandashme, marrin plotësinë të gëzimit.

Dhe kur ndahen, njeriu nuk mund të marrë plotësinë të gëzimit.”³

Por ndërkohë, siç dha mësim Shpëtimtari, ne mund të vazhdojmë të marrim zemër.⁴

Kam mësuar se dhimbja e hidhur dhe pothuaj e papërballueshme mund të bëhet e ëmbël kur i drejtoheni Atit tuaj në Qiell dhe luteni për ngushëllimin e Tij që vjen përmes planit të Tij; Birit të Tij, Jezu Krishtit; dhe Ngushëlluesit të Tij, që është Fryma e Shenjtë.

Çfarë bekimi të lavdishëm përbën kjo në jetën tonë! A nuk do të ishte tragjike nëse nuk do të ndienim pikëllim të madh kur humbasim një fëmijë? Sa mirënjohës i jam Atit tim në Qiell që na lejon të duam thellësisht dhe të duam përjetësisht. Sa mirënjohës jam për familjet e përjetshme. Sa mirënjohës jam që Ai ka zbuluar edhe një herë përmes profetëve të Tij të gjallë planin e lavdishëm të shëlbimit.

Kujtoni, kur morët pjesë në ceremoninë e varrimit të të dashurit tuaj,

ndjenja në zemrën tuaj tek po largoheshit nga varreza dhe u kthyet të shihnit atë arkivol të vetmuar – duke pyetur veten nëse do t’ju pushonte zemra.

Unë dëshmoj se për shkak të Tij, madje Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit, ato ndjenja pikëllimi, vetmie e dëshpërimi një ditë do të përpihen në një plotësi gëzimi. Dëshmoj se mund të mbështetemi tek Ai dhe kur Ai tha:

“Nuk do t’ju lë bonjakë, do të kthehem te ju.

Edhe pak kohë dhe bota nuk do të më shohë më, por ju do të më shihni; sepse unë jetoj, edhe ju do të jetoni.”⁵

Dëshmoj se, siç thuhet tek *Predikoni Ungjillin Tim*: “Kur mbështetemi në Shlyerjen e Jezu Krishtit, Ai mund të na ndihmojë të durojmë sprovat, sëmundjet dhe dhembjet tona. Ne mund të mbushemi me gëzim, paqe dhe ngushëllim. Gjithçka që është e padrejtë në jetë, mund të ndreqet me anë të Shlyerjes së Jezu Krishtit.”⁶

Dëshmoj se në atë mëngjes të shkëlqyer e të lavdishëm të Ringjalljes së Parë, njerëzit e mi dhe tuaj të dashur do të dalin nga varri siç është premtuar nga Vetë Zoti dhe ne do të kemi plotësinë të gëzimit. Për shkak se Ai jeton, ata dhe ne do të jetojmë gjithashtu.

Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Moroni 8:10–12.
2. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2007), f. 184–185.
3. Doktrina e Besëlidhje 93:33–34.
4. Shih Gjoni 16:33.
5. Gjoni 14:18–19.
6. *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar* (2004), f. 52.



Nga Plaku Rasëll M. Nelson,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Pyetni Misionarët! Ata Mund t'Ju Ndhimojnë!

Të gjithë misionarët, më të rinj dhe më të vjetër, shërbejnë me të vetmen shpresë për t'ua bërë jetën më të mirë njerëzve të tjerë.

Vëllezër, motra e miq të mi të dashur, ne shprehim dashurinë dhe përshëndetjet tona për secilin prej jush. Jemi të emocionuar nga njoftimi i Presidentit Tomas S. Monson këtë mëngjes, që e ndryshon moshën minimale për shërbim misionar në 18 vjeç për të rinjtë dhe 19 vjeçe për të rejtat. Me këtë mundësi, edhe më shumë vetë nga rinia jonë mund t'i gëzojnë bekimet e një misioni.

Dy vite më parë, dhe duke e ripo-huar fuqishëm sërish këtë mëngjes, Presidenti Monson ka thënë: “që çdo i ri i denjë dhe i aftë duhet të përgatitet që të shërbejë në mision. Shërbimi misionar është një detyrë priftërie – një detyrim që Zoti e pret prej nesh, të cilëve na është dhënë kaq shumë.”¹ Sërish ai shpjegoi se për motrat e reja, një mision është një mundësi e mirëpritur, por jo një përgjegjësi. Dhe përsëri ai ftoi shumë më tepër çifte në moshë që të shërbejnë.

Përgatitja për një mision është e rëndësishme. Një mision është një gjest vullnetar shërbimi ndaj Perëndisë dhe njerëzimit. Misionarët e përballojnë atë privilegj me kursimet e tyre vetjake. Mund të ndihmojnë edhe prindërit, familjet, miqtë dhe dhurimet për Fondin

e Përgjithshëm të Misionarëve. Të gjithë misionarët, më të rinj dhe më të vjetër, shërbejnë me të vetmen shpresë për t'ua bërë jetën më të mirë njerëzve të tjerë.

Vendimi për të shërbyer në një mision do t'i japë formë fatit shpirtëror të misionarit, bashkëshortes së tij apo bashkëshortit të saj dhe pasardhësve të tyre për brezat që do të vijnë. Dëshira për të shërbyer është një pasojë e natyrshme e kthimit në besim, denjësisë dhe e përgatitjes së dikujt.

Në këtë auditor të gjerë mbarëbotëror, shumë prej jush nuk janë anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme dhe dinë shumë pak për ne dhe për misionarët tanë. Ju jeni këtu ose po dëgjoni për shkak se dëshironi të dini më shumë rreth mormonëve dhe asaj çka japin mësim misionarët tanë. Teksa mësoni më shumë rreth nesh, ju do të zbuloni se kemi shumë vlera të përbashkëta me ju. Ne ju nxisim që të mbani gjithçka që është e mirë dhe e vërtetë dhe më pas të shihni nëse mund të shtojmë më tepër. Në këtë botë të mbushur me sfida, ne kemi vërtet nevojë për ndihmë herë pas here. Feja, e vërteta e përjetshme

dhe misionarët tanë janë pjesë jetike e asaj ndihme.

Misionarët tanë të rinj i shtojnë arsimimin, punësimin, takimet e tyre të dashurisë dhe çfarëdolloj gjëje tjetër që të rinjtë e rritur do të bënin zakonisht në këtë fazë të jetës. Për 18 deri në 24 muaj, ata e lënë gjithçka pezull për shkak të dëshirës së tyre të thellë për t'i shërbyer Zotit.² Dhe disa prej misionarëve tanë shërbejnë në vitet e kulmit të pjekurisë në jetë. E di se familjet e tyre janë të bekuara. Në vetë familjen tonë, tetë persona po shërbejnë tani si misionarë kohëplotë – tri bija, bashkëshortët e tyre, një mbesë dhe një nip.

Disa nga ju mund të pyesin veten rreth emrit *Mormon*. Është një nofkë për ne. Nuk është emri ynë i vërtetë, edhe pse njihemi gjerësisht si mormonë. Termi rrjedh nga një libër me shkrime të shenjta i njohur si Libri i Mormonit.

Emri i vërtetë i Kishës është Kisha e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Është Kisha e hershme e rivendosur e Jezu Krishtit. Gjatë jetës së Tij në vdekshmëri, Ai e organizoi Kishën e Tij. Ai thirri Apostuj, Të Shtatëdhjetë dhe udhëheqës të tjerë, të cilëve u dha autoritetin e priftërisë për të vepruar në emër të Tij.³ Pasi Krishti dhe apostujt e Tij ndërruan jetë, njerëzit i ndryshuan ordinancat dhe doktrinën. Kisha origjinale dhe priftëria humbën. Pas epokës së errët, nën drejtimin e Atit Qiellor, Jezu Krishti e riktheu Kishën e Tij. Tani ajo ekziston përsëri, e rivendosur dhe vepruese nën drejtimin e Tij hyjnor.⁴

Ne e ndjekim Zotin Jezu Krisht dhe japim mësim për Të. Ne dimë se pas ngadhënjimit të Tij të lavdishëm mbi vdekjen, Zoti i ringjallur iu shfaq dishepujve të Tij në shumë raste. Ai hëngri me ta. Ai eci me ta. Përpara Ngjitjes së Tij përfundimtare në qiell, Ai i porositi

ata që të “shkoni[n] . . . dhe [të] bëni[n] dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë”.⁵ Apostujt ia vunë veshin atij udhëzimi. Ata u bënë thirrje edhe të tjerëve që t'i ndihmonin për të përmbushur urdhrin e Zotit.

Sot, nën drejtimin e apostujve dhe profetëve të tanishëm, po e njëjta detyrë u është ngarkuar misionarëve të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Këta misionarë shërbejnë në më shumë se 150 kombe. Si përfaqësues të Zotit Jezu Krisht, ata përpiqen ta përmbushin atë urdhrë hyjnor – të dhënë sërish në kohën tonë nga Vetë Zoti – për ta çuar jashtë vendit plotësinë e ungjillit dhe për të bekuar jetën e njerëzve kudo.⁶

Misionarët në adoleshencën e vonë apo në fillimet e të 20-ave nuk kanë shumë përvojë me botën. Por ata bekohen me dhurata – të tilla si fuqia e Shpirtit të Shenjtë, dashuria e Perëndisë dhe dëshmitë e së vërtetës – që i bëjnë ata lajmëtarë të fuqishëm të Zotit. Ata përhapin lajmin e mirë të ungjillit që do t'u sjellë gëzim të vërtetë dhe lumturi të përhershme të gjithë atyre që ua vënë veshin mesazhit të tyre. Dhe në shumë raste, ata e bëjnë këtë në një vend dhe në një gjuhë të huaj për ta.

Misionarët përpiqen ta ndjekin Jezu Krishtin si me fjalë, ashtu edhe me vepra. Ata predikojnë rreth Jezu Krishtit dhe Shlyerjes së Tij.⁷ Ata japin mësim për rivendosjen e saktë të Kishës së lashtë të Krishtit përmes profetit të parë të ditëve të mëvonshme të Zotit, Jozef Smithit.

Ju mund t'i keni hasur apo madje t'i keni shpërfillur misionarët tanë më parë. Shpresa ime është që ju nuk do t'u druheni, por do të mësoni prej tyre. Ata mund të jenë një burim i dërguar nga qielli për ju.

Kjo u ndodhi Xherrit, një zotërie protestant në mes të të 60-ave të tij, që



Milano, Itali

jeton në Mesa të Arizonës. I ati i Xherrit ishte një shërbëstar baptist; nëna e tij një shërbëstare metodiste. Një ditë, mikja e ngushtë e Xherrit, Prishila i tregoi atij dhembjen që ndiente nga vdekja e fëmijës së saj gjatë lindjes dhe një divorci të hidhur që ndodhi pak pas kësaj. Me mundim si një nënë e vetme, Prishila ka katër fëmijë – tri vajza dhe një djalë. Teksa ia hapi zemrën Xherrit, ajo i rrëfeu se po mendonte të vetëvritej. Me të gjithë forcën dhe dashurinë që mundi të gjente brenda vetes, Xherri e ndihmoi atë të kuptonte se jeta e saj kishte vlerë. Ai e ftoi të frekuentonte kishën e tij, por Prishila i shpjegoi se kishte hequr dorë nga Perëndia.

Xherri nuk dinte ç'të bënte. Më vonë, ndërsa po ujiste pemët në kopshtin e tij, ky njeri me besim iu lut Perëndisë për udhëheqje. Ndërsa lutej, ai dëgjoji një zë në mendje duke i thënë: “Ndaloji djemtë mbi biçikleta”. Xherri, pak i hutuar, vrau mendjen se çfarë kuptimi kishte kjo. Ndërsa mendonte për këtë mbresë, ia nguli sytë rrugës dhe pa dy të rinj me këmbishë të bardha dhe kollare duke i dhënë biçikletës drejt shtëpisë së tij. I shtangur nga kjo “rastësi”, ai i pa tek kalonin me biçikletë. Pastaj, duke e kuptuar se situata e kërkonte që të vepronte, ai bërtiti: “Ej, ju, ndaloni ju lutem! Duhet të flas me ju!”

Me një shikim të pështjelluar por të entuziasmuar, të rinjtë ndaluan. Ndërsa

afroheshin, Xherri vuri re se ata mbanin etiketa emrash që i dallonin ata si misionarë në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Xherri pa drejt tyre dhe u tha: “Kjo mund të tingëllojë pak e çuditshme, por po lutesha dhe m'u tha që t'i 'ndaloja djemtë mbi biçikleta'. Pashë drejt rrugës dhe ja ku jeni. A mund të më ndihmoni?”

Misionarët buzëqeshën, dhe njëri tha: “Po, jam i sigurt se mundemi”.

Xherri u shpjegoi përse ishte i shqetësuar për Prishilën. Shpejt, misionarët u takuan me Prishilën, fëmijët e saj dhe Xherri. Ata diskutuan rreth qëllimit të jetës dhe planit të përjetshëm të Perëndisë për ata. Xherri, Prishila dhe fëmijët e saj u forcuan në besim nëpërmjet lutjes së sinqertë, studimit të Librit të Mormonit prej tyre dhe shoqërimit dashamirës me anëtarët e Kishës. Besimi tashmë i fortë i Xherrit në Jezu Krisht, u bë akoma më i fortë. Dyshimet dhe mendimet e Prishilës për vetëvrasje u kthyen në shpresë e lumturi. Ata u pagëzuan dhe u bënë anëtarë të Kishës së rivendosur të Krishtit.⁸

Po, misionarët mund të ndihmojnë në shumë mënyra. Për shembull, disa prej jush mund të dëshirojnë të dinë më shumë rreth paraardhësve të tyre. Ju mund t'i dini emrat e prindërve dhe të katër gjyshërve tuaj, por po ata të tetë stërgjyshërve? Ai i dini emrat

e tyre? A do të dëshironit të dinit më tepër rreth tyre? Pyetni misionarët! Ata mund t'ju ndihmojnë!⁹ Ata kanë qasje të shpejtë në dokumentet e historisë së gjerë familjare të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Disa prej jush janë anëtarë por nuk janë aktivë aktualisht. Ju e doni Zotin dhe mendoni shpesh për kthimin në vathën e Tij. Por ju nuk dini nga t'ia nisni. Ju rekomandoj që të pyesni misionarët!¹⁰ Ata mund t'ju ndihmojnë! Ata mund t'ju ndihmojnë edhe duke u dhënë mësim njerëzve tuaj të dashur. Ne dhe misionarët ju duam dhe dëshirojmë që ta sjellim gëzimin dhe dritën e ungjillit sërish në jetën tuaj.

Disa prej jush mund të dëshirojnë të dinë si të mposhtin një varësi apo të

jetojnë më gjatë dhe të gëzojnë shëndet më të mirë. Pyetni misionarët! Ata mund t'ju ndihmojnë! Studime të pavarura kanë treguar se, të marrë së bashku, anëtarët e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, janë një grup i shëndetshëm. Shkalla e tyre e vdekshmërisë është mes më të ulëtave dhe jetëgjatësia e tyre është më e madhe se e çdo grupi të përcaktuar qartë, të studiuar për një periudhë të zgjatur kohe të raportuar deri më tani në Shtetet e Bashkuara.¹¹

Disa prej jush mund të ndiejnë se jeta është e ngarkuar dhe e furishme, megjithatë thellë në zemrën tuaj ndieni një boshllëk gërryes, pa drejtim apo qëllim. Pyetni misionarët! Ata mund t'ju ndihmojnë! Ata mund t'ju

ndihmojnë të mësoni më tepër rreth qëllimit të vërtetë të jetës – përse jeni këtu në tokë dhe ku do të shkoni pas vdekjes. Ju mund të mësoni se si do t'ua bekojë jetën ungjilli i rivendosur i Jezu Krishtit përtej gjithçkaje që mund të përfytyroni tani.

Nëse jeni të shqetësuar për familjen tuaj, pyetni misionarët! Ata mund t'ju ndihmojnë! Forcimi i martesave dhe i familjeve ka rëndësinë më të madhe për shenjtorët e ditëve të mëvonshme. Familjet mund të jenë së bashku përgjithmonë. Kërkojuni misionarëve që t'ju mësojnë se si është e mundur kjo për familjen tuaj.

Misionarët mund t'ju ndihmojnë edhe me dëshirën tuaj për njohuri më të madhe. Shpirti njerëzor është i etur për ndriçim. Qoftë nëse e vërteta vjen nga një laborator shkencor apo prej një zbuluese nga Perëndia, ne e kërkojmë atë! Lavdia e Perëndisë është me të vërtetë inteligjencë.¹²

Zgjerimi i të mësuarit përfshin si njohuri shpirtërore ashtu edhe materiale. Ne e theksojmë rëndësinë e të kuptuarit të shkrimeve të shenjta. Një studim i pavarur, zbuloi së fundmi se shenjtorët e ditëve të mëvonshme kishin më tepër njohuri rreth krishtëritimit dhe Biblës.¹³ Nëse dëshironi ta kuptoni më mirë Biblën, ta kuptoni më mirë Librin e Mormonit dhe të fitoni një kuptueshmëri më të zgjeruar për vëllazërinë e njeriut dhe atësinë e Perëndisë, pyetni misionarët! Ata mund t'ju ndihmojnë!

Shumë prej jush kanë një dëshirë të thellë për t'i ndihmuar njerëzit në nevojë. Duke qenë se ndjekim Jezu Krishtin, shenjtorët e ditëve të mëvonshme nxiten nga ajo dëshirë e pafundme.¹⁴ Çdokush mund të bashkohet me ne për të ndihmuar nevojtarët dhe për të siguruar ndihmë për viktimat e fatkeqësive natyrore kudo në botë. Nëse dëshironi të merrni pjesë, pyetni misionarët! Ata mund t'ju ndihmojnë!



Dhe nëse dëshironi të dini më shumë rreth jetës pas vdekjes, rreth parajsës, rreth planit të Perëndisë për ju; nëse dëshironi të dini më shumë rreth Zotit Jezu Krisht, Shlyerjes së Tij dhe Rivendosjes së Kishës së Tij ashtu siç u krijua fillimisht, pyetni misionarët! Ata mund t'ju ndihmojnë!

Unë e di se Perëndia jeton. Jezusi është Krishti. Kisha e Tij është rivendosur. Unë lutem me zjarr që Perëndia të mund të bekojë secilin prej jush dhe secilin prej misionarëve tuaj të çmuar. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Tomas S. Monson, "Ndërsa Prapë Takohemi së Bashku", *Liahona*, nëntor 2010, f. 5–6.
2. Shih Doktrina e Besëlidhje 4:3.
3. Shih Mateu 10:1; Lluka 6:13; 10:1; Efesianëve 4:11–12.
4. Shih Doktrina e Besëlidhje 1:30.
5. Mateu 28:19.
6. Shih Doktrina e Besëlidhje 68:8; 84:62; 112:28.
7. Shih 1 Korintasve 2:2; 2 Nefi 25:26.
8. Komunikatë personale nga W. Trejsi Utson, ish-president i Misionit të Arizonës, Mesa.
9. Atje ku kam shprehur ftesën për t'i "pyetur misionarët", ju mund të pyesni edhe një mik që është anëtar i Kishës për ndihmë.
10. Edhe të afërm, miq dhe udhëheqës të Kishës që marrin pjesë aktivisht do të ishin gjithashtu të lumtur të ndihmonin.
11. Shih James E. Enstrom and Lester Breslow, "Lifestyle and Reduced Mortality among Active California Mormons, 1980–2004", *Preventative Medicine*, volumni 46 (2008), f. 135.
12. Shih Doktrina e Besëlidhje 93:36.
13. Shih *U.S. Religious Knowledge Survey* (Pew Forum on Religion and Public Life, 28 shtator 2010), f. 7.
14. Shih Ram Cnaan, Van Evans, and Daniel W. Curtis, *Called to Serve: The Prosocial Behavior of Active Latter-day Saints* (University of Pennsylvania School of Social Policy and Practice, 2012); "Mormon Volunteerism Highlighted in New Study" (16 mars 2012), <http://www.mormonnewsroom.org/article/mormon-volunteerism-report>; *Mormons in America: Certain in Their Beliefs, Uncertain of Their Place in Society* (Pew Forum on Religion and Public Life, 12 janar 2012), f. 43; Robert D. Putnam and David E. Campbell, *American Grace: How Religion Divides and Unites Us* (2010), f. 444–454.



Nga Presidenti Diter F. Uhtdorf,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Lidhur me Keqardhjet dhe Vendimet

Sa më shumë e përkushtojmë veten në përpjekjen për të arritur shenjtëri dhe lumturi, aq më të pakta janë gjasat që do të jemi në shtegun drejt keqardhjeve.

Lidhur me Keqardhjet

Presidenti Monson, të duam. Fa-leminderit për njoftimin e frymëzuar dhe historik mbi ndërtimin e tempujve të rinj dhe shërbimin misionar. Për shkak të tyre, jam i sigurt se bekime të mëdha do të na vijnë ne dhe shumë brezave të ardhshëm.

Vëllezërit e motrat e mia të dashura, miqtë e mi të dashur! Ne jemi të gjithë të vdekshëm. Shpresoj që kjo nuk i vjen e befasishme kujtdo.

Asnjëri prej nesh nuk do të qëndrojë në tokë shumë gjatë. Ne kemi një numër vitesh të çmuara, që, nga pikëpamja e përgjithshme, pothuaj nuk janë as sa një përpëlitje sysh.

Dhe më pas largohemi nga kjo jetë. Shpirtrat tanë "çohen në shtëpi tek ai Perëndi që [na] dha . . . jetë"¹. Ne shpëputemi nga trupat tanë dhe lëmë pas gjërat e kësaj bote kur shkojmë në mbretërinë tjetër të ekzistencës sonë.

Kur jemi të rinj, duket sikur do të jetojmë përgjithmonë. Mendojmë se ka një numër të pafundëm agimesh duke pritur pikërisht përtej horizontit, dhe e ardhmja na duket si një rrugë e vazhdueshme që shtrihet pambarim përpara nesh.

Megjithatë, sa më shumë që plakemi, aq më shumë priremi të shohim pas dhe të çuditemi se sa e shkurtër është në të vërtetë ajo rrugë. Ne pyesim veten se si vitet mund të kenë kaluar kaq shpejt. Dhe fillojmë të mendojmë për zgjedhjet që ndërmorëm dhe gjërat që kemi bërë. Gjatë [këtij] procesi, ne sjellim ndërmend shumë çaste të ëmbla që u japin ngrohësi shpirtave tanë dhe gëzim zemrave tona. Por kujtojmë edhe keqardhjet – gjërat që do të donim të mund të ktheheshim pas dhe t'i ndryshonim.

Një infermiere, e cila kujdeset për të sëmurët e gradës së fundit, thotë se shpesh u ka bërë një pyetje të thjeshtë pacientëve të saj ndërsa përgatiteshin për t'u larguar nga kjo jetë.

"A keni ndonjë keqardhje?" do të pyeste ajo.²

Të qenit aq pranë asaj dite të fundit të vdekshmërisë shpesh e qartëson mendimin dhe ofron largpamësi e perspektivë. Kështu që, kur këta njerëz pyeteshin për keqardhjet e tyre, ata hapnin zemrat. Ata reflektonin rreth asaj që do të ndryshonin nëse thjesht do të mund të ktheheshin pas në kohë.



Kur mendova ato çka kanë thënë, u habita se si parimet themelore të ungjillit të Jezu Krishtit mund të ndikojnë në drejtimin e jetës sonë për mirë, thjesht nëse do t'i zbatojmë ato.

Nuk ka asgjë të fshehtë rreth parimeve të ungjillit. Ne i kemi studiuar ato në shkrimet e shenjta, i kemi diskutuar në Shkollën e së Dieles dhe, shumë herë, i kemi dëgjuar gjatë mbledhjeve të Kishës. Këto parime dhe vlera hyjnore janë të thjeshta dhe të qarta; janë të bukura, të thella e të fuqishme; dhe pa dyshim mund të na ndihmojnë të shmangim keqardhjet e nesërme.

Do të Doja të Kisha Kaluar më Shumë Kohë me Njerëzit që Dua

Ndoshta keqardhja më e përhapur që shprehën pacientët që po vdisnin, ishte se ata do të donin të kishin kaluar më shumë kohë me njerëzit që duan.

Burrat në veçanti e kënduan këtë këngë vaji universal: ata “u penduan thellësisht që kaluan kaq shumë nga jeta e tyre në gjërat e rutinës [së përditshme] . . . të punës”³. Shumë kishin humbur mundësinë të kishin kujtime të veçanta që rrjedhin nga kalimi i kohës me familjen dhe miqtë. Ata humbën të krijuarën e një lidhjeje të thellë me njerëzit që kishin më shumë rëndësi për ta.

A nuk është e vërtetë që ne shpesh zihemi shumë me punë? Dhe, e trishtueshme për ta thënë, [por] ne madje e quajmë faktin që jemi të zënë simbol nderi, sikur të qenit i zënë, në vetvete, të qe një arritje ose shenjë e një jete të mrekullueshme.

A është kështu?

Mendoj për Zotin tonë dhe Shembullin e përsosur, Jezu Krishtin, dhe jetën e Tij të shkurtër midis njerëzve të Galileës dhe Jerusalemit. Jam përpjekur ta përfytyroj Atë duke u ngutur nga një mbledhje te tjetra ose duke bërë shumë gjëra njëkohësisht për të përmbushur një listë me gjëra të ngutshme.

Nuk mund ta shoh Atë duke bërë këtë gjë.

Përkundrazi, shoh Birin e dhembshur e dashmirës të Perëndisë duke e jetuar çdo ditë me qëllim. Kur Ai bashkëveproi me njerëzit përreth Tij, ata u ndien të rëndësishëm dhe ndien që Ai i donte. Ai e njihnte vlerën e pafundme të njerëzve që takoi. Ai i bekoi dhe iu shërbeu atyre. Ai i lartësoi dhe i shëroi ata. Ai iu dha atyre dhuratën e çmuar, kohën e Tij.

Në kohën tonë, është e lehtë që thjesht të pretendojmë se po kalojmë kohë me të tjerët. Me klikimin e kursorit ne mund “të lidhemi” me mijëra “miq” pa na u dashur ndonjëherë të takohemi personalisht me as edhe njërin prej tyre. Teknologjia mund të jetë gjë e mrekullueshme dhe është shumë e dobishme kur nuk mund të jemi pranë të dashurve tanë. Unë dhe bashkëshortja ime jetojmë larg pjesëtarëve të çmuar të familjes; ne e dimë ç’do të thotë. Megjithatë, besoj se nuk jemi duke përparuar në drejtimin e duhur, si individ dhe si shoqëri, kur lidhemi me familjen apo miqtë kryesisht duke vendosur në internet foto argëtuese, duke u dërguar gjëra të parëndësishme ose duke u kaluar të dashurve tanë faqe interneti. Mendoj se ka vend për këtë lloj veprimtarie, por sa kohë jemi të gatshëm të

kalojmë me të? Nëse nuk arrijmë të japim më të mirën nga vetja dhe kohën kushtuar vetëm ndaj atyre që janë vërtet të rëndësishëm për ne, një ditë do të ndiejmë keqardhje.

Le të vendosim të gëzojmë ata që duam duke kaluar kohë kuptimplote me ta, duke bërë gjëra së bashku dhe duke krijuar kujtime të çmuara.

Do të Doja të Kisha Përmbushur Potencialin Tim

Një tjetër keqardhje që shprehën njerëzit, ishte se ata nuk arritën të bësheshin personi që ata ndien se mund dhe duhej të ishin bërë. Kur menduan për jetën e tyre, ata kuptuan se kurrë nuk e kishin përmbushur potencialin e tyre, se shumë gjëra nuk qenë kryer.

Nuk po flas këtu për ngjitjen e shkallëve të suksesit në profesionet tona të ndryshme. Ajo shkallë, pavarësisht se sa e lartë mund të duket në këtë jetë, mezi arrin një shkallë të vetme në udhëtimin e madh e të përjetshëm që na pret.

Përkundrazi, po flas për t’u bërë personi që Perëndia, Ati ynë Qiellor, synoi që ne të jemi.

Ne vijmë në këtë botë, siç tha poeti: “Si re të varura lavdie”⁴ nga jeta paratokësore.

Ati ynë Qiellor e sheh potencialin tonë të vërtetë. Ai di rreth nesh gjëra që as vetë nuk i dimë. Ai na nxit gjatë jetës sonë që të plotësojmë qëllimin e krijimit tonë, që të bëjmë një jetë të drejtë dhe të rikthehemi në praninë e Tij.

Përse, atëherë, u kushtojmë kaq shumë nga koha dhe energjia jonë gjërave që janë kaq të përkohshme, kaq të paqëndrueshme dhe kaq sipërfaqësore? A kundërshtojmë të shohim marrëzinë te ndjekja e të parëndësishmes dhe të përkohshmes?

A nuk do të ishte më urtësi nga ana jonë të “mblidhni[m] për vete thesare

në qiell, ku as tenja as ndryshku nuk prishin dhe ku vjedhësit nuk shpërthejnë dhe nuk vjedhin”⁵?

Si e bëjmë ne këtë? Duke ndjekur shembullin e Shpëtimtarit, duke përfshirë mësimet e Tij në jetën tonë të përditshme dhe duke dashur me të vërtetë Perëndinë dhe bashkënjerezit tanë.

Pa dyshim që nuk mund ta bëjmë këtë nëse i qasemi dishepullimit me zvarritje të këmbëve, duke parë orën ngultas, duke u ankuar kur veprimet ndërta i afrohem dishepullimit.

Kur bëhet fjalë për të jetuarin e ungjillit, ne nuk duhet të jemi si djali që futi gishtin e këmbës në ujë dhe më pas pretendoi se notoi. Si bij dhe bija të Atit tonë Qiellor, ne jemi të aftë për akoma më tepër. Për këtë, qëllimet e mira nuk mjaftojnë. Ne duhet të *veprojmë*. Akoma më e rëndësishme, ne duhet të *bëhemi* personi që Ati Qiellor dëshiron që ne të jemi.

Shpallja e dëshmisë sonë për ungjillin është gjë e mirë, por të qenit një shembull i gjallë i ungjillit të rivendosur është gjë më e mirë. Të dëshirojmë që të jemi më besnikë ndaj besëlidhjeve tona është gjë e mirë; faktikisht të qenit besnik ndaj besëlidhjeve të shenjta – duke përfshirë të jetuarin e një jete të virtutshme, pagimin e të dhjetave e ofertave tona, mbajtjen e Fjalës së Urtësisë dhe shërbimin ndaj atyre në nevojë – është gjë shumë më e mirë. Bëra të ditur se ne do t'i kushtojmë më shumë kohë lutjes familjare, studimit të shkrimeve të shenjta dhe veprimtarive të dobishme familjare është gjë e mirë; por faktikisht bëra e të gjitha këtyre gjërave me vendosmëri do të sjellë bekimet e qiellit në jetën tonë.

Dishepullimi është përpjekja për të arritur shenjtëri dhe lumturi. Është shtegu drejt vetes sonë më të mirë e më të lumtur.

Le të vendosim të ndjekim Shpëtimtarin dhe të punojmë me zell për t'u bërë personi që jemi paracaktuar për t'u bërë. Le t'i dëgjojmë dhe t'u bindemi nxitjeve të Shpirtit të Shenjtë. Ndërsa e bëjmë këtë, Ati Qiellor do të na zbulojë gjëra që kurrë nuk i dinim për veten tonë. Ai do ta ndriçojë shtegun para nesh dhe do të na hapë sytë për të parë talentet tona të panjohura dhe ndoshta të papërfytyruara.

Sa më shumë e përkushtojmë veten në përpjekjen për të arritur shenjtëri dhe lumturi, aq më të pakta janë gjasat që do të jemi në shtegun drejt keqardhjeve. Sa më shumë mbështetemi te hiri i Shpëtimtarit, aq më shumë do të ndiejmë se jemi në shtegun që Ati ynë në Qiell synoi për ne.

Do të Doja ta Kisha Lejuar Vetën të Ishin më i Lumtur

Keqardhja tjetër e atyre që e dinin se po vdisnin, mund të jetë disi e habitshme. Ata do të dëshironin ta kishin lejuar veten të ishin më të lumtur.

Shumë shpesh jepemi pas iluzionit se ka diçka pak përtej mundësive tona që do të na sjellë lumturi: një situatë më e mirë familjare, një situatë më e mirë financiare ose fundi i një sprove sfiduese.

Sa më shumë plakemi, aq më shumë shohim pas dhe kuptojmë se rrethanat e jashtme në të vërtetë nuk kanë rëndësi ose nuk përcaktojnë lumturinë tonë.

Ne vërtet kemi rëndësi. *Ne* e përcaktojmë lumturinë tonë.

Unë dhe ju përfundimisht jemi përgjegjës për vetë lumturinë tonë.

Bashkëshortja ime, Herieta, dhe unë pëlqejmë të ngasim biçikletën. Është e mrekullueshme të dalësh dhe të shijosh bukuritë e natyrës. Kemi disa rrugë ku pëlqejmë ta ngasim biçikletën, por nuk i kushtojmë shumë vëmendje se sa larg shkojmë apo sa

shpejt ecim krahasuar me çiklistët e tjerë.

Megjithatë, herë pas here mendoj se duhet të jemi pak më konkurrues. Madje, mendoj se ne mund të arrinim në një kohë më të shkurtër ose mund të ngisnim me shpejtësi më të lartë sikur vetëm ta shtynim veten pak më shumë. Dhe më pas ndonjëherë bëj edhe gabimin e madh duke ia përmendur këtë ide bashkëshortes sime të mrekullueshme.

Reagimi i saj tipik ndaj sugjerimeve të mia të këtij lloji është gjithmonë shumë i dashur, shumë i qartë dhe shumë i hapur. Ajo buzëqesh dhe thotë: “Diter, nuk është garë; është udhëtim. Shijojë çastin.”

Sa të drejtë që ka!

Nganjëherë në jetë, ne bëhemi kaq të fiksuar pas vijës fundore sa që nuk arrijmë të gjejmë gëzim gjatë udhëtimit. Unë nuk shkoj të ngas biçikletën me gruan time sepse jam i emocionuar për përfundimin. Shkoj sepse përvoja e të qenit me të është e ëmbël dhe e gëzueshme.

A nuk duket qesharake të prishësh përvoja të ëmbla e të gëzueshme për shkak se po presim vazhdimisht çastin kur ato do të përfundojnë?

A e dëgjojmë muzikën e bukur duke pritur të zbehet nota përfundimtare përpara se t'ia lejojmë vetes ta shijojë atë vërtet? Jo. Ne e dëgjojmë dhe bashkohemi me variacionet e melodisë, ritmit dhe harmonisë gjatë gjithë kompozimit.

A i themi lutjet duke pasur vetëm “amen” ose fundin në mendje? Natyrisht që jo. Ne lutemi me qëllim që të jemi pranë Atit tonë Qiellor, për të marrë Shpirtin e Tij dhe për të ndier dashurinë e Tij.

Ne nuk duhet të presim që të jemi të lumtur derisa të arrijmë disa qëllime të ardhshme, veçse për të zbuluar se lumturia tashmë që e arritshme



– gjithë kohën! Jeta nuk është e thënë të vlerësohet vetëm në retrospektivë. “Kjo është dita që Zoti ka bërë . . .”, shkroi psalmisti. “Gëzoh[uni] dhe . . . ngazëll[ehuni] në të.”⁶

Vëllezër dhe motra, pavarësisht rrethanave tona, pavarësisht sfidave apo sprovave tona, ka diçka në çdo ditë për t’u gëzuar plotësisht dhe pëlqyer shumë. Ka diçka në çdo ditë që mund të sjellë mirënjohje dhe gëzim sikur vetëm ta shohim dhe vlerësojmë atë.

Ndoshta ne duhet të shohim më pak me sy dhe më shumë me zemër. Më pëlqen citati: “Njeriu sheh siç duhet vetëm me zemër. Çdo gjë thelbësore është e padukshme për sytë.”⁷

Ne jemi urdhëruar që “të [japim] falënderime në të gjitha gjërat”⁸. Ndaj, a nuk është më mirë të shohim me sy dhe zemër edhe gjërat e vogla për të cilat *mund* të jemi mirënjohës, në vend të theksimit të negatives në gjendjen tonë të tanishme?

Zoti ka premtuar: “Ai që i pranon të gjitha gjërat me falënderim, do të bëhet i lavdishëm; dhe gjërat e kësaj toke do t’i shtohen atij, madje njëqindfish”⁹.

Vëllezër dhe motra, me bekimet e bollshme të Atit tonë Qiellor, planin e Tij bujar të shpëtimit, të vërtetat qiellore të ungjillit të rivendosur dhe bukuritë e shumta të këtij udhëtimit në vdekshmëri “a nuk kemi shkak të gëzohemi”¹⁰?

Le të vendosim që të jemi të lumtur, pavarësisht rrethanave tona.

Lidhur me Vendimet

Një ditë ne do të ndërmarrim atë hap të pashmangshëm dhe do të

kalojmë nga kjo jetë në vdekshmëri në gjendjen tjetër. Një ditë do të mendojmë për jetën tonë dhe do të pyesim veten nëse mund të kishim qenë më të mirë, të kishim marrë vendime më të mira apo ta kishim përdorur kohën tonë me më shumë mençuri.

Për të shmangur disa prej keqardhjeve më të thella të jetës, do të ishte urtësi të merrnim disa vendime sot. Prandaj, le:

- Të vendosim të kalojmë më shumë kohë me ata që duam.
- Të vendosim të përpiqemi më me zell për t’u bërë personi që Perëndia dëshiron që të jemi.
- Të vendosim të gjejmë lumturi, pavarësisht rrethanave tona.

Kam dëshmi se shumë nga keqardhjet tona më serioze të së nesërme mund të parandalohen duke ndjekur Shpëtimtarin sot. Nëse kemi mëkatuar apo kemi bërë gabime – nëse kemi bërë zgjedhje për të cilat tani ndiejmë keqardhje – ne kemi dhuratën e çmuar të Shlyerjes së Krishtit, përmes së cilës mund të falemi. Ne mund të mos kthehemi prapa në kohë e të ndryshojmë të kaluarën, por mund të pendo kemi. Shpëtimtari mund t’i thajë lotët tanë të keqardhjes¹¹ dhe të heqë barrën e mëkateve tona¹². Shlyerja e Tij na lejon ta lëmë pas të kaluarën dhe të ecim përpara me duar të pafajshme dhe zemër të pastër¹³, dhe me vendosmërinë për të vepruar më mirë dhe veçanërisht për t’u bërë më të mirë.

Po, kjo jetë po kalon shpejt; ditët tona duken të veniten shpejt; dhe vdekja duket e frikshme ndonjëherë. Prapëseprapë, shpirti ynë do të vazhdojë të jetojë dhe një ditë do të bashkohet me trupin tonë të ringjallur, për të marrë lavdinë e pavdekshme. Unë jap dëshminë solemne se për shkak të Krishtit të mëshirshëm, ne të gjithë do të jetojmë sërish dhe përgjithmonë. Për shkak të Shpëtimtarit dhe Shëlbuesit tonë, një ditë do ta kuptojmë me të vërtetë dhe do të gëzohemi vërtet në kuptimin e fjalëve “thumbi i vdekjes është gëlltitur në Krishtin”¹⁴.

Shtegu drejt përmbyshjes së fatit tonë hyjnor si bij dhe bija të Perëndisë është i përjetshëm. Vëllezër dhe motra të mia të dashura, miq të dashur, ne duhet të fillojmë të ecim në atë shteg të përjetshëm sot; ne nuk mund të humbasim asnjë ditë të vetme. Lutem që nuk do të presim derisa të jemi gati të vdesim përpara se të mësojmë me të vërtetë të jetojmë. Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Alma 40:11.
2. Shih Susie Steiner, “Top Five Regrets of the Dying”, *Guardian*, 1 shkurt 2012, www.guardian.co.uk/lifeandstyle/2012/feb/01/top-five-regrets-of-the-dying.
3. Bronnie Ware, në Steiner, “Top Five Regrets of the Dying”.
4. “Ode: Intimations of Immortality from Recollections of Early Childhood”, *The Complete Poetical Works of William Wordsworth* (1924), f. 359.
5. Mateu 6:20.
6. Psalmeve 118:24.
7. Antoine de Saint-Exupéry, *The Little Prince [Princi i Vogël]*, përkth. Richard Howard (2000), f. 63.
8. Mosia 26:39; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 59:7.
9. Doktrina e Besëlidhje 78:19.
10. Alma 26:35.
11. Shih Zbulesa 7:17.
12. Shih Mateu 11:28–30.
13. Shih Psalmeve 24:4.
14. Mosia 16:8; shih edhe 1 Korintasve 15:54.



Paraqitur nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

Mbështetja e Drejtuesve të Kishës

Propozohet që ne të mbështesim Tomas Spenser Monson, si profet, shikues dhe zbulues, si dhe si President të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme; Henri Benion Ajring, si Këshilltar të Parë në Presidencën e Parë; dhe Diter Fridrih Uhtdorf, si Këshilltar të Dytë në Presidencën e Parë.

Ata që janë dakord, mund ta tregojnë atë.

Ata që janë kundër, nëse ka, mund ta tregojnë atë.

Propozohet që ne të mbështesim Bojd Kenet Paker, si President të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe ata që vijojnë si anëtarë të atij kuorumi: Bojd K. Paker, L. Tom Peri, Rasëll M. Nelson, Dallin H. Ouks, M. Rasëll Ballard, Riçard G. Skot, Robert D. Hejls, Xhefri R. Holland, Dejvid A. Bednar, Kuentin L. Kuk, D. Tod Kristoferson dhe Nil L. Andersen.

Ata që janë dakord, lutemi ta tregojnë atë.

Ndonjë kundër mund ta tregojë në të njëjtën mënyrë.

Propozohet që ne të mbështesim këshilltarët në Presidencën e Parë dhe Dymbëdhjetë Apostujt si profetë, shikues e zbulues.

Të gjithë që janë dakord, ju lutem tregojeni atë.

Kundër, në qoftë se ka, me të njëjtën shenjë.

Plaku Xhei E. Xhensen është liruar nga thirrja si anëtar i Presidencës së Kuorumeve të Të Shtatëdhjetëve.

Ata që mund të bashkohen me ne në një votim vlerësimi, lutemi ta tregojnë atë.

Propozohet që ne të mbështesim Plakun Krejg C. Kristensen si anëtar të Presidencës së Kuorumeve të Të Shtatëdhjetëve.

Të gjithë që janë dakord, ju lutem tregojeni atë.

Ata që janë kundër, nëse ka.

Propozohet që të lirojmë nga thirrja, me një votim vlerësimi për shërbimin e tij të shkëlqyer, Plakun Marlin K. Xhensen si Historian dhe Dokumentues i Kishës.

Të gjithë që janë dakord, ju lutem tregojeni atë.

Propozohet që të mbështesim Plakun Stiven E. Snou si Historian dhe Dokumentues i Kishës.

Të gjithë që janë dakord, ju lutem tregojeni atë.

Ndonjë kundër.

Propozohet që të lirojmë nga thirrjet Pleqtë Keith K. Hilbig, Xhei E. Xhensen, Marlin K. Xhensen dhe Oktaviano Tenorio, si anëtarë të Kuorumit të Parë të Të Shtatëdhjetëve dhe t'i caktojmë ata si Autoritete të Përgjithshme nderi.

Propozohet gjithashtu që të lirojmë nga thirrjet Pleqtë Keith R. Eduards dhe Leri W. Gibons si anëtarë të Kuorumit të Dytë të Të Shtatëdhjetëve.

Ata që dëshirojnë të bashkohen me ne për t'u shprehur mirënjohje këtyre Vëllezërve për shërbimin e tyre të shkëlqyer, ju lutem ta tregojnë atë.

Propozohet që ne të mbështesim Autoritetet e tjera të Përgjithshme, Të Shtatëdhjetët Zonalë dhe presidencat e përgjithshme të organizatave ndihmëse me përbërjen e tyre të tanishme.

Ata që janë dakord, lutemi ta tregojnë atë.

Ndonjë kundër mund ta tregojë.

Faleminderit, vëllezër dhe motra, për votimin tuaj mbështetës, besimin, përkushtimin dhe lutjet tuaja. ■





Nga Plaku L. Tom Peri,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Të Bëhemi Prindër të Mirë

Ka shumë mënyra se si prindërit e mirë mund të marrin ndihmën dhe mbështetjen për të cilën kanë nevojë, për t'u mësuar ungjillin e Jezu Krishtit fëmijëve të tyre.

Këtë verë, arrita një ngjarje me rëndësi të veçantë – festova 90-vjetorin e ditëlindjes time. Kur arrin etapa të caktuara në jetën tënde, është e dobishme dhe edukative të reflektosh mbi ngjarjet dhe përvojat e së kaluarës. Ju të rinjve që po dëgjoni ose lexoni këtë bisedë, mund të mos ju bëjnë shumë përshtypje 90 vite jetë, por kur u linda unë, të jetoje kaq gjatë konsiderohej një arritje e madhe. Çdo ditë, i jam mirënjohës Atit Qiellor që më ka bekuar me një jetë të gjatë.

Kaq shumë gjëra kanë ndryshuar gjatë jetës sime. Kam parë zhvillimin e periudhës industriale dhe asaj të informacionit. Automobilat e prodhuar në masë, telefoni dhe aeroplani, ishin risitë e mëdha të kohës kur unë isha i vogël. Sot, mënyra se si ne e gjejmë, e ndajmë dhe e përdorim informacionin, ndryshon pothuajse përditë. Në moshën time, mrekullohem me ndryshimin kaq të shpejtë të botës, në të cilën ne të gjithë jetojmë. Shumë nga zbulimet e mëdha të së sotmes zgjojnë kureshtjen me potencialin e tyre për të përmirësuar jetën tonë.

Përmes gjithë ndryshimit të shpejtë që ndodh në botë, ne lutemi dhe

punojmë me zell për të garantuar që vlerat e ungjillit të Jezu Krishtit të rezistojnë. Tashmë disa prej tyre janë në rrezik të humbasin. Në krye të listës së këtyre vlerave dhe, si rrjedhim, objektivat kryesorë të kundërshtarit, janë shenjtëria e martesës dhe rëndësia qendrore e familjes. Ato sigurojnë një shtëpi ku ka qëndrueshmëri dhe siguri, ku çdo fëmijë i një Ati të dashur Qiellor mund të ndikohet për mirë dhe të mësojë vlera të tjera të përjetshme.

Vetë familja ime, duke pritur festimin e kësaj etape 90-vjeçare në jetën time, filloi të më ndihmonte që të kujtoja dhe të vlerësoja përvojat e jetës sime të gjatë. Për shembull, mbesa ime mblodhi dhe ndau me mua disa letra që u kisha shkruar prindërve të mi pothuaj 70 vjet më parë nga baza ime ushtarake e marinsave në ishullin e Saipanit në Paqësor gjatë Luftës së II-të Botërore.

Njëra prej këtyre letrave e tërhoqi vëmendjen time në mënyrë të veçantë. Ishte një letër që ia shkrova nënës sime, me qëllim që ta hapte dhe ta lexonte për Festën e Nënës, në vitin 1945. Do të doja të ndaja me ju disa

pjesë, me shpresën që ju të shihni përsëri unë do t'u jem gjithmonë mirënjohës babait dhe nënës sime të dashur, për mësimet që mora nga mësimdhënia e tyre në shtëpi. Prindërit e mi janë shembulli më i mirë që unë kam për prindërit e mirë, të cilët e vunë martesën e tyre dhe rritjen e fëmijëve në mënyrën e duhur, si përparësinë e tyre më të lartë.

Letra ime e 1945-ës për Festën e Nënës fillonte:

“E dashur nënë,

Gjatë katër viteve të fundit kam pasur fatin e keq ta kaloj Festën e Nënës larg teje. Çdo vit kam dashur të isha me ty dhe të të thosha sesa të dua e sa shumë mendoj për ty, por meqë është sërish e pamundur, do të më duhet të bëj gjënë më të mirë që vjen pas kësaj, dhe të të dërgoj mendimet e mia nëpërmjet postës.

Në këtë vit më shumë se në çdo vit tjetër, mund të shoh se çfarë ka bërë për mua të paturit e një nëne të mrekullueshme. Pikë së pari, më ka marrë malli për gjërat e vogla që bëje për mua. Sa herë që ngrihesha nga krevati në mëngjes, nuk kisha pse të shqetësohesha kurrë nëse do gjeja këmbë dhe çorape të pastra. Gjithçka që duhej të bëja, ishte të hapja sirtarin dhe i gjeja. Gjatë vaktit të drekës, gjithmonë e dija se do të gjeja diçka që më pëlqente, të përgatitur në mënyrën më të mirë të mundshme. Natën, gjithmonë e dija se do të gjeja çarçafë të pastër në krevatin tim dhe tamam aq mbulesa sa duheshin për të qenë shumë rehat. Jetesa në shtëpi ishte me të vërtetë një kënaqësi e madhe”.

Kur i lexova këto dy paragrafë të parë të letrës, u trondita nga ajo se sa mallëngjyes tingëllonin. Ndoshta jeta në një çadër dhe fjetja nën një rrjetë mushkonjash në një shtrat kampi, i zhvendosi mendimet e mia në shtëpinë time tepër të veçantë.



Letra dërguar nënës sime vazhdonte:

“Por ndjenja për ty është më e thellë për shkak të shembullit që më ke dhënë. Jeta ishte kaq e gëzueshme për ne si familje sa që ne donim të ecnim në gjurmët e tua, të përjetonim të njëjtin gëzim që kishim kur ishim të vegjël. Ti gjithmonë gjeje kohën ta çoje familjen tonë te kanioni dhe ne mbështeteshim tek ty për të bërë çdo gjë, duke filluar nga ngjitja në mal deri tek të luajturit me top. Ti dhe Babi kurrë nuk shkonit vetëm për pushime. Familja ishte gjithmonë me ju. Tani që jam larg shtëpisë, më pëlqen të flas gjithmonë rreth jetës në shtëpinë time sepse ishte kaq e gëzueshme. Nuk mund t’i shpërfill mësimet tuaja tani sepse veprimet e mia do të pasqyrojnë karakterin tuaj. Jeta është shumë sfiduese për mua që të jem i denjë të thirrem i biri i Nora Soni Perit. Jam shumë krenar për këtë titull dhe shpresoj që gjithmonë do të jem i denjë për të.

Shpresoj që viti tjetër të më gjejë me ty, për të të treguar kohën e bukur që dua të kaloj me ty në Festën e Nënës, të cilën e kam planifikuar gjatë katër viteve të kaluara.

Zoti të bekoftë për të gjitha gjërat e mrekullueshme që ti ke bërë për këtë botë të trazuar.

Me gjithë dashurinë time, Tomi”¹

Kur e rilexova letrën time, mendova gjithashtu edhe për kulturën e familjes, lagjes, kunit dhe komunitetit në të cilin u rrita.

Kultura përkufizohet si mënyra e jetesës së një populli. Ka një kulturë unike ungjilli, një grup vlerash dhe pritshmëriash dhe praktikash të përbashkëta për të gjithë anëtarët e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Kjo kulturë e ungjillit ose mënyrë jetese, vjen nga plani i shpëtimit, urdhërimet e Perëndisë dhe mësimet e profetëve të gjallë. Është një demonstrim i mënyrës se si i rrisim familjet tona dhe se si e jetojmë jetën tonë individuale.

Udhëzimi i parë dhënë Adamit për përgjegjësinë e tij në vdekshmëri gjendet te Zanafilla 2:24: “Për këtë arsye njeriu do të braktisë babanë dhe nënën e tij dhe do të bashkohet me gruan e tij, dhe do të jenë një mish i vetëm”.

Bashkimi i një burri dhe një gruaje për të qenë legalisht dhe ligjrisht të martuar, nuk është vetëm një përgatitje për brezat e ardhshëm që të trashëgojnë tokën, por gjithashtu sjell gëzimin dhe kënaqësinë më të madhe që mund të gjendet në këtë përvojë të vdekshme. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur fuqitë e priftërisë e shpallin

një martesë të jetë për kohën dhe për gjithë përjetësinë. Fëmijët e lindur në martesë të tilla kanë një siguri që nuk gjendet askund tjetër.

Mësimet që jepen në shtëpi nga prindër të mirë, po bëhen akoma dhe më të rëndësishme në botën e sotme, ku ndikimi i kundërshtarit është kaq i përhapur. Siç e dimë, ai po përpiket të gërryëjë dhe shkatërrojë vetë themelin e shoqërisë sonë – familjen. Në mënyrë mjeshtërore dhe të maskuara me kujdes, ai po godet zotimin ndaj jetës familjare kudo në botë dhe po minon kulturën dhe besëlidhjet e shenjtorëve besnikë të ditëve të mëvonshme. Prindërit duhet ta ndajnë mendjen që mësimdhënia në shtëpi është përgjegjësia më e shenjtë dhe më e rëndësishmja. Ndërsa institucione të tjera, të tilla si kisha dhe shkolla, mund t’i ndihmojnë prindërit t’i “[mësojnë] fëmijës rrugën që duhet të ndjekë” (Fjalët e Urta 22:6), përfundimisht, kjo përgjegjësi u bie prindërve. Sipas planit të madh të lumturisë, prindërve të mirë u është besuar kujdesi dhe zhvillimi i fëmijëve të Atit tonë Qiellor.

Në kujdestarinë tonë të jashtëzakonshme prindërore, ka shumë mënyra se si prindërit e mirë mund të marrin ndihmën dhe mbështetjen për të cilën kanë nevojë, për t’u mësuar ungjillin e Jezu Krishtit fëmijëve të

tyre. Më lejoni t'ju sugjeroj pesë gjëra që prindërit mund të bëjnë për të krijuar kultura më të forta familjare:

Së pari, prindërit mund të lutën me zell, duke i kërkuar Atit të Përfjetshëm t'i ndihmojë ata që t'i duan, t'i kuptojnë dhe t'i udhëheqin fëmijët që Ai u ka dërguar atyre.


Së dyti, ata mund të bëjnë lutje familjare, studim të shkrimeve të shenjta e mbrëmje familjare dhe të hanë së bashku sa më shpesh të jetë e mundur, duke e kthyer darkën në një kohë komunikimi dhe mësimdhënieje të vlerave.

Së treti, prindërit mund të përfitojnë plotësisht nga rrjeti mbështetës i Kishës, duke komunikuar me mësuesit e Fillores të fëmijëve të tyre, udhëheqësit e rinisë dhe presidencat e klasave dhe kuorumeve. Duke komunikuar me ata që janë thirrur dhe veçuar që të punojnë me fëmijët e tyre, prindërit mund të sigurojnë një kuptueshmëri thelbësore të nevojave të veçanta dhe specifike të një fëmije.

Së katërti, prindërit mund të ndajnë shpesh dëshmitë e tyre me fëmijët, t'i zotojnë ata për të mbajtur urdhërimet e Perëndisë dhe t'u premtojnë bekimet që Ati ynë Qiellor u premtim fëmijëve të Tij besnikë.

Së pesti, ne mund t'i organizojmë familjet tona bazuar në rregulla dhe pritshmëri familjare të qarta e të thjeshta, tradita dhe zakone familjare të shëndetshme dhe "ekonomi familjare", ku fëmijët kanë përgjegjësi për punët shtëpiake dhe mund të fitojnë një shumë parash, kështu që ata të mund të mësojnë të kenë një buxhet, të kursejnë dhe të paguajnë të dhjetën për paratë që fitojnë.

Këto sugjerime për të krijuar *kultura më të forta familjare* funksionojnë në harmoni me kulturën e Kishës. Kulturat tona familjare të forcuara, do të jenë një mbrojtje për fëmijët tanë nga "shigjetat



e flakta të kundërshtarit" (1 Nefi 15:24) të ngulitura në kulturën e moshatarëve të tyre, në kulturën e argëtimit dhe popullaritetit, kulturën e nderimit të vetes dhe të dhënies së drejtë vetes, si dhe kulturën e internetit dhe të mediave ndaj të cilave ata janë vazhdimisht të ekspozuar. Kulturat e forta familjare do t'i ndihmojnë fëmijët tanë të jetojnë në botë dhe të mos bëhen të "bot[ës]" (Gjoni 15:19).

Presidenti Jozef Fielding Smith mësoi: "Është detyra e prindërve t'u mësojnë fëmijëve të tyre këto parime shpëtuese të ungjillit të Jezu Krishtit, kështu që ata do ta dinë përse duhet të pagëzohen dhe që të mund të kenë dëshirë në zemrat e tyre që të vazhdojnë të mbajnë urdhërimet e Perëndisë pasi të pagëzohen, që ata të mund të kthehen në praninë e Tij. Vëllezërit e motrat e mia, a i doni familjet tuaja, fëmijët tuaj, a dëshironi të vuloseni me etërit tuaj dhe nënat tuaja para jush . . .? Nëse është kështu, atëherë duhet të filloni t'i mësoni që në djep. Duhet t'i mësoni me anë të shembullit si dhe të këshillës."²

Proklamata mbi familjen thotë: "Bashkëshorti dhe bashkëshortja kanë një përgjegjësi solemne të duan dhe të kujdesen për njëri-tjetrin dhe për fëmijët e tyre. 'Bijtë janë një trashëgimi që vjen nga Zoti' (Psalmi 127:3). Prindërit kanë një detyrë të shenjta për të rritur fëmijët e tyre me dashuri dhe drejtësi, për të plotësuar nevojat e tyre fizike dhe shpirtërore dhe për

t'i mësuar ata ta duan e t'i shërbejnë njëri-tjetrit, të zbatojnë urdhërimet e Perëndisë dhe të jenë qytetarë që u binden ligjeve kudo që jetojnë. . . .

. . . Nëpërmjet planit hyjnor, etërit duhet të kryesojnë familjet e tyre me dashuri e drejtësi dhe janë përgjegjës për të siguruar gjërat e nevojshme për jetën dhe mbrojtjen për familjet e tyre. Nënat janë kryesisht përgjegjëse për edukimin e fëmijëve të tyre. Në këto përgjegjësi të shenjta, etërit dhe nënat kanë detyrim të ndihmojnë njëri-tjetrin si partnerë të barabartë."³

Unë besoj se është sipas qëllimit hyjnor që roli i mëmësisë thekson edukimin dhe mësimin e brezit pasues. Por është e mrekullueshme të shohësh bashkëshortë dhe bashkëshorte që kanë krijuar partneritete të vërteta ku ata përziejnë së bashku ndikimin e tyre dhe komunikojnë në mënyrë efikase si për fëmijët e tyre ashtu edhe me fëmijët e tyre.

Sulmi i furishëm i ligësisë kundër fëmijëve tanë është më i mprehtë dhe më i pacipë se sa ka qenë ndonjëherë. Ndërtimi i një kulture familjare më të fortë shton një shtresë tjetër mbrojtëse për fëmijët tanë, duke i veçuar ata nga ndikimet e botës.

Perëndia ju bekoftë ju nëna dhe etër të mirë në Sion. Ai ka lënë nën kujdesin tuaj fëmijët e Tij të përjetshëm. Si prindër ne bëhemi partnerë, madje bashkohemi me Perëndinë, që të bëjmë të ndodhë vepra dhe lavdia e Tij mes fëmijëve të Tij. Është detyra jonë e shenjta të bëjmë më të mirën tonë. Për këtë unë dëshmoj, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Letra e Festës së Nënës nga L. Tom Perry drejtuar së ëmës, dërguar nga Saipani, datë 3 maj 1945.
2. Joseph Fielding Smith, në Conference Report, tetor 1948, f. 153.
3. "Familja: Një Proklamata Drejtuar Botës", *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.



Nga Plaku M. Rasëll Ballard,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Përfshihuni me Zell

Gjëra të mëdha ndodhin dhe barrat lehtësohen nga përpjekjet e shumë duarve "të përfshira" me zell në një kauzë të mirë".

Plaku Peri, mendoj se duhet të jesh 90-vjeçari më i ri në të gjithë Kishën. E vutë re se si kërceu nga karrigia e tij.

Vëllezërit e motrat e mia të dashura, sa herë shijoj një domate të freskët e të pjekur mirë ose ha një pjeshkë të lëngshme të sapokëputur nga pema, mendja më shkon para 60 vjetësh kur babai im kishte në pronësi një pemëtoare të vogël pjeshkësh në Hollëdei të Jutas. Atje ai mbante koshere që të pjalmonin lulet e pjeshkëve të cilat, si përfundim, do të bëheshin pjeshkë shumë të mëdha e të shijshme.

Babai i pëlqente bletët e tij të dashura dhe mrekullohej me mënyrën se si mijëra prej tyre, duke punuar së bashku, e shndërronin nektarin e mbledhur nga lulet e tij të pjeshkës në mjaltë të ëmbël e të artë – një prej ushqimeve më të dobishme të natyrës. Në fakt, dietologët na thonë se është një nga ushqimet që i përfshin të gjitha substancat – enzimat, vitaminat, mineralet dhe ujin – të nevojshme për të siguruar jetën.

Babai im gjithmonë përpiquej të më përfshinte në punën e vet me kosheret e tij, por isha shumë i lumtur ta lija atë që të kujdesej për bletët e tij. Gjithsesi, që prej atyre ditëve, kam mësuar më shumë rreth kosheres së organizuar

mjaft mirë – një koloni prej 60.000 bletësh.

Bletët kanë nxitjen e fortë që të pjalmojnë, të mbledhin nektar e ta kondensojnë nektarin në mjaltë. Është zakoni i tyre i mahnitshëm i shkruar në strukturën e tyre gjenetike nga Krijuesi ynë. Është përlogaritur se për të prodhuar vetëm këtë një funt (0.45 kg) mjaltë, një zgjua mesatare prej 20.000 deri 60.000 bletësh duhet bashkërisht të vizitojnë miliona lule dhe të përkohjnë një largësi të barabartë me të udhëtuarin dy herë rreth botës. Gjatë jetës së saj të shkurtër prej vetëm disa javësh deri katër muajsh, ndihmesa e një blete të vetme në mjaltin e prodhuar për zgjojnë e saj, është vetëm sa një e dymbëdhjeta e lugës së çajit.

Megjithëse në dukje e parëndësishme krahasuar me sasinë totale, një e dymbëdhjeta lugë-çaji mjaltë e secilës bletë është thelbësore për jetën e zgjoit. Bletët mbështeten te njëra-tjetra. Puna që do të ishte dërrmuese për t'u bërë nga pak bletë, bëhet më e lehtë për shkak se të gjitha bletët bëjnë pjesën e tyre të punës me besnikëri.

Kosherja gjithmonë ka qenë simbol i rëndësishëm në historinë e Kishës sonë. Ne mësojmë në Librin e Mormonit se Jareditët morën bletë me vete (shih Ethëri 2:3) kur udhëtuan për në kontinentin amerikan mijëra

vjet më parë. Brigam Jangu e zgjodhi kosheren si simbol për të nxitur e frymëzuar energjinë bashkëpunuese, të nevojshme mes pionierëve për ta shndërruar djerrishtën e shkretëtë e joprodhimtare që rrethonte Liqenin e Madh të Kripur në luginat pjellore që kemi sot. Ne jemi përfituesit e vizionit të tyre të përbashkët dhe punës së tyre të zellshme të përbashkët.

Simboli i kosheres gjendet në pjesët e brendshme dhe të jashtme të shumë prej tempujve tanë. Ky podium ku po qëndroj, është bërë nga druri i një peme arre të rritur në oborrin pas shtëpisë së Presidentit Gordon B. Hinkli dhe është stolitur me figura të gdhendura bletësh.

I gjithë ky simbolizëm dëshmon një fakt: gjëra të mëdha ndodhin dhe barrat lehtësohen nga përpjekjet e shumë duarve "të përfshira" me zell në një kauzë të mirë" (DeB 58:27). Përfytyroni se çfarë mund të arrijnë miliona shenjtorët e ditëve të mëvonshme në botë nëse do të funksiononim si kosherja në zotimin tonë të fokusuar e të përqendruar te mësimet e Zotit Jezu Krisht.





Shpëtimtari dha mësim se urdhërimi i parë dhe i madhi është:

“Duaje Zotin, Perëndinë tënde me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd dhe më gjithë mendjen tënde. . . .

Dhe i dyti, i ngjashëm me këtë, është: ‘Duaje të afërmin tënd porsivetveten’.

Nga këto dy urdhërime varet i tërë ligji dhe profetët” (Mateu 22:37, 39–40).

Fjalët e Shpëtimtarit janë të thjeshta, sidoqoftë kuptimi i tyre është i thellë dhe mjaft domethënës. Ne duhet ta duam Perëndinë dhe t’i duam e të kujdesemi për fqinjët tanë si për veten. Përfytyroni se sa të mira mund të bëjmë në botë nëse lidhemi të gjithë së bashku, të bashkuar si pasues të Krishtit, duke iu përgjigjur me zell e vrull nevojave të të tjerëve dhe duke u shërbyer njerëzve rreth nesh – familjeve tona, miqve tanë, fqinjëve tanë, bashkëqytetarëve tanë.

Siç vë në dukje Letra e Jakobit, shërbimi është vetë përkufizimi i fesë së pastër (shih Jakobit [Bibël] 1:27).

Ne lexojmë për shërbimin që japin anëtarët e Kishës nëpër botë dhe veçanërisht shërbimin humanitar të dhënë në kohë krize – zjarri e përmbajtjeje dhe tufani e uragani. Këto përgjigje mjaft të nevojshme e mjaft të vlerësuara ndaj urgjencave, sigurisht që duhet të vazhdojnë si një mënyrë e mbajtjes së barrave të njëri-tjetrit. Po në lidhje me jetën tonë të përditshme? Cili do të qe ndikimi i përbashkët i miliona veprimeve të vogla e të dhembshura të kryera çdo ditë nga ne për shkak të dashurisë sonë të çiltër të krishterë për të tjerët? Me kohë kjo do të kishte një ndikim shndërrues mbi të gjithë fëmijët e Atit tonë Qiellor

përmes përcjelljes së dashurisë së Tij për ta nëpërmjet nesh. Bota jonë e trazuar ka nevojë për këtë dashuri të Krishtit sot më shumë se asnjëherë dhe do t’i duhet edhe më shumë në vitet e ardhshme.

Këto veprime të thjeshta e të përditshme shërbimi mund të mos duken si diçka e madhe të marra veç e veç, por kur merren parasysh në mënyrë kolektive, ato janë njësoj si një e dymbëdhjeta lugë-çaji mjaltë dhënë zgjoit nga një bletë e vetme. Ka fuqi në dashurinë tonë për Perëndinë dhe për fëmijët e Tij dhe, kur kjo dashuri shfaqet dukshëm në miliona veprimet e mirësisë së krishterë, ajo do ta ëmbëlsojë e ushqejë botën me nektarin jetëdhënës të besimit, shpresës dhe dashurisë hyjnore.

Çfarë na duhet të bëjmë që të jemi më shumë si bletët e përkushtuara dhe ta bëjmë atë përkushtim pjesë të karakterit tonë? Shumë prej nesh janë të përgjegjshëm në frekuencimin e mbledhjeve tona të Kishës. Ne punojmë fort në thirrjet tona, veçanërisht të dielave. Sigurisht kjo është për t’u lavdëruar. Por a janë mendja e zemra jonë të përfshira me po aq zell në veprime të mira gjatë pjesës tjetër të javës? A mos vetëm i bëjmë mekanikisht detyrat tona apo jemi me të vërtetë të kthyer në besim tek ungjilli i Jezu Krishtit? Si e marrim farën e besimit që është ushqyer në mendjen tonë dhe e mbjellin thellë në tokën pjellore të shpirtit tonë? Si e arrijmë ndryshimin e madh të zemrës që Alma thotë se është thelbësor për lumturinë dhe paqen tonë të përjetshme? (Shih Alma 5:12–21.)

Kujtoni, mjalti përmban të gjitha substancat e nevojshme për të siguruar

jetën e vdekshme. Dhe doktrina dhe ungjilli i Krishtit janë e vetmja rrugë për të arritur jetën e përjetshme.

Vetëm kur dëshmia jonë ta kapërcejë atë që ndodh në mendjen tonë dhe të bëjë strofull thellë në zemrën tonë, atëherë motivimi ynë për të dashur e për të shërbyer do të bëhet si i Shpëtimtarit. Atëherë dhe vetëm atëherë, ne do të bëhemi dishepuj të Krishtit thellësisht të kthyer në besim, të forcuar nga Shpirti për të ndikuar te zemrat e bashkënjerezve tanë.

Kur zemra jonë të mos vihet më mbi gjërat e kësaj bote, ne nuk do të aspirojmë më për nderet e njerëzve, as do të kërkojmë që vetëm të kënaqim krenarinë tonë (shih DeB 121:35–37). Përkundrazi, ne fitojmë cilësitë si të Krishtit që Jezusi i dha mësim:

- Ne jemi të mirësjellshëm dhe zemërbutë e të duruar (shih DeB 121:41).
- Ne jemi të mirë, pa hipokrizi apo mashtrim (shih DeB 121:42).
- Ne ndiejmë dashuri hyjnore ndaj të gjithë njerëzve (shih DeB 121:45).
- Mendimet tona janë përherë të virtytshme (shih DeB 121:45).
- Ne nuk dëshirojmë më të bëjmë keq (shih Mosia 5:2).
- Fryma e Shenjtë është shoqëruesi ynë i përhershëm, dhe doktrinat e priftërisë pikojnë mbi shpirtin tonë sikurse vesat nga qiejt (shih DeB 121:45–46).

Tani, vëllezër e motra, nuk po nxis zell të tepruar apo fanatizëm fetar. Kurrsesi! Thjesht po këshilloj që ne të hedhim hapin tjetër logjik në kthimin tonë të plotë në besim te ungjilli i Krishtit duke i përvetësuar doktrinat e tij thellë brenda zemrës dhe shpirtit tonë në mënyrë që të veprojmë e jetojmë – me integritet moral dhe – në përputhje me atë që themi se besojmë.

Ky integritet moral e thjeshton jetën tonë dhe i rrit ndjeshmëritë tona ndaj Shpirtit dhe nevojave të të tjerëve. I sjell gëzim jetës sonë dhe paqe shpirtit tonë – atë lloj gëzimi e paqeje që na vjen kur pendohemi për mëkatet tona dhe ndjekim Shpëtimtarin duke mbajtur urdhërimet e Tij.

Si e bëjmë [të mundur] këtë ndryshim? Si e rrënjosim këtë dashuri të Krishtit në zemrën tonë? Ka një veprim të thjeshtë e të përditshëm që mund të sjellë ndryshim për çdo anëtar të Kishës, përfshirë ju djem e vajza, ju të rinj e të reja, ju të rritur beqarë dhe ju nëna e etër.

Ai veprim i thjeshtë është: Në lutjen tuaj të mëngjesit çdo ditë të re, kërkojini Atit Qiellor t’ju drejtojë që të dalloni mundësi për t’i shërbyer një prej fëmijëve të Tij të çmuar. Pastaj vazhdojeni gjithë ditën me zemrën plot besim e dashuri, duke kërkuar të

gjëni dikë që mund ta ndihmoni. Jini të përqendruar, ashtu si bletët përqendrohen te lulet nga të cilat mbledhin nektarin dhe pjalmin. Nëse e bëni këtë, ndjeshmëritë tuaja shpirtërore do të zhvillohen dhe do të zbuloni mundësi për të shërbyer që kurrë më parë nuk i keni menduar të mundshme.

Presidenti Tomas S. Monson ka dhënë mësim se në shumë raste Ati Qiellor u përgjigjet lutjeve të një personi tjetër nëpërmjet nesh – nëpërmjet meje dhe jush – nëpërmjet fjalëve e veprave tona të dashura, nëpërmjet veprimeve tona të thjeshta të shërbimit e dashurisë.

Dhe Presidenti Spenser W. Kimball tha: “Perëndia na shikon dhe kujdeset për ne. Por zakonisht është nëpërmjet një personi tjetër që Ai i plotëson nevojat tona. Si rrjedhim, është jetike që ne t’i shërbejmë njëri-tjetrit”

(*Teachings of Presidents of the Church: Spencer W. Kimball* [2006], f. 82).

E di se nëse i bëni këto veprime të përditshme shërbimi – në shtëpi, shkollë, punë e kishë – Shpirti do t’ju udhëheqë dhe ju do të jeni në gjendje të dalloni ata që kanë nevojë për shërbimin e veçantë që vetëm ju mund të jeni në gjendje ta jepni. Ju do të shtyheni nga Shpirti dhe do të nxiteni mrekullisht për të ndihmuar në pjalmin e botës me dashurinë e pastër të Krishtit dhe ungjillin e Tij.

Dhe kujtoni, ashtu si një e dy- mbëdhjeta lugë-çaji mjaltë e bletës së vogël siguruar për zgjoin, nëse do t’i shumëfishojmë përpjekjet tona me dhjetëra mijërat dhe madje milionat përpjekje plot lutje për të ndarë dashurinë e Perëndisë për fëmijët e Tij nëpërmjet shërbimit të krishterë, [atëherë] do të ketë një forcë në rritje për mirë që do t’i sjellë Dritën e Krishtit kësaj bote përherë e më të errët. Të lidhur së bashku, ne do t’i sjellim dashuri e dhembshuri vetë familjes sonë dhe të vetmuarve, të varfërve, shpirtbregosurve dhe atyre prej fëmijëve të Atit tonë Qiellor që po kërkojnë të vërtetën dhe paqen.

Lutja ime e përlur, vëllezër e motra, është që ne do të kërkojmë në lutjet tona të përditshme frymëzim që të gjejmë dikë të cilit mund t’i japim ndonjë shërbim kuptimplotë, përfshirë shërbimin e ndarjes të së vërtetës së ungjillit dhe të dëshmisë sonë. Në fund të çdo dite, qofshim në gjendje të themi: “Po”, në përgjigje të pyetjes: “A kam bërë sot në botë unë ndonjë të mirë? Kam ndihmuar dikë në nevojë?” (*Hymns*, nr. 223).

Kjo është puna e Perëndisë. Qofshim në këtë punë po aq besnikë sa bletët e vogla të përkushtuara në punën e tyre, për këtë lutem me përlësi në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Qyteti i Meksikos, Meksikë



Nga Plaku Leri Eko Houk,
i Të Shtatëdhjetëve

“Eja tek Unë, O ti Shtëpi e Izraelit”

Kur vijmë te Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti, dhe pastrojmë zemrat tona, ne të gjithë do të jemi mjete në përmbushjen e premtimeve të fuqishme të Librit të Mormonit.

Gjatë luftës në Vietnam, unë dola vullnetar për shërbim ushtarak në Korpusin e Marinesave të Shteteve të Bashkuara. Pak pas mbërritjes time në Kuantiko të Virxhinias për trajnimin bazë, e gjeta veten duke qëndruar gatitu para shtratit tim të kazermës, së bashku me 54 rekrutë të tjerë të Korpusit të Marinesave. E takova instruktorin tim të stërvitjes, një veteran i kalitur nga lufta, kur ai me shqelm hapi derën e kazermës dhe hyri duke ulëritur fjalë të mbushura me përdhosje.

Pas këtij prezantimi tmerrues, ai filloi nga njëri cep i kazermës dhe e i doli përballë çdo rekruti me pyetje. Pa përjashtim, instruktori i stërvitjes metodikisht gjeti diçka për t'u tallur me çdo rekrut, me gjuhë të fortë vulgare. Teksa kalonte rreshtin, sipas urdhrit, çdo marins i përgjigjej duke bërë: “Po” ose “Jo, Instruktor Rreshter”. Nuk mund të shihja saktësisht se çfarë po bënte ai, sepse ne ishim urdhëruar të qëndronim gatitu me sytë drejtuar përpara. Kur erdhi radha ime, mund ta dalloja që ai mori çantën time të shpinës dhe e zbrazti çfarë kishte në dyshekun prapa meje. Ai pa përmes

gjërave të mia personale, pastaj u kthye për t'u përballur me mua. U përgatita për sulmin e tij. Në dorën e tij ishte Libri im i Mormonit. Prisja që të më bërtiste; në vend të kësaj, ai u afrua tek unë dhe pëshpëriti: “A je ti mormon?”

Sipas urdhrit, unë bërtita: “Po, Instruktor Rreshter”.

Përsëri prisja më të keqen. Përkundrazi, ai ndaloi dhe ngriti dorën e tij që mbante Librin tim të Mormonit, dhe me një zë shumë të qetë tha: “A beson në këtë libër?”

Unë përsëri thashë me zë të lartë: “Po, Instruktor Rreshter”.

Në këtë pikë isha i sigurt se ai do të thoshte se s'bën fjalë përçmuese për mormonët dhe Librin e Mormonit, por ai vetëm qëndroi atje në heshtje. Pas një momenti, ai u kthye te shtrati im dhe me kujdes vendosi Librin tim të Mormonit. Pastaj ai vazhdoi të ecte pranë meje pa u ndalur dhe vazhdoi të përçeshte e përçmonte me gjuhë përdhosëse të gjithë rekrutët e mbetur.

Shpesh kam pyetur veten përse ai rreshter i ashpër i Korpusit të Marinesave u tregua i mëshirshëm me mua atë ditë. Por unë jam mirënjohës

që isha i aftë të thosha pa hezitim: “Po, unë jam anëtar i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme” dhe “Po, unë e di se Libri i Mormonit është i vërtetë”. Kjo dëshmi është një dhuratë e çmuar që më është dhënë përmes Frymës së Shenjtë, me ndihmën e dy misionarëve dhe të një këshilltari në kuorumin e priftërinjve.

Kur isha 14 vjeç, dy misionarë, Li Pirsën dhe Bojd Kemfysen, i dhanë mësim familjes sime për ungjillin e rivendosur të Jezu Krishtit dhe unë u pagëzova. Dy vjet më vonë, këshilltari i kuorunit tim të priftërinjve, Riçard Boren, më sfidoi të lexoja Librin e Mormonit. E pranova atë sfidë dhe lexova të paktën 10 faqe çdo natë, derisa e përfundova.

Në faqen e titullit lexova se është “shkruar për Lamanitët, të cilët janë një mbetje e shtëpisë së Izraelit, si dhe për Judenj dhe Johebrenj”. Në parathënien e Librit të Mormonit: Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit, thuhet se lamanitët “janë midis paraardhësve [kryesorë] të Indianëve të Amerikës”. Ndërsa lexova Librin e Mormonit, m'u duk sikur ai ishte për paraardhësit e mi indianë të Amerikës. Ai tregon historinë e një populli, një pjesë e të cilit më vonë u përshkruan si “lamanitë”, të cilët u shpërngulën nga Jerusalemi për në një “tokë të premtimit” (1 Nefi 2:20) rreth viteve 600PR.K. Është një anal i marrëdhënieve të Perëndisë me këta banorë të lashtë të vendosur diku në kontinentet amerikane. Ai përfshin një rrëfim të shërbesës së Jezu Krishtit midis tyre pas Ringjalljes së Tij. Fragmente në Librin e Mormonit sugjerojnë se, me kalimin e kohës, ata u shpërndanë anembanë kontinenteve të Amerikës dhe ishujve në detet afër (shih Alma 63:9–10). Profetët e tyre parashikuan se shumë grupe njerëzish johebrenj do të vinin përfundimisht në



këtë tokë të premtuar dhe zemërimi i Perëndisë do të ishte mbi lamanitët, dhe ata do të shpërndaheshin goditëshin dhe pothuaj shkatërrheshin (shih 1 Nefi 13:10–14).

Stërgjyshi im Eko Houk, një indian pauni, u lind në mes të viteve 1800, në atë që tani quhet Nebraska. Kur ai ishte 19 vjeç, njerëzit pauni u detyruan të jepnin 9.3 milionë hektarë tokë të vendlindjes së tyre për t'u lënë vend kolonizatorëve. Në vitin 1874 populli pauni u çua me forcë disa qindra milje në jug, në një rezervat të vogël të vendosur në Territorin Indian të Oklahomës. Popullsia e njerëzve pauni kishte rënë nga mbi 12.000 vetë në më pak se 700, gjatë mbërritjes së tyre në Oklahoma. Paunit, sikurse fiset e tjera, ishin shpërndarë, goditur dhe pothuaj shkatërruar.

Libri i Mormonit ka një mesazh të veçantë për pasardhësit e lamanitëve, një mbetje e shtëpisë së Izraelit. Nefi e shprehu këtë mesazh ndërsa interpretonte vegimin e atit të tij për këto ditë të mëvonshme: “Dhe atë ditë, mbetja e farës sonë do të dijë

se ajo është nga shtëpia e Izraelit dhe se ata janë populli i besëlidhjes së Zotit; dhe atëherë ata do të dinë dhe do të vijnë në njohurinë e paraardhësve të tyre dhe gjithashtu në njohurinë e ungjillit të Shëlbuesit të tyre, i cili u ishte shërbyer etërve të tyre nga ai; prandaj ata do të vijnë në njohurinë e Shëlbuesit të tyre dhe të pikave kryesore të doktrinës së tij, që ata mund të dinë si të vijnë tek ai dhe të shpëtohen” (1 Nefi 15:14).

Libri i Mormonit është shkrim i shenjtë. Ai përmban plotësinë e ungjillit të përjetshëm. Profeti Jozef Smith shkroi se “Libri i Mormonit [është] më i sakti nga ndonjë libër mbi tokë dhe gurthemeli i besimit tonë, dhe se një njeri do t'i afrohet më shumë Perëndisë duke iu bindur porosive të tij, se nga ndonjë libër tjetër” (*Mësimet e Presidentëve të Kishës: Joseph Smith* [2007], f. 67). Kështu, ai ka një mesazh për të gjithë njerëzit në botë.

Si një djalë 17-vjeçar që e lexon Librin e Mormonit për herë të parë, unë u përqendrova në premtimin e Moroni: “Dhe kur ju t'i merrni këto gjëra,

unë do t'ju këshilloja që të pyesni Perëndinë, Atin e Amshuar, në emrin e Krishtit, në qoftë se këto gjëra nuk janë të vërteta; dhe në qoftë se ju do të kërkonti me një zemër të singërtë, me qëllim të vërtetë duke pasur besim në Krisht, ai do t'ju tregojë të vërtetën, nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë” (Moroni 10:4).

Kur u gjuhëzova në lutje, unë mora një dëshmi të fuqishme shpirtërore se Libri i Mormonit është i vërtetë. Ajo dëshmi më ka ndihmuar të planifikoj dhe të marr vendime gjatë gjithë jetës sime.

Unë i këshilloj të gjithë njerëzit ta lexojnë Librin e Mormonit: Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit.

Unë veçanërisht i kërkoj mbetjes së shtëpisë së Izraelit, pasardhësve të popullit të Librit të Mormonit, kudo që mund të jeni, të lexoni dhe të rilexoni Librin e Mormonit. Mësoni për premtimet që përmbahen në Librin e Mormonit. Ndiqni mësimet dhe shembullin e Jezu Krishtit. Bëni dhe mbani besëlidhjet me Zotin. Kërkonti dhe ndiqni udhëheqjen e Shpirtit të Shenjtë.

Po e përfundoj me fjalët e thëna nga Amaleki, një tjetër profet i Librit të Mormonit: “Dhe tani, vëllezërit e mi të dashur, unë do të doja që ju të vini te Krishti, që është i Shenjti i Izraelit dhe të merrni pjesë në shpëtimin e tij dhe në fuqinë e shlyerjes së tij. Po, ejani tek ai dhe dhuroni tërë shpirtat tuaj si një dhuratë ndaj tij dhe vazhdoni në agjërim dhe lutje dhe duroni deri në fund; dhe ashtu si Zoti jeton, ju do të shpëtoheni” (Omni 1:26).

Kur vijmë te Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti, dhe pastrojmë zemrat tona, ne të gjithë do të jemi mjete në përmbushjen e premtimeve të fuqishme të Librit të Mormonit. Për këtë unë dëshmoj, në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Plaku Robert C. Gei,
i Të Shtatëdhjetëve

Çfarë do të Japë Njeriu si Shkëmbim të Shpirtit të Vet?

Ne duhet të heqim dorë nga të gjitha mëkatet tona, të mëdha ose të vogla, për shpërblimin e Atit, jetën e përjetshme.

Shpëtimtari një herë u bëri di-shepujve të Tij pyetjen në vijim: “Çfarë do të japë njeriu si shkëmbim të shpirtit të vet?”¹

Kjo është një pyetje që im atë më mësoi ta mendoja me maturi vite më parë. Ndërsa po rritesha, prindërit e mi më caktuan punë të përditshme përreth shtëpisë dhe më paguanin një shumë të vogël të hollash për atë punë. Shpesh ato para, pak më shumë se 50 qindarka në javë, i përdorja për të shkuar në kinema. Atëherë një biletë filmi kushtonte 25 qindarka për një 11-vjeçar. Më mbeteshin 25 qindarka për t'u shpenzuar me ëmbëlsira, që kushtonin 5 qindarka copa. Një film me pesë ëmbëlsira! Më mirë se kaq nuk bëhej.

Çdo gjë shkoi mirë derisa mbusha 12 vjeç. Një pasdite duke qëndruar në radhë, mora vesh se çmimi i biletës për një 12-vjeçar ishte 35 qindarka dhe kjo do të thoshte dy ëmbëlsira më pak. Jo shumë i përgatitur për ta bërë atë sakrificë, unë arsyetova me vete: “Ti dukesh njëlloj si një javë më parë”.

Më pas hipa lart dhe kërkova një biletë 25 qindarkëshe. Sportelisti nuk më pa fare me sy hetues dhe unë bleva pesë ëmbëlsirat e mia të zakonshme në vend që të blija tri.

Më vonë, i ngazëllyer nga arritja ime, nxitova në shtëpi për t'i treguar tim eti për suksesin tim të madh. Kur po i tregoja hollësitë, ai nuk tha asgjë. Kur mbarova, ai thjesht më pa dhe tha: “Bir, a do të shisje shpirtin për një monedhë pesëqindarkëshe?” Fjalët e tij më therën në zemrën time 12-vjeçare. Është një mësim që nuk e kam harruar kurrë.

Vite më vonë, u gjenda duke i bërë po këtë pyetje një mbajtësi më pak aktiv të Priftërisë Melkizedeke. Ai ishte një burrë i mrekullueshëm që e donte familjen e tij. Megjithatë, nuk kishte qenë në kishë për shumë vite. Ai kishte një djalë të talentuar, i cili luante në një skuadër sportive tepër profesionale, e cila udhëtonte nëpër gara e që praktikohesh dhe luante ndeshje të dielave. Ajo skuadër kishte fituar kampionate të shumta të rëndësishme. Kur

u takuam, e kujtova atë se, si mbajtës i priftërisë, i qe premtuar se, nëse e lartësonte betimin dhe besëlidhjen e tij të priftërisë, ai do të merrte “gjithçka që Ati [ynë] ka”². Më pas e pyeta: “A ja vlen një kampionat kombëtar më shumë se gjithçka që Ati ka?” Ai me butësi tha: “E kuptoj ku do të dalësh” dhe caktoi një takim për t'u takuar me peshkopin e tij.

Sot është kaq e lehtë të përfshihesh në poteren e botës – pavarësisht qëllimeve tona të mira. Bota na shtyn të “[shohim] përtej shenjës”³. Kohët e fundit dikush më pyeti: “A përbën vërtet problem një pije alkoolike?” A mund ta shihni se është pyetja e kundërshtarit? Kaini pyeti: “Kush është Zoti, që unë duhet ta njoh atë?”⁴ dhe më pas humbi shpirtin. Satani triumfon me vetëjustifikimin e mëkateve të vogla. Për një shishe qumësht⁵, një emër të shkruar gabim⁶, një supë të kuqe⁷, është bërë tregti me parabisnitë dhe trashëgimitë.

Kur marrim parasysh shkëmbimet e pesëqindarkëshit apo kampionatit kombëtar në jetën tonë, ne ose mund t'i vetëjustifikojmë veprimet tona, si Kaini, ose mund të përpiqemi t'i nënshtrohemi vullnetit të Perëndisë. Pyetja që na parashtrohet nuk është nëse jemi duke bërë gjëra që kanë nevojë të korrigjohen, pasi gjithmonë jemi duke i bërë ato. Përkundrazi, pyetja është, a do ta “mpak[im]” apo do ta “mbarojmë” atë që kërkohet nga ne për të bërë vullnetin e Atit?⁸

Zoti e pëlqen drejtësinë tonë, por kërkon prej nesh pendim dhe nënshttrim të vazhdueshëm. Në Bibël lexojmë se qe një i ri pasanik, mbajtës i urdhërimeve, i cili u gjunjëzua përpara Shpëtimtarit dhe e pyeti se çfarë duhej të bënte që të kishte jetën e përjetshme. Ai u largua me keqardhje kur Shpëtimtari tha: “Një gjë të mungon; . . . shit të gjitha ato që ke”⁹.

Sidoqoftë, qe një njeri tjetër i pasur por prej botës, mbreti kryesor lamanit, babai i Lamonit, i cili gjithashtu bëri të njëjtën pyetje për jetën e përjetshme, duke thënë: “Çfarë duhet të bëj që të mund të lind nga Perëndia, duke shkukur këtë shpirt të keq nga gjoksi im dhe të marr Shpirtin e tij[?] . . . Unë do ta braktis mbretërinë time, që të mund të marr këtë gëzim të madh.”¹⁰

A e mbani mend përgjigjen që Zoti i dha mbretit përmes shërbëtorit të Tij, Aaronit? “Në qoftë se ti do të pendohesh për të gjitha mëkatet e tua dhe do të përulesh para Perëndisë dhe të thërrasësh emrin e tij me besim, duke besuar se do të marrësh, atëherë do të marrësh shpresën që dëshiron.”¹¹

Kur mbreti e kuptoi sakrificën e kërkuar, ai e përuli veten dhe ra përmbys, dhe më pas u lut: “O Perëndi, . . . unë do t’i braktis të gjitha mëkatet e mia për të të njohur”¹².

Ky është shkëmbimi që Shpëtimtari po kërkon prej nesh: ne duhet të heqim dorë nga të gjitha mëkatet tona, të mëdha ose të vogla, për shpërblimin e Atit, jetën e përjetshme. Ne duhet të harrojmë historitë vetëjustifikuese, shfajësimet, racionalizimet, mekanizmat mbrojtës, zvarritjet, pamjet e jashtme, krenarinë vetjake, mendimet gjyquese dhe bërjen e gjërave sipas mënyrës sonë. Ne duhet ta veçojmë veten nga të gjitha gjërat e botës dhe të marrim shëmbëlltërinë e Perëndisë në pamjen tonë.¹³

Vëllezër dhe motra, kujtoni se kjo detyrë është më shumë sesa thjesht mosbërja e gjërave të këqija. Për shkak se armiku ynë është aktiv, edhe ne duhet të veprojmë dhe jo të ulemi [në një gjendje] “të shkujdesur shtangësie”¹⁴. Të marrësh pamjen e Perëndisë do të thotë t’i shërbejmë njëri-tjetrit. Ka gjëra që bëjmë që janë të gabuara dhe gjëra



që nuk i bëjmë që duhet t’i bëjmë, dhe ne duhet t’i shmangim të dyja llojet e mëkateve.

Ndërsa po shërbeja si president misioni në Afrikë, mora si mësim përgjithnjë këtë të vërtetë të madhe. Isha rrugës për në një mbledhje kur pashë një djalë të vogël të vetëm, duke qarë me dënësë në anë të rrugës. Një zë brenda meje tha: “Ndalo dhe ndihmoje atë djalë”. Sapo e dëgjova këtë zë, brenda sekondës, arsyetova: “Nuk mund të ndalosh. Do të bëhesh vonë. Ti je drejtuesi kryesues dhe nuk mund të shkosh me vonësë.”

Kur mbërrita në shtëpinë e mbledhjeve, dëgjova po të njëjtin zë të thoshte sërish: “Shko ndihmoje atë djalë”. Atëherë ia dhashë çelësat e mi të makinës një anëtar të Kishës të quajtur Afaz dhe i kërkoja ta sillte djalin tek unë. Rreth 20 minuta më vonë, ndieva të më preknin në shpatull. Djali i vogël qe jashtë.

Ai ishte rreth 10 vjeç. Ne morëm vesh se i ati i kishte vdekur dhe e ëma

ishte në burg. Ai jetonte në një lagje të varfër të Akrës me një kujdestar, që i jepte ushqim dhe një vend për të fjetur. Për ta siguruar këtë ushqim e vend fjetjeje, ai shiste peshk të thatë nëpër rrugë. Por pas kësaj dite duke bërë tregti me njerëz në rrugë, kur e futi dorën në xhep, zbuloi se kishte një vrimë në të. Ai i kishte humbur të gjitha fitimet e tij. Unë dhe Afazi e dinim menjëherë se nëse ai do të kthehej pa paratë, ai do të quhej gënjeshhtar, me shumë gjasa do të rrihej dhe më pas do të flakej në rrugë. Kur e pashë në fillim, qe pikërisht në atë çast paniku të madh. Ne e qetësuam nga ajo gjendje frike, ia zëvendësuam fitimin e humbur dhe e kthyem në shtëpi te kujdestari i tij.

Ndërsa po shkoja në shtëpi atë mbrëmje, unë kuptova dy të vërteta të mëdha. Së pari, e dija si asnjëherë më parë se Perëndia di çdo gjë rreth secilit prej nesh dhe nuk do të na braktisë kurrë; dhe së dyti, e dija se ne gjithmonë duhet t’ia vëmë veshin zërit të



SHËNIME

1. Mateu 16:26.
2. Doktrina e Besëlidhje 84:38.
3. Jakobi [LiM] 4:14.
4. Moisiu 5:16.
5. Një shishe qumësht dhe kulloshtira e saj (ajka) qe thelbi i një debati midis bashkëshortes së Tomas B. Marshit dhe znj. Harris, të cilat kishin rënë dakord t'i bashkonin burimet dhe të bënin djathë. Kur znj. Harris u ankua që znj. Marsh nuk e përfshiu kulloshtrenë me qumështin por e mbajti për vete, znj. Harris u ankua dhe më pas gratë u grindën. Tomas Marsh e çoi çështjen te peshkopi, i cili vendosi që znj. Harris kishte të drejtë. Çështja shkoi nga peshkopi te këshilli i lartë, deri te Presidenca e Parë, të cilët të gjithë ranë dakord se znj. Marsh kishte gabuar. Kjo krijoi përçarje midis Tomas Marshit dhe Vëllezërve. Pak pas kësaj, Tomas Marshi dëshmoi përpara një gjyqtari nga Misuri se mormonët qenë armiq të shtetit të Misurit. (Shih George A. Smith, "Discourse", *Deseret News*, 16 prill 1856, f. 44.)
6. Kur Profeti Jozef Smith i paraqiti Simonds Rajderit thirrjen që të shërbente si misionar, Rajderi zbuloi se emri i tij ishte shkruar "Raider" në zbuluesën e shtypur. Ai u fye dhe kjo e çoi atë në braktisje dhe pjesëmarrjen përfundimtare në lyerjen me zift dhe mbulimin e profetit me pupla. Rajderi nuk e dinte se Jozef Smithi zakonisht ua diktonte zbuluesat shkruesve të tij dhe nuk kishte të bënte me drejtshkrimin. (Shih Milton V. Backman Jr., *The Heavens Resound: A History of the Latter-day Saints in Ohio, 1830–1838* [1983], f. 93–94; Donald Q. Cannon and Lyndon W. Cook, red., *Far West Record: Minutes of The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints, 1830–1844* [1983], f. 286.)
7. Te Zanafilla 25, ne mësojmë se Esau ia shtet parabininë Jakobit për "bukë dhe supë me thjerrëza" (vargu 34).
8. Shih Doktrina e Besëlidhje 19:18–19.
9. Shih Marku 10:21–22.
10. Alma 22:15.
11. Alma 22:16.
12. Alma 22:18.
13. Shih Alma 5:14–19.
14. Alma 60:7.
15. Marku 1:18.
16. Mateu 18:11.
17. Jakobi [LiM] 1:8.
18. Doktrina e Besëlidhje 58:27.
19. Shih Lluka 15:11–32.
20. Shih Joseph Smith – Historia 1:15–16.
21. Neal A. Maxwell, *Deposition of a Disciple* (1976), f. 88.
22. Shih Doktrina e Besëlidhje 19:38.

Shpirtit brenda nesh dhe të shkojmë "menjëherë"¹⁵ kudo që ai na çon, pa varësisht nga frikërat tona apo ndonjë shqetësim.

Një ditë dishepujt e pyetën Shpëtimtarin se cili qe më i madhi në mbretërinë e qiellit. Ai u tha atyre të ktheheshin në besim, të ishin të përlur e të nënshtuar si fëmijët e vegjël. Më pas, Ai tha: "Biri i njeriut erdhi për të shpëtuar atë që [ka] humbur"¹⁶. Ai e shpjegoi misionin tonë me atë fjali të vetme. Ne duhet të shkojmë të shpëtojmë – të humburit, ata që quhen të fundit dhe të parëndësishmit. Nuk mjafton të shmangim mëkatën; ne duhet "të durojm[im]ë kryqin e tij"¹⁷ dhe "të përfshiemi[mi] me zell"¹⁸, duke i ndihmuar të tjerët të kthehen në besim. Me dhembshuri dhe dashuri ne përqafojmë plangprishësin¹⁹, u përgjigjemi thirrjeve të jetimëve të pikëlluar, lutjeve të atyre në errësirë dhe dëshpërim²⁰ dhe thirrjeve të shqetësuar të familjeve në nevojë. "Satani nuk ka nevojë ta bindë këdo të bëhet si Kaini apo Juda . . .," tha Plaku Nil A. Maksuell. "Ai ka nevojë vetëm të bindë njerëz të aftë . . . që ta shohin veten si persona asnjans të sofistikuar."²¹

Pas një konference të fundit kunji, një adoleshent m'u afrua dhe më

pyeti: "A më do Perëndia?" Jeta jonë e shërbimit gjithmonë pohoftë se Perëndia nuk e braktis asnjërin.

Lidhur me pyetjen "Çfarë do të japë njeriu si shkëmbim të shpirtit të vet?" Satani do të donte që ne ta shisnim jetën për ëmbëlsirat dhe kampionatet e kësaj bote. Megjithatë, Shpëtimtari na thërret, pa na ofruar shpërblime tokësore, që të shkëmbejmë mëkatet tona, të marrim mbi vete pamjen e Tij dhe ta çojmë atë në zemrat e njerëzve brenda mundësive tona. Për shkak të kësaj ne mund të marrim gjithçka që Perëndia ka, që na është thënë se është më e madhe se të gjithë thesaret e marra bashkë të kësaj toke²². A mundet të arrini ta përfytyroni?

Gjatë një udhëtimi së fundmi në Nikaragua, vura re një pllakëz metalike në një shtëpi të thjeshtë të një familjeje që vizituam. Aty thuhej: "Dëshmia ime është pasuria ime më e çmuar". Kështu është edhe për mua. Dëshmia ime është thesari i shpirtit tim dhe, me ndershmërinë e zemrës sime, unë ju lë dëshminë se kjo kishë është Kisha e vërtetë e Perëndisë, se Shpëtimtari ynë qëndron në krye të saj dhe e drejton përmes profetit të Tij të zgjedhur. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Plaku Skot D. Uaiting,
i Të Shtatëdhjetëve

Standardi i Tempullit

Standardet e larta të ndërtimit të tempullit të përdorura nga kjo Kishë, janë një model dhe madje një simbol se si duhet ta jetojmë vetë jetën tonë.

Kohët e fundit, teksa po bëja një vizitë turistike në Tempullin e bukur të Brigam-Sitit në Juta, m'u kujtua një përvojë që pata gjatë kohës që shërbeja si koordinatori i shtëpisë së hapur, i ridedikimit dhe i festimit kulturor të tempullit historik të Laies në Havai.

Pak muaj përpara përfundimit të punës gjithëpërfshirëse restauruese, më ftuan që të vizitoja tempullin me Drejtorin Ekzekutiv të Departamentit të Tempullit, Plakun Uilliam R. Uoker dhe me kolegët e tij të Departamentit të Tempullit. Përveç kësaj, merrnin pjesë edhe anëtarë të ndryshëm të firmës së përgjithshme kontraktuese. Qëllimi i vizitës, pjesërisht, ishte të rishikohej përparimi dhe cilësia e punës së kryer. Në kohën kur po bëhej kjo vizitë, puna ishte 85 përqind e përfunduar.

Teksa lëviznim nëpër tempull, pashë dhe dëgjova Plakun Uoker dhe kolegët e tij se si kontrollonin punën dhe bisedonin me kontraktuesin e përgjithshëm. Gjatë vizitës, vura re një burrë që i prekte vazhdimisht muret me dorën e tij ndërsa ecnim nga dhoma në dhomë. Pasi e bente këtë disa herë, ai fërkonte gishtat e tij bashkë dhe pastaj i afrohej kontraktuesit të përgjithshëm dhe i thoshte:

“Ndiej ashpërsi në këtë mur. Ashpërsia nuk është standardi i tempullit. Duhet ta lëmoni këtë mur”. Kontraktuesi me bindje mbante shënim sa herë që ata ndienin se muri ishte i ashpër.

Kur iu afrova një zone në tempull që vetëm pak njerëz do ta shikonin ndonjëherë, i njëjti burrë na ndaloi dhe e drejtoi vëmendjen tonë te një dritare e bukur e bërë prej xham plumbi, e sapo instaluar. Kjo dritare i kishte përmasat rreth 0.6 m e gjerë dhe 1.8 m e gjatë, dhe përmbante një model të vogël gjeometrik me xham të ngjyrosur. Ai tregoi me gisht një katror xhami të vogël me ngjyrë 5 cm që ishte pjesë e modelit të thjeshtë dhe tha: “Ai katror është i shtrembër”. E pashë katrorin dhe mua nuk m'u duk i shtrembër. Megjithatë, kur përdora një aparat matës për ta këqyruar më nga afër, mund ta shihja që kishte defekt dhe se ky katror i vogël ishte me të vërtetë i shtrembëruar me 3 mm. Kontraktuesit iu dha udhëzimi që kjo dritare do të duhej të zëvendësohej sepse nuk ishte sipas standardit të tempullit.

E pranoj që u habita, që një dritare e tërë do të duhej të zëvendësohej sepse kishte një defekt kaq të vogël që mezi shihej. Sigurisht, nuk kishte të ngjarë që ndonjë njeri ta merrte

vesh ose madje ta vinte re këtë dritare, sepse kjo ishte një zonë e tempullit që jo shumë njerëz do ta shihnin ndonjëherë.

Ndërsa i jepja makinës atë ditë nga tempulli për në shtëpi, meditova rreth asaj që mësova nga kjo përvojë – ose me mirë, ajo që mendova se mësova. Nuk ndodhi deri disa javë më vonë, kur u ftova për të bërë një vizitë në tempullin tashmë të përfunduar, që kuptueshmëria ime për përvojën e mëparshme të vizitës u bë më e qartë.

Kur hyra në Tempullin e Laies në Havai të restauruar plotësisht, u mrekullova nga bukuria e tij dhe nga cilësia e ndërtimit të përfunduar. Ju mund ta kuptoni që unë isha i interesuar të shihja sërish muret e “ashpra” dhe dritaren “me defekt”. A i lëmoi muret kontraktuesi? A u zëvendësua dritarja me të vërtetë? Teksa iu afrova mureve të ashpra, u habita kur pashë letrën e bukur të murit që tani ishte ngjitur në të gjitha muret. Mendimi im i parë ishte: “Pra, kjo është mënyra se si kontraktuesi e rregulloi problemin me ashpërsinë – ai e mbuloi atë”. Por jo, unë mësova se plani kishte qenë që në fillim që të ngjysnin letër muri në këto mure. Pyeta veten, pse kishte rëndësi një sasi e vogël ashpërsie që vështirë se dallohej, nëse letra e murit do ta mbulonte atë? Atëherë me padurim iu afrova zonës ku ndodhej dritarja me defekt dhe u habita kur në një vazo pashë një lule të bukur të gjatë deri në tavan, të vendosur përpara dritares. Përsëri mendova: “Pra, kjo është mënyra se si kontraktuesi e rregulloi problemin e katrorit të vogël të shtrembër – ai e fshehu atë”. Kur iu afrova dritares, shtyva mënjanë gjethet e lules dhe buzëqesha ku pashë që dritarja me të vërtetë ishte zëvendësuar. Katrori i vogël, i shtrembër, i mëparshëm tani qëndronte i rregullt dhe në mënyrë të barabartë brenda



modelit. Mësova që kishte qenë gjithmonë pjesë e arredimit të brendshëm të vendoset një lule përpara kësaj dritareje.

Përse mure me pak ashpërsi dhe një dritare me pak asimetri do të kërkonin punë shtesë madje dhe zëvendësim, kur pak sy ose duar njerëzore do ta vinin re ndonjëherë? Përse duhej që një kontraktues të përmbushte standarde të tilla të larta?

Teksa dola nga tempulli i zhytur në mendime, e mora përgjigjen time kur pashë anën e jashtme të përfunduar dhe pashë këto fjalë: “Shenjtëri Zotit, Shtëpia e Zotit”.

Tempujt e kësaj Kishe janë saktësisht ashtu siç shpallen se janë. Këto ndërtesa të shenjta janë ndërtuar për përdorimin tonë dhe brenda mureve të tyre kryhen ordinanca të shenjta dhe shpëtuese. Por nuk duhet të ketë dyshim për faktin se e kujt është në të vërtetë shtëpia. Duke kërkuar standarde të sakta të ndërtimit deri në detajet më të vogla, ne tregojmë jo vetëm dashurinë dhe respektin tonë për Zotin Jezu Krisht, por ne u tregojmë të gjithë

vëzhguesve se ne e nderojmë dhe e adhurojmë Atë, të cilit i përket shtëpia.

Në zbulesën dhënë Profetit Jozef Smith për ndërtimin e një tempulli në Navu, Zoti udhëzoi:

“Ejani me gjithë floririn tuaj dhe argjendin tuaj, dhe gurët tuaj të çmuar, dhe me gjithë gjërat tuaja antike; dhe me gjithë ata që kanë njohuri për gjërat antike . . . dhe të sjellin . . . pemët e çmuara të tokës;

. . . Dhe i ndërtoni një shtëpi emrit tim, që Më i Larti të banojë atje.”¹

Kjo ndjek modelin e vendosur nga mbreti Salomon në Dhiatën e Vjetër, kur ai i ndërtoi një tempull Zotit, duke përdorur vetëm materialin dhe punimin më të mirë.² Sot, kur ndërtojmë tempujt e Kishës, ne vazhdojmë të ndjekim këtë model me përshtatshmërinë e duhur.

Unë mësova që edhe pse sytë dhe duart e vdekshme mund të mos e shohin apo ndiejnë kurrë një defekt, Zoti e di nivelin e përpjekjeve tona dhe nëse kemi bërë më të mirën tonë. E njëjta gjë vlen për vetë përpjekjet tona personale për të jetuar një jetë të

denjë për bekimet e tempullit. Zoti këshilloi:

“Dhe për aq sa njerëzit e mi më ndërtojnë një shtëpi mua në emër të Zotit dhe nuk lejojnë gjëra të papastra të hyjnë në të, që ajo të mos ndotet, lavdia ime do të pushojë në të;

Po, dhe prania ime do të jetë atje, sepse unë do të hyj në të, dhe gjithë të kulluarit në zemër që do të hyjnë në të, do ta shohin Perëndinë.

Por, në qoftë se ndotet, unë nuk do të hyj në të dhe lavdia ime nuk do të jetë atje; sepse unë nuk do të hyj në tempuj jo të shenjtë.”³

Ashtu si kontraktuesi, kur bëhemi të vetëdijshëm për elemente në vetë jetën tonë që nuk janë në përputhje me mësimet e Zotit, kur përpjekjet tona kanë qenë më pak se më e mira jonë, ne duhet të veprojmë shpejt për të ndrequr çdo gjë që është gabim, duke pranuar që nuk mund t’ia fshëhim mëkatet tona Zotit. Ne duhet të kujtojmë që “kur përpikemi t’i mbulojmë mëkatet tona . . . , vini re, qiejt tërhiqen; [dhe] Shpirti i Zotit hidhërohet”⁴.

Unë gjithashtu mësova që standardet e larta të ndërtimit të tempullit të përdorura nga kjo Kishë, janë një model dhe madje një simbol i mënyrës se si duhet ta jetojmë vetë jetën tonë. Ne mund t'i zbatojmë individualisht mësimet e apostullit Pal dhënë Kishës së hershme, kur ai tha:

“A nuk e dini ju se jeni tempulli i Perëndisë dhe se Fryma e Perëndisë banon në ju?”

Në qoftë se dikush e prish tempullin e Perëndisë, Perëndia do ta prishë atë, sepse tempulli i Perëndisë, i cili jeni ju, është i shenjtë.”⁵

Secili prej nesh është bërë prej materialit më të mirë dhe ne jemi rezultati i mrekullueshëm i mjeshtërisë hyjnore. Megjithatë, kur e kalojmë moshën e përgjegjshmërisë dhe fillojmë të luftojmë me mëkatën dhe tundimin, shpirti ynë mund të ketë nevojë për pendim dhe riparim shpirtëror. Ndoshta ka mure brenda nesh që janë të ashpra dhe kanë nevojë të lëmohen ose dritare të shpirtit tonë që kanë nevojë të zëvendësohen me qëllim që të qëndrojmë në vende të shenjta. Fatmirësisht, standardi i tempullit që ne kërkojmë të përmbushim, nuk është ai i përsosmërisë, megjithëse përpiqemi për të, por që ne të përpiqemi të mbajmë urdhërimet dhe të bëjmë më të mirën tonë për të jetuar si dishepuj të Jezu Krishtit. Është lutja ime që ne të gjithë do të përpiqemi të jetojmë një jetë të denjë për bekimet e tempullit duke bërë më të mirën tonë, duke bërë përmirësimet e nevojshme dhe duke eliminuar defektet dhe papërsosmëritë, kështu që Shpirti i Perëndisë të mund të jetojë gjithmonë me ne. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 124:26–27.
2. Shih 1 Mbretërve 6–7.
3. Doktrina e Besëlidhje 97:15–17.
4. Doktrina e Besëlidhje 121:37.
5. 1 Korintasve 3:16–17; shih edhe vargun 19.



Nga Plaku Nil L. Andersen,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Prova e Besimit Tuaj

Sikurse zjarri i fortë që e shndërron hekurin në çelik, kur ne qëndrojmë besnikë gjatë provave të zjarra të besimit tonë, ne përpunohemi dhe forcohemi shpirtërisht.

Dhjetë vite më parë, ndërsa bashkëshortja ime, Keti, dhe unë jetonim në Sao-Paulo të Brazilit, Presidenti Dejvid Meriot kryesonte Misionin Brazilian të Interlagosit të Sao-Paulos. Ai dhe bashkëshortja e tij, Nejl, dhe të bijtë Uilli, Uesli dhe Trejsi jetonin pranë nesh. Kishin lënë shtëpinë, punën dhe shumë pjesëtarë të familjes, që t'i përgjigjeshin një thirrjeje nga profeti për të shërbyer në një mision.

Presidenti Meriot më telefonoi një pasdite. Bija e tyre 21-vjeçare, e çmuar dhe e drejtë, Xhorxha, studente në vitin e katërt për interpretim në violinë në Universitetin e Indianës, qe përplasur nga një kamion ndërsa ngiste biçikletën për në shtëpi pas një mbledhjeje të Kishës. Sipas njoftimit të parë, Xhorxha ishte mirë. Në orët e mëvonshme gjendja e saj u përkeqësua në mënyrë tronditëse.

Familja dhe miqtë filluan të agjëronin dhe të luteshin për një mrekulli për Xhorxhën. Nëna e saj udhëtoi gjatë gjithë natës me avion nga Brazili. Në mbërritje në aeroportin e Indianës të nesërmen, e takuan fëmijët më të rritur, që përmes lotëve i shpjeguan se ata iu ndodhën pranë Xhorxhës kur ajo ndërroi jetë.

Vëzhgova familjen Meriot gjatë kohës së këtij përjetimi dhe në muajt e vitet që pasuan. Ata vajtonin, luteshin, flisnin për Xhorxhën, ndienin dhembje dhe hidhërim të pamasë, por besimi i tyre nuk u ligështua. Në këtë sesion të mëngjesit ne dëgjuam për besim të ngjashëm në jetët e bukura të familjeve Bouen dhe Uilberg.¹

Dhurata e besimit është një ndihmë e paçmuar shpirtërore. “Dhe kjo është jeta e përjetshme”, u lut Jezusi, “të të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar”².

Besimi ynë përqendrohet te Perëndia, Ati ynë, dhe te Biri i Tij, Jezu Krishti, Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë. Përkrahet nga dija që plotësia e ungjillit është rivendosur në tokë, që Libri i Mormonit është fjala e Perëndisë dhe që profetët e apostujt mbajnë sot çelësat e priftërisë. Ne e çmojmë besimin tonë, punojmë për ta forcuar besimin tonë, lutemi për besim të zhvilluar dhe bëjmë gjithçka që kemi fuqi, për ta ruajtur dhe mbrojtur besimin tonë.

Apostulli Pjetër përcaktoi diçka që e quajti “prova e besimit tuaj”³. Ai e kishte përjetuar atë. Kujtoni fjalët e Jezusit:

“Simon, . . . Satani ka kërkuar t’ju shoshë ashtu siç shoshet gruri.



Por unë jam lutur për ty, që besimi yt të mos mpaket.”⁴

Pjetri më vonë i inkurajonte të tjerët: “Mos [t’]ju duket çudi”, tha, “për provën e zjarrit që u bë ndër ju për t’ju provuar, se si ju ndodhi diçka e jashtëzakonshme”⁵.

Këto prova zjarri kanë si qëllim t’ju bëjnë më të fortë, por ato kanë mundësinë t’ju zvogëlojnë apo madje t’ju rrënojnë mirëbesimin te Biri i Perëndisë dhe t’ju zvogëlojnë vendosmërinë për t’i mbajtur premtimet që i keni bërë Atij. Këto prova shpeshherë janë të maskuara, gjë që i bën të vështira për t’i dalluar. Ato nisin në dobësitë tona, cënueshmëritë tona, ndjeshmëritë tona ose në ato gjëra që janë më të rëndësishmet për ne. Një provë e vërtetë, por e përballeshme për dikë, për një tjetër mund të jetë provë zjarri.

Si vazhdoni ju të jeni “të paepur dhe të palëvizshëm”⁶ gjatë një prove besimi? Zhyteni pikërisht në gjërat që ju ndihmuan të zhvilloni bërthamën tuaj të besimit: ju ushtroni besim te Krishti, ju luteni, ju mendoheni thellë për shkrimet e shenjta, ju pendoheni, ju zbatoni urdhërimet dhe ju u shërbeni të tjerëve.

Kur përballemi me një provë të besimit – çfarëdo që të bëni, mos iu largoni Kishës! T’i largohesh mbretërisë së Perëndisë gjatë një prove besimi, është si të lëshë sigurinë e një vendstrehimi për stuhi pikërisht kur shfaqet uragani.

Apostulli Pal tha: “Ju . . . nuk jeni më të huaj, as bujtës, por bashkë-qytetarë të shenjtoreve dhe pjestarë të familjes së Perëndisë”⁷. Pikërisht brenda shenjtërores së Kishës është vendi ku ne e mbrojmë besimin. Duke u mbledhur së bashku me të tjerë që besojnë, ne lutemi dhe gjejmë përgjigje për lutjet tona; adhurojmë përmes muzikës, rrëfijmë dëshmi për Shpëtimtarin, i shërbejmë njëri-tjetrit dhe ndiejmë Shpirtin e Zotit. Ne marrim sakramentin, marrim bekimet e priftërisë dhe frekuentojmë tempullin. Zoti shpalli: “Në ordinancat . . . fuqia e perëndishmërisë manifestohet”⁸. Kur ju përballemi me një provë besimi, vazhdoni të qëndroni brenda sigurisë dhe mbrojtjes së familjes së Perëndisë. Këtu ka gjithmonë një vend për ju. Asnjë provë nuk është aq e madhe, sa të mos e kapërcejmë dot bashkë.⁹

Presidenti Tomas S. Monson tha: “Standardet morale të shoqërisë kanë ndryshuar shpejt. Sjellje . . . dikur të konsideruara të papërshtatshme dhe imorale tani . . . konsiderohen nga . . . shumë njerëz si të pranueshme.”¹⁰

Në Kishë gjenden shumë të rritur beqarë që janë përtej viteve të tyre të hershme të moshës madhore. Ndonëse jeta e tyre e tanishme është e ndryshme nga ç’e kishin pritur, ata e zbatojnë ligjin e dëlirësisë.¹¹ Kjo mund të jetë provë e besimit të tyre. Unë shpreh respektin dhe admirimin tim të thellë për këta dishepuj të Krishtit.

“Perëndia ka urdhëruar që fuqitë e shenjta të krijimit të jetës duhet të përdoren vetëm midis burrit dhe gruas, ligjërisht të martuar si bashkëshort e bashkëshorte.”¹² Në Dhiatën e Re Shpëtimtari ngriti një standard moral për pasuesit e Tij, kur shpalli: “Kushdo që shikon një grua për ta dëshiruar, ka shkelur kurorën me të në zemrën e vet”¹³. Ai na mësoi që të mos i dënojmë të tjerët, por nuk druhej që të fliste drejtpërdrejt: “Shko”, tha ai, “dhe mos mëkato më.”¹⁴

Familja jonë ka një mike. Ndoshta ju njihni ndokënd si ajo ose ndoshta ju jeni si ajo. Përherë besnike, shërben me fisnikëri në Kishë, admirohet nga ana profesionale, adhurohet nga familja e vet dhe, ndërsa priste martesë e fëmijë, ajo është beqare. “Mora vendimin”, tha ajo, “që ta vë mirëbesimin . . . tim te Jezu Krishti. Vajtja e shpeshtë në tempull më ndihmon të mbaj një përqendrim më të madh në përjetësi. Më rikujton që unë nuk jam asnjëherë e vetme. Kam besim . . . se asnjë . . . bekim nuk do të frenohet . . . ndërsa . . . u qëndroj besnike besëlidhjeve të mia, përfshirë edhe ligjit të dëlirësisë.”¹⁵

Një mik tjetër kreu një mision të shquar, që vijoi me një përgatitje të rreptë akademike. Ai shpresonte të kishte një familje. Prova e tij e besimit: ndjesitë e tërheqjes ndaj së njëjtës gjini. Më shkruante së fundi: “Në bekimin tim patriarkal më premtohet se do të kem një ditë një familje timen. Nëse kjo do të ndodhë në këtë jetë

ose tjetrën, nuk e di. Por ajo që unë di është se nuk dëshiroj të bëj diçka që do të rrezikojë bekimet që Perëndia më ka premtuar si mua, ashtu edhe pasardhësve të mi në të ardhmen.

. . . Të jetosh [ligjin e dëlirësisë], është sfidë, por a nuk erdhëm në tokë për të përballuar sfida e për t'i treguar Perëndisë dashurinë dhe respektin tonë për Të duke zbatuar urdhërimet e Tij? Jam bekuar me shëndet të mirë, me ungjillin, me një familje të dashur dhe miq besnikë. Unë jam mirënjohës për bekimet e mia të shumta.”¹⁶

Bota bën protestë: “Si mund të kërkosh aq shumë?” Zoti përgjigjet:

“Mendimet e mia nuk janë mendimet tuaja, dhe as rrugët tuaja nuk janë rrugët e mia. . . .

Ashtu si qiejtë janë më të lartë se toka, kështu edhe rrugët e mia janë më të larta se rrugët tuaja dhe mendimet e mia janë më të larta se mendimet tuaja.”¹⁷

Këta dy dishepuj të Krishtit dhe dhjetëra mijë si ata e kanë ndier premtimin e Shpëtimtarit: “Unë po ju lë paqen, po ju jap paqen time: unë po jua jap, po jo si e jep bota; zemra juaj mos u tronditë dhe mos u frikësoftë.”¹⁸

Ja një tjetër provë. Përherë ka pasur disa që duan ta turpërojnë Kishën dhe të shkatërrojnë besimin. Sot ata përdorin internetin.

Disa informacione lidhur me Kishën, sado bindëse qofshin, thjesht nuk janë të vërteta. Më 1985, më kujtohet kur një koleg hyri në zyrën e punës sime në Florida. Ai kishte një artikull të gazetës *Time* të titulluar “Challenging Mormonism’s Roots” [“Sfidë Rrënjëve të Mormonizmit”]. Fliste për një letër të zbuluar rreth asaj kohe, gjoja e shkruar nga Martin Herrisi, që binte ndesh me rrëfimin e Jozef Smithit për gjetjen e fletëve të Librit të Mormonit.¹⁹

Kolegu më pyeti nëse ky informacion i ri do ta rrëzonte Kishën Mormone. Artikulli citonte një njeri i cili tha se po largohej nga Kisha për shkak të atij dokumenti. Më vonë, me sa thuhet, të tjerë u larguan nga Kisha.²⁰ Jam i sigurt se ishte një provë për besimin e tyre.

Pak muaj më vonë, ekspertët zbuluan (dhe falsifikuesi rrëfeu) se letra ishte krejt një mashtrim. Më kujtohet se vërtet shpresoja që ata që u larguan nga Kisha për shkak të këtij mashtrimi, ta gjenin rrugën e tyre të kthimit.

Disa e vënë në dyshim besimin e tyre, kur gjejnë një thënie të një udhëheqësi të Kishës dekada më parë, që duket në mospajtim me doktrinën tonë. Ekziston një parim i rëndësishëm që qeveris doktrinën e Kishës. Doktrina mësohet nga të 15 pjesëtarët e Presidencës së Parë e të Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve. Ajo nuk fshihet në një paragraf të turbullt të një bisede.



Parimet e vërteta mësohen shpesh e nga shumëkush. Doktrina jonë nuk është e vështirë për t'u gjendur.


Udhëheqësit e Kishës janë njerëz të ndershëm, por të papërkryer. Kujtoni fjalët e Moronit: “Mos më dënoni për papërsosurinë time dhe as atin tim . . . ; por më mirë jepini falënderime Perëndisë që vuri në dukje papërsosuritë tona, kështu që ju të mësoni dhe të jeni më të urtë sesa qemë ne”.²¹

Jozef Smithi tha: “Asnjëherë nuk ju thashë se jam i përkryer; por nuk ka gabim te zbulesat”.²² Mrekullia e dorës së Perëndisë në historinë dhe fatin e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme kuptohet vetëm nëpërmjet lentes së kërkimit shpirtëror. Presidenti Ezra Taft Benson tha: “Çdo [njeri], me kohë, do të mbështetet te muri i besimit dhe atje . . . duhet ta ketë vendqëndrimin e tij”.²³ Mos u befasoni kur kjo t’ju ndodhë!

Parimisht, provat do të jenë të vështira. Mund të ketë ankth, pështjellim, netë pa gjumë dhe jastëkë të lagur me lotë. Por nuk lypset që provat tona të jenë shpirtërisht fatale. Nuk lypset të na largojnë nga besëlidhjet tona dhe nga familja e Perëndisë.

“Mbani mend, . . . është mbi shkëmbin e Shëlbuesit tonë që është Krishti, biri i Perëndisë, që ju duhet të ndërtoni themelin tuaj; që kur djalli të çojë erërat e tij të fuqishme, po, shigjetat e tij në shtjellë të erës, po, kur i gjithë breshëri i tij dhe furtuna e tij e fuqishme do të lëshohen mbi ju, nuk do të ketë fuqi mbi ju, që t’ju tërheqë në humnerën e mjerimit dhe të vuajtjes së pafund, për shkak të shkëmbit mbi të cilin jeni ndërtuar, që është një bazë e sigurt, një bazë mbi të cilën në qoftë se njerëzit ndërtojnë, nuk mund të bien.”²⁴

Sikurse zjarri i fortë që e shndërron hekurin në çelik, kur ne qëndrojmë besnikë gjatë provave të zjarra të



besimit *tonë*, ne përpunohemi dhe forcohemi shpirtërisht.

Plaku D. Tod Kristoferson shpjegoi se çfarë mësoi nga një provë shpirtërore: “Ndonëse atëherë vuajta, kur shoh pas tani, jam mirënjohës që nuk pati një zgjidhje të shpejtë për problemin tim. Fakti se isha i detyruar t’i drejtohesha Perëndisë për ndihmë thujse çdo ditë gjatë një periudhe të zgjatur vitesh, më mësoi vërtet se si të lutesha e të merrja përgjigje për lutjen dhe më mësoi në një mënyrë shumë praktike të kisha besim te Perëndia. Unë arrita të njoh Shpëtimtarin tim dhe Atin tim Qiellor në një mënyrë dhe në një shkallë që, përndryshe, nuk do të mund të kishte ndodhur ose që do të më duhej shumë më tepër kohë për ta arritur. . . . Mësova t’i mirëbesoj Zotit me gjithë zemër. Unë mësova të eci me Të ditë pas dite.”²⁵

Pjetri i përshkroi këto përvoja si “shumë më [të çmuara] nga ari”²⁶. Moroni shtoi se një dëshmi vjen pas “provës së besimit tuaj”²⁷.

Fillova me ngjarjen e familjes Meriot. Javën e kaluar, Ketii dhe unë

shkuam me ta te varri i Xhorxhës. Dhjetë vjet kanë kaluar. Familja dhe miqtë folën për dashurinë dhe kujtimet që kanë për Xhorxhën. Pati tullumbace të bardha të fryra me helium, për të lartësuar jetën e saj. Mes lotësh, nëna e Xhorxhës foli me ndjenjë për shtimin e besimit dhe të të kuptuarit që ajo ka marrë, dhe babai i Xhorxhës më tregoi qetas për dëshminë e premtuar që i ka ardhur atij.

Tok me besimin vijnë provat e besimit, duke sjellë shtim të besimit. Siguridhënia ngushëlluese e Zotit për Profetin Jozef Smith, është po i njëjti premtim që Ai ju bën juve në provën tuaj të besimit: “Qëndro . . . , mos ki frikë . . . , sepse Perëndia do të jetë me ty përherë e përgjithmonë”²⁸. Për këtë jap dëshminë time të shenjtë, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Shein M. Bouen, “Sepse Unë Jetoj, Edhe Ju do të Jetonit” dhe En M. Dib, “Unë e Di Këtë. Unë e Jetoj Këtë. Unë e Dua Këtë”, në sesionin e paradites së shtunës të konferencës së përgjithshme të tetorit 2012.
2. Gjoni 17:3.
3. 1 Pjetri 1:7.

4. Lluca 22:31–32.
5. 1 Pjetri 4:12; kursivi iu shtua.
6. Alma 1:25.
7. Efesianëve 2:19.
8. Doktrina e Besëlidhje 84:20.
9. Shih Mosia 18:8–10.
10. Tomas S. Monson, “Qëndroni në Vende të Shenjta”, *Liahona*, nëntor 2011, f. 82.
11. Shih Ezra Taft Benson, “The Law of Chastity”, *New Era*, janar 1988, f. 4–7; “The Law of Chastity” në *Brigham Young University 1987–88 Speeches* (1988), f. 1–5, speeches.byu.edu; shih edhe *Parimet e Ungjillit* (2010), f. 235–243.
12. “Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.
13. Mateu 5:28.
14. Gjoni 8:11.
15. Letërkëmbim vetjak, 2012.
16. Letërkëmbim vetjak, 2012.
17. Isaia 55:8–9.
18. Gjoni 14:27.
19. Shih Richard N. Ostling, “Challenging Mormonism’s Roots”, *Time*, 20 maj 1985, f. 44.
20. Shih Gordon B. Hinckley, “Lord, Increase Our Faith”, *Ensign*, nëntor 1987, f. 52.
21. Mormoni 9:31.
22. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 556.
23. Ezra Taft Benson, “The Book of Mormon Is the Word of God”, *Tambuli*, maj 1988, f. 6.
24. Helamani 5:12.
25. D. Tod Kristoferson “Bukën Tonë të Përditshme Na e Jep Sot” (Mbledhje rreth vatrës e Sistemit Arsimit të Kishës, 9 janar 2011), lds.org/broadcasts.
26. 1 Pjetri 1:7; shih edhe 1 Pjetri 4:13.
27. Ethëri 12:6.
28. Doktrina e Besëlidhje 122:9; Presidenti Xhorxh Q. Kenon tha: “Pavarësisht sa serioze prova, sa i thellë dëshpërimi, sa i madh hidhërimi, [Perëndia] kurrë nuk do të na braktisë. Kurrë nuk na ka braktisur dhe kurrë nuk do të na braktisë. Ai nuk mund ta bëjë. Nuk është karakteri i Tij. Ai është genie e pandryshueshme; i njëjti dje, i njëjti sot dhe do të jetë i njëjti gjatë gjithë epokave të përjetshme që vijnë. Ne e kemi gjetur atë Perëndi. Ne e kemi bërë Atë mik, duke iu bindur Ungjillit të Tij; dhe Ai do të qëndrojë krah nesh. Ne mund të përshkojmë furrën e zjarrtë; ne mund të përshkojmë ujërat e thella; por ne nuk do të shkatërrohemi e as do të dërmohemi. Nga të gjitha këto prova e vështirësi ne do të dalim më të mirë e më të pastër prej tyre, nëse vetëm i mirëbesojmë Perëndisë tonë dhe i zbatojmë urdhërimet e Tij” (“Remarks”, *Deseret Evening News*, Mar. 7, 1891, 4); shih edhe Jeffrey R. Holland, “Come unto Me”, *Ensign*, prill 1998, f. 16–23.



Nga Plaku Dallin H. Ouks,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Mbrojini Fëmijët

Askush nuk duhet t'i bëjë qëndresë lutjes që të bashkohemi për të rritur interesimin tonë për mirëqenien dhe të ardhmen e fëmijëve tanë – brezit të ri.

Të gjithë ne mund t'i kujtojmë ndjenjat tona kur një fëmijë i vogël qante me dënësë dhe na u drejtua për ndihmë. Një Atë i dashur Qiellor na i jep ato ndjenja për të na nxitur që t'i ndihmojmë fëmijët e Tij. Ju lutem, sillini ndër mend ato ndjenja ndërsa po flas për përgjegjësinë tonë që t'i mbrojmë dhe të veprojmë për mirëqenien e fëmijëve.

Unë flas nga këndvështrimi i ungjillit të Jezu Krishtit, përfshirë planin e Tij të shpëtimit. Kjo është thirrja ime. Udhëheqësit vendorë të Kishës kanë përgjegjësi për një zonë të vetme gjeografike, të tillë si një lagje ose kunj, por një Apostull është përgjegjës që t'i dëshmojë të gjithë botës. Në çdo komb, të çfarëdo race dhe besimi, të gjithë fëmijët janë fëmijë të Perëndisë.

Edhe pse nuk flas për sa u përket politikave ose politikës publike, ashtu si udhëheqës të tjerë të Kishës, nuk mund të flas për mirëqenien e fëmijëve pa diskutuar gjithashtu për zgjedhjet e bëra nga qytetarët, nëpunësit publikë dhe punonjësit në organizata private. Ne jemi të gjithë nën urdhrin e Shpëtimtarit për ta dashur e për t'u kujdesur për njëri-tjetrin dhe veçanërisht për të dobët e të pambrojturit.

Fëmijët janë jashtëzakonisht të cenueshëm. Ata kanë pak ose aspak fuqi

që të mbrohen apo të sigurojnë për vete, si dhe pak ndikim në kaç shumë gjëra që janë jetike për mirëqenien e tyre. Fëmijët kanë nevojë që të tjerët të flasin për ta dhe ata kanë nevojë për vendimmarrës që ta vendosin mirëqenien e tyre përpara interesave egoiste të të rriturve.

I.

Në mbarë botën, ne tronditemi nga miliona fëmijë që bëhen viktime të krimeve dhe egoizmit të lig të të rriturve.

Në disa vende në luftë, fëmijët i rrëmbejnë që të shërbejnë si ushtarë në ushtritë ndërluftuese.

Një raport i Kombeve të Bashkuara vlerëson se mbi dy milionë fëmijë bëhen viktime çdo vit nëpërmjet prostitucionit dhe pornografisë¹.

Nga këndvështrimi i planit të shpëtimit, një nga abuzimet më të rënda të fëmijëve është t'u mohosh atyre lindjen. Kjo është një prirje mbarëbotërore. Përqindja kombëtare e lindjeve në Shtetet e Bashkuara është më e ulta në 25 vite² dhe përqindjet e lindjeve në shumicën e vendeve europiane dhe aziatike janë nën nivelet e zëvendësimit [të popullsisë] prej shumë vitesh. Kjo nuk është thjesht një çështje fetare. Ndërsa brezi i ri zvogëlohet si numër, kulturat dhe

madje kombet dobësohen dhe përfundimisht zhduken.

Një nga shkaqet e zvogëlimit të përqindjes së lindjeve është kryerja e aborteve. Në mbarë botën, vlerësohet se kryhen më shumë se 40 milionë aborte në vit³. Shumë ligje e lejojnë ose madje e nxisin abortin, por për ne kjo është një e keqe e madhe. Abuzime të tjera të fëmijëve që ndodhin gjatë shtatzënisë, janë dëmtimet e fetusit që rezultojnë nga ushqimi i papërshtatshëm i nënës ose përdorimi i drogave prej saj.

Ka një ironi tragjike në morinë e fëmijëve të eliminuar ose të dëmtuar para lindjes, ndërkohë që shumë çifte jopjellore kanë mall dhe kërkojnë foshnja që t'i birësojnë.

Abuzimet në vegjëli ose shpërfillja e fëmijëve, që ndodhin pas lindjes, janë më të dukshme botërisht. Në mbarë botën, gati tetë milionë fëmijë vdesin përpara ditëlindjes së tyre të pestë, shumica prej sëmundjeve edhe të kurueshme edhe të parandalueshme⁴. Dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë raporton se një në katër fëmijë ka vonesë në rritje, mendërisht dhe fizikisht, për shkak të ushqimit të pamjaftueshëm.⁵ Duke jetuar dhe duke udhëtuar në mbarë botën, ne udhëheqësit e Kishës shohim shumë nga kjo. Presidenca e përgjithshme e Fillores raporton për fëmijë që jetojnë në kushte "përtej përfytyrimit tonë". Një nënë në Filipine tha: "Nganjëherë ne nuk kemi para mjaftueshëm për ushqim, por s'ka gjë, sepse kjo më jep mundësinë t'u mësoj fëmijëve të mi për besimin. Ne mblidhemi e lutemi për ndihmë dhe fëmijët e shohin se Zoti na bekon."⁶ Në Afrikën e Jugut, një punonjëse e Fillores hasi një vajzë të vogël, të vetmuar dhe të dëshpëruar. Me përgjigje të mekura ndaj pyetjeve të përzemërta, ajo tha se nuk kishte nënë, as baba dhe as gjyshe

– vetëm një gjysh që kujdesej për të.⁷ Tragjedi të tilla janë të zakonshme në një kontinent ku shumë përkujdesës kanë vdekur nga AIDS/SIDA.

Edhe në kombe të pasura, fëmijë të vegjël dhe të rinj dëmtohen nga lënia pas dore. Fëmijët që rriten në varfëri, kanë kujdes më të ulët shëndetësor dhe mundësi të përshtatshme arsimore. Ata gjithashtu ekspozohen ndaj mjediseve të rrezikshme në rrethanat e tyre fizike e kulturore dhe madje nga shpërfillja prej prindërve të tyre. Plaku Xhefri R. Holland së fundi tregoi përvojën e një polici shdm. Gjatë një hetimi, ai gjeti pesë fëmijë të vegjël të krupulllosur së bashku dhe në përpjekje për të fjetur pa shtrat në një dysheme të pistë, në një banesë ku nëna e tyre dhe njerëz të tjerë po pinin dhe po bënin festë. Në apartament nuk kishte ushqim për të lehtësuar urinë e tyre. Pasi i futi fëmijët në një shtrat të improvizuar, polici u gjunjëzua dhe u lut për mbrojtjen e tyre. Ndërsa eci drejt derës, një prej tyre, rreth gjashtë vjeç, e ndoqi, e rroku nga duart dhe iu përgjërua: “A do të më adoptosh të lutem?”⁸

Ne kujtojmë mësimet e Shpëtimtarit tonë kur Ai vuri një fëmijë të vogël para pasuesve të Tij dhe shpalli:

“Dhe kushdo që e pranon një fëmijë të vogël si ky në emrin tim, më pranon mua.

Por ai që do të skandalizojë një prej këtyre të vegjëlve që besojnë tek unë, do të jetë më mirë për atë t'i varet në qafë një gur mulliri (që e sjell rrotull gomari) dhe të zhytet në thellësi të detit” (Mateu 18:5–6).

Kur marrim parasysh rreziqet prej të cilave duhet të mbrohen fëmijët, duhet të përfshijmë gjithashtu abuzimin psikologjik. Prindërit ose kujdestarë të tjerë, ose mësuesit, ose bashkëmoshatarët që poshtërojnë, keqtrajtojnë,

ose përuhin fëmijë apo të rinj, mund të shkaktojnë dëmtim më të qëndrueshëm sesa dëmtimi fizik. Të bërit e një fëmije apo të riu që të ndihet i pavlerë, i padashur, ose i padëshiruar mund të shkaktojë dëmtim të rëndë dhe të zgjatur në mirëqenien dhe zhvillimin emocional të tij apo të saj⁹. Të rinjtë që po luftojnë me çfarëdo situatë të veçantë, përfshirë tërheqjen mes së njëjtës gjini, janë veçanërisht të cenueshëm dhe kanë nevojë për mirëkuptim të përzemërt – jo për keqtrajtim ose refuzim.¹⁰

Me ndihmën e Zotit, ne mund të pendohejmë e të ndryshojmë dhe të jemi më të përzemërt e të dobishëm ndaj fëmijëve – fëmijëve tanë dhe atyre rreth nesh.

II.

Ka pak shembuj të kërcënimeve fizike ose emocionale ndaj fëmijëve aq të rëndësishëm sa ato që rrjedhin nga marrëdhëniet e tyre me prindërit ose kujdestarët e tyre. Presidenti Tomas S. Monson ka folur për ato që ai i quajti “veprime të ulta” të abuzimit ndaj fëmijëve, ku një prind ka dëmtuar ose shpërfytyruar një fëmijë, fizikisht apo emocionalisht¹¹. Jam brengosur kur kam studiuar fakte tronditëse të rasteve të tilla gjatë shërbimit tim në Gjykatën e Lartë të Jutas.

Me rëndësi maksimale për mirëqenien e fëmijëve janë faktet nëse prindërit e tyre ishin të martuar, natyra dhe kohëzgjatja e martesës dhe, më gjerësisht, kultura dhe pritshmëritë për martesën e kujdesin ndaj fëmijëve në vendin ku jetojnë. Dy studiues të familjes shpjegojnë: “Gjatë gjithë historisë, martesë ka qenë së pari dhe mbi të gjitha një institucion për lindjen dhe rritjen e fëmijëve. Ajo ka siguruar nyjen kulturore që kërkon të lidhë babanë me fëmijët e tij duke e angazhuar atë ndaj nënës së fëmijëve të tij. Megjithatë, në kohët aktuale, fëmijët gjithmonë e më shumë po largohen nga qendra e vëmendjes.”¹²

Një profesor i ligjit në Harvard përkrauan ligjin dhe qëndrimin aktual kundrejt martesës dhe divorcit: “Historia [aktuale] amerikane mbi martesën, siç tregohet nga ligji dhe në literaturën shumë të përhapur, është diçka si kjo: martesë është një marrëdhënie që ekziston kryesisht për përmbushjen e bashkëshortëve individualisht. Nëse pushon së kryeri këtë funksion, askujt nuk i vihet faj dhe secili prej bashkëshortëve mund ta përfundojë atë sipas dëshirës. . . . Fëmijët mezi shfaqen në histori; më së shumti ata janë personazhe disi të turbullt në sfond.”¹³

Udhëheqësit e Kishës sonë kanë dhënë mësim se ta shohësh martesën



“si një kontratë të thjeshtë ku mund të hysh sipas qejfit . . . dhe mund ta prishësh në vështirësinë e parë . . . është një veprim i lig që meriton dënim të rreptë”, veçanërisht aty ku “fëmijëve do t’u shkaktohet vuajtje”¹⁴. Dhe fëmijët ndikohen nga divorcet. Më shumë se gjysma e divorceve në një nga vitet e fundit, përfshiu çifte me fëmijë në moshë të mitur.¹⁵

Shumë fëmijë do të kishin pasur bekimin e rritjes nga të dy prindërit e tyre vetëm nëse prindërit do të kishin ndjekur këtë mësim të frymëzuar në proklamaten mbi familjen: “Bashkëshorti dhe bashkëshortja kanë një përgjegjësi solemne të duan dhe të kujdesen për njëri-tjetrin dhe për fëmijët e tyre. . . . Prindërit kanë një detyrë të shenjtë për të rritur fëmijët e tyre me dashuri dhe drejtësi, për të plotësuar nevojat e tyre fizike dhe shpirtërore dhe për t’i mësuar ata ta duan e t’i shërbejnë njëri-tjetrit.”¹⁶ Mësimdhënia më e fuqishme për fëmijët është nëpërmjet shembullit të prindërve të tyre. Prindërit që divorcohen, pashmangshmërisht japin një mësim negativ.

Sigurisht ka raste kur një divorc është i domosdoshëm për të mirën e fëmijëve, por këto rrethana janë tepër të rralla¹⁷. Në shumicën e grindjeve martesore, prindërit që grinden, duhet t’u japin shumë më tepër peshë intereseve të fëmijëve. Me ndihmën e Zotit, ata mund ta bëjnë këtë. Fëmijëve u nevojitet forca emocionale dhe personale që vjen nga rritja prej të dy prindërve, të cilët janë të bashkuar në martesën e tyre dhe synimet e tyre. Si një njeri që u rrita nga një nënë e ve, e di nga përvoja personale se kjo nuk mund të arrihet gjithmonë, por është ideali që duhet të kërkohet kurdoherë që është e mundur.

Fëmijët janë viktimat e para të ligjeve aktuale që lejojnë të ashtuquajturit “divorce pa përgjegjësi”. Nga



këndvështrimi i fëmijëve, divorci është tepër i lehtë. Duke përmbledhur dekada kërkimesh në shkencat shoqërore, një studiues i kujdesshëm arriti në përfundimin se “struktura familjare që prodhon rezultatet më të mira për fëmijët, mesatarisht, përbëhet nga dy prindërit biologjikë që mbeten të martuar”¹⁸. Një autor në *New York Times* vuri re “faktin mbresëlënës se edhe pse martesat tradicionale është dobësuar në Shtetet e Bashkuara . . . janë rritur provat për rëndësinë e këtij institucioni për mirëqenien e fëmijëve”¹⁹. Ky realitet duhet të japë udhërrëfim të rëndësishëm për prindërit [aktualë] dhe prindërit e ardhshëm në vendimet e tyre në lidhje me martesën dhe divorcin. Neve na duhet gjithashtu që politikanët, politikëbërësit dhe nëpunësit ta shtojnë vëmendjen e tyre ndaj asaj që është më e mira për fëmijët përkundër interesave egoiste të votuesve dhe të zëdhënësve të interesave të të rriturve.

Fëmijët bëhen gjithashtu viktimat nga martesat që nuk kryhen. Pak fakte mbi mirëqenien e brezit tonë të ri janë më shqetësuese sesa raporti aktual se 41 për qind e të gjitha lindjeve në

Shtetet e Bashkuara u kryen nga gra që nuk ishin të martuara²⁰. Nënata e pamartuara kanë sfida të gjera dhe provat janë të qarta që fëmijët e tyre janë në situatë të rëndësishme të pafavorshme në krahasim me fëmijët e rritur nga prindër të martuar.²¹

Shumica e fëmijëve të lindur nga nëna të pamartuara – 58 për qind – u lindën nga çifte që po bashkëjetonin²². Çfarëdo gjëje që mund të themi për këto çifte që nuk po martohen, studimet tregojnë se fëmijët e tyre vuajnë situata të rëndësishme të pafavorshme në krahasim me fëmijët e tjerë.²³ Për fëmijët, qëndrueshmëria relative e martesës ka rëndësi.

Ne duhet të hamendësojmë të njëjtat situata të pafavorshme për fëmijët që rriten nga çifte të së njëjtës gjini. Literatura e shkencave shoqërore është e diskutueshme dhe me ngarkesë politike për ndikimet afatgjata të saj mbi fëmijët, kryesisht sepse, siç vërejt një autor i *New York Times*, “martesa brenda së njëjtës gjini është një eksperiment shoqëror dhe, ashtu si për shumicën e eksperimenteve, do të duhet kohë për të kuptuar pasojat e saj”²⁴.



III.

Unë kam folur në emër të fëmijëve – të fëmijëve gjithandej. Disa njerëz mund të mos i pranojnë disa prej këtyre shembujve, por askush nuk duhet t'i bëjë qëndresë lutjes që të bashkohemi për të rritur interesimin tonë për mirëqenien dhe të ardhmen e fëmijëve tanë – brezit të ri.

Ne po flasim për fëmijët e Perëndisë dhe, me ndihmën e Tij të fuqishme, mund të bëjmë më shumë për t'i ndihmuar ata. Në këtë lutje unë u drejtohem jo vetëm shenjtorëve të ditëve të mëvonshme por gjithashtu edhe të gjithë njerëzve me besim fetar dhe të tjerëve që kanë një sistem vlerash, i cili i bën t'ua nënshtrojnë nevojat e tyre personale atyre të njerëzve të tjerë, veçanërisht mirëqenies së fëmijëve.²⁵

Njerëzit fetarë gjithashtu janë të vetëdijshëm për mësimin e Shpëtimtarit në Dhiatën e Re se fëmijët e vegjël e të dëlirë janë modele për rolet tona për sa i përket përlësisë dhe aftësisë për të marrë mësim:

“Në të vërtetë po ju them: në qoftë se nuk ktheheni dhe nuk bëheni si fëmijët e vegjël, ju nuk do të hyni fare në mbretërinë e qiejve.

Kush, pra, do të përulet si ky fëmijë i vogël, do të jetë më i madhi në mbretërinë e qiejve” (Mateu 18:3–4).

Në Librin e Mormonit ne lexojmë për Zotin e ngritur që u mëson

nëfitëve se ata duhet të pendohen dhe të pagëzohen “dhe të bëhe[n] si një fëmijë i vogël” ose nuk do të mund të trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë (3 Nefi 11:38; shih edhe Moroni 8:10).

Unë lutem që ne do të përulemi si fëmijë të vegjël dhe do të zgjatemi që t'i mbrojmë fëmijët tanë të vegjël, sepse ata janë e ardhmja për ne, për Kishën tonë dhe për kombet tona. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih UNICEF, *The State of the World's Children 2005: Childhood Under Threat* (2004), f. 26.
2. Shih Haya El Nasser, “National Birthrate Lowest in 25 Years”, *USA Today*, 26 korrik 2012, A1.
3. Shih Gilda Sedgh and others, “Induced Abortion: Incidence and Trends Worldwide from 1995 to 2008”, *The Lancet*, vëll. 379, nr. 9816 (18 shkurt 2012), f. 625–632.
4. Shih UNICEF, “Young Child Survival and Development”, <http://www.unicef.org/childsurvival/index.html>.
5. Shih World Health Organization, *World Health Statistics 2012* (2012), f. 109, 118.
6. Report of Primary general presidency, 13 shtator 2012.
7. Report of Primary general presidency.
8. Shih Xhefri R. Holland, “Izrael, Izrael, Perëndia po Thërret”, (Sistemi Arsimor i Kishës, takim shpirtëror për të rinjtë në moshë madhore, 9 shtator 2012), si.lids.org; shih edhe R. Scott Lloyd, “Zion Not Only Where, but How We Live, Says Elder Holland”, *Deseret News*, 10 shtator 2012, B2.
9. Shih Kim Painter, “Parents Can Inflict Deep Emotional Harm”, *USA Today*, 30 korrik 2012, B8; Rachel Lowry, “Mental Abuse as Injurious as Other Forms of Child Abuse, Study Shows”, *Deseret News*, 5 gusht 2012, A3.

10. Shih “End the Abuses”, *Deseret News*, 12 qershor 2012, A10.
11. Thomas S. Monson, “A Little Child Shall Lead Them”, *Liahona*, qershor 2002, 2.
12. W. Bradford Wilcox and Elizabeth Marquardt, red., *The State of Our Unions: Marriage in America* (2011), f. 82.
13. Mary Ann Glendon, *Abortion and Divorce in Western Law: American Failures, European Challenges* (1987), f. 108.
14. David O. McKay, “Structure of the Home Threatened by Irresponsibility and Divorce”, *Improvement Era*, qershor 1969, f. 5.
15. Shih Diana B. Elliott dhe Tavia Simmons, “Marital Events of Americans: 2009”, *American Community Survey Reports*, gusht 2011.
16. “Familja: Një Proklamata drejtuar Botës”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.
17. Shih Dallin H. Ouks, “Divorci”, *Liahona*, maj 2007, f. 71; Konferenca e Përgjithshme, prill 2007, f. 82.
18. Charles Murray, *Coming Apart: The State of White America, 1960–2010* (2012), f. 158.
19. Ross Douthat, “Gay Parents and the Marriage Debate”, *New York Times*, 11 qershor 2012, <http://douthat.blogs.nytimes.com/2012/06/11/gay-parents-and-the-marriage-debate>.
20. Shih Joyce A. Martin and others, “Births: Final Data for 2010”, *National Vital Statistics Reports*, vëll. 61, nr. 1 (gusht 2012), f. 10.
21. Shih William J. Doherty and others, *Why Marriage Matters: Twenty-One Conclusions from the Social Sciences* (2002); W. Bradford Wilcox and others, *Why Marriage Matters: Thirty Conclusions from the Social Sciences*, bot. 3-të (2011).
22. Shih Martin, “Births: Final Data for 2010”, f. 10–11.
23. Shih Wilcox, *Why Marriage Matters*.
24. Douthat, “Gay Parents and the Marriage Debate”. Studimet më të fundit dhe më të plota gjejnë situata të rëndësishme të pafavorshme raportuar nga të rinjtë në moshë madhore me një prind që ka pasur marrëdhënie brenda të njëjtës gjini përpara se fëmija të mbushte 18 vjeç (shih Mark Regnerus, “How Different Are the Adult Children of Parents Who Have Same-Sex Relationships? Findings from the New Family Structures Study”, *Social Science Research*, vëll. 41 [2012], f. 752–770).
25. Shenjtorët e ditëve të mëvonshme janë veçanërisht të zotuar ndaj prindërimit si një nga synimet më të rëndësishme në jetë (shih Pew Research Center's Forum on Religion and Public Life, *Mormons in America: Certain in Their Beliefs, Uncertain of Their Place in Society*, 12 janar 2012, f. 10, 16, 51).



Nga Plaku D. Tod Kristoferson,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Vëllezër, Ne Kemi Punë për të Bërë

Si burra të priftërisë, ne kemi një rol thelbësor për të luajtur në shoqëri, në shtëpi dhe në Kishë.

Vëllezër, shumë është thënë dhe shkruar vitet e fundit rreth sfidave të burrave dhe djemve. Pak shembuj të titujve të librave, për përmendur disa, përfshijnë *Why There Are No Good Men Left [Përse nuk kanë mbetur burra të mirë]*, *The Demise of Guys [Fund i njerëzve]*, *The End of Men [Fund i burrave]*, *Why Boys Fail [Përse dështojnë djemtë]* dhe *Manning Up [Burrërimi]*. Interesant, shumica e këtyre duket të ketë qenë shkruar nga gra. Sidoqoftë, një fill i përbashkët që përshkon këto analiza, është se, në shumë shoqëri sot, burrat po marrin sinjale pështjelluese dhe kontradiktore mbi rolet dhe vlerat e tyre në shoqëri.

Autori i *Burrërim* e karakterizoi në këtë mënyrë: “Ka qenë thuajse një rregull universal i qytetërimit që, ndërsa vajzat bëheshin gra thjesht duke arritur pjekurinë fizike, djemtë duhej të kalonin një provë. Ata duhej të demonstrojnë kurajë, vlerë fizike apo zotërim të aftësive të nevojshme. Qëllimi ishte të vërtetonin kompetencën e tyre si mbrojtës të grave dhe fëmijëve; ky ishte gjithmonë roli i tyre parësor social. Sot, sidoqoftë, me gra

që shkojnë përpara në një ekonomi të përparuar, burrat dhe baballarët siguroes të të ardhurave nuk janë detyrim tani dhe cilësitë e karakterit që u nevojiteshin burrave për të luajtur rolin e tyre – guximi, durimi, kuraja, besnikëria – janë të vjetra dhe madje pak sikletosëse.”¹

Në zellin e tyre për të nxitur mundësi për gratë, gjë që ne e vlerësojmë, ka nga ata që ua ulin vlerën burrave dhe kontributeve të tyre. Ata duket se e mendojnë jetën si një garë midis mashkullit dhe femrës – që njëri duhet ta sundojë tjetrin dhe tani është radha e grave. Disa argumentojnë se një karrierë është gjithçka dhe martesë e fëmijët duhet të jenë tërësisht fakultative – prandaj, përse na duhen burrat?² Në shumë filma të Hollivudit, shfaqje në TV dhe kabllorë dhe madje reklama, burrat portretizohen si të paaftë, të papjekur apo egoistë. Ky zhburrërim kulturor i meshkujve po ushtron një ndikim të dëmshëm.

Në Shtetet e Bashkuara, për shembull, raportohet se: “Vajzat ua kalojnë djemve tani në çdo nivel, nga shkolla

fillore deri në shkollën e lartë. Në klasën e tetë, për shembull, vetëm 20 për qind e djemve janë të aftë në të shkruar dhe 24 për qind në të lexuar. Ndërkohë, rezultatet e të rinjve në provimin për në kolegji në 2011-ën ishin më të ulëtat që kanë qenë gjatë 40 viteve. Sipas Qendrës Kombëtare për Statistikat e Arsimit, djemtë kanë 30 për qind më shumë gjasë sesa vajzat që ta ndërpresin edhe shkollën e mesme edhe kolegjin. . . . Parashikohet që gratë do të fitojnë 60 për qind diplomën e shkallës së parë të universitetit, 63 për qind diplomën e masterit dhe 54 për qind doktoratën në 2016-ën. Dy të tretat e studentëve në programet e veçanta për të prapambeturit në arsim janë meshkuj.”³

Disa burra dhe të rinj i kanë marrë sinjalet negative si një justifikim për të shmangur përgjegjësinë dhe kurrë nuk rriten vërtet. Në një vëzhgim që është shumë shpesh një karakterizim i drejtë, një profesor universiteti vërejt: “Burrat futen në klasë me kaskat e tyre të bejsbollit të vendosura mbrapsht dhe justifikime [mburoja e tyre] si ‘procesori i uordit (programi word) ma hëngri detyrën e shtëpisë’. Ndërkohë, gratë kontrollojnë programet e tyre ditore dhe kërkojnë rekomandime për një shkollë jurisprudence.”⁴ Një kritike filmash femër shprehu pikëpamjen mjaft përbuzëse se “ajo për çka ne mund t’i llogarisim burrat, nëse jemi me fat dhe zgjedhim të kemi një partner, është të jetë vetëm kjo – një partner. Dikush që qëndron në hapësirën e vet për aq sa ai respekton pavarësinë tonë.”⁵

Vëllezër, nuk mund të jetë kështu me ne. Si burra të priftërisë, ne kemi një rol thelbësor për të luajtur në shoqëri, në shtëpi dhe në Kishë. Por ne duhet të jemi burra që gratë mund t’u besojnë, që fëmijët mund t’u besojnë dhe që Perëndia mund t’u



Dhe kështu të gjithëve që po mbajnë vesh, kudo që ky mesazh mund të vijë te ju, unë ju them siç i tha Jehovai Jozueut: “Ji i fortë dhe trim” (Jozueu 1:6). Merrni zemër dhe përgatituni sa më mirë që mundeni, cilatdo qofshin rrethanat tuaja. Përgatituni për të qenë një bashkëshort dhe baba i mirë; përgatituni për të qenë një qytetar i mirë dhe frytdhënës; përgatituni për t’i shërbyer Zotit, priftërinë e të cilit mbani. Kudo që jeni, Ati ynë Qiellor mendon për ju. Ju nuk jeni vetëm; dhe ju keni priftërinë dhe dhuratën e Frymës së Shenjtë.

Nga shumë vende ku ka nevojë për ju, një nga më të rëndësishmit është kuorumi i priftërisë. Neve na nevojiten kuorume që sigurojnë ushqim shpirtëror për anëtarët të dielën dhe që gjithashtu shërbejnë. Ne kemi nevojë për udhëheqës kuorumesh që përqendrohen në bërjen e punës së Zotit dhe në mbështetjen e anëtarëve të kuorunit dhe të familjeve të tyre.

Mendoni për punën misionare. Të rinj, ju nuk keni kohë për të humbur. Ju nuk mund të prisni për t’u bërë seriozë derisa të bëheni 17 apo 18 vjeç. Kuorumet e Priftërisë Aarone mund t’i ndihmojnë anëtarët e tyre që ta kuptojnë betimin dhe besëlidhjen e priftërisë dhe që të bëhen gati për shugurim si pleq, ata mund t’u ndihmojnë atyre që t’i kuptojnë dhe të përgatiten për ordinancat e tempullit; dhe ata mund t’u ndihmojnë që të bëhen gati për misione të suksesshme. Kuorumet e Priftërisë Melkizedeke dhe Shoqata e Ndihmës mund t’u ndihmojnë prindërve që të përgatisin misionarë që e njohin Librin e Mormonit dhe që do të shkojnë në terrenin e misionit plotësisht të zotuar. Dhe në çdo lagje dhe degë, po këto kuorume mund të udhëheqin në një bashkëpunim të efektshëm me misionarët kohëplotë që po shërbejnë atje.

besojë. Në Kishë dhe në mbretërinë e Perëndisë në këto ditë të mëvonshme, ne nuk mund të kemi djem dhe burra që nuk angazhohen aktivisht në punë. Ne nuk mund të kemi të rinj pa vetëdisiplinë dhe që jetojnë vetëm për t’u argëtuar. Ne nuk mund të kemi të rritur në moshë madhore që nuk po shkojnë gjëkund në jetë, që nuk janë seriozë rreth formimit të familjes dhe dhënies së një ndihmese reale në këtë botë. Ne nuk mund të kemi bashkëshortë dhe baballarë që nuk sigurojnë udhëheqje shpirtërore në shtëpi. Ne nuk mund t’ia lejojmë vetes që ata që e mbajnë dhe e ushtrojnë Priftërinë e Shenjtë, sipas Urdhrit të Birit të Perëndisë, ta shpërdorojnë fuqinë e tyre në pornografi apo ta kalojnë jetën e tyre në hapësirën kibernetike (ironikisht, duke qenë të botës pa qenë në botë).

Vëllezër, ne kemi punë për të bërë.

Të rinj, ju nevojitet të keni rezultate të mira në shkollë dhe pastaj të vazhdoni arsimin tuaj përtej shkollës së mesme. Disa nga ju do të duan të ndjekin studimet universitare dhe karriera në biznes, bujqësi, qeveri, apo profesione të tjera. Disa do të shquhen në arte, muzikë apo mësuesi. Të tjerë do të duan të zgjedhin një karrierë ushtarake apo të mësojnë një zanat. Gjatë viteve, unë kam pasur një numër zanaçinsh që punonin në projekte dhe riparime në shtëpinë time dhe unë kam admiruar punën e rëndë e mjeshtërinë e këtyre burrave. Në çfarëdo që zgjidhni, është thelbësore

që ju të bëheni të aftë në mënyrë që të mund të mbështesni familjen dhe të jepni ndihmesë të vlefshme në komunitetin tuaj dhe vendin tuaj.

Kohët e fundit, pashë një video që tregonte një ditë nga jeta e një të riu 14-vjeçar në Indi me emrin Amar. Ai ngrihet herët dhe punon në dy punë, përpara dhe pas shkollës, gjashtë ditë e gjysmë në javë. E ardhura e tij siguron një pjesë thelbësore për jetesën e familjes së tij. Ai nxiton për në shtëpi me biçikletën e tij të vjetër nga puna e dytë pasi erret dhe gjen kohë për detyrat e shtëpisë, përpara se të lëshohet në krevatin e tij në dysheme, midis vëllezërve e motrave të tij që flenë, rreth orës njëmbëdhjetë të natës. Edhe pse nuk e kam takuar kurrë, unë ndihem krenar për të për zellin dhe kurajën e tij. Ai po bën më të mirën që mundet, me burimet dhe mundësitë e tij të kufizuara, dhe është një bekim për familjen e vet.

Ju burra të rritur – baballarë, të rritur beqarë, udhëheqës, mësues shtëpie – jini modele të denja dhe ndihmoheni brezin e djemve që po rriten, që të bëhen burra. Mësojuni atyre aftësi shoqërore dhe të tjera: si të marrin pjesë në një bashkëbisedim, si të njihen dhe të ndërveprojnë me të tjerë, si të bisedojnë dhe t’i kuptojnë gratë e vajzat, si të shërbejnë, si të jenë aktivë dhe ta gëzojnë kohën e lirë, si t’i ndjekin gjërat që u pëlqejnë pa u bërë të varur, si t’i korrigojnë gabimet dhe të bëjnë zgjedhje më të mira.

Një detyrë përkatëse që është kryesisht përgjegjësi e priftërisë, është thirrja e Shpëtimtarit, e përsëritur nga Presidenti Tomas S. Monson, për t'i shpëtuar ata që janë larguar nga Kisha ose që janë bërë të pakënaqur për çfarëdo arsye. Ne kemi një sukses të mrekullueshëm në këtë përpjekje, përfshirë punë të mrekullueshme nga të rinjtë. Një kuorum i Priftërisë Aarone në Lagjen (spanjolle) Rio Grande në Albuquerk të Nju-Meksikos, u konsultua së bashku rreth atyre që mund të rikthente, dhe pastaj si grup shkuan të vizitonin secilin prej tyre. Njëri tha: "Kur ata erdhën te dera ime, unë u ndieva i rëndësishëm", dhe një tjetër tha në mirëbesim: "Unë ndihem i lumtur në vetvete që dikush vërtet do që unë të shkoj në kishë; kjo më bën tani që të dua të shkoj në kishë". Kur anëtarët e kuorumit e ftuan një të ri që të rikthehej, ata i kërkuan të shkonte me ta në vizitën e radhës dhe ai shkoi. Ata nuk po e ftonin atë të vinte në kishë; ata po e bënë aty për aty pjesë të kuorumit.

Në punë tjetër sfiduese por nxitëse e priftërisë është ajo e historisë familjare dhe e tempullit. Prisni për një letër të Presidencës së Parë që do të vijë së shpejti dhe do të ofrojë një thirrje të ripërtërirë e një vështrim më të epërm të kësaj pjese jetike të punës që duhet të bëjmë.

Kuorumet tona përbëjnë gjithashtu një vëllazëri mbështetjeje të ndërsjelltë. Presidenti Gordon B. Hinkli dikur tha: "Do të jetë një ditë e mrekullueshme, vëllezër të mi – do të jetë një ditë e përmbushjes së qëllimeve të Zotit – kur kuorumet tona të priftërisë të bëhen një spirancë force për çdo burrë që u përket atyre, kur çdo burrë i tillë mund të jetë në gjendje të thotë siç duhet: 'Unë jam anëtar i një kuorumi priftërie të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të

Mëvonshme. Unë qëndroj gati për t'i ndihmuar vëllezërit e mi në të gjitha nevojat e tyre, siç jam i sigurt se ata janë gati të më ndihmojnë në të miat. . . . Duke punuar së bashku, ne mund të qëndrojmë, pa zor dhe pa frikë, kundër çdo ere fatkeqësie që mund të fryjë, qoftë ekonomike, shoqërore apo shpirtërore.'"⁶

Me gjithë përpjekjet tona më të mira, gjërat jo gjithmonë dalin siç kemi planifikuar dhe një "kohë fatkeqësie" e veçantë që mund të vijë në jetën e një njeriu, është papunësia. Një broshurë e hershme e Kishës për mirëqenien deklaronte: "Një burrë pa punë është i një rëndësie të veçantë për Kishën, sepse i privuar nga prirja e tij e natyrshme për të punuar, ai është në sprovë siç ishte Jobi në sprovë – për ndershmërinë e tij. Ndërsa ditët kthehen në javë dhe muaj e madje në vite fatkeqësie, dhembja bëhet më e thellë. . . . Kisha nuk mund të shpresojë ta shpëtojë një burrë të dielën nëse gjatë javës shih sprovat e ashpra nëpër të cilat ai kalon dhe nuk bën asgjë për këtë."⁷

Në prill të 2009-ës, ish-këshilltari i Peshkopatës Kryesuese, Riçard C. Exhli, tregoi historinë e një kuorumi shembullor që u mobilizua për të ndihmuar një anëtar që pati humbur punën e tij:

"Ofiçina 'Fil's Auto' e Sentervilit, në Juta, është një dëshmi se çfarë mund të bëjë udhëheqja e priftërisë dhe një kuorum. Fili ishte anëtar i një kuorumi pleqsh dhe punonte si mekanik në një ofiçinë vendore për riparim automjesh. Fatkeqësisht, ofiçina e riparimeve ku punonte Fili, pati një problem financiar dhe duhej ta pushonte Filin nga puna. Ai u rrënuar nga mënyra si rrodhën ngjarjet.

Kur dëgjoi për humbjen e punës të Filin, peshkopi i tij, Leon Olson, dhe udhëheqja e tij e kuorumit të pleqve,

me lutje, shqyrtuan mënyrat për ta ndihmuar Filin të ringrihej. Në fund të fundit, ai ishte një bashkanëtar kuorumi, një vëlla dhe kishte nevojë për ndihmë. Ata arritën në përfundimin se Fili i kishte aftësitë të mbante biznes të vetin. Një nga anëtarët e kuorumit u shpreh se kishte një hangar të vjetër që ndoshta mund të përdorej si ofiçinë riparimesh. Anëtarë të tjerë të kuorumit mund të ndihmonin me mbledhjen e veglave dhe furnizimet e nevojshme për ta pajisur ofiçinën e re. Thuajse secili në kuorum mundej të paktën të ndihmonte që të pastrohej hangari i vjetër.

Ata ia treguan idetë e tyre Filin; pastaj ua treguan planin anëtarëve të kuorumit të tyre. Hangari u pastrua dhe u rinovua, veglat u grumbulluan dhe gjithçka u vendos në rregull. 'Fil's Auto' u bë një sukses dhe përfundimisht u transferua në një vend më të mirë dhe më rezident – dhe e gjithë kjo sepse vëllezërit e tij në kuorum ndihmuan në kohë krize."⁸

Sigurisht, siç është përsëritur nga profetët ndër vite: "Gjëja më e rëndësishme e punës së Zotit që do të bëni ndonjëherë, do të jetë brenda mureve të shtëpisë suaj"⁹. Ne kemi shumë për të bërë për ta forcuar martesën në shoqëritë që gjithnjë e më shumë e konsiderojnë të parëndësishme dhe nuk i pranojnë rëndësinë dhe qëllimin e saj. Ne kemi shumë për të bërë për t'i mësuar fëmijët tanë "të luten dhe të ecin drejt përpara Zotit" (DeB 68:28). Detyra jonë nuk është asgjë më pak sesa t'i ndihmojmë fëmijët tanë të përjetojnë ndryshimin e fuqishëm të zemrës apo kthimin në besim te Zoti që thuhet aq qartë në Librin e Mormonit (shih Mosia 5:1–12; Alma 26). Së bashku me Shoqatën e Ndhmës, kuorumet e priftërisë mund të formojnë prindër dhe martesë, dhe kuorumet mund të japin bekimet e

priftërisë për familje me një prind.

Po, vëllezër, ne kemi punë për të bërë. Faleminderit për sakrificat që bëni dhe të mirën që bëni. Vazhdoni dhe Zoti do t'ju ndihmojë. Ndonjëherë ju mund të mos e dini saktësisht çfarë të bëni ose çfarë të thoni – thjesht shkoni përpara. Filloni të veproni dhe Zoti siguron që “një derë frytdhënëse do të hapet për [ju]” (DeB 118:3). Filloni të flisni dhe Ai premtan: “Ju nuk do të ngatërroheni përpara njerëzve; Sepse do t'ju jepet në orën e duhur, po, në çastin e duhur, se çfarë duhet të thoni” (DeB 100:5–6). Është e vërtetë se ne jemi në shumë mënyra të zakonshëm dhe të papërsosur, por ne kemi një Mësues të përsosur që kreu një Shlyerje të përsosur, dhe ne kemi thirrje në hirin e Tij dhe në priftërinë e Tij. Kur ne pendo kemi dhe pastrojmë shpirtat tanë, neve na premtan se do të mësohemi dhe do të na dhurohet fuqi nga lart (shih DeB 43:16).

Kisha dhe bota, si dhe gratë po bëjnë thirrje për burra, burra që po zhvillojnë aftësinë dhe talentet e tyre,

që janë të gatshëm të punojnë dhe të bëjnë sakrifica, që do t'i ndihmojnë të tjerët për të arritur lumturi dhe shpëtim. Ata po thërrasin: “Ngrihuni, ju burra të Perëndisë!”¹⁰ Perëndia na ndihmon ta bëjmë këtë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Kay S. Hymowitz, *Manning Up: How the Rise of Women Has Turned Men into Boys* (2011), f. 16.
2. “Kur i pyet të rinjtë sot çfarë do t'i bëjë ata të rritur, thuajse asnjë nuk e përmend martesën. Ka shumë më tepër gjasa që t'i shohin çështjet lidhur me punën – plotësimin e arsimit, pavarësinë financiare, një punë kohëplotë – si shenja se kanë arritur sukses. Puna, karriera, pavarësia: këto janë burime parësore të identitetit sot” (Hymowitz, *Manning Up*, f. 45). Presioni mbi gratë për ta përvetësuar këtë qëndrim kundër martesës është veçanërisht i fortë. Një artikullshkruese e *Times* të Londrës shkruante: “Askush, as familja ime apo mësuesit e mi, nuk thanë ndonjëherë: ‘Oh po, dhe meqë ra fjala ti mund të duash të jesh bashkëshorte dhe nënë gjithashtu’. Ata ishin aq të vendosur që ne të ndiqnim një shteg të ri, barazimtar, të kohës, sa që ambiciet historike të brezave të grave – për t'u martuar dhe për të ngritur familje – qenë fshirë qëllimisht nga përfytyrimi i tyre mbi të ardhmen tonë” (Eleanor Mills,

“Learning to Be Left on the Shelf”, *Sunday Times*, 18 prill 2010, www.thetimes.co.uk; në Hymowitz, *Manning Up*, f. 72). Një tjetër shkrimtare në të 40-at e saj citonte disa përgjigje ndaj një artikulli që ajo kishte shkruar rreth keqardhjeve të saj që nuk ishte martuar: “Unë jam tërësisht e tronditur nga nevoja juaj për një burrë”, “Kini pak vetëvlërësim!” “Ju e keni çuar varësinë në një nivel të ulët tërësisht të ri” dhe “Nëse bija ime do ta dëshirojë një burrë sa gjysma juaj kur të rritet, unë do ta di se kam bërë diçka gabim në rritjen e saj” (Lori Gottlieb, *Marry Him: The Case for Settling for Mr. Good Enough* [2010], f. 55).

Lajmi i mirë është se shumica e njerëzve, përfshirë të rinjtë në moshë madhore, nuk po besojnë te mesazhet kundër martesës, kundër familjes. “Sipas një studimi nga një ekonomist i Universitetit të Pensilvanisë, në Shtetet e Bashkuara në 2008-ën, 86 për qind e grave të bardha me arsimim kolegji ishin martuar rreth moshës 40 vjeç, krahasuar me 88 për qind të atyre që kishin më pak se një gradë arsimimi katërvjeçar. Shifrat për burrat e bardhë me arsimim kolegji janë të ngjashme: 84 për qind e tyre ishin martuar rreth moshës 40-vjeçare në 2008-ën. Urtësia e zakonshme, e pambështetur nga kërkimet, sidoqoftë, mund të thotë se martesë është një pazar i keq për gratë. Por gratë e bardha me arsimim kolegji nuk duket se e besojnë këtë. Nga cilido grup ato kanë më shumë gjasa që të mendojnë se ‘njerëzit e martuar janë në përgjithësi më të lumtur se njerëzit e pamartuar’. . . . Shumica e madhe – 70 për qind – e studenteve të kolegjit në vit të parë mendojnë se ngritja e një familjeje është ‘thelbësore’ ose ‘shumë e rëndësishme’ për të ardhmen e tyre” (Hymowitz, *Manning Up*, f. 173–174).

3. Philip G. Zimbardo dhe Nikita Duncan, *The Demise of Guys: Why Boys Are Struggling and What We Can Do about It* (2012), libër elektronik; shih kapitullin “Behind the Headlines”.
4. Barbara Dafoe Whitehead, *Why There Are No Good Men Left: The Romantic Plight of the New Single Woman* (2003), f. 67.
5. Amanda Dickson, “‘Hunger Games’ Main Character a Heroine for Our Day”, *Deseret News*, 2 prill 2012, www.deseretnews.com.
6. Gordon B. Hinckley, “Welfare Responsibilities of the Priesthood Quorums”, *Ensign*, nëntor 1977, f. 86.
7. *Helping Others to Help Themselves: The Story of the Mormon Church Welfare Program* (1945), f. 4.
8. Richard C. Edgley, “This Is Your Phone Call”, *Liahona*, maj 2009, f. 54.
9. *Teachings of Presidents of the Church: Harold B. Lee* [2000], f. 134.
10. “Rise Up, O Men of God”, *Hymns*, nr. 323.





Peshkopi Geri E. Stivenson,
Peshkop Kryesues

Ji Trim me Guxim, Fuqi dhe Energji

Kualifikojeni veten siç bënë 2.000 ushtarët e rinj duke qenë trima me kurajë si mbajtës të denjë të priftërisë.

Sonte ndihem veçanërisht i bekuar të flas si peshkop për të rinjtë, mbajtësit e Priftërisë Aarone, mbledhur nga e gjithë bota për të dëgjuar këtë mbledhje të përgjithshme të priftërisë. Do t'ju tregoj një ngjarje nga Libri i Mormonit që përshkruan Helamanin dhe 2.000 ushtarët e tij të rinj. Ky shkrim i shenjtë do të japë një depërtim të karakteri i atyre të rinjve – dhe frymëzim për ju, të rinj të ditëve të mëvonshme. Po citoj një shkrim të shenjtë të parapëlqyer: “Dhe që të gjithë ishin djem të rinj dhe ishin jashtëzakonisht trima, për sa i përket guximit dhe gjithashtu fuqisë dhe energjisë; por vini re, kjo nuk ishte e gjitha – ata qenë njerëz të besuar në çdo kohë”¹. Guxim, fuqi, energji dhe të besuar – tipare shumë të admirueshme!

Do të doja të përqendrohesh tek tipari i parë që i përshkruan ata: “trima, për sa i përket guximit”. Për mua, kjo përshkruan bindjen e këtyre të rinjve për të bërë me guxim atë që është e drejtë, ose siç përshkruan Alma: “të qëndrojnë] si dëshmitarë të Perëndisë në të gjitha kohërat . . . dhe në të gjitha vendet”². 2.000 ushtarët e rinj patën çaste të panumërta për ta

treguar konkretisht guximin e tyre. Secili prej jush do të ketë gjithashtu çaste të rëndësishme në jetën e tij kur do të duhet guxim. Një mik i imi, Xhoni, më tregoi një nga ato çaste të jetës së tij.

Disa vite më parë, Xhoni që pranuar në një universitet të shquar japonez. Ai do të ishte pjesë e një programi ndërkombëtar studentësh me shumë studentë të tjerë nga më të mirët nga e gjithë bota. Disa u regjistruan me shpresën që të thellojnë kuptimin e tyre për kulturën dhe gjuhën, të tjerë e shihnin atë si një hap drejt një profesioni dhe punësimit të mundshëm në Japoni, por të gjithë studentët ishin larguar nga shtëpia për të studiuar në një vend të huaj.

Pak pas mbërritjes së Xhonit, u fol midis popullatës së studentëve të huaj, për një festë që do të bëhej në tarracën e një banese private. Atë mbrëmje, Xhoni dhe dy miq shkuan për tek adresa e njoftuar.

Pas ngritjes me ashensor për në katin e sipërm të ndërtesës, Xhoni dhe miqtë e tij ndoqën shkallën e ngushtë teke që të çonte në tarracë dhe filluan të bisedonin me të tjerët. Ndërsa u bë vonë natën, atmosfera ndryshoi. Zhurma, volumi i muzikës dhe alkooli

u shtuan, ashtu si dhe shqetësimi i Xhonit. Pastaj befasisht dikush filloi t'i organizonte studentët në një rreth të madh me qëllim që të ndante cigare marihuane. Xhoni bëri një ngërdheshje dhe u tha dy miqve të tij se ishte koha të largoheshin. Thuajse ngacmueshëm, njëri prej tyre u përgjigj: “Xhon, kjo është e lehtë – thjesht do të qëndrojmë në rreth dhe kur të na vijë radha, thjesht do t'ia kalojmë tjetrit në vend që ta tymosim. Në këtë mënyrë ne nuk do të na duhet ta sikletosim veten përpara të gjithëve duke u larguar.” Kjo tingëlloi e lehtë për Xhonin, por nuk tingëlloi e drejtë. Ai e dinte se duhej ta thoshte synimin e tij dhe të vepronte. Brenda një çasti, mori guximin dhe u tha atyre se mund të bënin si t'u pëlqente, por ai po largohej. Njëri prej miqve vendosi të qëndrojë dhe u bashkua në rreth; tjetri pa qejf ndoqi Xhonin poshtë shkallëve për t'u futur në ashensor. Për befasinë e tyre të madhe, kur dyert e ashensorit u hapën, oficerët e policisë japoneze dolën dhe nxituan për t'iu ngjitur shkallëve për në tarracë. Xhoni dhe miku i tij u futën në ashensor dhe u larguan.

Kur policia arriti në krye të shkallëve, studentët me shpejtësi hodhën drogat ilegale nga tarraca që të mos kapeshin. Pasi siguruan shkallët, sidoqoftë, oficerët rreshtuan secilin në tarracë dhe i kërkuan secilit student të zgjaste të dy duart. Oficerët atëherë kaluan nëpër rresht, duke nuhatur me kujdes gishtat e mëdhenj dhe ata tregues të secilit student. Të gjithë ata që patën mbajtur marihuana, pavarësisht nëse e kishin tymosur apo jo, besohej të ishin fajtorë dhe kishte pasoja tepër të rënda. Thuajse pa përjashtim, studentët që patën qëndruar në tarracë, u përjashtuan nga universitetet e tyre përkatëse dhe ata të dënuar për krim me gjasa u dëbuan nga Japonia. Ëndrrat e një arsimit, vite përgatitjeje

dhe mundësia e një punësimi të ardhshëm në Japoni, u rrënuan në një çast.

Tani më lejoni t'ju tregoj çfarë ndodhi me këta tre miq. Miku që qëndroi në tarracë, u dëbua nga universiteti në Japoni, për të cilin pati punuar aq shumë që të pranohej dhe iu kërkua të kthehej në shtëpi. Miku që la festën atë natë me Xhonin, e përfundoi shkollën në Japoni dhe vazhdoi të fitonte grada shkencore në dy universitete nga më të mirët në Shtetet e Bashkuara. Karriera e tij e riktheu në Azi, ku ai ka pasur një sukses profesional të pallogaritshëm. Ai mbetet mirënjohës deri sot për shembullin guximtar të Xhonit. Ndërsa për Xhonin, pasojat në jetën e tij kanë qenë të pamatshme. Koha e tij në Japoni atë vit, e çoi atë në një martesë të lumtur dhe në lindjen më pas të dy djemve. Ai ka qenë një sipërmarrës shumë i suksesshëm dhe kohët e fundit u bë

profesor në një universitet japonez. Përfytyroni sa ndryshe do të kishte qenë jeta e tij nëse nuk do të kishte pasur guximin të largohej nga festa në atë mbremje të rëndësishme në Japoni.³

Të rinj, do të ketë kohë kur juve, si Xhoni, do t'ju duhet të tregoni guximin tuaj të drejtë ndërsa bashkëmoshatarët tuaj ju shohin, pasojat e së cilës mund të jenë tallja dhe sikleti. Përveç kësaj, në botën tuaj me teknologji, përleshjet me kundërshtarin do të kryhen gjithashtu në një fushëbetejë të heshtur, vetmitare, përpara një ekrani. Teknologjia me përfitimet e saj të dukshme, sjell gjithashtu sfida me të cilat nuk janë përballur brezat përpara jush. Një studim kombëtar i kohëve të fundit zbuloi se adoleshentët e sotëm nuk tundohen në nivele dëshpëruese çdo ditë vetëm në shkollë, por gjithashtu duke përdorur internetin. Studimi

zbuloi se adoleshentët që ishin gjendur përpara pamjesh të përdorimit të pijes apo drogës në faqe rrjetesh shoqërore, kishin tre deri katër herë më shumë gjasa që të përdornin alkoolin apo drogat. Duke komentuar mbi studimin, një ish-sekretar i kabinetit të presidentit të SHBA-së deklaroi: "Studimi i këtij viti zbulon një lloj të ri të presionit të fuqishëm nga bashkëmoshatarët – presioni dixhital i shokëve. Presioni dixhital i shokëve lëviz përtej miqve të një fëmije dhe fëmijëve me të cilët ata shoqërohen. Ai sulmon shtëpinë dhe dhomën e gjumit të fëmijës nëpërmjet internetit."⁴ Shfaqja e guximit të drejtë do të jetë shpesh aq e lehtë sa të klikosh apo të mos klikosh. Misionarëve u është mësuar nga *Predikoni Ungjillin Tim*: "Ajo që ju zgjidhni të mendoni dhe të bëni kur jeni vetëm dhe kur mendoni se askush nuk po ju shikon, është një masë e fortë e virtytit tuaj"⁵. Jini guximtarë! Jini të fortë! "Qëndroni në vende të shenjta dhe mos lëvizni."⁶

Të rinj, unë premtoj se Zoti do t'ju fuqizojë. "Sepse Perëndia nuk na ka dhënë frymë frike, por force."⁷ Ai do t'ju shpërblejë për guximin dhe sjelljen tuaj të drejtë – me lumturi dhe gëzim. Një guxim i tillë do të jetë rezultat i besimit tuaj në Jezu Krisht dhe në Shlyerjen e Tij, i lutjeve tuaja dhe i bindjes tuaj ndaj urdhërimeve.

Presidenti N. Eldon Taner tha: "Një djalë i ri në mjedisin e shkollës mund të ketë një ndikim të fuqishëm për mirë. Një i ri në skuadrën e futbollit ose në konviktet e studentëve, apo midis bashkëpunonjësve të tij mundet, duke e jetuar ungjillin, të nderojë priftërinë e tij dhe, duke mbrojtur të drejtën, të bëjë mirësi të pamatshme. Shpesh ju do të përjetoni shumë kritika dhe tallje madje nga ata që besojnë të njëjtat gjëra si ju, edhe pse ata mund t'ju respektojnë që veproni drejt. Por kujtoni se vetë Shpëtimtari u torturua,





u tall, u pështy dhe në fund u kryqëzua sepse nuk u lëkund në bindjen e Tij. A keni ndaluar ndonjëherë të mendoni se çfarë do të kishte ndodhur nëse Ai do të dobësohej dhe do të thoshte: ‘Ç’dobi sjell kjo?’ dhe do ta braktiste misionin e Tij? A duam të jemi frikacakë, apo duam të jemi shërbëtorë trima edhe pse ka shumë kundërshtim dhe ligësi në botë? Le të kemi guximin të ngrihemi dhe të llogaritemi si ndjekës të vërtetë e të devotshëm të Krishtit.”⁸

Unë ju ftoj ta bëni veten të denjë siç bënë 2.000 ushtarët e rinj duke qenë trima me kurajë si mbajtës të denjë të priftërisë. Kujtoni, ajo që bëni, atje ku shkoni dhe ajo që shihni, do të përcaktojë se cilët do të bëheni. Cili doni të bëheni? Bëhuni një dhjak i denjë, një mësues i denjë, një prift i denjë. Vendosni një qëllim që të jeni i denjë të hyni në tempull tani dhe që të jeni i denjë të merrni ordinancën tuaj të radhës në moshën e përshtatshme dhe në fund të merrni Priftërinë Melkizedeke. Kjo

është një udhë drejtësie që fton ndihmë hyjnore. Zoti tha: “Në ordinancat e saj, fuqia e perëndishmërisë manifestohet”⁹.

Prindërit, udhëheqësit e priftërisë dhe përparësitë profetike që gjenden në broshurat tuaja *Detyrë ndaj Perëndisë* dhe *Për Forcën e Rinisë*, do t’ju drejtojnë përgjatë udhës.

Presidenti Tomas S. Monson, kohët e fundit këshilloi:

“Për t’i marrë [vendimet] me mençuri, duhet kurajë – kurajë për të thënë jo, kurajë për të thënë po. . . .

Unë ju lutem që, . . . pikërisht tani, të merrni një vendim për të mos u shmangur nga shtegu që do të na çojë tek qëllimi ynë: jeta e përjetshme me Atin tonë në Qiell.”¹⁰

Pikërisht ashtu si 2.000 ushtarët iu përgjigjën thirrjes për betejë të udhëheqësit të tyre, Helamanit, dhe mobilizuan trimërinë e tyre të guximshme, ju gjithashtu mund të bëni të njëjtën gjë duke ndjekur udhëheqësin tuaj profet, Presidentin Tomas S. Monson.

Mbajtës të rinj të mi të Priftërisë Aarone, në mbyllje unë jap dëshminë time për Perëndinë, Atin, dhe Jezu Krishtin, dhe fjalët e Jozef Smithit: “Vëllezër, a nuk do të vazhdojmë në një kauzë kaq të madhe? Ecni përpara dhe jo prapa. Kurajë, vëllezër; dhe përpara, përpara drejt fitores!”¹¹ Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Alma 53:20.
2. Mosia 18:9.
3. Histori personale treguar autorit.
4. Xhozef A. Califano Jr., themelues dhe kryetar nderi i Qendrës Kombëtare për Vartësinë dhe Abuzimin me Substanca në Univesitetin Kolumbia, në një deklaratë për shtyp lidhur me kërkimin, casacolumbia.org.
5. *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar* (2004), f. 118.
6. Doktrina e Besëlidhje 87:8.
7. 2 Timoteut 1:7.
8. N. Eldon Tanner, “For They Loved the Praise of Men More Than the Praise of God”, *Ensign*, nëntor 1975, f. 74–75.
9. Doktrina e Besëlidhje 84:20.
10. Tomas S. Monson, “Tre Parimet e Zgjedhjes”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 68.
11. Doktrina e Besëlidhje 128:22.



Nga Plaku Entoni D. Perkins,
i Të Shtatëdhjetëve

Hapini Sytë për Vetën Tuaj

Qëndroni në shtegun e priftërisë duke e thelluar kthimin tuaj në besim dhe duke e forcuar familjen. . . . Shmangeni tragjedinë duke ua vënë veshin shenjave shpirtërore me shënimin “kini kujdes” të vendosura përgjatë rrugës nga Perëndia dhe profetët.

Kur isha i ri, familja jonë udhëtonte me makinë përmes Maleve Shkëmbore të Amerikës për të vizituar gjyshërit. Rruga fillonte në rrafshina me sherbelë, ngrihej përmes shpateve të rrëpirëta të mbuluara me pisha dhe së fundmi dilte në korije me drurë plepash dhe në livadhe në majën e malit ku mund të shihnim shumë larg.

Por kjo rrugë e bukur nuk qe mjaft e sigurt. Shumë prej autostradës ishte e ndërtuar brenda rrugës së rrëpirët malore. Për t'i mbrojtur udhëtarët, ndërtuesit e rrugës ndërtuan parmaqe mbrojtëse dhe vendosën shenja ku lexohej: “Kini Kujdes: Shkëmbinjtë Mund të Rrëzohen”. Ne pamë arsye të mjaftueshme për këto paralajmërimet. Shkëmbinj dhe gurë qenë përhapur përgjatë shtratit të lumit shumë më poshtë rrugës. Me raste, mund të shihnim automjete të shkatërruara në fund të kanionit, një tregues tragjik i shoferëve që nuk kishin pasur kujdes.

Betimi dhe Besëlidhja e Priftërisë

Vëllezër, secili prej jush ka hyrë ose së shpejti do të hyjë në betimin dhe besëlidhjen e Priftërisë Melkizedeke.¹ Kjo besëlidhje përfshin një udhëtim të lavdishëm që fillon me marrjen edhe të priftërisë më të ulët, ashtu edhe të asaj më të lartë, vazhdon me lartësimin e thirrjeve tona dhe ngjitet përherë lart për te bekimet më të mëdha të Perëndisë derisa të marrim “gjihtëcka që Ati . . . ka”².

Projektuesi i urtë i asaj rruge celestiale ka vendosur shenja paralajmëruese për udhëtimin tonë. Betimi dhe besëlidhja e priftërisë përmban këtë paralajmërim që nxit analizim të thellë të vetes: “Unë tani ju jap një urdhërim të hapni sytë për vetën tuaj”³.

Përse duhej të na urdhëronte Perëndia që të hapnim sytë? Ai e di se Satani është një qenie reale⁴ i cili kërkon të na i tërheqë shpirtat në humnerën e mjerimit⁵. Perëndia gjithashtu e di se brenda mbajtësve të priftërisë struket një “njeri [i natyrshëm]”⁶ “i prirur për të dalë nga rruga”⁷. Prandaj, profetët na

ftojnë të “zhv[ishemi] [nga] njeri[u] [i] vjetër”⁸ dhe të “[vishemi me] Krishtin”⁹ nëpërmjet besimit, pendimit, ordonancave shpëtuese dhe të jetuarit të përditshëm të ungjillit.

Shmangia e Tragjedisë

Ndërkohë që ngjitet në shtegun e priftërisë, çdo djalë ose burrë mund të tërhiqet poshtë nëse harron të bëjë kujdes. A jeni shtangur dhe trishtuar ndonjëherë nga rënia e papritur e një të riu të jashtëzakonshëm, një misionari të sapokthyer, një udhëheqësi të respektuar të priftërisë apo një anëtar të dashur të familjes?

Historia e Davidit të Dhiatës së Vjetër është një shembull tragjik i çuarjes dem të fuqisë së priftërisë. Megjithëse e mundi Goliathin kur ishte i ri dhe jetoi me drejtësi për dekada¹⁰, ky profet-mbret ishte ende i cenueshëm shpirtërisht. Në atë çast vendimtar kur nga çatia ai pa Bath-Sheban e bukur duke u larë, nuk pati asnjë rojtar moral që t'i thërriste: “Ki kujdes David, po tregohesh i marrë!” Fakti që ai nuk i hapi sytë për vetën e tij¹¹ dhe që nuk veproi sipas paralajmërimeve të Shpirtit¹² çoi në humbjen e familjes së tij të përjetshme.¹³

Vëllezër, nëse madje edhe Davidi i madh mund të rrëshqiste nga rruga e ekzaltimit, si mund ta shmangim në një fat të ngjashëm?

Dy parimet mbrojtëse të kthimit të thellë vetjak në besim dhe të marrëdhënieve të forta familjare na ndihmojnë për të na mbajtur në autostradën e qiellit.

Duke e ditur këtë, Satani vendos gurë pengues në shtegun e zhvillimit të priftërisë që do ta dëmtojnë kthimin tonë në besim dhe do t'i shkatërrojnë familjet tona. Fatmirësisht, Jezu Krishti dhe profetët e tij kanë vendosur shenja me shënimin “kini kujdes” përgjatë udhës. Ata na paralajmërojnë



vazhdimisht për krenarinë¹⁴ që dëmton kthimin në besim dhe për mëkatet që i shkatërrojnë familjet, të tilla si zemërimi, lakmia dhe epshi.

Shumë kohë më parë, Moisiu këshilloi: “Ki kujdes të mos harrosh Zotin”¹⁵. Në botën tonë me ritëm të përshpejtuar e të mbushur me argëtim, njerëzit janë ende të shpejtë për ta “harr[uar] Zotin . . . [për të] bë[r]ë” paudhësi dhe [për t’u] udhëh[equr] nga i ligu”¹⁶.

Thellojeni Kthimin në Besim dhe Forcojeni Familjen

Për të qëndruar të sigurt në shtegun e priftërisë mes rrëshqitjeve të gurëve të tundimit, unë po ju kujtoj gjashtë parime themelore që e thellojnë kthimin në besim dhe e forcojnë familjen.

Së pari, lutja gjithnjë hap dyert e ndihmës hyjnore për ta “mposh[tur] Satanin”¹⁷. Sa herë që Jezusi i paralajmëron mbajtësit e priftërisë që të “je[n]ë syhapur, sepse Satani dëshiron t’i shoshisë”, Ai rekomandon lutjen si mjet për të mos rënë në tundim.¹⁸ Presidenti Tomas S. Monson ka dhënë mësim: “Nëse ndonjëri prej nesh ka qenë i ngadaltë për t’ia vënë veshin këshillës për t’u lutur gjithmonë, nuk ka orë më të mirë për të filluar sesa tani. . . . Një njeri nuk qëndron kurrë më lart sesa kur është i gjunjëzuar.”¹⁹

Së dyti, studimi i shkrimeve të shenja të lashta dhe të kohëve të sotme na lidh me Perëndinë. Zoti i porositi anëtarët e Kishës që “të ruhen se si i mbajnë [profetët], me qëllim që . . . të mos llogariten si gjë me pak vlerë dhe ata të sillen nën dënim për shkak të kësaj, dhe të pengohen e të bien”²⁰. Për ta shmangur këtë ndëshkim solem, ne duhet t’i lexojmë me

zell shkrimet e shenja, si edhe revistat dhe faqet e internetit të Kishës që na mundësojnë të “këshillohemi në një mënyrë të ngushtë dhe personale nga profeti i zgjedhur [i Zotit]”²¹.

Së treti, pjesëmarrja denjësisht në ordianca na përgatit për të marrë “Shpirtin e Shenjtë si udhëzuesin [tonë]”²². Kur Zoti paralajmëroi: “Ruhuni që të mos mashtroheni”, Ai premtoi se ne nuk do të mashtrohemi nëse “kërkojmë” me zell dhuratat më të mira” të Shpirtit.²³ Marrja denjësisht e sakramentit çdo javë i kualifikon anëtarët që të “kenë gjithmonë Shpirtin e tij me ta”²⁴. Në adhurimin në tempull ne mund të “marri[m] plotësi të Frymës së Shenjtë”²⁵.

Së katërti, shfaqja e dashurisë së sinqertë është në qendër të kthimit vetjak në besim dhe të marrëdhënieve familjare. Mbreti Beniamin udhëzoi: “Kujdes se mos ngjallen grindje mes jush”²⁶. Mos harroni se Satani është “ati i grindjes”²⁷ dhe kërkon që pjesëtarët e familjes të “luftojnë dhe të grinden”²⁸. Vëllezër, nëse jemi të dhunshëm emocionalisht, gojarisht apo fizikisht ndaj ndonjë pjesëtari të familjes sonë, atëherë ne e humbasim fuqinë e priftërisë.²⁹ Zgjidhni ta kontrolloni zemërimin. Pjesëtarët e familjes duhet të dëgjojnë bekime nga goja jonë, jo mallkime. Ne duhet të ndikojmë tek të tjerët vetëm me bindje, durim, mirësjellje, zemërbutësi, me dashuri të pashtirur, me dashamirësi dhe dashuri hyjnore.³⁰

Së pesti, bindja ndaj ligjit të së dhjetës është një përbërës thelbësor i besimit dhe i bashkimit të familjes. Për shkak se Satani e përdor lakminë dhe të shkuarit pas zotërimeve materiale

për t’i nxjerrë familjet nga autostrada çelestiale, Jezusi këshilloi: “Ruhuni nga kopracia”³¹. Kopracia kufizohet kur ne planifikojmë mbi të ardhurat tona, paguajmë një të dhjetë të ndershme dhe një ofertë agjërimi bujare, financojmë shpenzimet e nevojshme, shmangim borxhin e panevojshëm, kursejmë për nevojat e së ardhmes dhe bëhemi të mbështetur te vetja nga ana materiale. Premtimi i Perëndisë ndaj nesh është: “Por para së gjithash kërkoni mbretërinë e Perëndisë dhe drejtësinë e tij dhe të gjitha këto gjëra do t’ju shtohen”³².

Së gjashti, të jetuarit plotësisht të ligjit të dëlirësisë sjell sigurinë për të qëndruar “në prani të Perëndisë” me Frymën e Shenjtë si “shoqëruesi[n] [tonë] [të] vazhdueshëm”³³. Satani po i sulmon virtytin dhe martesën me një sasi të madhe gjërash të turpshme. Kur Zoti i paralajmëroi shkelësit e kurorës që t’i “hapin sytë dhe të pendohen me shpejtësi”, përkufizimi i Tij shkonte përtej aktit fizik të tradhtisë bashkëshortore për te mendimet e shpejta që e paraprijnë atë.³⁴ Profetët dhe apostujt e kohëve të sotme kanë folur shpesh dhe qartë për problemin e pornografisë. Presidenti Gordon B. Hinkli dha mësim: “[Pornografia] është si një stuhi e fortë, që shkatërron individë dhe familje, që shkatërron krejtësisht atë që dikur ishte e shëndetshme dhe e bukur. . . . Koha ka ardhur që ata nesh që janë përfshirë në të tilla gjëra ta nxjerrin veten nga balta”³⁵. Nëse tundoheni për ta shkelur ligjin e dëlirësisë në çfarëdo lloji forme, ndiqni shembullin e Jozefit të Egjiptit i cili “iku duke vrapsur jashtë”³⁶.

Këto gjashtë parime themelore i ndihmojnë mbajtësit e priftërisë që të vazhdojnë të sigurt lart nëpër autostradën e qiellit mes parmaqeve mbrojtës shpirtërore të kthimit vetjak në besim dhe të marrëdhënieve familjare. Të rinj, bindja ndaj këtyre parimeve do t’ju përgatisë për besëlidhjet e tempullit,

shërbimin si misionarë kohëplotë dhe martesën e përrjetshme. Bashkëshortë dhe etër, të jetuarit e këtyre parimeve do t'ju kualifikojnë për ta kryesuar shtëpinë me drejtësi, duke shërbyer si udhëheqësi shpirtëror i familjes suaj me bashkëshorten tuaj si një partnere të barabartë.³⁷ Shtegu i priftërisë është një udhëtim i mbushur me gëzim.

Qëndrimi në Shtegun e Priftërisë

Duke u kthyer te përvojat e mia kur isha i ri, më kujtohet një kalim nëpër Malet Shkëmbore. Pasi kaloi një shenjë ku shkruhej: “Kujdes: Shkëmbinjtë Mund të Rrëzohen”, babai im dalloi guralecë dhe gurë të vegjël mbi rrugën e shtruar para nesh. Ai me nxitim e ngadalësoi makinën derisa e ndaloi pothuajse plotësisht, pikërisht kur një gur sa një top basketbolli nisi të lëshonte zhurma pranë nesh. Babi priti derisa të ndalonte rrëshqitja e shkëmbit përpara se të vazhdonte. Vëmendja e vazhdueshme e babait tim dhe veprimi i menjëhershëm siguroi që familja jonë të arrinte e sigurt në pikëmbërritje.

Vëllezër, Satani kërkon t'i “shkaterrojë shpirtrat e njerëzve”³⁸. Nëse shpirti juaj po ju shtyn drejt buzës së humnerës, ndaloni tani përpara se të bini dhe kthehuni sërish në drejtimin e duhur.³⁹ Nëse ndieni se shpirti juaj gjendet i mbytur poshtë një kanioni në vend që të jetë lart në shtegun e priftërisë për shkak se ju i shpërfillët shenjat shënimit “kini kujdes” dhe mëkatuat, unë dëshmoj se nëpërmjet pendimit të sinqertë dhe fuqisë së sakrificës shlyese të Krishtit, ju mund të ngriheni lart dhe të rivendoseni në autostradën qiellore të Perëndisë.⁴⁰

Jezusi dha mësim: “Ruhuni nga . . . hipokrizia”⁴¹. Nëse nuk jeni të denjë për ta ushtruar priftërinë, ju lutem të takoheni me peshkopin tuaj, i cili mund t'ju ndihmojë të pendo-heni. Merrni guxim sepse megjithëse

Shpëtimtari pohon: “[Bëni] kujdes . . . dhe largohuni nga mëkati”,⁴² Ai gjithashtu premton: “Unë, Zoti, ju fal juve. . . . Shkoni në udhët tuaja e mos mëkatoni më”⁴³.

Unë e ftoj çdo djalë dhe burrë që të qëndrojnë në shtegun e priftërisë duke e thelluar kthimin e tij në besim dhe duke e forcuar familjen. Lutjet, shkrimet e shenja dhe ordinancat e thellojnë kthimin në besim. Dashuria, e dhjeta dhe dëlirësia e forcojnë familjen. Shmangeni tragjedinë duke ua vënë veshin shenjave shpirtërore “kini kujdes” të vendosura përgjatë rrugës nga Perëndia dhe profetët. Përpuni të ndiqni shembullin e përsosur të Jezu Krishtit, i cili “vuajti tundime, por nuk ua vuri veshin atyre”⁴⁴.

Unë premtoj se, nëse burrat e mbajnë besëlidhjen e priftërisë për t'i “hap[ur] sytë për veten [e] t[yr]e”⁴⁵, ne dhe familjet tona mund të sigurohemi se do të arrijmë të sigurt në pikëmbërritjen tonë të ekzaltimit në mbretërinë çelestiale. Unë dëshmoj kështu, në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:33–44.
2. Doktrina e Besëlidhje 84:38.
3. Doktrina e Besëlidhje 84:43.
4. Shih Joseph Smith-Historia 1:16; shih edhe Moisiu 1:12–22.
5. Shih Helamani 5:12; shih edhe 2 Nefi 1:13; Helamani 7:16.
6. Mosia 3:19; shih edhe 1 Korintasve 2:14.
7. “Come, Thou Fount of Every Blessing”, [“Eja Burim i Çdo Bekimi”] *Hymns* (1948), nr. 70.
8. Shih Kolosianëve 3:8–10; shih edhe Efesianëve 4:22–24.
9. Galatasve 3:27; shih edhe Romakëve 13:14.
10. Shih 1 Samuelit 13:14; 17:45–47.
11. Shih 2 Samuelit 11:1–17.
12. “Ju nuk do të bëni gabime të mëdha pa qenë të paralajmëruar më parë nga nxitjet e Frymës së Shenjtë” (Boyd K. Paker, “Këshillë për Rininë”, *Liahona*, nëntor 2011, f. 18).
13. Shih Doktrina e Besëlidhje 132:39; shih edhe Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “David”, f. 25.
14. Shih Doktrina e Besëlidhje 23:1; 25:14; 38:39; shih edhe Ezra Taft Benson, “Beware of Pride”, *Ensign*, maj 1989, f. 4–7.

15. Ligji i Përtërirë 6:12; shih edhe Ligji i Përtërirë 8:11–19.
16. Alma 46:8.
17. Doktrina e Besëlidhje 10:5.
18. Shih Doktrina e Besëlidhje 52:12–15; shih edhe Lluca 22:31–32; Alma 37:15–17; 3 Nefi 18:18–19.
19. Thomas S. Monson, “Come unto Him in Prayer and Faith”, *Liahona*, mars 2009, f. 4.
20. Doktrina e Besëlidhje 90:5; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 41:1, 12.
21. Gordon B. Hinckley, “Faith: The Essence of True Religion”, *Ensign*, nëntor 1981, f. 5.
22. Doktrina e Besëlidhje 45:57.
23. Doktrina e Besëlidhje 46:8; shih edhe Efesianëve 4:14; Doktrina e Besëlidhje 52:14–16; Kolosianëve 2:8.
24. Moroni 4:3; Doktrina e Besëlidhje 20:77; shih edhe 3 Nefi 18:1–11.
25. Doktrina e Besëlidhje 109:15.
26. Mosia 2:32.
27. Shih 3 Nefi 11:29–30.
28. Mosia 4:14.
29. Shih Doktrina e Besëlidhje 121:36–37; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 63:61–63.
30. Shih Doktrina e Besëlidhje 121:41–45.
31. Lluca 12:15; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 38:39.
32. Mateu 6:33; shih edhe 3 Nefi 13:33.
33. Doktrina e Besëlidhje 121:45–46; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 67:11; Moisiu 1:11.
34. Shih Doktrina e Besëlidhje 63:14–16; shih edhe Mateu 5:27–28; 3 Nefi 12:27–30.
35. Gordon B. Hinckley, “A Tragic Evil among Us”, *Liahona*, nëntor 2004, f. 59, 62; Gordon B. Hinkli, “Një e Ligë Tragjike mes Nesh”, Konferenca e Përgjithshme tetor 2004 [nr. art. 00056 101], f. 87, 90; shih edhe Dallin H. Oaks, “Pornography”, *Liahona*, maj 2005, f. 87–90; Dallin H. Oaks, “Pornografia”, Konferenca e Përgjithshme prill 2005 [00074 101], f. 102–107; Xhefri R. Holland, “Jo më Vend për Armikun e Shpirtit Tim”, *Liahona*, maj 2010, f. 44–46.
36. Zanafilla 39:12.
37. Shih *Handbook 2: Administering the Church* (2010), 2.3.
38. Doktrina e Besëlidhje 10:27; shih edhe 1 Pjetrit 5:8.
39. Shih Doktrina e Besëlidhje 3:9–10; 1 Korintasve 10:12–13; 2 Pjetrit 3:17.
40. Shih Alma 13:2–29; Doktrina e Besëlidhje 109:21.
41. Lluca 12:1; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 50:6–9.
42. Doktrina e Besëlidhje 82:2.
43. Doktrina e Besëlidhje 82:1, 7.
44. Doktrina e Besëlidhje 20:22; shih edhe Hebrejve 2:17–18; 4:14–16.
45. Doktrina e Besëlidhje 84:43; shih edhe Ligji i Përtërirë 4:9; Mosia 4:29–30.



Nga Presidenti Diter F. Uhtdorf,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Gëzimi i Priftërisë

Le ta përqafojmë dhe ta kuptojmë mrekullinë dhe privilegjin e priftërisë. Le t'i pranojmë dhe t'i duam përgjegjësitë që na janë kërkuar të përmbushim.

Gëzimi i të Fluturuarit

Shumë vite më parë, disa kapitenë aeroplanësh të linjave dhe unë vendosëm të plotësonim një ëndërr fëmijërie për të restauruar një aeroplan antik. Së bashku, ne blemë një aeroplan të tipit Pajpër Kab të vitit 1938, të vjetëruar, dhe filluam të punojmë që ta kthenim në formën e tij origjinale. Projekti ishte një punë që e bënim me qejf. Ai kishte një domethënie të veçantë për mua sepse unë mësova të fluturoj me një aeroplan të ngjashëm kur isha i ri.

Ky aeroplan ishte ndërtuar vetëm 35 vite pasi vëllezërit Rajt kryen fluturimin e tyre të parë të famshëm. Thjesht të menduarit e asaj më bënë të ndihem shumë i vjetër.

Motori nuk kishte ndezës elektrik; ndërsa e ndizje motorin nga kabina, dikush tjetër në tokë do të kapej pas helikës dhe do ta rrotullonte me gjithë forcën gjersa motori të lëvizte vetë. Çdo ndezje motori ishte një çast emocion dhe guximi.

Sapo u ngrit në fluturim, u bë e qartë se Pajpër Kab nuk ishte ndërtuar për shpejtësi. Në fakt, kur frynte erë e fortë përballë aeroplanit, duke sikur ne nuk po lëviznim fare. Unë kujtoj kur fluturonim së bashku me djalin tim adoleshent, Guido, mbi autoban në Gjermani dhe pa dyshim,

makinat poshtë lëviznin shumë më shpejt sesa ne!

Por, oh, sa e doja këtë avion të vogël! Ishte mënyra e përsosur për të përjetuar mrekullinë dhe bukurinë e fluturimit. Mund të dëgjoje, të ndieje, të nuhatje dhe të shihje se ç'do të thotë në fund të fundit fluturim. Vëllezërit Rajt e shprehën atë kështu: "Nuk ka [asgjë] që barazohet me atë që shijojnë aviatorët kur mbarten përmes ajrit mbi krahë të mëdhenj të bardhë"¹.

Në kontrast me këtë, më herët këtë vit, pata privilegjin të fluturoja me një reaktiv luftarak të sofistikuar F-18 me Engjëjt Blu me famë botërore, skuadra e fluturimit demonstrativ të Forcave Detare të Shteteve të Bashkuara. Ishte si të bëje një fluturim mbi dhe përgjatë vijës së kujtesës pasi saktësisht 50 vite më parë, thuajse po atë ditë, unë pata plotësuar trajnimin tim për t'u bërë pilot luftarak i forcave ajrore.

Përvoja e fluturimit me F-18, sigurisht, ishte tërësisht e ndryshme nga ajo me Pajpër Kab. Ajo më tregoi një bukuri më të gjallë të fluturimit. Ishte si t'i zbatoje ligjet ekzistuese të aerodinamikës në një mënyrë më të përsosur. Sidoqoftë, fluturimi me Engjëjt Blu shpejt më kujtoi gjithashtu se të jesh pilot reaktivi luftarak është e përshtatshme vetëm për të rinj. Për t'i cituar

përsëri vëllezërit Rajt: "Më shumë se çdo gjë tjetër, ndjesia [e fluturimit] është një ndjesi e paqes së përsosur, përzier me një ngacmim që tendos deri në kulm çdo nerv"². Përveç kësaj, fluturimi me Engjëjt Blu sugjeronte një mënyrë tërësisht të ndryshme të të pasurit rreth vetes "engjëj" që të ngenë lart.

Nëse do të më pyesnit cilës nga këto dy përvoja fluturimi iu gëzova më shumë, unë nuk jam i sigurt se mund t'ju them. Në disa mënyra të dukshme, ato ishin të ndryshme, për të thënë më të paktën. Dhe përsëri në mënyra të tjera, ato ishin shumë të ngjashme.

Edhe në Pajpër Kab edhe në F-18, unë ndieva emocionin, bukurinë dhe gëzimin e fluturimit. Në të dyja unë mund ta kuptoja thirrjen e poetit për "[të rrëshqitur] nga prangat armike të Tokës dhe [për të vallëzuar] qiejve mbi krahë argjenduar prej qeshjes"³.

E Njëta Priftëri Kudo

Tani, ju mund të pyesni, çfarë lidhje kanë këto dy përvoja tërësisht të ndryshme fluturimi, me mbledhjen tonë sot apo me priftërinë, që ne kemi privilegjin ta mbajmë, apo me shërbimin e priftërisë që ne e duam aq shumë?

Vëllezër, a nuk është e vërtetë se përvojat tona vetjake të shërbimit në priftëri mund të jenë të gjitha krejt të ndryshme? Do të mund të thoshim se disa nga ju po fluturojnë në reaktivë F-18, ndërsa të tjerë po fluturojnë në Pajpër Kabë. Disa nga ju jetojnë në lagje dhe kunje ku çdo pozitë, nga ndihmësi për udhëheqësin e grupit të priftërinjve të lartë deri te sekretari i kuorumit të dhjakëve, është mbushur me një mbajtës priftërie aktiv. Ju keni privilegjin të merrni pjesë në një organizim lagjeje që ka mjaft njerëz sa t'i plotësojë të gjitha thirrjet.

Të tjerë nga ju jetojnë në zona të botës ku ka vetëm një numër të vogël anëtarësh dhe mbajtës priftërie të



Kishës. Ju mund të ndiheni të vetmuar dhe të rënduar me peshën e gjithçkaje që duhet bërë. Për ju mund të kërkojë shumë përfshirje vetjake për ta vënë në lëvizje motorin e shërbimit të priftërisë. Ndonjëherë madje mund të duket se dega apo lagjja juaj nuk po përparon aspak.

Sidoqoftë, pavarësisht se cilat mund të jenë përgjegjësitë apo rrethanat tuaja, ju dhe unë e dimë se ka gjithmonë një gëzim të veçantë që vjen nga shërbimi i përkushtuar i priftërisë.

Gjithmonë e kam dashur fluturimin, qoftë në një Pajper Kab, një F-18 apo çfarëdo avioni tjetër. Në Pajper Kab, nuk u ankova për mungesën e shpejtësisë; ndërkohë në F-18 nuk shfryva kur tendosja nga manovrat akrobatike në ajër zbulonte pa mëshirë realitetet e moshës sime në përparim.

Po, gjithmonë ka diçka të papërsosur në çfarëdo situatë. Po, është e lehtë të gesh gjëra për t'u ankuar.

Por vëllezër, ne jemi mbajtës të Priftërisë së Shenjtë, sipas Urdhrit të Birit të Perëndisë! Secilit prej nesh i janë vendosur duart mbi kokë dhe ne morëm priftërinë e Perëndisë. Neve na është dhënë autoriteti dhe përgjegjësia për të vepruar në emrin e Tij si shërbëtorët e Tij në tokë. Qoftë në një lagje

të madhe apo në një degë të vogël, ne jemi thirrur të shërbejmë, të bekojmë dhe të veprojmë me çdo mënyrë për të mirën e të gjithëve dhe çdo gjëje që i është besuar kujdesit tonë. A mund të ketë ndonjë gjë më emocionuese?

Le ta kuptojmë, ta vlerësojmë dhe ta ndiejmë gëzimin e shërbimit në priftëri.

Gëzimi i Priftërisë

Dashuria për fluturimin ndikoi në drejtimin e gjithë jetës sime. Por ndërsa përvojat e mia si pilot ishin gjallëruese dhe të hareshme, përvojat e mia si anëtar i kësaj Kishë kanë qenë shumë më depërtuese, më të gëzueshme dhe tejet më të thella. Ndërsa jam zhytur në shërbimin në Kishë, unë e kam ndier fuqinë e Perëndisë së plotfuqishëm si dhe mëshirat e Tij të dhembshura.

Si pilot, unë kam prekur qiejt. Si anëtar i Kishës, unë kam ndier dashurinë dhe kujdesin nga qielli.

Ndodh të më marrë malli që të ulem në një kabinë aeroplani. Por shërbimi pranë vëllezërve dhe motrave të mia në Kishë ma kompenson lehtësisht atë. Mundësia që të ndiej paqen dhe gëzimin madhështor, që vjen nga të qenit një pjesë e vogël e kësaj kauze dhe pune të madhe, nuk do të doja të më mungonte për asnjë gjë në botë.

Sot ne jemi mbledhur si një grup i madh i mbajtësve të priftërisë. Është gëzimi dhe privilegji ynë i shenjtë që t'i shërbejmë Zotit dhe bashkëqenieve tona, të bëjmë më të mirën që është brenda nesh, për kauzën fisnike të lartësisimit të të tjerëve dhe për ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë.

Ne e dimë dhe e kuptojmë se priftëria është fuqia dhe autoriteti i përjetshëm i Perëndisë. Ne mund ta recitojmë lehtësisht këtë përkufizim përmendësh. Sidoqoftë, a e kuptojmë vërtet rëndësinë e asaj që po themi? Më lejoni të përsëris: *Priftëria është fuqia dhe autoriteti i përjetshëm i Perëndisë.*

Mendoni për të. Me anë të priftërisë, Perëndia i krijoi dhe i qeveris qiejt dhe tokën.

Nëpërmjet kësaj fuqie, Ai i shëlben dhe i ekzulton fëmijët e Tij, duke bërë “të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut”⁴.

Priftëria, siç shpjegoi Profeti Jozef Smt, është “kanali përmes së cilës i Plotfuqishmi filloi të zbulojë lavdinë e Tij në fillim të krijimit të kësaj toke dhe përmes së cilës Ai ka vazhduar t’ia zbulojë Vetën fëmijëve të njerëzve deri në kohën e tanishme, dhe përmes së cilës Ai do të bëjë të njohura qëllimet e Tij deri në fund të kohës”⁵.

Ati ynë i gjithëfuqishëm në Qiell na e ka besuar autoritetin e priftërisë neve – qenieve të vdekshme që, nga përkufizimi, jemi me të meta dhe të papërsosur. Ai na e jep neve autoritetin për të vepruar në emrin e Tij për shpëtimin e fëmijëve të Tij. Nëpërmjet kësaj fuqie ne jemi të autorizuar për të predikuar ungjillin, për të administruar ordinancat e shpëtimit, për të ndihmuar që të ndërtohet mbretëria e Perëndisë në tokë dhe për të bekuar dhe për t’u shërbyer familjeve e bashkëqenieve tona.

E Disponueshme për të Gjithë

Kjo është priftëria e shenjtë që ne mbajmë.

Priftëria, ose çfarëdo përgjegjësie brenda saj, nuk mund të blihet apo të urdhërohet. Përdorimi i fuqisë së priftërisë nuk mund të ndikohet, t'i bindet apo të detyrohet nga pozita, pasuria apo pushteti. Ajo është një fuqi shpirtërore që vepron sipas ligjit qiellor. Ajo buron nga Ati i madh Qie-llor i të gjithëve ne. Fuqia e saj mund të kontrollohet dhe drejtohet vetëm nëpërmjet parimeve të drejtësisë⁶, jo vetëdrejtësisë.

Krishti është burimi i të gjithë autoritetit dhe fuqisë së vërtetë të priftërisë në tokë.⁷ Është puna e Tij, në të cilën ne jemi të privilegjuar të ndihmojmë. “Dhe askush s’mund të ndihmojë në këtë punë, nëse nuk do të jetë i përlulur dhe plot dashuri, duke patur besim, shpresë dhe dashuri hyjnore, duke qenë i matur në gjithë gjërat, çfarëdo që do t'i besohet kujdesit të tij.”⁸

Ne nuk veprojmë për përfitim vetjak, por përkundrazi përpiqemi t'u shërbejmë dhe t'i lartësojmë të tjerët. Ne udhëheqim jo me forcë por përmes “bindjes, . . . durimit, . . . mirësjelljes dhe zemërbutësisë dhe nëpërmjet dashurisë së pashtirur”⁹.

Sobral, Brazil



Priftëria e Perëndisë së Plotfuqishëm është e disponueshme për burrat e denjë kudo që mund të jenë – pavarësisht nga prejardhja e tyre, pavarësisht sa të përlulura mund të jenë rrethanat e tyre, në pjesët më të afërta apo më të largëta të globit. Ajo është e disponueshme pa para apo çfarëdo çmimi tjetër tokësor. Për të perfrazuar profetin e lashtë Isaia, *të gjithë* që kanë etje, mund të vijnë tek ujërat dhe nuk kërkohet para për të ardhur dhe për të ngrënë!¹⁰

Dhe për shkak të Shlyerjes së përjetshme dhe të pakuptueshme të Shpëtimtarit tonë, Jezu Krisht, priftëria e Perëndisë mund të jetë e disponueshme madje edhe nëse keni bërë gabime apo keni qenë i padenjë në të kaluarën. Nëpërmjet përmirësimit shpirtëror dhe procesit pastrues të pendimit, ju mund “të ngrih[eni] dhe të shkëlqeni”¹¹. Për shkak të dashurisë së pakufishme e falëse të Shpëtimtarit dhe Shëlbuesit tonë, ju mund t'i ngrini sytë lart, të bëheni të pastër e të denjë dhe të bëheni bij të drejtë dhe fisnikë të Perëndisë – mbajtës të denjë të priftërisë më të shenjtë të Perëndisë së Plotfuqishëm.

Mrekullia dhe Privilegji i Priftërisë

Unë ndiej njëfarë dëshpërimi për ata që nuk e kuptojnë dhe nuk e

vlerësojnë mrekullinë dhe privilegjin e priftërisë. Ata janë si pasagjerët në një aeroplan që e kalojnë kohën duke shfryrë për madhësinë e paketës së kikirikave, ndërsa fluturojnë në ajër, shumë mbi retë – diçka për të cilën mbretërit e lashtë do të jepnin gjithçka kishin për ta provuar vetëm një herë!

Vëllezër, ne jemi bekuar për të qenë të përlulur për këtë autoritet dhe fuqi të madhe priftërie. Le t'i çojmë sytë lart dhe ta shohim, ta njohim dhe ta pranojmë këtë mundësi për atë që është në të vërtetë.

Nëpërmjet shërbimit të drejtë, të dashur dhe të përkushtuar, ne do të jemi në gjendje të përjetojmë kuptimin e vërtetë të zbulesës: “Unë do të shkoj përpara fytyrës suaj. Unë do të jem në të djathtën e në të majtën tuaj dhe Shpirti im do të jetë në zemrat tuaja e engjëjt e mi përreth jush, për t'ju ngritur lart.”¹²

Le ta përqafojmë dhe ta kuptojmë mrekullinë dhe privilegjin e priftërisë. Le t'i pranojmë dhe t'i duam përgjegjësitë që na janë kërkuar të përmbushim – përgjegjësi në shtëpitë tona dhe në njësitë tona të Kishës, pavarësisht sa të mëdha apo të vogla që mund të jenë. Le të rritemi vazhdimisht në drejtësi, përkushtim dhe shërbim priftërie. Le ta gjejmë gëzimin e të shërbyerit në priftëri!

Ne mund ta bëjmë këtë më mirë duke zbatuar parimet e njohurisë, të bindjes dhe besimit.

Kjo do të thotë se, së pari, ne duhet të njohim dhe të bëjmë pjesë të qenies sonë doktrinën e priftërisë që gjendet te fjala e zbuluar e Perëndisë. Është e rëndësishme t'i kuptojmë besëlidhjet dhe urdhërimet mbi të cilat vepron priftëria.¹³

Pastaj, le të jemi të urtë dhe të veprojmë sipas kësaj njohurie të fituar vazhdimisht e ndershmërisht. Ndërsa u bindemi ligjeve të Perëndisë,

e disiplinohet mendjen dhe trupin tonë dhe i përputhim veprimet tona me modelet e drejtësisë të dhëna mësim nga profetët, ne do të përjetojmë gëzimin e shërbimit të priftërisë.

Dhe më në fund, le ta thellojmë besimin tonë në Zotin tonë, Jezu Krisht. Le ta marrim mbi vete emrin e Tij dhe të zotohemi çdo ditë të veçantë për të ecur përsëri në shtegun e të qenit dishepull. Le të bëhet besimi ynë i përsosur nëpërmjet veprave tona.¹⁴ Nëpërmjet të qenit dishepuj, ne mund të përsosemi shkallë-shkallë duke i shërbyer familjes sonë, bashkënjerezve tanë dhe Perëndisë.

Kur shërbejmë në priftëri me gjithë zemrën, fuqinë dhe forcën tonë, ne kemi një premtim për njohuri, paqe dhe dhurata shpirtërore madhështore. Ndërsa e nderojmë priftërinë e shenjtë, Perëndia do të na nderojë dhe ne do të "qëndrojmë" të pafaj përpara [Atij] në ditën e fundit¹⁵.

Paçim përherë sy që të shohim, dhe zemër që të ndiejmë mrekullinë dhe gëzimin e priftërisë së Perëndisë sonë të madh dhe të fuqishëm, është lutja ime në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Wilbur Wright, në James Tobin, *To Conquer the Air: The Wright Brothers and the Great Race for Flight* (2003), f. 238.
2. Wright brothers, në Tobin, *To Conquer the Air*, f. 397.
3. John Gillespie Magee Jr., "High Flight", në botimin e Diane Ravitch, *The American Reader: Words That Moved a Nation* (1990), f. 486.
4. Moisiu 1:39.
5. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2007), f. 108–109.
6. Shih Doktrina e Besëlidhje 121:36.
7. Shih Hebrejve 5:4–10; Doktrina e Besëlidhje 107:3.
8. Doktrina e Besëlidhje 12:8.
9. Doktrina e Besëlidhje 121:41.
10. Shih Isaia 55:1.
11. Doktrina e Besëlidhje 115:5.
12. Doktrina e Besëlidhje 84:88.
13. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:33–44; 121:34–46.
14. Shih Jakobi (Bibël) 2:22.
15. Doktrina e Besëlidhje 4:2.



Nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

Ndihmojini të Vënë Qëllime të Larta

Me drejtimin tuaj, ata që ju udhëhiqni do të jenë në gjendje të shohin, të dëshirojnë e të besojnë se mund ta arrijnë potencialin e tyre të plotë për shërbim në mbretërinë e Perëndisë.

Jam mjaft mirënjohës për këtë mundësi që jam në këtë mbledhje të shkëlqyer të priftërisë, që kam dëgjuar të këtitill mësim e dëshmi të mrekullueshme. Më bëri të mendoja për përvojën time vetjake. Pothuajse çdo gjë që kam qenë në gjendje të përmbush si mbajtës priftërie, është ngaqë persona të caktuar të cilët më njihnin panë tek unë gjëra që unë nuk mund t'i shihja.

Kur isha baba i ri, lutesha që të dija se çfarë kontributesh mund të jepnin fëmijët e mi në mbretërinë e Zotit. Për djemtë, e dija se mund të kishin mundësi priftërore. Për vajzat, e dija se do të jepnin shërbim duke përfaqësuar Zotin. Të gjithë do të bënin punën e Tij. E dija që secili ishte i veçantë nga tjetri dhe, prandaj, Zoti do t'u kishte dhënë dhurata të veçanta që secili t'i përdorte në shërbim të Tij.

Tani, unë s'mund t'i them çdo babai e çdo udhëheqësi të të rinjve hollësitë e asaj që është më e mira për të bërë. Por mund t'ju premtoj se do t'i bekonin ata duke i ndihmuar të dallojnë dhuratat shpirtërore me të cilat u lindën. Çdo njeri është i ndryshëm dhe ka

një kontribut të veçantë për të dhënë. Askush nuk është paracaktuar që të dështojë. Ndërsa kërkoni zbuluesë që të shihni dhuratat që Perëndia sheh tek ata që ju i udhëhiqni në priftëri – veçanërisht të rinjtë – ju do të bekoheni për ta lartuar fushëpamjen e tyre te shërbimi që mund të kryejnë. Me drejtimin tuaj, ata që ju udhëhiqni do të jenë në gjendje të shohin, të dëshirojnë e të besojnë se mund ta arrijnë potencialin e tyre të plotë për shërbim në mbretërinë e Perëndisë.

Për vetë fëmijët e mi, unë u luta për zbuluesë që të dija se si mund ta ndihmoja secilin më vete të përgatitej për mundësi të veçanta për t'i shërbyer Perëndisë. E më pas u përpoqa t'i ndihmoja të përfytyronin, të shpresonin e të punonin për këtë të ardhme. Për secilin bir gdhenda një tabelë me një citim nga shkrimi i shenjtë, që përshkruante dhuratat e tij të veçanta, dhe një figurë që përfaqësonte dhuratën përkatëse. Poshtë figurës dhe mbishkrimit gdhenda datat e pagëzimit e të shugurimit të secilit djalë te detyrat e priftërisë, tok me shenjë e gjatësisë së tij në datën e secilës nga ngjarjet.



Do të përshkruaj tabelat që gdhenda për secilin bir që ta ndihmoja të shihte dhuratat e tij shpirtërore, dhe se çfarë mund të kontribuonte në punën e Zotit. Ju mund të frymëzoheni të dalloni, sikurse unë, dhurata të veçanta dhe mundësi të përveçme për secilin prej të rinjve të cilët i doni e i udhëhiqni.

Kur biri im më i madh u bë dhjak dhe Skautist Shqiponjë, më erdhi në mendje një figurë shqiponjeje teksa mendoja për të dhe të ardhmen e tij. Jetonim në Ajdaho, pranë rrëzës së malit të Tetonit Jugor, ku ngjiteshim së bashku dhe vëzhgonim ngritjen e shqiponjave. Ajo pamje në mendje më dha ndjesinë e fjalëve të Isaias:

“Ai i jep forcë të lodhurit dhe rrit fuqinë e të këputurit.

Të rinjtë mundohen dhe lodhen, të rinjtë e zgjedhur me siguri pengohen dhe rrëzohen,

por ata që shpresojnë te Zoti fitojnë forca të reja, ngrihen me krahë si shqiponja, vrapojnë pa u lodhur dhe ecin pa u lodhur.”¹

Në fakt, me më të rriturin, kishim ndaluar ngjitjen poshtë majës së Tetonit Jugor, ngaqë im bir u lodh. Ai dëshiroi të ndalonte. Ai tha: “A do të më vijë keq përherë që nuk e arritëm majën? Babi, vazhdoni ju – nuk dua që të zhgënjeheni.”

Iu përgjigja: “Unë kurrë nuk do të zhgënjehem dhe ty kurrë nuk do të të vijë keq. Përherë do ta kujtojmë që u ngjitëm këtu së bashku.” Në krye të tabelës së gjatësisë së tij unë gdhenda një shqiponjë dhe mbishkrimin “Me Krahë Shqiponjash”.

Me kalimin e viteve, im bir si misionar u ngrit më lart se ç’e kisha përfytyruar unë në shpresat e mia më

të përkëdhelura. Në sfidat e fushës së misionit, disa gjëra nga ato që ai përballoi dukeshin mbi mundësitë e tij. Për djalin që ju e inkurajoni, mund të ndodhë, sikurse me tim bir, që në predikimin e ungjillit në një gjuhë të vështirë Zoti e lartoi më shumë se ç’e kisha menduar të ishte e mundur. Nëse do të përpiqeni me cilindo të ri që t’i kuptojë mundësitë e tij priftërore, unë ju premtoj se Zoti do t’ju tregojë po aq sa t’ju nevojitet. Djali juaj mund të ketë potencial edhe përtej asaj që Zoti do t’ju zbulojë. Ndhimoheni të vërë qëllime të larta.

Djali që ju po inkurajoni, mund të duket shumë i ndrojtur për të qenë një shërbëtor i fuqishëm priftërie. Një tjetër nga bijtë e mi ishte aq i turpshëm kur ishte djalë i vogël, sa nuk do të hynte në dyqan dhe nuk do të fliste as me shitësin. Ishte shumë i ndrojtur. Unë shqetësohesha kur lutesha lidhur me të ardhmen e tij priftërore. E mendoja atë në fushën e misionit – kjo gjë nuk tingëllonte premtuese. Iu drejtova një shkrimi të shenjtë te Fjalët e Urta: “I pabesi ikën me vrap edhe nëse askush nuk e ndjek, por i drejti është i sigurt si një luan”².

Gdhenda fjalët “I Sigurt si një Luan” në tabelën e tij, nën figurën e një koke luani të madh që hungërinte. Në misionin e tij dhe në vitet që vijuan, ai e përmbushi shpresën e gdhendjes sime. Im bir, dikur i turpshëm, predikoi ungjillin me bindje të lartë dhe përballoi rreziqe me trimëri. Ai u përforcua në përgjegjësitë e tij për të përfaqësuar Zotin.

Kjo mund të ndodhë për të riun që ju po udhëhiqni. Duhet t’i zhvillonin besimin se Zoti mund ta shndërrojë

atë në një shërbëtor më trim sesa djali i ndrojtur që ju shihni tani.

Ne e dimë se Zoti i bën të guximshëm shërbëtorët e Tij. Djaloshi Jozef i cili pa Perëndinë Atë dhe Birin e Tij, Jezu Krishtin, në një korije pemësh, u shndërrua në një gjigant shpirtëror. Parli P. Prat e pa këtë kur Profeti Jozef Smith qortoi rojet e ligj të cilët i mbanin ata rob. Plaku Prat shënonte:

“Befas ai u ngrit në këmbë dhe foli me një zë bubullime, apo si luan gjëmues, duke shqiptuar, me aq sa kujtoj, fjalët e mëposhtme:

“*QETËSI, ju djaj të humnerës së skëtërrshme. Në emrin e Jezu Krishtit unë ju qortoj dhe ju urdhëroj të heshtni; unë nuk do të jetoj asnjë minutë tjetër dhe të dëgjoj fjalë të tilla. Ndërpriteni këtë të folur ose unë apo ju do të vdesim KËTË ÇAST!*”

Për atë përvojë, Plaku Prat shkroi: “Dinjitetin dhe madhësitinë e kam parë veç *njëherë*, ndërsa u ngrit në këmbë, i lidhur me zinxhirë, në mesnatë, në një birucë të një katundi pak të njohur të Misurit”³.

Zoti do t’u japë shërbëtorëve të Tij të drejtë mundësi të jenë të guximshëm si luanë kur flasin në emrin e Tij dhe si dëshmitarë në priftërinë e Tij.

Një bir tjetër, madje që fëmijë, kishte një rreth të gjerë miqsh të cilët shpesh i kërkonin shoqëri. Ai krijonte lehtësisht lidhje me njerëzit. Ndërsa lutesha e përpiqesha të parashihja kontributin e tij në mbretërinë e Perëndisë, ndieva se ai do të kishte fuqi për t’i afruar njerëzit bashkë në dashuri e unitet.

Kjo më çoi te rrëfimi i gjendur te Doktrina e Besëlidhje, që përshkruan përpjekjet e pleqve të priftërisë për të ndërtuar Stonin në Misuri deri në brohoritjen prej engjëjve të cilët panë përpjekjet e tyre dhe kontributet e tyre. Ajo kërkoi sakrificë të madhe. Zbulesa në Doktrina e Besëlidhje



thotë: “Megjithatë, ju jeni të bekuar, sepse dëshmia që ju keni dhënë, shënohet në qiell, që engjëjt ta vështrojnë; dhe ata gëzohen për ju dhe mëkatet tuaja ju janë falur”⁴.

Në tabelën e gjatësisë së tim biri, unë gdhenda fjalët “Engjëjt Gëzohen për Ty”.

Aftësia e madhe e këtij biri për të grumbulluar dhe ndikuar te njerëzit u shtri edhe pas viteve të tij shkollorë. Tok me bashkëmbajtës të priftërisë, ai organizonte aktivitete kunji të cilat i dhanë rinisë së zonës së tij besim për të duruar e madje për të ngadhënjyer në situata të vështira. Kur ai zhvillonte besimin e këtyre të rinjve dhe të rejava, ai ndihmonte ngritjen e vendrojtave të Sionit në qendrat urbane të Amerikës. Në gdhendje vura engjëjt që u binin trumbetave, gjë që mund të mos jetë me saktësi mënyra si e bëjnë atë, por ishte më e lehtë të gdhendja një trumbetë, sesa britmën.

Engjëjt gëzojnë teksa udhëheqësit e priftërisë anekënd botës ndërtojnë Sionin në lagjet, kunjet dhe misionet e tyre. E ata do të gëzojnë për të rinjtë e të rejat që ju i ndihmoni për të ndërtuar Sionin kudo që janë dhe në çfarëdo rrethanash që mund të jenë. Sioni është rezultati i njerëzve të bashkuar nga besëlidhja dhe dashuria. Ju ftoj që ta ndihmoni rininë të bashkohet me të.

Për një nga bijtë e mi u nxita të gdhend një diell – d.m.th., diellin në qiell – dhe fjalët e marra nga Lutja Ndërmjetësuese e Shpëtimtarit: “Kjo Është Jeta e Përjetshme”. Pranë

përfundimit të shërbesës së Tij në vdekshmëri, Shpëtimtari iu lut Atit të Tij:

“Dhe kjo është jeta e përjetshme, të të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar.

Unë të kam përlëvduar mbi tokë; unë e kam kryer veprën që më ke dhënë të bëj.”⁵

Im bir ka dhënë shërbim priftërie nëpër tre kontinente, por më të rëndësishmin në shtëpinë e tij dhe brenda familjes së tij. E ka ndërtuar jetën e vet rreth tyre. Ai punon pranë shtëpisë dhe shpeshherë rikthehet për të qenë së bashku me bashkëshorten dhe fëmijët e tij më të vegjël në orën e drekës. Familja e tij jeton shumë pranë meje e Motrës Ajring. Kujdesen për oborrin tonë si të ishte i tyri. Ky bir jeton jo vetëm që të cilësohet i përshtatshëm për jetë të përjetshme, por gjithashtu për të jetuar i rrethuar nga familjarë mirënjohës të cilët ai po mbledh rreth vetes.

Jeta e përjetshme është të jetosh në unitet, në familje, me Atin, Birin dhe Frymën e Shenjtë. Jeta e përjetshme është e mundur vetëm nëpërmjet çelësave të priftërisë së Perëndisë, të cilat u rivendosën përmes Profetit Jozef Smith. T’ia inkurajosh atë qëllim të përjetshëm rinisë që ju udhëhiqni, është një dhuratë e madhe aq sa mund t’u jepnit. Ju do ta bëni këtë kryesisht me anë të shembullit në vetë familjen tuaj. Ata që ju udhëhiqni, mund të mos kenë një familje në Kishë, por ju nxis që t’i ndihmoni të ndiejnë dhe ta dëshirojnë dashurinë

për familjen në të dyja anët e velit.

Tabelat e gjatësisë që kam përshkruar janë vetëm njëra mënyrë për t’i ndihmuar të rinjtë të kenë një ide të madhështisë që Perëndia sheh tek ata dhe tek e ardhmja e tyre si edhe të shërbimit të përveçëm që Ai i ka përgatitur të japin. Ai do t’ju ndihmojë që të shihni në ç’mënyrë ta bëni këtë për fëmijët tuaj ose për të rinjtë që ju udhëhiqni. Por, kur kërkoni me ndihmën e lutjes ta kuptoni për vete këtë të ardhme dhe t’ia kumtoni atë të riut vetëm për vetëm, ju do të arrini të dini që Perëndia e njeh dhe e do secilin prej fëmijëve të Tij si individë dhe sheh dhurata të mëdha e të përveçme te çdo një prej tyre.

Si baba, unë u bekova të shoh të ardhme të shkëlqyera në mbretërinë e Perëndisë për bijat e mia sikurse për bijtë e mi. Kur me ndihmën e lutjes kërkoja udhëheqje, më tregohej një mënyrë për t’i ndihmuar bijat e mia të njihnin mirëbesimin që Perëndia kishte tek ato si shërbëtores që mund të ngrenë mbretërinë e Tij.

Kur bijat e mia ishin të reja, pashë se ne mund t’i ndihmonin të tjerët të ndienin dashuri për ata të përtej velit, gjatë gjithë brezave. E dija që dashuria vjen nga shërbimi dhe që frymëzon shpresë për jetë të përjetshme.

Kështu, ne gdhendëm tabaka për brumë, mbi të cilat vinim një bukë të bërë në shtëpi dhe shkonim së bashku për t’ua dhënë ofertën tonë të vejjave, të veje dhe familjeve. Mbishkrimi që gdhenda mbi secilën prej atyre tabakave, thoshte: “J’aime et J’espere”, varianti frëngjisht për “Dua dhe Shpresoj”. Prova e dhuratave të tyre të veçanta shpirtërore u shfaq jo thjesht në tabakat që gdhenda, por më me qartësi kur ne ua shpërndamë ato atyre që u nevojitej, mes dhembjes apo humbjes, siguria se dashuria e Shpëtimtarit dhe Shlyerja e Tij mund të krijonte një



Autoritetet e Përgjithshme të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Tetor 2012

PRESIDENCA E PARË



Henri B. Aiting
Këshilltar i Parë



Tomas S. Monson
President



Dieter F. Uchtdorf
Këshilltar i Dytë

KUORUMI I DYMËDHJETË APOSTOJUE



Boyd K. Packer



L. Tom Perri



Russell M. Nelson



Dallin H. Oaks



M. Russell Ballard



Riçard G. Skot



Robert D. Hejls



Xhefiri R. Holland



Dejvid A. Bednar



Kuentin L. Kuk



D. Tod Kristoferson



Nili L. Andersen

PRESIDENCA E TË SHITATËDHJETËVE



Ronald A. Rosstand



Uolter F. Gonzales



L. Ulmri Klejton



Donald L. Hollistrom



Ted R. Kejster



Riçard J. Menis



Kreig C. Kristensen

KUORUMI I PARË I TË SHITATËDHJETËVE

(sipas rendit alfabetik)



Markos A. Alukaitis



Hoze L. Alonso



Karlos T. Amado



Jan S. Audem



Mervin B. Arnold



Dejvid S. Balster



Shein M. Bowen



Keig A. Kardon



Jun Huan Çoi



Don R. Klark



Karl B. Kuk



Lorens E. Korbrxh



Klaudio K. M. Kosta



Leçrand K. Kurtis i Riu



Benjamin Die Hojps



Xhion B. Dikson



Kevin R. Dankan



Leri Eko Houk



Shenli G. Elis



Dejvid E. Evans



Enrike R. Falabalo



Eduardo Govaret



Robert C. Gei



Karlos A. Goudi



Kriandel Goolden i Riu



Gerit W. Gong



C. Skot Grou



Xhejms J. Hamula



Daniel L. Xhanson



Pol V. Xhanson



Patrik Kieron



Pol E. Kollkar



Erik W. Kopsishke



Markus B. Nash



Brent H. Nilson



Alan E. Pakar



Kevin W. Pison



Etroni D. Perkins



Pol B. Pajper



Rafael E. Piro



Bus D. Porter



Dej G. Renlund



Majkell T. Ringud



Lin G. Robins



Xhozef W. Siani



Sivven E. Snou



Ulises Soreash



Majkell Xhon U. Teh



Zhocé A. Teisheira



Huan A. Uceda



Fransko J. Vinjns



W. Kristofer Uadell



Ulliam R. Uolker



F. Majkell Utanson



Skar D. Uaining



Kazuniko Jamashita



Horge F. Zebalos



Klaudio D. Zivic



W. Meig Zuik

KUORUMI I DYTË I TË SHITATËDHJETËVE

(sipas rendit alfabetik)



Ulfard W. Andersen



Korçj Jojngj



Randall K. Benet



Brus A. Karlson



J. Devn Kornish



Bredri D. Foster



O. Vinsent Hobeik



Leri R. Lorens



Per G. Malm



Xhejms B. Marfino



Jaro Macagardi



Kent F. Rigand



Gregori A. Shvicer



Kent D. Utanson



Len Y. Ulison

PESHKOPATA KRYESUESE



Zhejndi Kosé
Këshilltar i Parë



Gejt E. Stinson
Peshkopit Kryesues



Dri M. Dejvis
Këshilltar i Dytë



Falë asaj që Presidenti Tomas S. Monson e quajti "mbulim i pandodhur më parë", shenjtoret e ditëve të mëvonshme në të gjithë botën i gëzuan bekimet e konferencës së përgjithshme. Të paraqitur në drejtim të akrepave të orës duke filluar lart në të majtë janë fotografi të anëtarëve dhe misionarëve nga Kuelimani në Mozambik; Talini në Estoni; Varshava në Poloni; Meksiko-Siti në Meksikë; Edinburgu në Skoci; Tajpei në Tajvan dhe Gaboroni në Botsvana.



ndriçim të përkryer të shpresës. Kjo është jetë e përgjeshme për bijat e mia dhe për secilin nga ne.

Tani, ndoshta po mendoni: “Vëllai Ajring, a po thua se duhet të mësoj se si të gdhend?” Përgjigja është që jo. Unë mësova të gdhend vetëm me ndihmën e një drejtuesi dashamirës e të talentuar, në atë kohë Plaku Bojd K. Paker. Ajo pak aftësi që arrita unë, mund t’i kushtohet dhuratës së tij të shkëlqyer si skalitës dhe durimit të tij si mësues. Vetëm qielli mund të japë një drejtues të tillë si Presidenti Paker. Por ka shumë mënyra me të cilat ju mund të ndikoni në zemrat e fëmijëve pa gdhendur për ta tabela druri ose tabela gjatësie.

Për shembull, teknologjitë e reja të komunikimit lejojnë të ndahen bashkërisht mesazhe besimi dhe shprese nëpër mijëra kilometrat që na ndajnë, në çast dhe me pak ose pa pagesë. Bashkëshortja më ndihmon ta bëj këtë gjë. Fillojmë duke folur në telefon me nipërit e mbesat ose fëmijët që arrijmë të kontaktojmë. U kërkojmë të na tregojnë ngjarje të sukseseve të tyre vetjake dhe të shërbimit të tyre të dhënë. Gjithashtu u lutemi të dërgojnë fotografi të atyre veprimtarive. Ne i përdorim ato fotografi për të ilustruar ca paragrafë teksti. Shtojmë një a dy vargje nga Libri i Mormonit. Ndoshta Nefit dhe Mormonit nuk do t’u bënte shumë përshtypje cilësia shpirtërore e asaj që shkruajmë, apo e përpjekjes së kufizuar që kërkohet për të krijuar atë që ne e quajmë “Ditari i Familjes: Fletët e Vogla”. Por Motra Ajring dhe unë jemi bekuar nga kjo përpjekje. Ne ndihemi të frymëzuar në zgjedhjen e fragmenteve të shkrimit të shenjtë dhe të mesazheve të shkurtra të dëshmisë që shkruajmë. Dhe ne shohim në jetën e tyre prova të kthimit të zemrës së tyre drejt nesh dhe drejt Shpëtimtarit e lart.

Gjenden mënyra të tjera për të

ardhur në ndihmë; ju tashmë jeni përfshirë në shumë prej tyre. Zakoni i lutjes familjare dhe i leximit të shkrimit të shenjtë do të krijojnë kujtime që mbahen mend më gjatë dhe ndryshime më të mëdha zemre, sesa mund të përfytyroni tani. Madje edhe veprimtari që nuk duken shpirtërore, si pjesëmarrja në një ngjarje atletike ose ndjekja e një filmi, mund të ndikojë në zemrën e fëmijës. Ajo që ka rëndësi nuk është veprimtaria, por ndjenjat që vijnë ndërsa e bëni atë. Kam zbuluar një kriter të mirë për të dalluar veprimtari që kanë mundësinë të sjellin ndryshim të madh në jetën e një të riu. Është që ta sugjerojnë ata veprimtarinë, të nisur nga një interesim që mendojnë se u ka ardhur si dhuratë nga Perëndia. E di nga vetë përvoja ime se kjo është e mundur.

Kur u bëra dhjak, në moshën 12-vjeçare, unë jetoja në Nju-Xhersi, 50 milje (80 km) nga Nju-Jork-Siti. Ëndërroja që të isha një lojtar i madh bejzbolli. Babai pranoi të më merrte që të shihja një lojë që zhvillohej në stadiumin e vjetër dhe historik Janki, në Bronks. Ende arrij të kujtoj vërtitjen e shkopit kur Xho Di-Maxhio shënoi një vrapim rreth e qark, i ulur në ndenjset qendrore të fushës me babanë tim pranë, të vetmen herë që kemi shkuar bashkë në një ndeshje bejzbolli të ligës kryesore.

Por një ditë tjetër me babanë tim, ndikoi përgjithmonë në jetën time. Ai më solli nga Nju-Xhersi në shtëpinë e një patriarku të shuguruar, në Solt-Lejk-Siti. Nuk e kisha parë asnjëherë më parë atë burrë. Babai më la te pragu i derës. Patriarku më shpuri te një karrige, i vendosi duart mbi kokën time dhe shprehu një bekim si dhuratë nga Perëndia, që përfshiu një shpallje të dëshirës së madhe të zemrës sime.

Ai tha që unë isha një prej atyre për të cilët është thënë: “Lum ata

që përpiqen për paqen”.⁶ Isha aq i befasuar që një plotësisht i panjohur mund ta njihnte zemrën time, sa që i hapa sytë për të parë dhomën ku po ndodhte një mrekulli e tillë. Ai bekim i mundësive të mia ka formësuar jetën time, martesën time dhe shërbimin tim në priftëri.

Nga ajo përvojë dhe nga ato në vijim, unë mund të dëshmoj: “Sepse të gjithë nuk e kanë çdo dhuratë të dhënë atyre; sepse ka shumë dhurata dhe çdo njeriu i jepet një dhuratë me anë të Shpirtit të Perëndisë”.⁷

Nëpërmjet zbulesës së një dhurate nga Zoti, kam qenë në gjendje të dalloj e të përgatitem për mundësi që ta ushtroj për bekimin e atyre që i dua dhe u shërbej.

Perëndia i di dhuratat tona. Sfida që kam për ju dhe për vete është të lutemi për të njohur dhuratat që na janë dhënë, të dimë si t’i zhvillojmë ato dhe të njohim mundësitë që na jep Perëndia për t’u shërbyer të tjerëve. Por më shumë se gjithçka, unë lutem që ju të frymëzoheni për t’i ndihmuar të tjerët të zbulojnë dhuratat e tyre të veçanta nga Perëndia për të shërbyer.

Ju premtoj se, nëse kërkoni, ju do të bekoheni për t’i ndihmuar dhe lartuar të tjerët deri në potencialin e tyre të plotë në shërbim të atyre që ata udhëheqin dhe i duan. Ju dëshmoj që Perëndia jeton, Jezusi është Krishti, kjo është priftëria e Perëndisë, ajo të cilën ne mbajmë, dhe Perëndia na ka përgatitur me dhurata të veçanta për t’i shërbyer Atij përtej shpresave më të dashura që kemi ushqyer. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Isaia 40:29–31.
2. Fjalët e Urta 28:1.
3. *Autobiography of Parley P. Pratt*, red. Parli P. Prati i Riu. (1938), f. 211.
4. Doktrina e Besëlidhje 62:3.
5. Gjoni 17:3–4.
6. Mateu 5:9.
7. Doktrina e Besëlidhje 46:11.



Nga Presidenti Tomas S. Monson

Shihini të Tjerët ashtu siç Mund të Bëhen

Ne duhet të zhvillojmë aftësinë për t'i parë njerëzit jo siç janë në këtë çast, por si mund të bëhen.

Vëllezër të mi të dashur, dy herë në vit kjo Qendër madhështore e Konferencave mbushet plot me mbajtës të priftërisë së Perëndisë, ndër sa mblidhemi për të dëgjuar mesazhet e frymëzimit. Ka një ndjenjë të mrekullueshme shpirtërore që përhapet në mbledhjen e përgjithshme të priftërisë të Kishës. Kjo ndjenjë shpirtërore buron nga Qendra e Konferencave dhe hyn në çdo ndërtesë ku mblidhen bijtë e Perëndisë. Ne me siguri e kemi ndier atë ndjenjë shpirtërore sonte.

Disa vite më parë, përpara se të ndërtohej kjo Qendër e bukur e Konferencave, një vizitor te Sheshi i Tempullit në Solt-Lejk-Siti mori pjesë në një sesion të konferencës së përgjithshme në Tabernakull. Ai dëgjoi mesazhet e Vëllezërve. Ai u kushtoi vëmendje lutjeve. Ai dëgjoi muzikën e bukur nga Kori i Tabernakullit. Ai u mahnit nga madhështia e organos së mrekullueshme të Tabernakullit. Pasi përfundoi mbledhja, ai u dëgjua tek thoshte: “Do të jepja gjithçka që kam nëse do ta dija se ajo që këta folës thanë sot ishte e vërtetë”. Në thelb ai po thoshte: “Do të doja që të kisha një dëshmi për ungjillin”.

Nuk ka absolutisht asnjë gjë në këtë botë që do të sillte më shumë

ngushëllim dhe lumturi sesa një dëshmi e së vërtetës. Unë besoj se çdo burrë apo i ri këtu sonte ka një dëshmi, ndonëse dëshmitë e tyre ndryshojnë nga shkalla e fuqisë. Nëse ndieni se nuk e keni ende thellësinë e dëshmisë që do të donit, unë ju këshilloj të punoni për ta arritur një dëshmi të tillë. Nëse është e fortë dhe e thellë, punoni që ta mbani të tillë. Sa të bekuar jemi që kemi njohurinë e së vërtetës!

Mesazhi im sonte, vëllezër, është se ka individë të panumërt që pikërisht tani kanë një dëshmi të vogël ose asnjë dëshmi, megjithatë, ata mund dhe do ta marrin një dëshmi të tillë nëse ne do të jemi të gatshëm të bëjmë përpjekje për ta ndarë atë dhe për t'i ndihmuar ata të ndryshojnë. Në disa rase mund të ofrojmë nxitjen për ndryshim. Së pari, do t'u drejtohem atyre që janë anëtarë, por që aktualisht nuk janë zotuar plotësisht ndaj ungjillit.

Shumë vite më parë, në një konferencë zone të mbajtur në Helsinki, në Finlandë, dëgjova një mesazh të fuqishëm, të paharrueshëm e nxitës të dhënë gjatë një sesioni për nënat dhe bijat. Nuk e kam harruar atë mesazh, ndonëse kanë kaluar pothuaj 40 vjet që kur e dëgjova atë. Midis shumë të

vërtetave për të cilat diskutoi folësja, ajo tha se një grua ka nevojë që t'i thuhet se është e bukur. Ka nevojë që t'i thuhet se është e çmuar. Ka nevojë që t'i thuhet se ka vlerë.

Vëllezër, e di që burrat janë shumë të ngjashëm me gratë në këtë aspekt. Ne kemi nevojë që të na thuhet se jemi të çmuar, se jemi të zotë dhe kemi vlerë. Ne kemi nevojë të na jepet mundësia për të shërbyer. Për ata anëtarë që nuk janë aktivë apo janë ngurrues për të qenë aktivë, ne mund të kërkojmë me lutje ndonjë mënyrë për t'i ndihmuar. T'u kërkojmë atyre që të shërbejnë në disa pozicione mund të jetë thjesht stimuli që iu nevojitet për t'u kthyer në aktivitet të plotë. Por ata udhëheqës që mund të ndihmojnë në këtë aspekt, ndonjëherë nuk janë të gatshëm ta bëjnë këtë. Ne duhet ta ngulisim në mendje që njerëzit mund të ndryshojnë. Ata mund t'i lënë pas veset e këqija. Ata mund të pendohen për shkeljet. Ata mund ta mbajnë priftërinë me denjësi. Dhe mund t'i shërbejnë Zotit me zell. Më lejoni të jap disa shembuj.

Kur u bëra së pari anëtar i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, pata mundësinë të shoqëroja Presidentin N. Eldon Taner, këshilltar i Presidentit Dejvid O. Mek-Kei, në një konferencë kunji në Alberta të Kanadasë. Gjatë mbledhjes, presidenti i kunjit lexoi emrat e katër vëllezërve që ishin kualifikuar për t'u shuguruar pleq. Këta ishin burra të cilët Presidenti Taner i njihte, pasi dikur kishte jetuar në atë zonë. Por Presidenti Taner i njihte dhe i mbante mend se si qenë dikur, dhe nuk e dinte që ata kishin ndryshuar krejtësisht jetën e tyre dhe ishin kualifikuar plotësisht për t'u bërë pleq.

Presidenti i kunjit lexoi emrin e burrit të parë dhe i kërkoi të ngrihej në këmbë. Presidenti Taner më pëshpëriti: “Shikoje atë. Nuk e mendova kurrë se do t'ia dilte.” Presidenti i kunjit lexoi



emrin e burrit të dytë, dhe ai u ngrit në këmbë. Presidenti Taner më shtyu lehtë sërish dhe shfaqti habinë e tij. Dhe kështu qe me që të katërt vëllezërit.

Pas mbledhjes, Presidenti Taner dhe unë patëm mundësinë t'i përgëzonim këta katër vëllezër. Ata kishin treguar se njerëzit mund të ndryshojnë.

Gjatë viteve 1940 dhe 1950, një drejtor amerikan burgu, Klinton Dafi, ishte i njohur për përpjekjet e tij për të riaftësuar burrat në burgun e tij. Një kritik tha: "A nuk e dini se ujku qimen e ndërron por zakonin s'e harron?"

Drejtori Dafi u përgjigj: "Ti duhet ta dish se unë nuk punoj me ujqër. Unë punoj me njerëz dhe njerëzit ndryshojnë çdo ditë."¹

Shumë vite më parë, pata mundësinë për të shërbyer si president i Misionit të Kanadasë. Atje kishim një degë me një numër shumë të vogël mbajtësish të priftërisë. Ne gjithmonë kishim një misionar që kryesonte në degë. Unë mora një mbresë të fortë se ne duhej të kishim një anëtar të degës që të kryesonte.

Ne kishim një anëtar të rritur në degë, i cili ishte dhjak në Priftërinë Aarone, por që nuk mernte pjesë ose nuk përfshihej mjaftueshëm sa të përparonte në priftëri. U ndieva i frymëzuar që t'i jepja atij thirrjen si president degë. Do ta kujtoj gjithnjë ditën që pata intervistën me të. I thashë se Zoti më kishte frymëzuar që t'i jepja thirrjen për të qenë president i degës. Pas shumë kundërshtimesh nga ana e tij dhe shumë inkurajim nga ana e bashkëshortes së tij, ai tha se do të shërbente. E shugurova prift.

Ishte fillimi i një dite të re për atë burrë. Jeta e tij menjëherë u rregullua dhe ai më siguroi se do t'i jetonte urdhërimet siç pritej që t'i jetonte. Në pak muaj ai u shugurova plak. Ai dhe bashkëshortja e tij përfundimisht shkuan në tempull dhe u vulosën. Fëmijët e tyre shërbyen në misione dhe u martuan në shtëpinë e Zotit.

Ndonjëherë t'ua bëjmë të ditur vëllezërve tanë se kemi nevojë për ta dhe se i çmojmë, mund t'i ndihmojmë të ndër marrin atë hap drejt zotimit dhe

aktivitetit të plotë. Kjo mund të jetë e vërtetë për mbajtësit e priftërisë pavarësisht moshës. Është përgjegjësia jonë t'u japim atyre mundësinë që të jetojnë siç duhet. Ne mund t'i ndihmojmë ata t'i mposhtin të metat e tyre. Ne duhet të zhvillojmë aftësinë për t'i parë njerëzit jo siç janë në këtë çast, por si mund të bëhen kur të marrin dëshmi të ungjillit të Krishtit.

Një herë mora pjesë në një mbledhje në Ledvill të Kolorados. Ledvilli ndodhet në një lartësi mbi 3.000 m. E mbaj mend atë mbledhje të veçantë për shkak të lartësisë së madhe, por gjithashtu e mbaj mend për shkak të asaj që ndodhi atë mbrëmje. Atje ishin të pranishëm vetëm një numër i vogël mbajtësish të priftërisë. Sikurse me degën në Misionin Kanadez, ajo degë kryesohej nga një misionar dhe gjithmonë ishte kryesuar nga një i tillë.

Atë natë patëm një mbledhje të këndshme, por ndërsa po këndonim himnin e mbylljes, më erdhi frymëzimi se atje duhej të kryesonte një president degë vendor. U ktheva nga

presidenti i misionit dhe e pyeta: “A ndodhet këtu dikush që mund të kryesojë – një burrë nga vendi?”

Ai u përgjigj: “Nuk njoh ndonjë”.

Gjatë këndimit të asaj kënge pashë me kujdes burrat që ishin ulur në tre rreshtat e parë. Vëmendja ime u duk se u përqendrua te njëri prej vëllezërve. “A mundet ai të shërbejë si president dege?”, i thashë presidentit të misionit.

Ai u përgjigj: “Nuk e di. Ndoshta mundet.”

Unë i thashë: “President, do ta marr atë në sallën tjetër dhe do ta intervistoj. Ti fol pas himnit të mbylljes derisa ne të kthehemi.”

Kur të dy ne u kthyem në sallë, presidenti i misionit e mbylli dëshminë e tij. Unë prezantova emrin e vëllait që do të ishte presidenti i ri i degës. Nga ajo ditë e më tej, Ledvill në Kolorado, ka një anëtar nga vendi që e drejton njësinë.

I njëjti parim, vëllezër, zbatohet ndaj atyre që nuk janë ende anëtarë. Ne duhet ta zhvillojmë aftësinë për t'i parë njerëzit jo siç janë, por si mund të bëhen kur të jenë anëtarë të Kishës, kur të kenë një dëshmi për ungjillin dhe kur jeta e tyre të jetë në përputhje me mësimet e tij.

Kohë më parë në vitin 1961 u mbajt një konferencë mbarëbotërore për presidentët e misioneve dhe çdo president misioni në Kishë u soll në Solt-Lejk-Siti për këto mbledhje. Unë erdha në Solt-Lejk-Siti nga misioni im në Toronto, Kanada.

Në një mbledhje të veçantë, N. Eldon Taner, i cili atëherë ishte Ndihmës i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, sapo ishte kthyer nga përvoja e tij fillestare e kryesimit në misionet në Britaninë e Madhe dhe Europën perëndimore. Ai tregoi për një misionar që kishte qenë misionari më i suksesshëm, të cilin e kishte takuar në të gjitha intervistat që kishte kryer. Ai tha se ndërsa e intervistoi atë misionar, i tha: “Mendoj se të gjithë njerëzit të cilët i

ke pagëzuar erdhën në Kishë me anë të rekomandimeve”.

Djali i ri u përgjigj: “Jo, ne i gjetëm të gjithë ata duke shpërndarë pamflete”.

Vëllai Taner e pyeti atë se cili që ndryshimi lidhur me qasjen e tij – përse ai pati një sukses të tillë të jashtëzakonshëm kur të tjerët nuk e patën. Djali i ri i tha se ai u orvat të pagëzonte çdo person që takoi. Ai tha se nëse do të trokiste në derë dhe do të shihte një burrë duke pirë duhan dhe të veshur me veshje të vjetra, dhe në dukje pa interes për gjë – veçanërisht për fenë – misionari do ta përfytyronte atë në vetë mendjen e tij se si do të dukej ai burrë në një sërë rrethanash të ndryshme. Në mendjen e tij do ta shihte atë si të porsarruar dhe të veshur me këmishë të bardhë dhe pantallona të bardha. Dhe misionari do ta përfytyronte veten duke e drejtuar atë burrë në ujërat e pagëzimit. Ai tha: “Kur e shoh dikë në atë mënyrë, unë kam aftësinë t’ia tregoj

atij dëshminë time në një mënyrë që mund të prekë zemrën e tij”.

Ne kemi përgjegjësinë t’i shohim në këtë mënyrë miqtë tanë, kolegët tanë, fqinjët tanë. Sërish, ne kemi përgjegjësinë për t’i parë individët jo siç janë, por përkundrazi, ashtu si mund të bëhen. Do t’ju lutesha që të mendoni për ta në këtë mënyrë.

Vëllezër, Zoti na tha diçka rreth rëndësisë së kësaj priftërie që ne mbajmë. Ai na tha se ne mund ta marrim atë me betim dhe besëlidhje. Ai na dha udhëzimin që ne duhet të jemi besnikë dhe të vërtetë në gjithçka që marrim, dhe se kemi përgjegjësinë për ta mbajtur këtë besëlidhje madje deri në fund. Dhe më pas gjithçka që Ati ka do të na jepet neve.²

Guxim është fjala që ne duhet të dëgjojmë dhe mbajmë pranë zemrave tona – guxim për t’ia kthyer krahët tundimit, guxim për të ngritur zërin tonë gjatë dëshmisë ndaj të gjithë



atyre që takojmë, duke kujtuar se çdokush duhet të ketë mundësinë ta dëgjojë mesazhin. Për pjesën më të madhe nuk është një gjë e lehtë për ta bërë këtë. Por ne mund të arrijmë të besojmë në fjalët e Palit drejtuar Timoteut:

“Sepse Perëndia nuk na ka dhënë frymë frike, por force, dashurie dhe urtësie.

Mos ki turp, pra, të dëshmosh Zotin tonë.”³

Në maj të 1974-ës isha me vëllanë Xhon H. Groberg në ishujt tongan. Ne patëm një takim që të vizitonim mbretin e Tongës dhe shkuam me të në një mbledhje zyrtare. Ne shkëmbyem komplimentet e zakonshme. Megjithatë, përpara se të largoheshim, Xhon Grobergu tha diçka që ishte ndryshe nga zakonisht. Ai tha: “Madhëria juaj, ju vërtet duhet të bëheni mormon dhe nënshtetasit tuaj gjithashtu, pasi atëherë problemet tuaja dhe të atyre do të zgjidheshin në shkallë të gjerë”.

Mbreti buzëqeshi shumë dhe u përgjigj: “Xhon Groberg, ndoshta ke të drejtë”.

Mendova për Apostullin Pal përpara Agripës. Mendova për përgjigjen e Agripës ndaj dëshmisë së Palit: “Për pak dhe po ma mbush mendjen të bëhem i krishterë”⁴. Vëllai Groberg pati guximin ta ndante dëshminë e tij me një mbret.

Sonte ka mijëra mbajtës të priftërisë që po i shërbejnë Zotit me kohë të plotë si misionarë të Tij. Në përgjigje të një thirrjeje për mision, ata kanë lënë pas shtëpinë, familjen, miqtë e shkollën dhe kanë shkuar përpara për të shërbyer. Ata të cilët nuk e kuptojnë, bëjnë pyetjen: “Përse përgjigjen me kaq dëshirë dhe japin me gatisshmëri kaq shumë?”

Misionarët tanë mund të përgjigjen fare mirë me fjalët e Palit, atij misionari të pashoq të kohës së hershme: “Sepse, në qoftë se unë predikoj

ungjillin, s’ka asgjë që unë të mburrrem, sepse kjo është një nevojë që më është ngarkuar; edhe mjerë unë, po nuk predikova ungjillin!”⁵

Në shkrimet e shenjta nuk ka shpallje më të përshtatshme, përgjegjësi më detyruese dhe udhëzim më të drejtëpërdrejtë sesa urdhërimi i dhënë nga Zoti i ringjallur ndërsa iu shfaq në Galile të njëmbëdhjetë dishepujve. Ai tha:

“Mua më është dhënë çdo pushtet në qiell e në tokë.

Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë,

dhe duke i mësuar të zbatojnë të gjitha gjërat që unë ju kam urdhëruar. Dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës.”⁶

Ky urdhër hyjnor, i bashkuar me premtimin e tij të lavdishëm, është motoja jonë sot, sikurse që në meridianin e kohës. Puna misionare është një tipar dallues i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Përherë ka qenë; gjithmonë do të jetë. Sikurse shpalli Profeti Jozef Smith: “Pas gjithçkaje që është thënë, detyra më e madhe dhe më e rëndësishme është të predikojmë Ungjillin”⁷.

Brenda dy viteve të shkurtër, të gjithë misionarët kohëplotë që shërbejnë aktualisht në këtë ushtri madhështore të Perëndisë, do t’i kenë përfunduar punët e tyre me kohë të plotë dhe do të jenë kthyer në shtëpitë e tyre dhe tek të dashurit e tyre. Zëvendësuesit e tyre gjenden sonte te mbajtësit e Priftërisë Aaronë të Kishës. Të rinj, a jeni gati të përgjigjen? A jeni të gatshëm të punoni? A jeni të përgatitur të shërbeni?

Presidenti Xhon Tejlor i përmbloodhi kërkesat: “Lloji i burrave që ne dëshirojmë si mbajtës të këtij mesazhi të ungjillit janë burrat që kanë besim në Perëndi; burrat që kanë besim në fenë e tyre; burrat që e nderojnë priftërinë

e tyre; . . . burra plot me Frymën e Shenjtë dhe fuqinë e Perëndisë[.] . . . burra të nderit, integritetit moral, virtytit dhe dëlirësisë”⁸.

Vëllezër, çdonjërit prej nesh i vjen urdhri për të ndarë ungjillin e Krishtit. Kur jeta jonë pajtohet me vetë standardet e Perëndisë, ata të cilët ndikohen nga ne, asnjëherë nuk do të shprehin vajtmin: “Korja ka mbaruar, vera ka marrë fund dhe ne nuk kemi shpëtuar.”⁹

Bariu i përsosur i shpirtave, misionari që shëlbeu njerëzimin, na dha sigurimin e Tij hyjnor:

“Dhe nëse është që ju duhet të punoni gjithë ditët tuaja për t’u shpallur pendim këtyre njerëzve dhe sillni qoftë edhe një shpirt tek unë, sa i madh do të jetë gëzimi juaj me të në mbretërinë e Atit tim!

Dhe tani, nëse gëzimi juaj do të jetë i madh me një shpirt që keni sjellë tek unë në mbretërinë e Atit tim, sa i madh do të jetë gëzimi juaj nëse do të më sillni shumë shpirta!”¹⁰

Unë jap dëshminë time vetjake për Atë që i foli këto fjalë. Ai është biri i Perëndisë, Shëlbuesi ynë dhe Shpëtimtari ynë.

Lutem që do të kemi guximin të zgjasim dorën e miqësisë, këmbënguljen për t’u përpjekur e përpjekur sërish, dhe përlulësinë e nevojshme për të kërkuar drejtim nga Ati ynë ndërsa përmbushim urdhrin tonë për të ndarë ungjillin. Përgjegjësinë e kemi ne mbi supë, vëllezër. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Në Bill Sands, *The Seventh Step* (1967), f. 9.
2. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:33–39.
3. 2 Timoteut 1:7–8.
4. Veprat e Apostujve 26:28.
5. 1 Korintasve 9:16.
6. Mateu 28:18–20.
7. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 349.
8. *Teachings of Presidents of the Church: John Taylor* (2001), f. 73.
9. Jeremia 8:20.
10. Doktrina e Besëlidhje 18:15–16.



Nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

Ku Është Tenda?

Tenda që duket se i bëhet pengesë ndihmës hyjnore nuk mbulon Perëndinë, por me raste ajo na mbulon ne. Perëndia kurrë nuk fshihet, por ama ne ndonjëherë fshihemi.

Në thellësitë e ankthit të tij në burgun e Libertisë, profeti Jozef Smith thirri: “O Perëndi, ku je ti? Dhe ku është tenda që mbulon vendin tënd të fshehjes?”¹ Shumë prej nesh ndiejnë se e kemi larg Perëndinë në çastet e ankthit vetjak. Tenda që duket se i bëhet pengesë ndihmës hyjnore nuk mbulon Perëndinë, por me raste ajo na mbulon ne. Perëndia kurrë nuk fshihet, por ama ne ndonjëherë fshihemi, të mbuluar nga një tendë arsyeshe që na largojnë nga Perëndia dhe e bëjnë Atë të duket i largët dhe i paarritshëm. Ndjesia e një tende që largon Perëndinë, krijohet nga vetë dëshirat tona dhe jo nga një ndjesi e tipit: “U bëftë vullneti yt”². Perëndia është përherë në gjendje të na shohë e të komunikojë me ne, por ne mund të mos jemi të gatshëm ta dëgjojmë ose t’i nënshtrohemi vullnetit dhe kohës së caktuar prej Tij për ne.

Ndjesitë tona të largësisë nga Perëndia do të zvogëlohen teksa bëhemi më shumë si fëmijë përpara Tij. Kjo nuk është e lehtë në një botë ku mendimet e qenieve të tjera njerëzore mund të kenë ndikim kaq të madh te shtysat tona. Por do të na ndihmojë që ta dallojmë këtë të vërtetë: Perëndia është pranë nesh dhe në dijeni për ne,

dhe kurrë nuk u fshihet fëmijëve të Tij besnikë.

Mbesa ime tri vjeçare tregoi fuqinë e pafajësisë dhe përlësisë që na lidh me Perëndinë. Ajo shkoi me familjen e saj në shtëpinë e hapur të Tempullit të Brigam-Sitit në Juta. Në një nga dhomat e asaj ndërtese të bukur, ajo vështrroi përreth the pyeti: “Mami, ku është Jezusi?” E ëma i shpjegoi se nuk do ta shihte Jezusin në tempull, por që do të ishte në gjendje të ndiente ndikimin e Tij në zemrën e saj. Eliza e mendoi me kujdes përgjigjen e të ëmës dhe pastaj u duk e kënaqur e tha: “Oh, Jezusi ka ikur të ndihmojë dikë”, arsyetoi ajo.

Asnjë tendë nuk e errësoi kuptueshmërinë e Elizës, as nuk u bë pengesë që ajo ta kuptonte realitetin. Perëndia është pranë saj dhe ajo ndihet pranë Tij. Ajo e dinte se tempulli është shtëpia e Zotit, por gjithashtu kuptoi se Jezu Krishti i ringjallur e i përlëvduar ka një trup dhe mund të jetë vetëm në një vend në një kohë të caktuar.³ Nëse Ai nuk qe në shtëpinë e Tij, ajo e kuptoi se Ai duhet të ishte diku tjetër. Nga njohuria e saj për Shpëtimtarin, ajo e dinte se Ai do të ishte ndokund duke u bërë të mira fëmijëve të Atit të Tij. Ishte e qartë se kishte shpresuar

të shihte Jezusin, jo për të pasur një mrekulli që t’ia vërtetonte ekzistencën e Tij, por thjesht sepse e donte Atë.

Shpirti mundi t’i zbulonte mendjes e zemrës së saj fëmijërore ngushëllimin që na duhet dhe dëshirohet prej të gjithëve ne. Jezu Krishti jeton, Ai na njeh, na ruan dhe kujdeset për ne. Në çaste dhembjeje, vetmie apo hutimi, nuk na duhet ta shikojmë Jezu Krishtin që të dimë se Ai është në dijeni të rrethanave tona dhe se misioni i Tij është që të na bekojë.

Unë e di nga vetë jeta ime që përvoja e Elizës mund të bëhet përvoja jona edhe shumë kohë pasi e lëmë fëmijërinë. Në vitet e hershme të karrierës sime, punova fort që të fitoja një pozicion si profesor në Universitetin e Stenfordit. Mendova se kisha siguruar një jetë të mirë për veten dhe për familjen time. Jetonim pranë prindërve të gruas sime në një ambient shumë të qetë. Sipas standardeve të botës, kisha arritur sukses të madh. Por m’u dha mundësia nga Kisha që të largohesha nga Kalifornia dhe të shkoja në kolegjin “Riks” në Reksburg të Ajdahos. Synimet e mia profesionale në jetë mund të kishin qenë si një tendë që të më shkëpusnin nga një Atë i dashur që e dinte më mirë se unë se çfarë më priste në të ardhmen. Por pata bekimin se e dija që çfarëdo sukcesi që kisha arritur në karrierën e jetën time familjare deri në atë çast, qe një dhuratë nga Perëndia. Dhe kështu, si fëmijë, u gjunjëzova në lutje që të pyesja se çfarë duhet të bëja. Qeshë në gjendje të dëgjoja një zë të ulët në mendjen time që tha: “Është shkolla Ime”. Nuk kishte asnjë tendë që të më mbulonte nga Perëndia. Me besim e përlësi, ia nënshtrova vullnetin tim të Tijit dhe ndieva përkujdesjen e afërsinë e Tij.

Vitet e mia në kolegjin “Riks”, gjatë të cilave u përpoqa të mësoja vullnetin e Perëndisë dhe të vepra sipas tij, nuk e



lanë tendën që të më mbulonte apo të fshihte rolin aktiv të Perëndisë në jetën time. Ndërsa përpiqesha të bëja punën e Tij, ndihesha pranë Tij dhe ndieja sigurinë që Ai i dinte rrethanat e mia dhe kujdesej fort për lumturinë time. Por ashtu si me Stenfordin, shtysat e kësaj bote filluan të më paraqiteshin. Njëra qe një ofertë pune tërheqëse, që m'u paraqit kur po mbaroja vitin tim të pestë si president i kolegjit "Riks". E mora parasysh ofertën dhe u luta rreth saj dhe madje e diskutova me Presidentin e Parë. Ata u përgjigjën me ngrohtësi e pak humor, por sigurisht jo me ndonjë udhëzim. Presidenti Spenser W. Kimball më dëgjoi teksta ia paraqisja ofertën që kisha marrë nga një korporatë e madhe dhe tha: "Epo, Henri, duket si një mundësi e mrekullueshme! Dhe nëse do kemi ndonjëherë nevojë për ty, do ta dimë ku të të gjejmë." Ata do ta kishin ditur se ku të më gjenin, por dëshirat e mia për sukses profesional mund të kishin krijuar një tendë që do të ma vështirësonin të gjeja Perëndinë dhe do të ma bënin të vështirë që t'i dëgjoja e t'i ndiqja ftesat e Tij.

Gruaja ime, duke e ndier këtë, pati një përshtypje të fortë që nuk duhej të largoheshim nga kolegji "Riks". Unë thashë: "Kjo mjafton për mua". Por me urtësi, ajo këmbënguli që duhet të merrja zbuluesin time vetjake. Dhe kështu u luta përsëri. Këtë herë mora vërtet udhëzim, në trajtën e një zëri

në mendjen time që tha: "Do të të lë të qëndrosh pak më gjatë në kolegjin 'Riks'". Ambiciet e mia vetjake mund ta kishin megjulluar vështirimin tim të realitetit dhe mund të ma kishin bërë të vështirë që të merrja zbuluesin.

Tridhjetë ditë pasi u bekova me vendimin e frymëzuar që ta refuzoja ofertën e punës dhe të qëndroja në kolegjin "Riks", digja e Tetonit shpërtheu aty afër. Perëndia e dinte që digja do të shpërthente dhe se qindra njerëz do të kishin nevojë për ndihmë. Ai më la që të kërkoja këshillë dhe të merrja lejen e Tij për të qëndruar në kolegjin "Riks". Ai i dinte të gjitha arsyet përse shërbimi im mund të ishte ende i vlefshëm në kolegji dhe në Reksburg. Pra unë isha aty që t'i kërkoja vazhdimisht në lutje Atit Qiellor që të më drejtonte të bëja ato gjëra që do t'u vinin në ndihmë njerëzve, pasuria dhe jeta e të cilëve qe dëmtuar. Kalova kohë duke punuar me ata njerëz që të pastroja baltën dhe ujin prej shtëpive. Dëshira ime për të ditur dhe për të bërë vullnetin e Tij më dha një mundësi që të hapja shpirtin.

Kjo ngjarje paraqet një mënyrë tjetër se si ne mund të krijojmë një pengesë për të ditur vullnetin e Perëndisë apo për ta ndier dashurinë e Tij për ne: ne s'mund të këmbëngulim tek kalendari ynë ndërkohë që Zoti ka të Tijin. Unë mendova se kisha kaluar mjaft kohë duke shërbyer në Reksburg dhe e kisha me nxitim që të bëja përpara.

Ndonjëherë këmbëngulja jonë për të vepruar sipas vetë kalendarit tonë mund të na e turbullojë vullnetin e Tij për ne.

Në burgun e Libertisë, profeti Jozef i kërkoi Zotit t'i ndëshkonte ata që përndiqnin anëtarët e Kishës në Misuri. Lutja e tij qe për një ndëshkim të sigurt dhe të shpejtë. Por Zoti u përgjigj se "jo shumë vjet që nga [aljo kohë]"⁴ Ai do të merrej me ata armiq të Kishës. Në vargjet 24 dhe 25 të seksionit të 121-të të Doktrina e Besëlidhje, Ai thotë:

"Vini re, sytë e mi i shohin dhe i njohin të gjitha veprat e tyre dhe unë kam në ruajtje një gjykim të shpejtë në stinën e tij për të gjithë ata;

Sepse ka një kohë të caktuar për çdo njeri, sikurse do të jenë veprat e tij"⁵.

Ne e heqim tendën kur ndiejmë e lutemi: "U bëftë vullneti yt", dhe "në vetë kohën e caktuar nga Ti". Koha e Tij duhet të jetë mjaftueshëm shpejt për ne, meqenëse e dimë se Ai dëshiron vetëm më të mirën.

Nusja e njerit prej bijve të mi kaloi shumë vite duke ndier se Perëndia kishte vendosur një tendë mbi të. Ajo qe një nënë e re e tre fëmijëve, e cila dëshironte më shumë fëmijë. Pas dy abortesh, lutjet e saj përgjëruese u bënë më të ankthshme. Teksa kaluan më shumë vite shterpësie, ajo ndieu tundimin për t'u zemëruar. Kur më i vogli shkoi në shkollë, zbrazëtia e shtëpisë së saj dukej se e përqeshte vendimin e saj për t'u përqendruar te mëmësia – po kështu edhe shtatzënësitë e paplanifikuara e madje të padëshiruara të të njohurave të saj. Ajo u ndie po aq e përkushtuar dhe e shenjtëruar sa Maria, e cila pohoi: "Ja shërbëtorja e Zotit"⁶. Por megjithëse i tha këto fjalë brenda zemrës së saj, ajo nuk mund të dëgjonte asgjë si përgjigje.

I shoqi, duke shpresuar ta ngrinte shpirtërisht, e ftoi të shkonte me të në një udhëtim pune në Kaliforni. Ndërsa ai merrte pjesë në mbledhje, ajo ecte

përgjatë një plazhi të bukur e të zbrazët. Me zemrën gati në shpërthim, ajo u lut me zë të lartë. Për herë të parë, nuk kërkoi një fëmijë tjetër, por një qëllim hyjnor. “Atë Qiellor”, thirri ajo, “do të të jap të gjithë kohën time; të lutem më trego se si ta mbush atë.” Ajo shprehu gatishmërinë e saj për ta çuar familjen e vet kudo që do t’u kërkohet të shkonin. Ajo lutje krijoi një ndjenjë të papritur paqeje. Me siguri që nuk e kënaqi dëshirën gërryese të mendjes së saj, por për herë të parë pas kaq vitesh, ia qetësoi zemrën.

Lutja e hoqi tendën dhe hapi pragjet e qiellit. Brenda dy javësh mësoi se po priste një fëmijë. Foshnja e vogël që vetëm një vjeç kur thirrja e misionit i erdhi tim biri dhe nuses së tij. Duke qenë se kishte premtuar se do të bënte çdo gjë, kudo qoftë, ajo e la mënjanë frikën dhe i mori fëmijët përtej detit. Gjatë kohës së misionit ajo lindi një fëmijë tjetër – në ditën e transferimit të misionarëve.

Nënshtrimi i plotë ndaj vullnetit të qiellit, siç bëri kjo nënë e re, është thelbësor për të larguar tendat shpirtërore që ndonjëherë i vendosim mbi kokat tona. Por kjo nuk siguron përgjigje të menjëhershme ndaj lutjeve tona.

Zemra e Abrahamit duket të ketë qenë e drejtë shumë më përpara se Sara të ngjizej me Isakun dhe përpara se të merrnin tokën e tyre premtuar. Qielli kishte qëllime të tjera për të përmbushur në fillim. Ato qëllime përfshinin jo vetëm forcimin e besimit të Abrahamit dhe Sarës, por edhe t’u mësonin atyre të vërteta të përzetshme, që ata i ndanë me të tjerët në rrugëtimin e tyre të gjatë e gjarpërues drejt tokës së përgatitur për ta. Vonesat e Zotit shpesh duken të gjata; disa zgjatin një jetë të tërë. Por ato gjithmonë kanë qëllim të bekojnë. Ato vonesa kurrë nuk duhet të jenë periudha vetmie apo dhembjeje ose padurimi.

Megjithëse koha e caktuar nga Ai nuk është gjithmonë koha kur duam ne, ne mund të jemi të sigurt se Zoti i mban premtimet. Për secilin nga ju që tani ndien se Ai është larg për t’u arritur, unë dëshmoj se do të vijë dita që ne të gjithë do ta shohim Atë ballë për ballë. Ashtu si nuk ka asgjë që ta turbullojë vështrimin e Tij drejt nesh, nuk do të ketë asgjë që ta turbullojë vështrimin tonë drejt Tij. Ne të gjithë do të qëndrojmë personalisht para Tij. Ashtu si mbesa ime, ne dëshirojmë ta shikojmë Jezu Krishtin tani, por takimi ynë i sigurt me Të para shufrës së gjykimit do të jetë më i këndshëm nëse bëjmë së pari gjërat që e bëjnë Atë aq të afërt për ne, sa jemi ne për Të. Ndërsa i shërbejmë Atij, ne bëhemi si Ai dhe ndihemi më pranë Tij teksa i afrohem asaj dite kur asgjë nuk do ta pengojë pamjen tonë.

Ky përparim drejt Perëndisë mund të jetë i vazhdueshëm. “Ejani, të bekuar të Atit tim; merrni në trashëgim mbretërinë që u bë gati për ju që nga krijimi i botës”⁷, jep mësim Shpëtimtari. Dhe pastaj na tregon mënyrën:

“Sepse pata uri dhe më dhatë për të ngrënë, pata etje dhe më dhatë për të pirë; isha i huaj dhe më pritët:

isha i zhveshur dhe më veshët, isha i sëmurë dhe ju më vizitonit, isha në burg dhe erdhët tek unë’.

Atëherë të drejtët do t’i përgjigjen duke thënë: ‘Zot, kur të pamë të uritur dhe të dhamë për të ngrënë; ose të etur dhe të dhamë për të pirë?’

Dhe kur të pamë të huaj dhe të pritëm ose të zhveshur dhe të veshëm?

Dhe kur të pamë të lënguar ose në burg dhe erdhëm te ti?’

Dhe Mbreti duke iu përgjigjur do t’u thotë: ‘Në të vërtetë po ju them: sa herë ia keni bërë këtë ndonjërit prej këtyre vëllezërve të mi më të vegjël, këtë ma bëtë mua’.⁸

Kur bëjmë atë që Ai do që ne të bëjmë për fëmijët e Atit të Tij, Zoti e quan atë mirësi ndaj Tij dhe do të ndihemi më pranë Tij teksa ndiejmë dashurinë dhe miratimin e Tij. Me kohë, ne do të bëhemi si Ai dhe do të mendojmë rreth Ditës së Gjykimit duke e pritur me lumturi.

Tenda që duket se ju fsheh nga Perëndia, mund të jetë më tepër frika nga njerëzit se sa kjo dëshirë për t’u shërbyer të tjerëve. Shtysa e vetme e Shpëtimtarit që të ndihmonte njerëzit. Shumë prej jush, ashtu si unë, kanë pasur frikë t’i afrohen dikujt që e keni fyer ose dikujt që ju ka lënduar. Dhe prapëseprapë kam parë që Zoti i ka zbutur zemrat herë pas here, përfshirë timen. Dhe kështu ju sfidoj që të shkoni në emër të Zotit te dikush, pavarësisht çdo frike që mund të keni,



që t'i tregoni dashuri e falje. Ju premtoj se kur ta bëni këtë, ju do të ndieni dashurinë e Shpëtimtarit për atë njeri dhe dashurinë e Tij për ju, dhe nuk do të duket sikur vjen nga shumë larg. Për ju, ajo sfidë mund të jetë brenda familjes, mund të jetë brenda komunitetit ose mund të jetë përqark një kombi.

Por nëse shkoni në emër të Zotit që të bekonit të tjerët, Ai do ta vërë re e do t'ju shpërblejë për të. Nëse e bëni këtë aq shpesh dhe aq gjatë sa duhet, ju do të ndieni një ndryshim në vetë karakterin tuaj përmes Shlyerjes së Jezu Krishtit. Jo vetëm që do të ndiheni më pranë Tij, por ju do të ndieni edhe që gjithmonë e më shumë po bëheni si Ai. Pastaj, kur vërtet ta shihni Atë, siç do ta shohim të gjithë, do të ndodhë me ju siç ndodhi me Moronin, kur tha: "Dhe tani, unë po ju them të gjithëve, lamtumirë. Së shpejti do të shkoj të pushoj në parajsën e Perëndisë, deri kur shpirti dhe trupi im do të bashkohen përsëri dhe unë do të çohem ngadhënjimtar nëpër ajër, për t'ju takuar para shufrës së këndshme të Jehovahit të madh, Gjykatësit të Përrjetshëm të atyre që janë gjallë dhe që kanë vdekur. Amen."⁹

Nëse shërbejmë me besim, përlësi dhe një dëshirë për të bërë vullnetin e Perëndisë, unë ju dëshmoj që shufra e gjykimin e Jehovahit të madh do të jetë e këndshme. Ne do ta shohim Atin tonë të dashur dhe Birin e Tij ashtu siç na shohin Ata tani – me qartësi të përsosur dhe dashuri të përsosur. Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 121:1.
2. Shih Mateu 6:10; Lluca 11:2; 3 Nefi 13:10; Ethëri 12:29; Doktrina e Besëlidhje 109:44; Moisiu 4:2.
3. Shih Doktrina e Besëlidhje 130:22.
4. Doktrina e Besëlidhje 121:15.
5. Doktrina e Besëlidhje 121:24–25.
6. Lluca 1:38.
7. Mateu 25:34.
8. Mateu 25:35–40.
9. Moroni 10:34.



Nga Presidenti Bojd K. Paker,
President i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Shlyerja

Kudo që mund të shkojnë anëtarët dhe misionarët tanë, mesazhi ynë është ai i besimit dhe i shpresës te Shpëtimtari Jezu Krisht.

Mesazhi im u drejtohet atyre midis nesh që po vuajnë, ngaqë janë rënduar me faj dhe dobësi e dështim, dhembje e dëshpërim.

Në vitin 1971, u caktova në konferencat e kunjeve në Samoan Perëndimore, përfshirë organizimin e një kunji të ri në ishullin Upolu. Pas disa intervistave, ne morëm me qira një aeroplan të vogël për në ishullin Savai, për të mbajtur një konferencë kunji atje. Aeroplani u ul në një fushë me bar në Faala dhe duhej të kthehej të nesërmen pasdite për të na kthyer në ishullin Upolu.

Ditën që duhej të ktheheshim nga Savai, po binte shi. Duke e ditur që aeroplani nuk mund të ulej në fushën e lagur, ne u drejtuam me makinë në anën perëndimore të ishullit, ku qe një lloj piste në majë të një brezi të ngushtë koralesh. Ne pritëm deri në të ngrysur, por nuk erdhi asnjë aeroplan. Më në fund, mësuam nëpërmjet radios se kishte ndodhur një stuhi dhe se aeroplani nuk mund të nisej. Ne iu kthyem një mesazh nëpërmjet radios se do të vinim me anije. Dikush duhej të na takonte në Mulifanu.

Ndërsa u nisëm nga porti i Savait, kapiteni i anijes 12 metërshe e pyeti presidentin e misionit nëse kishte një elektrik dore. Fatmirësisht, ai e

kishte dhe ia bëri dhuratë kapitenit. Ne përrshkuam kalimin prej 21 kilometrash për në ishullin Upolu në një det shumë të trazuar. Asnjëri prej nesh nuk e kuptoi se një stuhi e egër tropikale e kishte goditur ishullin dhe ne po shkonim drejt e në të.

Ne mbërritëm në skelën e Mulifanit. Qe vetëm një kalim i ngushtë nëpër të cilin duhej të kalonim përgjatë shkëmbinjve nënujorë. Kalimi i ngushtë bëhej i dukshëm nga drita në kodrën sipër plazhit dhe nga një dritë tjetër më e ulët. Kur anija manovrohej në mënyrë që të dyja dritat të ishin njëra mbi tjetrën, anija drejtohej siç duhej për të kaluar përmes shkëmbinjve të rrezikshëm që vijëzonin kalimin.

Por atë natë kishte vetëm një dritë. Dy misionarë po prisnin në vendin e zbarkimit për të na takuar, por për të kaluar nga ana tjetër u desh më shumë kohë se zakonisht. Pasi vëzhguan me orë të tëra për ndonjë shenjë të anijes tonë, misionarët u lodhën dhe i zuri gjumi, duke neglizhuar ndezjen e dritës së dytë, dritën më të ulët. Për pasojë, kalimi mes shkëmbinjve nënujorë nuk qe i qartë.

Kapiteni e manovroi anijen aq mirë sa mundi në drejtim të dritës së vetme të mësipërme në breg, ndërsa një pjesëtar i ekuipazhit mbante mbi një



elektrikun e dorës të marrë hua duke kontrolluar përpara për shkëmbinj. Ne mund të dëgjonim dallgët duke u përplasur mbi shkëmbinjtë nënujorë. Kur ishim aq pranë sa duhej për t'i parë ata me elektrikun e dorës, kapiteni bënte thirrje me furi për t'u rrotulluar dhe kthehej mbrapsht me qëllim që të përpiqej sërish për të gjetur kalimin.

Pas shumë përpjekjesh, ai e kuptoi se do të ishte e pamundur ta gjente kalimin. Gjithçka që mund të bënim, ishte të përpiqeshim të arrinim skelën e Apias, që ishte 64 kilometra larg. Ne ishim të pambrojtur kundër fuqisë së egër të stuhisë. Nuk mbaj mend të kem qenë ndonjëherë në një vend me aq errësirë.

Nuk bëmë gjë gjatë orës së parë, ndonëse motori ishte në maksimum. Anija do të luftonte me një dallgë vigane dhe më pas do të ndalonte në rraskapitje në majë të kreshtës me helikat jashtë ujit. Dridhja e helikave e tundte anijen aq shumë sa thuajse do ta ndante copash përpara se të futej poshtë anës tjetër.

Ne po rrinim të shtrirë mbi mbulesën e ngarkesës me krahët dhe këmbët e shtrira, duke i mbajtur duart tona në njëren anë dhe gishtat e këmbëve të mbërthyer në anën tjetër për t'u mbrojtur nga e lagura jashtë bordit. Vëllai Mark Litellford e humbi kontrollin

dhe u përplas në parmakun e poshtëm prej hekuri. Çau kokën, por parmaku nuk e la që ta rrëmbente dallga.

Përfundimisht, bëmë përpara dhe afër agimit më në fund u futëm në skelën në Apia. Anijet qenë lidhur me litar me njëra-tjetrën për siguri. Skela që plotësisht e bllokoi nga këto anije. Ne u zvarritëm mbi to, duke u përpjekur që të mos i shqetësonim ata që po flinin në kuvertën e anijes. Arritëm në Pesega, thamë rrobat dhe u drejtua për në Vailutai për të organizuar kunjin e ri.

Nuk e di se kush kishte qenë duke na pritur në plazhin në Mulifanu. Nuk pranova që të ma tregonin. Por është e vërtetë që pa dritën më të ulët, ne të gjithë mund të kishim vdekur.

Në librin tonë të himneve është një himn shumë i vjetër dhe rrallëherë i kënduar që ka pasur domethënie të veçantë për mua.

Shkëlqen shndritshëm mëshira e Atit tonë

Nga fari i Tij gjithmonë,

Por për ndezjen e dritave përpara bregut

Përgjegjësini neve na e ka lënë.

Dritat më të ulëta le të ndriçojnë;

Një dritë të vogël matanë dallgëve dërgo.

Disa detarë të shkretë, të drobitur

Ti mund t'i shpëtosh, Ti mund t'i mbrosh.

*Errësira e natës së mëkatit ka ardhur;
Gjëmon fort deti i tërbuar.
Sytë e etur janë duke parë, duke
u malluar,
Për dritat përgjatë bregut.*

*Kujdesu për dritat e ulëta, vëlla;
Disa lundërtarë fatkeq, të bllokuar
në stuhi,
Që për te porti përpiqen të çajnë,
Në errësirë mund të humbasin.¹*

Sot u flas atyre që mund të kenë humbur, dhe po kërkojnë atë dritë më të ulët që t'i ndihmojë për t'i drejtuar të kthehen.

Ne e kuptuam që në fillim se në vdekshmëri nuk do të mund të ishim të përsosur. Nuk pritej që ne do të jetonim pa shkelur një ligj apo një tjetër.

“Pasi njeriu i natyrshëm është një armik ndaj Perëndisë dhe ka qenë që nga rënia e Adamit dhe do të jetë gjithmonë e përgjithmonë, nëse ai nuk dëgjon thirrjet e Frymës së Shenjtë dhe nuk zhvesh njeriun e natyrshëm dhe nuk bëhet një shenjtor nëpërmjet shlyerjes së Krishtit Zot.”²

Nga Perla me Vlerë të Madhe, ne kuptojmë se “asgjë e papastër nuk mund të banojë [në mbretërinë e Perëndisë]”³, dhe kështu që u sigurova një mënyrë që të gjithë ata që mëkatojnë të pendohen dhe të bëhen sërish të

denjë për praninë e Atit tonë në Qiell.

U zgjodh një Ndërmjetës, një Shëlbues, dikush që do ta jetonte jetën e Tij përsosmërisht, nuk do të bënte mëkat dhe do ta ofronte “veten si sakrificë për mëkatin, për t’iu përgjigjur kërkesave të ligjit, për të gjithë ata që kanë një zemër të thyer dhe një shpirt të penduar; dhe për askënd tjetër nuk mund të plotësohen kërkesat e ligjit”⁴.

Lidhur me rëndësinë e Shlyerjes, tek Alma mësojmë: “Pasi është e nevojshme që një shlyerje duhet bërë; . . . përndryshe i tërë njerëzimi do të mbarojë patjetër”⁵.

Nëse nuk keni bërë asnjë gabim, atëherë nuk keni nevojë për Shlyerjen. Nëse keni bërë gabime, dhe secili prej nesh ka bërë, qoftë të vogla apo serioze, atëherë keni nevojë të pamasë për të zbuluar se si ato mund të fshihen në mënyrë që të mos jeni më në errësirë.

“[Jezu Krishti] është drita dhe jeta e botës.”⁶ Kur e përqendrojmë vështrimin te mësimet e Tij, ne do të drejtohem për në portin e sigurisë shpirtërore.

Neni i tretë i besimit shpall: “Ne besojmë se nëpërmjet Shlyerjes së Krishtit, i gjithë njerëzimi mund të shpëtohet, me anë të bindjes ndaj ligjeve dhe ordinancave të Ungjillit”⁷.

Presidenti Jozef F. Smith dha mësim: “Njerëzit nuk mund t’i falin vetë mëkatet e tyre; ata nuk mund ta pastrojnë veten nga pasojat e mëkateve të tyre. Njerëzit mund të reshtin së mëkatuari dhe mund të bëjnë atë që është e drejtë në të ardhmen, dhe [për] aq sa veprimet e tyre të jenë të pranueshme përpara Zotit, ata [bëhen] të denjë për t’u marrë në konsideratë. Por kush do t’i ndreqë gabimet që ata i kanë bërë vetes dhe të tjerëve, që duket e pamundur që ata t’i ndreqin vetë? Nëpërmjet shlyerjes së Jezu Krishtit mëkatet e të penduarit do të pastrohen; sikur



të jenë të kuqe purpur, do të bëhen të bardha si leshi [shih Isaia 1:18]. Ky është premtimi i dhënë për ne.”⁸

Ne nuk e dimë me saktësi se si Zoti e kreu Shlyerjen. Por ne vërtet dimë se tortura mizore e kryqëzimit që vetëm një pjesë e dhembjes së tmerrshme që filloi në Gjetseman – ai vend i shenjtë i vuajtjes – dhe përfundoi në Golgota.

Lluka shënon:

“Dhe u largua prej tyre, aq sa mund të hidhet një gur, dhe ra në gjunj dhe lutej,

duke thënë: ‘O Atë, po të duash, largoje këtë kupë nga unë! Megjithatë mos u bëftë vullneti im, por yti’.

Atëherë iu shfaq një engjell nga qielli për t’i dhënë forcë.

Dhe ai, duke qenë në agoni, lutej edhe më fort; dhe djersa e tij po i bëhej si gjak i mpiksur që bie për tokë.”⁹

Me aq sa kam qenë në gjendje të kuptoj, ka vetëm një rrëfim me fjalët e vetë Shpëtimtarit që përshkruan atë që Ai duroi në Kopshtin e Gjetsemanit. Zbulesa shënon:

“Pasi vër re, unë, Perëndia, i kam vuajtur këto gjëra për të gjithë, që ata të mos vuajnë nëse do të pendohen;

Por nëse nuk do të pendohen, ata duhet të vuajnë po aq sa unë;

Vuajtje që më bëri mua, madje Perëndi, më i madhi i të gjithëve, të dridhem për shkak të dhembjes e të më dalë gjak nga çdo por.”¹⁰

Do të ketë periudha, gjatë jetës suaj, kur keni shkuar në vende ku nuk duhej të kishit shkuar asnjëherë dhe

keni bërë gjëra që nuk duhej t’i kishit bërë kurrë. Nëse do të largoheni nga mëkati, ju do të jeni në gjendje që një ditë ta njihni paqen që vjen nga ndjekja e shtegut të pendimit të plotë.

Pavarësisht se cilat kanë qenë shkeljet tona, pavarësisht se sa shumë mund të jenë lënduar të tjerët nga veprimet tona, ai faj mund të harrohet i gjithi. Për mua, ndoshta fraza më e bukur në të gjithë shkrimin e shenjtë është kur Zoti tha: “Vini re, ai që është penduar për mëkatet e tij, po ai falet dhe unë, Zoti, nuk i kujtoj më ato”¹¹.

Ky është qëllimi i ungjillit të Jezu Krishtit dhe i Shlyerjes: të marrë këdo që vjen, këdo që do të bashkohet dhe t’i bëjë të kalojnë përmes një përvoje në mënyrë që në fund të jetës së tyre, ata të mund ta kalojnë velin duke qenë të penduar për mëkatet e tyre dhe duke qenë të pastruar përmes gjakut të Krishtit.¹²

Kjo është ajo që shenjtorët e ditëve të mëvonshme bëjnë anekënd botës. Kjo është Drita që ne iu ofrojmë atyre që janë në errësirë dhe që kanë humbur rrugën. Kudo që mund të shkojnë anëtarët dhe misionarët tanë, mesazhi ynë është ai i besimit dhe i shpresës te Shpëtimtari Jezu Krisht.

Presidenti Jozef Filding Smith shkroi tekstin e himnit “Does the Journey Seem Long?” [“I Gjatë, Udhëtimi, a Duket?”] Ai ishte një mik i im i dashur. Himni përmban inkurajim dhe një premtim ndaj atyre që kërkojnë të ndjekin mësimet e Shpëtimtarit:

*I gjatë, udhëtimi, a duket,
A rrugët të vështira e të rrëpirëta?
A ka shqopa dhe gjemba përgjatë
rrugës?*

*Gurët e mprehtë, këmbët, a t'i çajnë
Teksa orvatesh të ngrihesh
Në lartësitë përmes nxehtësisë së ditës?*

*Zemrën, a e ke të dobët e të trishtë,
Shpirti yt i lëshuar a është,
Teksa mundohesh nën barrën
e kujdesit?*

*Barra e rëndë a duket
A je i detyruar që të ngjitesh?
A nuk ke ndokënd që barrën
të ndash?*

*Zemrën mos e lejo të ligështohet
Tani që udhëtimin fillove;
Është Dikush që thirrje ende të bën.
Ndaj shih lart me gëzim
Dhe mbahu pas dorës së Tij;
Ai do të drejtojë për në lartësitë që
janë të reja -*

*Në një tokë të shenjtë e të pastër,
Ku gjithë shqetësimet përfundojnë,
Dhe jeta jote do të çlirohet nga të
gjitha mëkatet,
Ku asnjë lot nuk do të derdhet,
Pasi asnjë hidhërim s'do mbetet.
Dorën e Tij merr dhe hyr bashkë
me Të.¹³*

Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. "Brightly Beams Our Father's Mercy", *Hymns*, nr. 335.
2. Mosia 3:19.
3. Moisiu 6:57.
4. 2 Nefi 2:7.
5. Alma 34:9.
6. Mosia 16:9.
7. Nenet e Besimit 1:3.
8. *Teachings of Presidents of the Church: Joseph F. Smith* (1998), f. 99-100.
9. Lluca 22:41-44.
10. Doktrina e Besëlidhje 19:16-18.
11. Doktrina e Besëlidhje 58:42.
12. Shih Zbulesa 1:5.
13. "Does the Journey Seem Long?" *Hymns*, nr. 127.



Nga Linda K. Barton,
Presidente e Përgjithshme e Shoqatës së Ndhmës

Së Pari Vëzhgoni, Pastaj Shërbeni

*Me praktikë, secili prej nesh mund të bëhet më shumë
si Shpëtimtari teksa u shërbejmë fëmijëve të Perëndisë.*

Një nga treguesit më të mëdhenj që kemi, se profeti ynë i dashur, Presidenti Tomas S. Monson është shërbëtori i zgjedhur i Zotit, është që ai ka mësuar të ndjekë shembullin e Shpëtimtarit – duke u shërbyer [njerëzve] personalisht, një e nga një. Ata prej nesh që kanë hyrë në ujërat e pagëzimit, kanë bërë besëlidhje për të bërë të njëjtën gjë. Ne kemi bërë besëlidhje që "gjithmonë ta kujtoj[m]ë [Shpëtimtarin] e të zbatoj[m]ë ë urdhërimet [e Tij]"¹ dhe Ai ka thënë: "Ky është urdhërimi im: ta doni njëri-tjetrin, ashtu si unë ju kam dashur juve"².

Vini re se si fjalët vijuese nga Presidenti Monson përfshijnë po të njëjtën ftesë: "Ne jemi të rrethuar nga ata që kanë nevojë për vëmendjen tonë, nxitjen tonë, mbështetjen tonë, ngushëllimin tonë, dashamirësinë tonë. . . . Ne jemi duart e Zotit këtu në tokë, me autorizimin për të shërbyer dhe për të ngritur moralisht fëmijët e Tij. Ai varet nga secili prej nesh."³

A e dëgjuat atë – ftesën për ta dashur njëri-tjetrin? Për disa, shërbimi ose shërbesa një për një, duke ndjekur shembullin e Shpëtimtarit, nuk vjen lehtësisht. Por me praktikë, secili prej

nesh mund të bëhet më shumë si Shpëtimtari teksa u shërbejmë fëmijëve të Perëndisë. Do të dëshiroja të sugjeroja pesë fjalë për t'u mbajtur mend që të na ndihmojnë ta duam më shumë njëri-tjetrin: "Së pari vëzhgoni, pastaj shërbeni".

Pothuajse 40 vjet më parë, bashkëshorti im dhe unë, shkuam në tempull për takimin tonë të së premtes mbrëma. Ne kishim qenë të martuar vetëm për një kohë të shkurtër dhe ndihesha në siklet sepse kjo ishte vetëm hera e dytë që e vizitoja tempullin si e sapomartuar. Një motër, që qe ulur pranë meje, duhet ta ketë vënë re. Ajo u përkul dhe më pëshpëriti me nderim: "Mos u shqetëso. Unë do të të ndihmoj." Frika ime u qetësua dhe unë qeshë në gjendje ta shijoja pjesën tjetër të sesionit të tempullit. Ajo më parë vëzhgoi, pastaj shërbeu.

Ne ftohemi të gjithë që të ndjekim mësimet e Jezusit dhe t'u shërbejmë të tjerëve. Kjo ftesë nuk është e kufizuar vetëm për motrat engjellore. Teksa tregoj disa shembuj të jetës së përditshme rreth anëtarëve që kanë mësuar të vëzhgojnë e më pas të shërbejnë, dëgjoni për të gjetur mësimet e Jezusit që ata ilustrojnë.



Një fëmijë gjashtë vjeçar i Fillores tha: “Kur u zgjodha të isha ndihmësi i klasës, unë mund të zgjidhja një shok që të punonte me mua. Zgjodha [një djalë në klasën time që më ngacmontel] sepse ai nuk zgjidhej kurrë nga të tjerët. Unë dëshiroja që ta bëja të ndihej mirë.”⁴

Çfarë vëzhgoi ky fëmijë? Ai vuri re se ngacmuesi i klasës nuk zgjidhej asnjëherë. Çfarë bëri ai për të shërbyer? Ai thjesht e zgjodhi atë që të ishte shoku i tij si ndihmës i klasës. Jezusi dha mësim: “Duani armiqtë tuaj, bekoni ata që ju mallkojnë, u bëni të mirë atyre që ju urrejnë”⁵.

Në një lagje, mbajtësit e Priftërisë Aarone së pari vëzhguan dhe tani shërbejnë në një mënyrë kuptimplote. Çdo javë, të rinjtë mbërrijnë herët dhe qëndrojnë jashtë shtëpisë së mbledhjes, në shi, në dëborë, ose në të nxehtin përvëlues, duke pritur mbërritjen e shumë anëtarëve të moshuar në lagjen e tyre. Ata nxjerrin karroca dhe këmbësore invalidësh jashtë makinave, sigurojnë krahë të fuqishëm për të shtrënguar dhe shoqërojnë të moshuar me flokë të argjendit brenda në ndërtesë. Ata janë me të vërtetë duke e plotësuar detyrën e tyre ndaj Perëndisë. Teksa vëzhgojnë dhe pastaj shërbejnë, ata janë shembuj të gjallë të mësimit të Shpëtimtarit: “Sa herë ia keni bërë këtë ndonjërit prej këtyre vëllezërve të mi më të vegjël, këtë ma

bëtë mua”⁶. Teksa zbatohet programi i ri mësimor i rinisë, sytë e këtyre të rinjve do të jenë pa dyshim të hapur ndaj edhe më shumë mundësive për të shërbyer sipas mënyrës së Krishtit.

Vëzhgimi dhe shërbimi ndonjëherë kërkojnë përpjekje të madhe. Një e re e frymëzuar e quajtur Aleksandria vuri re se kushërira e saj, Medisoni, nuk qe në gjendje t'i plotësonte kërkesat e Përparimit të saj Personal pasi vuante nga një autizëm i rëndë. Aleksandria e mori të renë në lagjen e saj, u këshillua me udhëheqësit e saj dhe vendosën të bënin diçka për Medin që ajo nuk mund ta bënte vetë. Secila prej të rejave përfundoi një pjesëz të veprimtarive dhe të projekteve të Përparimit Personal në emër të saj që t'i jepnin Medit mundësinë për të marrë medalionin e saj.⁷

Këto të reja do të përparojnë për në rolet e mëmësisë dhe të motërisë së Shoqatës së Ndhmës sepse ato po mësojnë të vëzhgojnë dhe pastaj të shërbejnë në mënyra të dashura.

Presidenti Monson na ka kujtuar se dashuria hyjnore, “dashuria e pastër e Krishtit”⁸ – ose me fjalë të tjera vëzhgimi dhe shërbimi – “është e dukshme kur njerëzit kujtohen për një vejtje të moshuar dhe e caktojnë në role të lagjes” dhe “kur motra që ulet vetëm në Shoqatën e Ndhmës merr ftesën: ‘Eja – ulu pranë nesh’”⁹. Këtu zbatohet rregulla e artë: “Gjithçka, pra,

që ju dëshironi t’ju bëjnë njerëzit, ua bëni edhe ju atyre”¹⁰.

Një bashkëshort vëzhgues shërbeu në dy mënyra të rëndësishme. Ai tregon:

“Po e ndihmoja bashkëshorten time një të diel në klasën e saj të Fillores plot me shtatë vjeçarë energjikë. Kur filloi koha e përbashkët e Fillores, vura re se një nga anëtarët e klasës u ngjesh pas karriges dhe dukej që nuk ndihej mirë. Shpirti më pëshpëriti se ajo kishte nevojë për lehtësim, kështu që u ula pranë saj dhe e pyeta qetësisht se çfarë nuk shkonte. Ajo nuk u përgjigj . . . , ndaj fillova t’i këndoja ëmbëlsisht.

Fillorja po mësonte një këngë të re dhe kur kënduam vargjet: ‘E, nëse me zemër dëgjoj, Shpëtimtari po flet’, nisa të ndieja dritën dhe ngrohtësinë më të pabesueshme të më mbushte shpirtin. . . . Mora një dëshmi vetjake për dashurinë e Shpëtimtarit tonë për të . . . dhe për mua. . . . Mësova se ne jemi duart [e Shpëtimtarit] kur i shërbejmë individit.”¹¹

Ky vëlla i ngjashëm me Krishtin, jo vetëm që e vuri re nevojën për ta ndihmuar bashkëshorten e tij me një klasë plot me shtatë vjeçarë; ai i bëri edhe shërbim individual një fëmije në nevojë. Ai ndoqi Shpëtimtarin i cili dha mësim: “Pasi atë që më keni parë të bëj, madje atë duhet të bëni ju”¹².

Kohët e fundit një përmbytje krijoi

shumë mundësi që dishepujt e Jezu Krishtit së pari të vëzhgonin dhe më pas të shërbenin. Burra, gra, adoleshentë dhe fëmijë panë biznese e shtëpi të shkatërruara dhe lanë gjithçka që të ndihmonin për t'i pastruar e për t'i riparuar godinat e dëmtuara. Disa panë nevojën për të ndihmuar me detyrën mbingarkuese të larjes së rrobave.

Të tjerë pastruan me merak fotografi, dokumente ligjore, letra dhe materiale të tjera të rëndësishme në letër, më pas i varën me kujdes që të thaheshin për të ruajtur çfarëdo që mundeshin. Vëzhgimi dhe më pas shërbimi nuk është gjithnjë i leverdisshëm dhe nuk u përshatet përherë orareve tona.


Cili është vendi më i mirë për të vëzhguar së pari e më pas për të shërbyer se sa në shtëpi? Një shembull nga jeta e Plakut Riçard G. Skot ilustron:

“Një natë, djali ynë i vogël, Riçardi, që kishte një problem zemre, u zgjua duke qarë. . . Normalisht, gruaja ime ngrihej gjithmonë që të kujdesej për foshnjën që qante, por këtë herë unë thashë: ‘Do të kujdesem unë për të’.

Për shkak të problemit të tij, kur fillonte të qante, zemra e tij e vogël do t'i rrihte shumë shpejt. Ai do ta nxirrte ç’kishte ngrënë dhe do të ndotëte mbulesat e shtratit. Atë natë e mbajta shumë pranë që të përpiqesha t’i qetësoja zemrën që i rrihte dhe ta pushoja së qari, ndërsa i ndërrova rrobat dhe vura shtresa të tjera shtrati. E mbajta derisa e zuri gjumi. Nuk e dija atëherë, se vetëm disa muaj më vonë, ai do të ndërronte jetë. Do ta kujtoj gjithmonë duke e mbajtur në krahë në mes të asaj nate.”¹³

Jezusi tha: “Secili prej jush që do të dojë të bëhet i madh, qoftë shërbëtor i juaj”¹⁴.

Ndonjëherë ne tundohehi për të shërbyer në mënyrën që ne dëshirojmë të shërbejmë, dhe jo domosdoshmërisht në mënyrën që nevojitet



në moment. Kur Plaku Robert D. Hejls dha mësim parimin e të jetuarit me maturi, ai tregoi një shembull kur i bleu një dhuratë bashkëshortes së tij. Ajo e pyeti: “A po e blen këtë për mua apo për vete?”¹⁵ Nëse e përshtasim këtë pyetje me veten kur shërbejmë dhe të pyesim: “A po e bëj këtë shërbim për Shpëtimtarin, apo po e bëj për vete?” shërbimi ynë ka më tepër të ngjarë që t’i shëmbëllet shërbesës së Shpëtimtarit. Shpëtimtari pyeti dhe kështu duhet të pyesim dhe ne: “Çfarë doni të bëj për ju?”¹⁶

Pak javë më parë, po nxitoja dhe isha e stresuar me shumë gjëra për të bërë në listën time. Pata shpresuar të shkoja në tempull atë ditë, por ndieva se isha tepër e zënë. Sapo më kaloi ndër mend mendimi i paftuar i të qenit tepër e zënë për shërbim në tempull, ai më kujtoi se çfarë kisha më shumë nevojë të bëja. Dola nga zyra për të ecur drejt Tempullit të Solt-Lejkut, duke pyetur veten nëse do ta rifitoja kohën që po humbisja. Fatmirësisht, Zoti është i duruar dhe mëshirëplotë dhe më dha një mësim të bukur atë ditë.

Kur u ula në dhomën e sesionit, një motër e re dhe e ëmbël m’u afrua dhe më pëshpëriti me nderim: “Jam shumë në siklet. Kjo është vetëm hera ime e dytë në tempull. A mund të më ndihmoni ju lutem?” Si munda vallë ajo ta dinte se ato fjalë ishin pikërisht ato

që kisha nevojë të dëgjoja? Ajo nuk e dinte, por Ati Qiellor e dinte. Ai e kishte vëzhguar nevojën time më të madhe. Unë kisha nevojë të shërbeja. Ai e nxiti këtë motër të re e të përlurur që të më shërbente duke më ftuar t’i shërbeja. Ju siguroj se isha unë ajo që përfitoi më shumë.

I falënderoj me mirënjohje të thellë njerëzit e shumtë si Krishti që i kanë shërbyer familjes sonë përgjatë viteve. Unë i shpreh vlerësim veçanërisht bashkëshortit dhe familjes sime të dashur, që shërbejnë me vetmohim e me dashuri të madhe.

Synofshim të gjithë që së pari të vëzhgojmë, pastaj të shërbejmë. Unë dëshmoj se kur e bëjmë këtë, shërbimi ynë, si ai i Presidentit Monson, do të jetë tregues i dishepullimit tonë. E di se Shpëtimtari jeton. Shlyerja e Tij na mundëson t’i jetojmë mësimet e Tij. Unë e di se Presidenti Monson është profeti ynë sot. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 20:77.
2. Gjoni 15:12.
3. Tomas S. Monson, “Çfarë Kam Bërë për Dikë Sot?” *Liahona*, nëntor 2009, f. 86.
4. Canyon H., “A Good Choice”, *Friend*, janar 2012, f. 31.
5. Mateu 5:44.
6. Mateu 25:40.
7. Shih “For Madison”, lds.org/youth/video/for-madison.
8. Moroni 7:47.
9. Tomas S. Monson, “Dashuria Nuk Ligështohet Kurrë”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 125; shih edhe *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society* (2011), f. 101.
10. 3 Nefi 14:12.
11. Al VanLeeuwen, “Serving the One”, *Liahona*, gusht 2012, f. 19; shih edhe Sally DeFord, “Nëse me Zemër Dëgjoj”, *2011 Orientues për Kohën e Përbashkët*, f. 28.
12. 3 Nefi 27:21.
13. Riçard G. Skot, “Bekimet e Përrjetshme të Martesës”, *Liahona*, maj 2011, f. 96.
14. Mateu 20:26.
15. Robert D. Hejls, “Të Bëhemi Kujdestarë të Matur, Materialisht dhe Shpirtërisht”, *Liahona*, maj 2009, f. 9.
16. Mateu 20:32.



Nga Plaku Uolter F. Gonzáles,
i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve

Të Mësuarit me Zemër

Një mënyrë për të ardhur te Krishti është duke kërkuar t'i mësojmë të vërtetat thelbësore me zemër.

Ejani] tek unë, që të mund të ndieni dhe të shihni”¹. Ky ishte një urdhërim që Shpëtimtari ua bëri banorëve të Amerikës së lashtë. Ata ndien me duart e tyre dhe panë me sytë e tyre se Jezusi ishte Krishti. Ky urdhërim është pikërisht po aq i rëndësishëm për ne sot sa qe për ata në kohën e tyre. Ndërsa vijmë te Krishti, ne mund të ndiejmë dhe “mës[ojmë] me siguri”² – jo me duart e sytë tanë por me gjithë zemrën e mendjen tonë – se Jezusi është Krishti.

Një mënyrë për të ardhur te Krishti është duke kërkuar t'i mësojmë të vërtetat thelbësore me zemër. Ndërsa e bëjmë këtë, mbresat që vijnë nga Perëndia do të na japin njohuri, të cilën nuk mund ta marrim në asnjë mënyrë tjetër. Apostulli Pjetër e dinte me siguri se Jezusi ishte Krishti, Biri i Perëndisë së Gjallë. Shpëtimtari shpjegoi se burimi i dijenisë së Pjetrit nuk ishte “as mishi as gjaku, por Ati . . . që është në qiej”³.

Profeti Abinadi shpjegoi rolin e ndjenjave që vijnë në zemrat tona nga Perëndia. Ai dha mësim se ne nuk mund t'i marrim vesh shkrimet e shenjta plotësisht, veç nëse i përdorim zemrat tona që t'i kuptojmë.⁴

Kjo e vërtetë u shpreh fare mirë në një libër të fëmijëve, *The Little Prince [Princi i Vogël]* nga Antuan de

Sent-Ekzuperi. Në tregim, princi i vogël miqësohet me një dhelpër. Përpara se të ndaheshin, dhelpëra i tregoi një sekret princit të vogël. Ajo i tha: “Ja cili është sekreti im . . . : Është vetëm nëpërmjet zemrës që dikush mund të shohë siç duhet; ajo që është thelbësore është e padukshme për syrin”⁵.

Vëllai Tomas Koelo, tetëdhjetë e tetë vjeç, është shembull i mirë i një personi që pa me zemrën e tij gjëra thelbësore. Ai qe anëtar besnik i këshillit tonë të lartë në Paisandu, Uruguai. Përpara se të bashkohej me Kishën, ai pësoi një aksident teksa po ngiste motoçikletën. Ndërsa qe i shtrirë përtokë, i paaftë të ngrihej, dy nga misionarët tanë e ndihmuan që të ngrihej dhe të kthehej në shtëpi. Ai tha se ndieu diçka të veçantë kur misionarët erdhën ta ndihmonin. Më vonë, ai sërish përjetoi ndjenja të fuqishme kur misionarët i dhanë mësim. Ndikimi i atyre ndjenjave ishte i tillë sa që ai e lexoi Librin e Mormonit nga fillimi në fund në vetëm pak ditë. Ai u pagëzua dhe shërbeu pa u lodhur nga ajo ditë e tutje. Më kujtohet ai duke e ngarë motoçikletën lart e poshtë rrugëve të qytetit tonë, madje edhe në dimrin e ftohtë dhe me shira, për t'i sjellë të tjerët në Kishë, në mënyrë që ata të mund të shihnin, ndienin dhe dinin me siguri sikurse ai.

Sot, të rrethuar nga kaq shumë informacion, ne mund të mendojmë se kërkimi nëpër një mori faqesh interneti do të na japë gjithçka që kemi nevojë të dimë. Në internet mund të gjejmë informacion të mirë dhe të keq, por vetëm informacioni nuk është i mjaftueshëm. Perëndia na ka dhënë një tjetër burim për njohuri më të madhe,⁶ madje njohuri të dërguar nga qielli. Ati ynë Qiellor mund të na e japë këtë njohuri kur e kërkojmë në faqen çelestiale me zemrën dhe mendjen tonë. Profeti Jozef Smith tha se kishte “librin më të vjetër në zemrën [e tij], madje dhuratën e Frymës së Shenjtë”⁷.

Ne e përdorim këtë burim çelestial [Frymën e Shenjtë], kur bëjmë gjëra të tilla si leximi i shkrimeve të shenjta, dëgjimi i profetit të gjallë dhe lutja. Është gjithashtu e rëndësishme të rrimë të qetë⁸ dhe të ndiejmë e ndjekim nxitjet çelestiale. Kur e bëjmë këtë, do “të ndiejmë] dhe [do] të sh[ohim]” gjëra që nuk mund të mësohen me teknologjinë bashkëkohore. Sapo të kemi njëfarë përvoja në të kërkuarin në këtë faqe çelestiale, ne do ta dallojmë të vërtetën, edhe kur lexojmë histori jofetare apo tema të tjera. Kërkuesit e sinqertë të së vërtetës do ta dinë të vërtetën e të gjitha gjërave nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë.⁹

Tani, një paralajmërim: e drejta për të hyrë në këtë faqe çelestiale zvoqëlohet nga paudhësia dhe harrimi i Zotit. Nefi u tha vëllezërve të tij se “nuk mund [t'i] ndjeni[n] fjalët e [Zotit]” për shkak se ata ishin “të shpejtë të bëni[n] paudhësi [dhe] të ngadalshëm të kujtoni[n] Zotin”¹⁰. Paudhësia e pengon aftësinë tonë për të parë, ndier dhe dashur të tjerët. Të qenit të shpejtë për të kujtuar Zotin duke u lutur “me gjithë fuqinë e zemrës”¹¹ dhe kujtimi i përvojave shpirtërore rrit



Barcelonë, Spanjë

aftësinë tonë për të parë e ndier gjërat e Krishtit. Tani ju pyes:

- A e kujtoni paqen që ndiet kur, pas shumë vuajtjeve, iu përgjëruat Atit në lutje të fuqishme?
- A ju kujtohet ndryshimi i listës së planeve tuaja për të ndjekur nxitjen në zemër?

Njerëzit e mëdhenj në Librin e Mormonit e rritën aftësinë për të arritur njohuri më të madhe duke kujtuar përvojat e tyre kyçe shpirtërore. Alma i fuqizoi dhe forcoi fëmijët e tij duke u kujtuar rreth përvojës së tij të kthimit në besim.¹² Helamani u mësoi Nefit dhe Lehit që të mbanin mend – të mbanin mend se ishte mbi shkëmbin e Krishtit që ata duhet të ndërtonin themelin e tyre që djalli të mos kishte fuqi mbi ta.¹³ Ne duhet të bëjmë të njëjtën gjë. Të kujtuarit e Perëndisë na ndihmon të ndiejmë dhe jetojmë. Kjo i jep kuptim më të thellë fjalëve të mbretit Beniamin, i cili tha: “Dhe tani, O njeri, mbaj mend dhe mos vdis!”¹⁴.

Një ndër kujtimet më të shenjta që më pëlqen shumë, është ndjenja që pata kur arrita të dija se Libri i Mormonit ishte fjala e Perëndisë. Mësova se ne mund të përjetojmë një gëzim që fjalët nuk mund ta shprehin siç duhet. Pikërisht atë ditë, i gjunjëzuar, ndieva dhe njoha me siguri gjëra që nuk mund t’i kisha mësuar në ndonjë

mënyrë tjetër. Një kujtim i tillë është arsye për mirënjohje të përjetshme dhe më forcon në kohë vështirësie.

Ata që marrin njohuri, jo nga mishi e gjaku por nga Ati ynë Qiellor vërtet e dinë me siguri se Jezusi është Krishti dhe se kjo është Kisha e Tij. Pikërisht kjo njohuri jep fuqinë për të bërë ndryshimet e nevojshme për të ardhur te Krishti. Për këtë arsye, ne e ftojme çdo shpirt tani të pagëzohet, pendohet dhe kthehet tek Ai.¹⁵

Duke ardhur te Krishti, çdo shpirt mund të shikojë, të ndiejë dhe të dijë me siguri se Krishti vuajti dhe shleu për mëkatet tona që të mund të kemi jetë të përjetshme. Nëse pendohemi, ne nuk do të vuajmë kot.¹⁶ Falë Tij, shpirtrat e plagosur munden të shërohen dhe zemrat e thyera munden të shërohen. Nuk ka asnjë barrë që Ai nuk mund ta lehtësojë apo heqë. Ai i njeh hidhërimet dhe sëmundjet tona. Unë ju premtoj dhe dëshmoj se, kur të gjitha dyert duken të jenë të mbyllura, kur gjithçka tjetër duket se ka mbaruar, Ai nuk do t’ju lerë në baltë. Krishti do të ndihmojë dhe kjo është rrugëdalja, qoftë nëse lufta është me varësinë, depresionin ose diçka tjetër. Ai di “sesi të ndihmojë popullin e tij”¹⁷. Martesat dhe familjet që po luftojnë për shkak të çfarëdo arsyeje – sfidave ekonomike, ndikimit të keq të mjeteve të komunikimit apo situatave familjare – do të ndiejnë një ndikim qetësues nga qielli. Është ngushëlluese

të “ndiejmë] dhe të sh[ohim]” që Ai u ngrit së vdekuri “me shërimin në krahët e tij”¹⁸, që për shkak të Tij, ne do të takojmë e përqafojmë sërish njerëzit e dashur që kanë ndërruar jetë. Me të vërtetë, kthimi ynë në besim te Ai është shpërblyer me shërimin tonë.¹⁹

Unë e di me siguri se e gjitha kjo është e vërtetë. Për këtë arsye e bashkoj zërin tim me atë të banorëve të hershëm të Amerikës së lashtë, duke thirrur: “Hosana! I bekuar qoftë emri i Më të Lartit Perëndi!”²⁰ Ai na jep shpëtim. Jap dëshmi se Jezusi është Krishti, Mesia i shenjtë. Ai është Zoti i Ushtrive, Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. 3 Nefi 18:25.
2. 3 Nefi 11:15.
3. Shih Mateu 16:16–17.
4. Shih Mosia 12:27.
5. Antoine de Saint-Exupéry, *The Little Prince*, përkth. Katherine Woods (1971), f. 87.
6. Shih Ethëri 4:13.
7. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 136.
8. Shih Doktrina e Besëlidhje 101:16.
9. Shih Moroni 10:3–5.
10. 1 Nefi 17:45.
11. Moroni 7:48.
12. Shih Alma 36:5–24; 38:6–9.
13. Shih Helamani 5:12.
14. Mosia 4:30.
15. Shih 3 Nefi 9:13.
16. Shih Doktrina e Besëlidhje 19:16.
17. Alma 7:12.
18. 2 Nefi 25:13; shih edhe 3 Nefi 25:2.
19. Shih 2 Nefi 16:10; 3 Nefi 9:13.
20. Shih 3 Nefi 11:15–17.





Nga Plaku Xhefri R. Holland,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Urdhërimi i Parë i Madh

Duhet të bëjmë një jetë prej dishepulli të përkushtuar që të tregojmë dashurinë tonë për Zotin.

Nuk ka pothuaj asnjë grup njerëzish në histori për të cilët të kem më shumë dhembshuri sesa për njëmbëdhjetë apostujt e mbetur fill pas vdekjes së Shpëtimtarit të botës. Mendoj se ndonjëherë harrojmë sesa të papërvojë qenë ende ata dhe sesa tërësisht të varur nga Jezusi duhet të kenë qenë ata. Ai u tha atyre: “Ka kaq kohë që unë jam me ju dhe [ju] nuk më ke[ni] njohur akoma . . . ?”¹

Por, sigurisht, sipas tyre Ai thujse nuk kishte qenë aq gjatë sa duhet me ta. Tre vjet nuk përbëjnë shumë kohë për të thirrur një Kuorum të tërë të Dymbëdhjetë Apostujve prej një grushti të kthyerish të rinj në besim, të largosh prej tyre gabimin e zakoneve të vjetra, t’u mësosh mrekullitë e ungjillit të Jezu Krishtit dhe pastaj t’i lësh të bëjnë përpara me punën derisa edhe ata u vranë. Një e ardhme pothuaj tronditëse për këtë grup pleqsh të saposhuguruar.

Veçanërisht pjesa kur do të liheshin vetëm. Jezusi në mënyrë të përsëritur ishte përpjekur t’u thoshte se *nuk* do të ishte fizikisht i pranishëm me ta, por ata ose nuk mundeshin ose nuk donin ta kuptonin një mendim kaq pikëllues. Marku shkruan:

“Ai . . . i mësonte dishepujt e vet dhe

u thoshte atyre: ‘Së shpejti Biri i njeriut do të dorëzohet në duart e njerëzve dhe ata do ta vrasin; dhe, pasi të jetë vranë, ai do të ringjallet ditën e tretë.

Por ata nuk i kuptonin këto fjalë dhe kishin frikë ta pyesnin.”²

Pastaj, pas një kohe aq të shkurtër mësimi [prej Krishtit] e pas edhe më pak kohë përgatitjeje, e papërfytyrueshmja ndodhi, e pabesueshmja që e vërtetë. Zoti dhe Mësuesi i tyre, Këshilltari e Mbreti i tyre, u kryqëzua. Shërbesa e Tij në vdekshmëri mbaroi dhe Kisha e vogël e në vështirësi që Ai kishte themeluar, dukej e dënuar me përcmim dhe e paracaktuar për t’u shuar. Apostujt e Tij e panë në gjendjen e Tij të ringjallur por edhe kjo vetëm ua shtoi hutimin. Siç, me siguri, duhet të kenë pyetur veten: “Çfarë të bëjmë tani?” ata iu drejtuan për përgjigje Pjetrit, apostullit më të vjetër në shërbesë.

Këtu kërkoj tolerancën tuaj tekta marr pak liri të portretizoj vetë, jo prej shkrimeve të shenjta, atë që këmbyen ata me njëri-tjetrin. Në thelb, Pjetri u tha bashkëpunëtorëve të tij: “Vëllezër, kanë qenë tre vite të lavdishme. Asnjëri nga ne nuk mund t’i kishte përfytyruar kaq pak muaj më parë mrekullitë që kemi

parë dhe përvojat hyjnore që kemi gëzuar. Ne kemi folur, jemi lutur e kemi punuar pikërisht me Birin e Vetë Përrëndisë. Kemi ecur me Të e kemi qarë me Të dhe natën e atij fundi të tmerrshëm, asnjëri nuk qau më me hidhërim se unë. Por kjo ka mbaruar. Ai ka mbaruar punën e Tij dhe është ngritur nga varri. Ai ka punuar për shpëtimin e Tij dhe tonin. Pra ju pyesni: ‘Çfarë të bëjmë tani?’ Nuk di çfarë t’ju them më shumë sesa që t’i ktheheni jetës suaj të mëparshme me gëzim. Unë kam ndërmend të ‘shkoj të peshkoj.’” Dhe të paktën gjashtë nga dhjetë apostujt e tjerë të mbetur thanë duke rënë dakord: “Po vijmë edhe ne me ty”. Gjoni, i cili qe njëri prej tyre, shkruan: “Dolën dhe hipën menjëherë në barkë”³.

Por, për të ardhur keq, peshkimi nuk doli shumë mirë. Natën e tyre të parë të kthimit në liqen ata nuk kapën asgjë – as dhe një peshk të vetëm. Në kohën e daljes së rrezeve të para të agimit, u kthyen të zhgënjyer në drejtim të bregut, ku panë në largësi një siluetë që u thirri: “O djema, a keni kapur ndonjë gjë?” Të zymtë, këta apostuj-të-kthyer-sërisht-në-peshkatarë dhanë përgjigjen që asnjë peshkatar nuk dëshiron ta japë. “Nuk kemi kapur asgjë”, mermëritën dhe, për t’i shtuar fyerje situatës së pafavorshme, ata po thirreshin “djema”⁴.

“Hidhni rrjetën në anën e djathtë të barkës dhe do të gjeni”⁵, thërret i huaji – dhe nga ato fjalë të thjeshta, ata shpejt fillojnë ta dallojnë Atë. Vetëm tre vjet më parë po këta burra kishin qenë duke peshkuar në po këtë det. Edhe në atë rast ishin “mundua[r] gjithë natën dhe nuk [kishin] zënë asgjë”⁶, thotë shkrimi i shenjtë. Por një shok galileas në bregdet u kishte thirrur që t’i hidhnin [prapë] rrjetat e tyre dhe ata kishin zënë “një sasi . . . të madhe peshku”⁷ aq sa iu shqyen rrjetat, sasia e kapur mbushte dy barka

aq rëndë sa filluan të fundosen.

Tani po ndodhte sërish. Këta “djema” siç u thirrën me të drejtë, i ulën rrjetat e tyre me padurim dhe “s’mundën . . . ta tërhiqnin nga shumica e peshqve”⁸. Gjoni tha atë që qe e qartë: “Është Zoti”⁹. Dhe Pjetri i papërmbajtshëm u hodh nga skaji i barkës.

Pas një ribashkimi të gëzuar me Jezusin e ringjallur, Pjetri pati një bisedë me Shpëtimtarin që e quaj pikën vendimtare të kthesës për shërbesën apostullore në përgjithësi dhe sigurisht për Pjetrin në veçanti, duke e frymëzuar këtë njeri të madh të quajtur shkëmb drejt një jete madhështore shërbimi dhe udhëheqjeje të përkushtuar. Duke vështruar barkat e tyre të dëmtuara, rrjetat e tyre të holluara dhe një grumbull të habitshëm prej 153 peshqish, Jezusi i tha apostullit të Tij më të vjetër: “Pjetër, a më do ti Mua më shumë se gjithë këto?” Pjetri tha: “Po, Zot, ti e di se unë të dua”¹⁰.

Shpëtimtari iu përgjigjet këtyre fjalëve, por vazhdon të shikojë në sytë e dishepullit të Tij dhe thotë sërish: “Pjetër, a më do ti Mua?” Me siguri i hutuar disi nga përsëritja e pyetjes, peshkatari i madh përgjigjet për herë të dytë: “Po, Zot, ti e di se unë të dua”¹¹.

Shpëtimtari sërish jep një përgjigje



të shkurtër, por me vështrimin ngultas pyet për të tretën herë: “Pjetër, a më do ti Mua?” Me siguri tashmë Pjetri ndihet vërtet në siklet. Ndoshta në zemrën e tij qëndron kujtimi i vetëm disa ditëve më parë kur i ishte bërë një pyetje tjetër tri herë dhe të cilës i ishte përgjigjur me të njëjtën forcë – por në mënyrë mohuese. Ose ndoshta filloi të pyeste veten se mos e keqkuptoi pyetjen e Mësuesit Zot. Ose ndoshta po hetonte zemrën e vet, duke kërkuar konfirmim të ndershëm të përgjigjes që kishte dhënë aq lehtë, pothuajse vetvetishëm. Pavarësisht ndjenjave të veta, Pjetri tha për të tretën herë: “Zot, . . . ti di se unë të dua”¹².


Të cilës Jezusi iu përgjigj (dhe këtu përsëri pranoj se po jap rrëfimin tim, jo nga shkrimet e shenjta), ndoshta duke thënë diçka të tillë: “Atëherë përse je këtu, Pjetër? Përse jemi kthyer në po të njëjtin breg, pranë po të njëjtave rrjeta, duke bërë po të njëjtën bisedë? A nuk qe e qartë që atëherë dhe a nuk është e qartë tani se nëse dua peshk, mund ta siguroj vetë peshkun? Pjetër, ajo çfarë më duhet janë dishepujt – dhe më duhen përgjithmonë. Më duhet dikush që të kujdeset për delet e mia e të shpëtojë qengjat e mi. Më duhet dikush që të predikojë ungjillin tim e të mbrojë fenë time. Më duhet dikush që më do, që më do plotësisht me të vërtetë dhe e ka për zemër atë që Ati ynë në Qiell më ka thirrur të bëj. Mesazhi ynë nuk është i pafuqi. Nuk është detyrë e përkohshme. Ai nuk është i pafat, nuk është i pashpresë; nuk ka për t’iu dorëzuar hirit të historisë në harresë. Është puna e të Plotfuqishmit dhe ka për të ndryshuar botën. Kështu që për herë të dytë dhe supozoj për herë fundit, Pjetër, po të kërkoj që ta lësh të gjithë këtë dhe të shkosh të japësh mësim e të dëshmosh, të punosh e të shërbesh me besnikëri deri ditën që

ata do të bëjnë me ty pikërisht atë që bënë me Mua.”

Pastaj, duke u kthyer nga të gjithë apostujt, Ai mund të ketë thënë diçka të tillë: “A ishit ju po aq marrëzisht të nxituar sa skribët dhe farisenjtë? Sa Herodi e Pilati? A menduat ju, si ata, që kjo punë mund të shuhej thjesht duke më vrarë mua? A menduat ju, si ata, që kryqi dhe gozhdët e varri qenë fundi i gjithë kësaj dhe që secili mund të kthehej hareshëm për të qenë ai njeri çfarëdo që ishte më parë? Djema a nuk jua preku zemrën më thellësisht se kaq jeta ime dhe dashuria ime?”

Vëllezërit e motrat e mia të dashura, nuk jam i sigurt tamam se si do të jetë përvoja jonë Ditën e Gjykimit, por do të jem shumë i habitur nëse, në një çast të caktuar gjatë asaj bisede, Perëndia nuk na pyet pikërisht atë që Krishti i pyeti Pjetrit: “A më doje Mua?” Mendoj se Ai do të dëshirojë të dijë nëse pikërisht në kuptimin tonë të vdekshëm e të papërshtatshëm dhe ndonjëherë fëmijëror të gjërave, a ia arritëm të paktën të kuptonim *një* urdhërim, të parin dhe më të madhin e të gjithë urdhërimeve – “Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë forcën tënde dhe me gjithë mendjen tënde”¹³. Dhe nëse në një çast të tillë mund t’ia dalin në një farë mënyre të themi: “Po, Zot, ti e di se unë të dua”, atëherë Ai mund të na kujtojë se tipari themelor i dashurisë është gjithmonë besnikëria.

“Nëse më doni, zbatoni urdhërimet e mia”¹⁴, tha Jezusi. Pra [tani] kemi fqinjë për të bekuar, fëmijë për të ruajtur, të varfër për të ngritur moralisht dhe të vërtetën për ta mbrojtur. Kemi gabime për të ndrequr, të vërteta për të shpërndarë dhe të mira për të bërë. Me pak fjalë, duhet të bëjmë një jetë prej dishepulli të përkushtuar që të tregojmë dashurinë tonë për Zotin. Ne nuk mund



ka qëndruar ndonjëherë në një vaskë pagëzimi dhe me krahun e ngritur katror ka thënë: “Duke qenë i autorizuar nga Jezu Krishti”¹⁶. Ai autorizim kishte qëllim ta ndryshonte përgjithmonë njeriun tuaj të kthyer në besim; por sigurisht që mendohet t’ju ketë ndryshuar edhe ju përgjithmonë. Rinisë së Kishës që po rriten për t’u përfshirë në misione, tempuj e martesë, i themi: “Duajeni Perëndinë dhe qëndroni të pastër nga gjaku e mëkatet e këtij brezi. Ju keni një punë madhështore për të bërë, të theksuar nga lajmërimi i mrekullueshëm që bëri Presidenti Tomas S. Monson dje në mëngjes. Ati juaj në Qiell pret nga ju besnikëri e dashuri në çdo etapë të jetës suaj.”

Të gjithëve që mund të dëgjojnë zërin tim, u them se zëri i Krishtit vjen kumbues përmes korridoreve të kohërave, duke e pyetur secilin prej nesh, ndërsa ka kohë: “A më do ti Mua?” Dhe për gjithsecilin prej nesh, unë përgjigjem me nder e me shpirt: “Po, Zot, ne të duam me të vërtetë”. Dhe pasi kemi vënë “dorë[n] [tonë] në parmendë”¹⁷, ne kurrë nuk do të shikojmë prapa derisa kjo punë të ketë mbaruar dhe dashuria për Perëndinë e fqinjin të sundojë botën. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Gjoni 14:9.
2. Marku 9:31–32.
3. Gjoni 21:3.
4. Shih Gjoni 21:5.
5. Gjoni 21:6.
6. Lluka 5:5.
7. Lluka 5:6.
8. Gjoni 21:6.
9. Gjoni 21:7.
10. Gjoni 21:15.
11. Gjoni 21:16.
12. Gjoni 21:17.
13. Lluka 10:27; shih edhe Mateu 22:37–38.
14. Gjoni 14:15.
15. Frederic W. Farrar, *The Life of Christ* (1994), f. 656; shih kapitullin 62 për më shumë të dhëna mbi vështirësinë e kësaj Kishë të sapothemeluar.
16. Doktrina e Besëlidhje 20:73.
17. Lluka 9:62.

të dorëzohemi dhe nuk mund të kthehemi mbrapsht. Pas takimit me Birin e gjallë të Perëndisë së gjallë, asgjë nuk është kurrë më siç qe përpara. Kryqëzimi, Shlyerja dhe Ringjallja e Jezusit shënojnë fillimin e jetës së krishterë, jo fundin e saj. Qe kjo e vërtetë, ky realitet, që i mundësoi një grushti galileasish peshkatarë-të-kthyer-sërish-apostuj të cilët pa “as edhe një sinagogë apo shpatë”¹⁵ i lanë ato rrjeta për herë të dytë dhe nisën të gdhendnin historinë e botës në të cilën jetojmë tani.

U dëshmoj nga thellësia e zemrës sime, me gjithë forcën e shpirtit tim, të gjithëve që mund ta dëgjojnë zërin tim, se ato çelësa apostullore janë rivendosur në tokë dhe gjenden në

Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Atyre që ende nuk janë bashkuar me ne në këtë çështje të madhe finale të Krishtit, ne u themi: “Ju lutemi bëjeni atë”. Atyre që dikur qenë me ne por janë tërhequr, duke parapëlqyer të përzgjedhin e marrin pjesë në disa aspekte kulturore të Kishës pa marrë pjesë në bekimet e plota të Rivendosjes dhe duke lënë pjesën tjetër të festës, unë u them se kam frikë se përballeni me shumë net të gjata dhe rrjeta të zbrazura. Thirrja është që të ktheheni, të qëndroni të vërtetë, të doni Perëndinë dhe të jepni një dorë në ndërtimin e mbretërisë. Përfshij në këtë thirrje për besnikëri të palëkundur çdo misionar të kthyer që



Nga Presidenti Tomas S. Monson

Merrni Parasysh Bekimet

Ati ynë Qiellor është në dijeni të nevojave tona dhe do të na ndihmojë kur i thërrasim për ndihmë.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, kjo konferencë shënon vitin e 49-të që kur u mbështeta si anëtar i Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve më 4 tetor 1963. Dyzet e nëntë vjet përbën shumë kohë. Megjithatë, në shumë mënyra, më duket se ka kaluar shumë pak kohë që kur qëndrova te podiumi në Tabernakull dhe dhashë pikërisht fjalimin tim të parë në konferencën e përgjithshme.

Shumë gjëra kanë ndryshuar që prej 4 tetorit 1963. Ne jetojmë në një kohë të veçantë të historisë së botës. Ne jemi bekuar me kaq shumë gjëra. Dhe pra-pëseprapë ndonjëherë është e vështirë t'i shikojmë problemet dhe lëshimet për mëkatin rreth nesh e të mos ndihemi të shkurajuar. Kam zbuluar se, në vend që të mendojmë vetëm për negativën, nëse do të hedhim një hap prapa e do të marrim parasysh bekimet në jetën tonë, përfshirë bekimet në dukje të vogla e ndonjëherë të pavënëre, ne mund të gjejmë lumturi më të madhe.

Teksa kam rishqyrtuar 49 vitet e kaluara, kam bërë disa zbulime. Një zbulim është se përvojat e panumërta që kam pasur, nuk kanë qenë domosdoshmërisht nga ato që do të quheshin të jashtëzakonshme. Në fakt,

gjatë kohës kur kanë ndodhur, shpesh janë dukur jo mbresëlënëse dhe madje të zakonshme. Dhe ende, kur shikoj prapa, ato kanë pasuruar e bekuar jetë – mes të tjerash dhe vetë jetën time.

Do t'jua rekomandoja po këtë ushtrim juve – domethënë, që të bëni një inventar të jetës suaj dhe të shikoni në mënyrë të hollësishme për bekimet, të mëdha e të vogla, që keni marrë.

Dijenja ime që lutjeve tona iu vihet veshi e marrin përgjigje është përforcuar vazhdimisht nga vetë rishqyrtime që u kam bërë viteve të kaluara. Ne njihemi me të vërtetën që gjendet te 2 Nefi në Librin e Mormonit: “Njerëzit janë, që ata të mund të kenë gëzim”¹. Dëshmoj se një pjesë e madhe e atij gëzimi vjen kur e kuptojmë se mund të komunikojmë me Atin tonë Qiellor përmes lutjes dhe se ato lutje do të dëgjohen e do të marrin përgjigje – ndoshta jo sipas mënyrës dhe në kohën që presim ne që të marrin përgjigje, por ato *do të* marrin përgjigje nga një Atë Qiellor që na njeh e na do në mënyrë të përsosur dhe që dëshiron lumturinë tonë. A nuk na ka premtuar Ai: “Ji i përulur; dhe Zoti, Perëndia yt, do të të udhëheqë përdore dhe do t'u japë përgjigje lutjeve të tua”²?

Për këto pak minuta në vijim që kam në dispozicion, do të doja të ndaja me ju vetëm një grup të vogël shembujsh nga përvojat që kam pasur kur lutjet janë dëgjuar e kanë marrë përgjigje dhe të cilat, në retrospektivë, kanë sjellë bekime në jetën time si edhe të të tjerëve. Ditari im i përditshëm, i mbajtur gjatë gjithë këtyre viteve, ka ndihmuar në sigurimin e disa veçorive që në të kundërt ka shumë gjasa që nuk do të isha në gjendje t'i rrëfeja.

Në fillim të 1965-ës, më caktuan të frekuentoja disa konferenca kunji dhe të mbaja mbledhje të tjera nëpër gjithë zonën e Paqësorit Jugor. Kjo që vizita ime e parë në atë pjesë të botës dhe që një kohë për të mos u harruar kurrë. Gjatë kësaj detyre, teksa u takova me udhëheqës, anëtarë e misionarë, ndodhën shumë ngjarje që qenë me natyrë shpirtërore.

Fundjavën e së shtunës dhe së dielës, më 20 dhe 21 shkurt, qemë në Brisbejn të Australisë, për të mbajtur sesionet e rregullta të konferencës së Kunjit të Brisbejn. Gjatë mbledhjeve të së shtunës, më prezantuan me presidentin e distriktit nga një zonë fqinj. Kur i dhashë dorën, pata një përshtypje të fortë se duhej të flisja me të dhe t'i ofroja këshillë, dhe kështu i kërkova nëse mund të më shoqëronte të nesërmen për te sesioni i paradites të së dielës në mënyrë që të mund ta përmbushja këtë gjë.

Në vijim të sesionit të së dielës, patëm mundësinë të flisnim së bashku. Ne folëm rreth përgjegjësive të tij të shumta si president distrikti. Teksa e bëmë këtë, ndieva nxitjen për t'i dhënë sugjerime të posaçme në lidhje me punën misionare dhe me mënyrën se si ai dhe anëtarët e tij mund t'i ndihmonin misionarët kohëplotë në punët e tyre në zonën e tij. Më vonë mësova se ky burrë që lutur për drejtim në lidhje me këtë gjë. Për të, vizita



jonë që një dëshmi e veçantë që lutjet e tij qenë dëgjuar dhe kishin marrë përgjigje. Kjo që një mbledhje në dukje e zakonshme por e tillë që unë jam i bindur se u udhëhoq nga Shpirti dhe bëri ndryshim në jetën dhe në administrimin [e thirrjes] së presidentit të distriktit, në jetën e anëtarëve të tij dhe në suksesin e misionarëve atje.

Vëllezërit dhe motrat e mia, qëllimet e Zotit shpesh përmbushen kur ia vëmë veshin udhëheqjes së Shpirtit. Besoj se sa më shumë veprimet sipas frymëzimit dhe përshtypjeve që na vijnë, aq më shumë Zoti do të na i besojë porositë e Tij.

Siç kam përmendur në mesazhet e mëparshme, kam mësuar që të mos e shtyj kurrë një nxitje. Në një rast,

shumë vite më parë, po bëja vajtje-ardhje me not në palestrën e vjetër 'Deseret' në Solt-Lejks-Siti kur ndieva frymëzimin që të shkoja te Spitali Universitar për të vizituar një shok të mirë timin, i cili kishte humbur përdorimin e gjymtyrëve të tij të poshtme për shkak të një sëmundjeje të keqe dhe ndërhyrjes kirurgjikale pasuese. U largova menjëherë nga pishina, u veshja dhe shpejt mora rrugën për të parë këtë njeri të mirë.

Kur arrita te dhoma e tij, pashë që qe bosh. Pasi pyeta, mësova se ndoshta do ta gjeja në zonën e pishinës së spitalit, një zonë që përdorej për terapi fizike. Dhe kështu ishte vërtet. Ai kishte shkuar vetë atje me karrocën e tij me rrota dhe qe i vetëm

në sallë. Ai qe në anën e largët të pishinës, pranë pjesës fundore të thellë. E thirra dhe ai manovroi me karrocën e tij të invalidit drejt meje për të më përshëndetur. Vizita qe e gëzueshme për të dy dhe unë e shoqërova përsëri në kthimin për te dhoma e tij në spital ku i dhashë një bekim.

Më vonë mësova nga shoku im se kishte qenë plotësisht i dëshpëruar atë ditë dhe kishte menduar t'i jepte fund jetës. Ai ishte lutur për qetësim por kishte filluar të ndiente se lutjet e tij nuk kishin marrë përgjigje. Ai kishte shkuar te pishina me mendimin se kjo do të qe mënyra për t'i dhënë fund vuajtjes së tij – duke e çuar karrocën e tij drejt pjesës fundore të thellë të pishinës. Kisha shkuar në një çast vendimtar, në përgjigje të asaj që e di se qe frymëzim nga lart.

Shoku im qe në gjendje të jetonte edhe për shumë vite – vite të mbushura me lumturi e mirënjohje. Sa i lumtur jam që kam qenë një mjet në duart e Zotit në atë ditë vendimtare në pishinë.

Në një rast tjetër, kur unë dhe motra Monson po udhëtonim me makinë për në shtëpi pasi vizituam disa miq, pata përshtypjen që duhet të shkonim në qytet – një distancë prej shumë kilometrash me makinë – që t'i bënim një vizitë një të veje të moshuar që dikur kishte jetuar në lagjen tonë. Emri i saj qe Zela Tomas. Në atë kohë ajo qe banore e një qendre përkujdesjeje. Atë pasdite herët e gjetëm tepër të dobët fizikisht, por të shtrirë në paqe në shtratin e vet.

Zela kishte qenë e verbër prej shumë kohësh, por i njohu menjëherë zërat tanë. Më kërkoi nëse mund t'i jepja një bekim, duke shtuar se qe gati të vdiste nëse Zoti dëshironte që ajo të kthehej në shtëpi. Pati një shpirt të ëmbël e paqësor në dhomë, dhe të gjithë ne e dinim se koha që i mbetej

në vdekshmëri do të ishte e shkurtër. Zela më kapi për dore dhe tha se qe lutur me gjithë shpirt që të vija ta takoja e t'i jepja një bekim. I thashë se kishim ardhur për shkak të një frymëzimi të drejtpërdrejtë nga Ati ynë Qiellor. E putha në ballë, duke e ditur se ndoshta nuk do ta shihja sërish në këtë jetë tokësore. Dhe kështu ndodhi vërtet, pasi ajo ndërroi jetë ditën tjetër. Qe një bekim për të dhe për mua që qemë në gjendje t'i jepnim disi ngushëllim e paqe Zelës sonë të ëmbël.

Mundësia për të qenë bekim në jetën e dikujt tjetër shpesh vjen papritmas. Një mbrëmje tepër të ftohtë të shtune gjatë dimrit të viteve 1983–1984, unë dhe motra Monson udhëtuam me makinë disa kilometra drejt luginës malore të Midueit në Juta, ku kemi një shtëpi. Temperatura atë natë qe minus 31 gradë celsius (-24°F), dhe ne donim të siguroheshim që çdo gjë shkonte mirë te shtëpia jonë atje. Ne kontrolluam dhe pamë që qe në rregull, kështu që u nisëm për t'u kthyer në Solt-Lejks-Siti. Nuk kishim bërë as pak kilometra në autostradë kur makina jonë ndaloi së punuari. Ndodheshim në një pozitë plotësisht të vështirë. Rrallë, për të mos thënë asnjëherë, nuk kam pasur aq ftohtë sa atë natë.

Me gjysmë zemre, filluam të ecnim drejt qytetit më të afërt, makinat na kalonin pranë si shigjetë. Më në fund një makinë ndaloi dhe një i ri u ofrua të ndihmonte. Përfundimisht morëm vesh që nafta në serbatorin tonë qe trashur për shkak të të ftohtit, duke e bërë të pamundur që ta ngisnim makinën. Ky i ri i sjellshëm na ktheu me makinë deri te shtëpia jonë në Miduei. U përpoqa t'ia kompensoja në para shërbimin, por ai refuzoi me mirësjellje. Ai vuri në dukje se qe djalë Skautist dhe dëshironte të jepte një shërbim. Unë i thashë kush isha dhe

ai shprehu mirënjohje për privilegjin që pati të na ofronte ndihmë. Duke hamendësuar se ishte pak a shumë në moshë për mision, e pyeta nëse kishte plane të shërbente në një të tillë. Ai tregoi se nuk qe shumë i sigurt se çfarë dëshironte të bënte.

Mëngjesin tjetër të së hënës, i shkrova një letër këtij të riu dhe e falënderova për mirësinë e tij. Në letër e nxita që të shërbente në një mision kohëplotë. Me letrën futa një kopje të një prej librave të mi dhe nënvizova kapitujt mbi punën misionare.

Afërsisht një javë më pas, nëna e të riut telefonoi dhe tha se i biri qe një i ri i dalluar, por që për shkak të disa ndikimeve në jetën e vet, dëshira e tij e vjetër për të shërbyer një mision ishte zbehur. Ajo tregoi se ajo dhe i ati kishin agjëruar e ishin lutur që zemra e tij të ndryshonte. Ata ia kishin përfshirë emrin te lista e emrave për lutje në Tempullin e Provos në Juta. Ata shpresonin që zemra e tij do të prekej disi, në një farë mënyre, për mirë dhe atij do t'i kthehej dëshira për të përmbushur një mision e për t'i shërbyer Zotit me besnikëri. E ëma dëshironte që të dija se ajo i shikonte ngjarjet e asaj mbrëmjeje të ftohtë si përgjigje të lutjeve të tyre në emrin e tij. I thashë: "Jam dakord me ju".

Pas disa muajsh e pas më shumë komunikimi me këtë të ri, unë dhe motra Monson patëm gëzimin e madh që të merrnim pjesë në lamtumirën e tij si misionar para nisjes së tij për në Misionin e Kanadasë – Vankuver.

A qe rastësi që rrugët tona u kryqëzuan atë natë të ftohtë dimri? Nuk e besova këtë për asnjë çast. Përkundrazi, besoj se takimi ynë qe një përgjigje e lutjeve të ndiera të një nëne dhe babai për të birin që e donin fort.

Përsëri, vëllezërit e motrat e mia, Ati ynë Qiellor është në dijeni të nevojave tona dhe do të na ndihmojë

kur i thërrasim për ndihmë. Unë besoj se asnjë shqetësim i yni nuk është tepër i vogël ose i parëndësishëm. Zoti është i shqetësuar edhe për hollësitë e jetës sonë.

Do të doja ta mbyllja duke treguar një përvojë të kohëve të fundit e cila pati ndikim te qindra veta. Ndodhi gjatë festimit kulturor për Tempullin e Kansas-Sitit, vetëm pesë muaj më parë. Ashtu si me kaq shumë gjëra që ndodhin në jetën tonë, në atë kohë dukej se qe thjesht një tjetër përvojë ku çdo gjë kishte shkuar për së mbari. Megjithatë, kur mësova rrethanat e lidhura me festimin kulturor mbrëmjen përpara dedikimit të tempullit, kuptova se interpretimi atë mbrëmje nuk qe i zakonshëm. Përkundrazi, qe mjaft mbresëlënës.

Ashtu si me të gjitha ngjarjet kulturore që janë pjesë e përkushtimit të tempujve, të rinjtë në Distriktin e Tempullit të Kansas-Sitit në Misuri, i kishin bërë provat e shfaqjes në grupe të ndara në vetë zonat e tyre. Plani qe se do të takoheshin të gjithë së bashku në tërësi, do të merrnin me qira qendër bashkiake mëngjesin e të shtunës së shfaqjes në mënyrë që të mësonin se kur dhe ku do të hynin, ku do të qëndronin, sa hapësirë do të kishte mes tyre dhe personit fqinj, si do të dilnin nga skena kryesore e kështu me radhë – shumë hollësi që duhej t'i kuptonin gjatë ditës teksa njerëzit në detyrë i lidhnin skenat e ndryshme së bashku në mënyrë që shfaqja finale të dilte shkëlqyeshëm dhe të ishte profesionale.

Pati vetëm një problem madhor atë ditë. I tërë xhirimi varej nga fragmente të regjistruara më parë që do të shfaqeshin në ekranin e madh të njohur si Xhambotron. Këto fragmente të regjistruara qenë të rëndësishme për të gjithë xhirimin. Jo vetëm që i vunë ato të gjitha së bashku, por secili fragment



televiziv do të prezantonte interpretimin vijues. Fragmentet pamore përbënin strukturën mbi të cilin varej i gjithë xhirimi. Dhe Xhambotroni nuk po punonte.

Teknikët punuan me të gjithë forcën për ta zgjidhur problemin teksta të rinjtë prisnin, qindra prej tyre, duke humbur nga koha e çmuar e provave. Situata filloi të dukej e pazgjidhshme.

Skenaristja dhe drejtuesja e festimit, Suzan Kuper, shpjegoi më vonë: “Pasi kaluam nga plani A te ai B e pastaj te ai Zh, e dinim se nuk do të funksiononte. . . . Teksa po shikonim programin, e dinim se do të ishte përtej aftësive tona, por e dinim se kishim një prej forcave më të mëdha aty poshtë [në skenë] – 3.000 të rinj. Ne duhet t’u dilnim përpara e t’u tregonim atë që po ndodhte dhe të përdornim besimin e tyre.”³

Vetëm një orë para se dëgjuesit do të fillonin të hynin në qendër, 3.000 të rinjtë u gjunjëzuan mbi dysheme dhe u lutën së bashku. Ata u lutën që ata që po merreshin me Xhambotronin do të frymëzoheshin për të ditur se çfarë të bënin që ta riparonin; i kërkuan Atit të tyre Qiellor që të bënte atë që ata vetë nuk mundeshin ta bënin për shkak të kohës së shkurtër.

Një person që shkroi rreth saj më pas tha: “Qe një lutje që rinia nuk do ta harrojë kurrë, jo ngaqë dyshemeja qe e fortë por pasi e ndien Shpirtin gjer në palcë”⁴.

Nuk kaloi shumë kohë kur një prej teknikëve erdhi t’u thoshte se problemi ishte gjendur dhe zgjidhur. Ai ia dha meritat fatit të mirë për zgjidhjen e problemit, por të gjithë ata të rinj e dinin të vërtetën.

Kur hymë në qendrën bashkiake atë mbrëmje, nuk ia kishim idenë e vështirësive që kishin pasur atë ditë. Vetëm më vonë i morëm vesh. Sidoqoftë, ajo që pamë qe një interpretim i bukur dhe i shkëlqyer – një nga më të mirët që kam parë. Të rinjtë rrezatonin një shpirt të lavdishëm e të fuqishëm, i cili u ndie nga të gjithë të pranishmit. Dukej se e dinin tamam se kur të hynin, ku të qëndronin dhe si të ndërvepronin me të gjithë interpretuesit e tjerë rreth tyre. Kur mësova se provat e tyre ishin shkurtuar dhe se për shumë prej numrave të shfaqjes nuk ishin bërë prova fare nga grupi në tërësi, u habita. Askush nuk do ta kishte vënë re. Zoti me të vërtetë kishte kompensuar atë që ata nuk e kishin bërë dot në prova.

Kurrë nuk resht së mahnituri se si Zoti mund t’i japë shtysë dhe ta drejtojë çdo pjesë të mbretërisë së Tij dhe përsëri ka kohë të japë frymëzim lidhur me një njeri – ose një festim kulturor apo një Xhambotron. Fakti që Ai mundet, dhe Ai e bën këtë, është një dëshmi për mua.

Vëllezërit e motrat e mia, Zoti është i pranishëm në jetën e gjithsecilit prej nesh. Ai na do. Ai dëshiron të na bekojë. Ai dëshiron që ne t’i kërkojmë ndihmë. Teksa Ai na udhëheq e drejton dhe i dëgjon e u përgjigjet lutjeve tona, ne do të gjejmë lumturinë që Ai dëshiron për ne në këtë vend e në këtë kohë. Qofshim të vëtdijshëm për bekimet e Tij në jetën tonë, lutem në emrin e Jezu Krishtit, Shpëtimtarit tonë, amen. ■

SHËNIME

1. 2 Nefi 2:25.
2. Doktrina e Besëlidhje 112:10.
3. Susan Cooper, në Maurine Proctor, “Nothing’s Too Hard for the Lord: The Kansas City Cultural Celebration”, *Meridian Magazine*, 9 maj 2012, ldsmag.com.
4. Proctor, *Meridian Magazine*, 9 maj 2012.



Nga Plaku Robert D. Hejls,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Të Qenit më Shumë i Krishterë si Krishti

*Kjo është thirrja e Krishtit për çdo të krishterë sot:
“Kulloti qengjat e mi! . . . Ki kujdes për delet e mia”.*

Cfarë do të thotë të jesh
i krishterë?

Një i krishterë ka besim në Zotin Jezu Krisht, se Ai është Biri i vërtetë i Perëndisë, i dërguar nga Ati i Tij për të vuajtur për mëkatet tona në veprimin suprem të dashurisë, që e njohim si Shlyerja.

Një i krishterë beson se nëpërmjet hirit të Perëndisë Atit dhe Birit të Tij, Jezu Krishtit, ne mund të pendohemi, të falim të tjerët, të zbatojmë urdhërimet dhe të trashëgojmë jetën e përjetshme.

Fjala *të krishterë* nënkupton të marrim mbi vete emrin e Krishtit. Ne e bëjmë këtë nëpërmjet pagëzimit dhe marrjes së dhuratës së Frymës së Shenjtë me anë të vënies së duarve, nga ata të cilët mbajnë autoritetin e Tij të priftërisë.

Një i krishterë e di se gjatë gjithë epokave, profetët e Perëndisë gjithmonë kanë dëshmuar për Jezu Krishtin. Po i njëjti Jezu, i shoqëruar nga Ati Qiellor, iu shfaq Profetit Jozef Smith në vitin 1820 dhe rivendosi ungjillin e organizimin e Kishës së Tij të hershme.

Me anë të shkrimit të shenjtë dhe dëshmisë së Jozef Smithit, ne e dimë se Perëndia, Ati ynë Qiellor, ka një trup të përlëvdur e të përsosur prej mishi e kockash. Jezu Krishti është Biri i Tij i Vetëmlindur në mish. Fryma e Shenjtë është një personazh i shpirtit, funksioni i të cilit është të dëshmojë për Atin dhe Birin. Kreu-Perëndi përbëhet nga tri qenie të ndara dhe të ndryshme, të bashkuara në qëllim.

A mund të ketë ndonjë dyshim apo pikëpyetje që ne, si anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, me këto doktrina si baza e besimit tonë, jemi të krishterë? Megjithatë për çdo të krishterë, qëndron pyetja e thjeshtë: çfarë lloj të krishterësh jemi? Me fjalë të tjera, si po ecim në udhëtimin tonë për të ndjekur Krishtin?

Mendoni me mua përvojën e dy dishepujve të krishterë:

“Duke ecur gjatë bregut të detit të Galileës, Jezusi pa dy vëllezër: Simonin, të quajtur Pjetër, dhe Andrean, të vëllanë, të cilët po hidhnin rrjetën në det, sepse ishin peshkatarë;

dhe u tha atyre: ‘Ndiqmeni dhe unë do t’ju bëj peshkatarë njerëzish’.

Dhe ata i lanë menjëherë rrjetat dhe e ndoqën.”¹

Si të krishterë sot, ne kemi mundësinë të veprojmë pa u vonuar, menjëherë dhe me vendosmëri, pikërisht siç bënë Pjetri dhe Andrea: “ata i lanë menjëherë rrjetat dhe e ndoqën”². Ne gjithashtu jemi thirrur t’i lëmë rrjetat tona, t’i refuzojmë veset, zakonet dhe traditat e botës. Neve na bëhet thirrje edhe që t’i braktisim mëkatet tona. “Pastaj [Jezusi] e thirri pranë vetes turmën . . . dhe iu tha: ‘Kushdo që don të vijë pas meje, të mohojë vetveten, të marrë kryqin e vet dhe të më ndjekë.’”³ Mohimi i vetvetes nga sjellja e pafe është fillimi i pendimit, që sjell një ndryshim të fuqishëm të zemrës derisa të mos kemi “më prirje të bëjmë keq”⁴.

Ky ndryshim i zemrës, i quajtur kthim në besim, është i mundur vetëm nëpërmjet Shpëtimtarit. Jezusi premtoi: “Dhe në qoftë se njerëzit vijnë tek unë, unë do t’u tregoj atyre dobësinë e tyre. . . . Hiri im është i mjaftueshëm për të gjithë njerëzit që përulen para meje; pasi në qoftë se ata përulen para meje dhe kanë besim tek unë, atëherë unë do të bëj që gjërat e dobëta, të bëhen të forta në ta”⁵. Kur bëhemi më të mirë përmes Krishtit, vetë natyra jonë ndryshon dhe ne nuk dëshirojmë më t’u kthehemi veseve tona të vjetra.

Edhe pse kështu, të krishterët besnikë gjithmonë do të bekohen për të përjetuar vështirësi dhe zhgënjime. Kur vijnë këto sfida gdhendëse, ne mund të tundohejmë për t’iu kthyer veseve tona të vjetra. Pas kryqëzimit të Shpëtimtarit, Ai iu shfaq grave dhe u tha atyre se vëllezërit do ta gjenin Atë në Galileë. Kur Pjetri, Apostulli më i vjetër, u kthye në Galileë, ai gjithashtu iu kthye asaj që dinte – asaj që u ndie i qetë të bënte. “Po shkoj të peshkoj”⁶, shpjegoi ai, dhe mori disa dishepuj me vete.



Në të vërtetë, Pjetri dhe të tjerët peshkuan gjithë natën pa kapur asnjë peshk. Të nesërmen në mëngjes Jezusi u shfaq në breg dhe u thirri atyre matanë ujit: “Hidhni rrjetën [tuaj] në anën e djathtë”. Dishepujt të cilët qëndruan në barkë, ndoqën udhëzimet e Shpëtimtarit, dhe shpejt zbuluan se rrjetat e tyre ishin mbushur mrekullisht derisa po derdheshin jashtë. Gjoni menjëherë e njohu zërin e Shpëtimtarit, dhe Pjetri u hodh menjëherë në ujë dhe notoi drejt bregut.⁷

Të krishterët që u janë kthyer ve-seve të tyre të vjetra e më pak besnike, të marrin parasysh shembullin besnik të Pjetrit. Mos u vononi. Hajdeni, dëgjojeni dhe pranojeni thirrjen e zërit të Mësuesit. Pastaj kthehuni menjëherë tek Ai dhe merrini edhe një herë bekimet e Tij me bollëk.

Kur vëllezërit u kthyhen në breg, ata gjetën një banket me peshq dhe bukë. “Ejani të hani mëngjes”⁸, i ftoi Shpëtimtari. Pasi i ushqeu ata, Ai e pyeti Pjetrin tri herë: “Simon nga Jona, a më do ti mua?” Kur Pjetri shprehu dashurinë e tij, Shpëtimtari iu lut: “Kulloti qengjat e mi! . . . Ki kujdes për delet e mia.”⁹

Kjo është thirrja e Krishtit për çdo të krishterë sot: “Kulloti qengjat e mi! . . . Ki kujdes për delet e mia” – ndani

ungjillin tim me këdo pavarësisht moshës, duke i lartësuar, bekuar, ngushëlluar, inkurajuar dhe duke i ngritur moralisht, veçanërisht ata të cilët mendojnë dhe besojnë në mënyrë të ndryshme nga ne. Ne i kullozim qengjat e Tij në shtëpitë tona nëpërmjet mënyrës si e jetojmë ungjillin: duke zbatuar urdhërimet, duke u lutur, duke studiuar shkrimet e shenja dhe ndjekur shembullin e Tij se si të tregojmë dashuri. Ne i kullotim delet e Tij në Kishë kur shërbejmë në kuorimet e priftërisë dhe organizatat ndihmëse. Dhe ne i kullotim delet e Tij kudo në botë duke qenë fqinj të krishterë, duke ushtruar fenë e pastër nëpërmjet vizitave dhe shërbimit ndaj të vejave, jetimëve, të varfërve dhe atyre që janë në nevojë.

Për shumë vetë, thirrja për të qenë i krishterë mund të duket kërkuese, madje dërrmuese. Por ne nuk duhet të jemi të frikësuar apo të ndihemi të papërshtatshëm. Shpëtimtari ka premtuar se Ai do të na bëjë të përshtatshëm dhe të aftë për të bërë punën e Tij. “Ndiqmëni”, tha Ai, “dhe unë do t’ju bëj peshkatarë njerëzish.”¹⁰ Kur ne e ndjekim Atë, Ai na bekon me dhurata, talente dhe forcë për të bërë vullnetin e Tij, duke na lejuar të shkojmë përtej zonave të rehatisë dhe të bëjmë gjëra që ne kurrë nuk i kemi menduar më

parë se janë të mundura. Kjo mund të nënkuptojë ndarjen e ungjillit me fqinjët, shpëtimin e atyre që janë të humbur shpirtërisht, shërbimin në një mision kohëplotë, punën në tempull, rritjen e fëmijës me nevoja të veçanta, të treguarit e dashurisë ndaj plangprishësit, shërbimin ndaj një shoku/shoqeje të sëmurë, durimin e keqkuptimeve apo vuajtjen e hidhërimeve. Do të thotë ta përgatisësh veten për t’iu përgjigjur thirrjes së Tij duke thënë: “Do shkoj ku ti do që të shkoj; do them çfar’ ti do që un’ të them; do jem çfar’ ti do që të jem”¹¹.

Për të qenë njerëzit që Ati Qiellor dëshiron që ne të jemi, ne ndjekim Jezu Krishtin. Unë dëshmoj se Ai po na thërret vazhdimisht për ta ndjekur. Nëse sapo e keni mësuar se shenjtoret e ditëve të mëvonshme janë të krishterë të zotuar apo nëse nuk keni marrë pjesë plotësisht në Kishë dhe dëshironi ta ndiqni Atë sërish – mos u druani! Dishepujt e parë të Shpëtimtarit qenë të gjithë anëtarë të rinj të Kishës, të sapokthyer në besim në ungjillin e Tij. Jezusi me durim i dha mësim secilit. Ai i ndihmoi ata t’i përmbushnin përgjegjësitë e tyre. Ai i quajti ata miq të Tij dhe ka dhënë jetën për ta. Dhe Ai tashmë ka bërë të njëjtën gjë për ju dhe për mua.



Unë dëshmoj se përmes dashurisë dhe hirit të Tij të pafund, ne mund të bëhemi më shumë të krishterë si Krishti. Merrni parasysh cilësitë vijuese si të Krishtit. Si po veprojmë për t'i forcuar ato brenda vetes?

Dashuria e krishterë. Jezusi e çmoi gjithsecilin. I këndshëm dhe i dhe-mbshur ndaj të gjithëve, Ai la të nëntë-dhjetë e nëntat për të gjetur njëri, ¹² pasi “edhe flokët e kokës janë . . . të numëruara” ¹³ për Të.

Besimi i krishterë. Pavarësisht tundimeve, sprovave dhe përndjekjeve, Shpëtimtari i mirëbesoi Atit tonë Qie-llor dhe zgjodhi të ishte besnik e i bindur ndaj udhërimeve të Tij.

Sakrifica e krishterë. Gjatë gjithë jetës së Tij, Shpëtimtari dha nga koha e Tij, energjia e Tij dhe, përfundimisht, përmes Shlyerjes, dha Vetën në mënyrë që të gjithë fëmijët e Perëndisë të mund të ringjallen dhe të kenë mundësinë për të trashëguar jetën e përjetshme.

Kujdesi i krishterë. Sikurse Samaritani i mirë, Shpëtimtari po ofrohej vazhdimisht që t'i shpëtonte, t'i donte dhe t'i ushqente njerëzit përreth Tij, pa dallim kulture, besimi apo rrethanash.

Shërbimi i krishterë. Qoftë duke marrë ujë nga pusi, duke gatuar një vakt me peshq ose duke larë këmbët e pluhurosura, Shpëtimtari i kaloi ditët e Tij duke u shërbyer të tjerëve – duke lartësuar të këputurin dhe duke forcuar të dobëtin.

Durimi i krishterë. Gjatë pikëllimit dhe vuajtjes së Tij vetjake, Shpëtimtari shpresoi tek Ati i Tij. Me durim për ne, Ai shpreson te ne që të bëjmë atë që është e drejtë dhe të vijmë në shtëpi.

Paqja e krishterë. Gjatë gjithë shërbesës së Tij, Ai nxiti mirëkuptim dhe për-krahu paqen. Sidomos midis dishepujve të Tij, Ai dha mësim se të krishterët nuk mund të debatojnë me të krishterët e tjerë, pavarësisht mospajtimeve të tyre.

Falja e krishterë. Ai na mësoi t'i bekojmë ata që na mallkojnë. Na tregoi

mënyrën duke u lutur, që të faleshin ata që e kryqëzuan.

Kthimi i krishterë në besim. Sikurse Pjetri dhe Andrea, shumë e njohën të vërtetën e ungjillit sapo e dëgjuan. Ata janë kthyer në besim menjëherë. Për të tjerët mund të zgjasë më shumë. Në një zbulesë dhënë Jozef Smithit, Shpëtimtari dha mësim: “Ajo që është prej Perëndisë, është dritë; dhe ai që merr dritë e vazhdon në Perëndinë, merr më shumë dritë; dhe ajo dritë shkëlqen gjithnjë e më shumë, derisa dita është e plotë” ¹⁴, dita e përsosur e kthimit tonë në besim. Jezu Krishti është “drita dhe Shëlbuesi i botës; Shpirti i së vërtetës” ¹⁵.

Durimi i krishterë deri në fund. Gjatë gjithë jetës së Tij, Shpëtimtari nuk u dorëzua kurrë duke bërë vullnetin e Atit të Tij, por vazhdoi në drejtësi, mirësi, mëshirë dhe të vërtetë deri në fund të jetës së Tij të vdekshme.

Këto janë disa prej tipareve të atyre që e dëgjojnë dhe ua vënë veshin zërit të Shpëtimtarit. Si një nga dëshmitarët e Tij të veçantë në tokë, unë jap dëshminë time të krishterë se Ai po ju thërret sot: “Eja[ni] e më ndiq[ni]” ¹⁶. Ejani ecni në shtegun që të çon drejt lumturisë së përjetshme, gëzimit dhe jetës së përjetshme në mbretërinë e Atit tonë Qiellor. Në emrin e Jezu Krishtit, Shpëtimtarit e Shëlbuesit tonë, amen. ■

SHËNIME

1. Mateu 4:18–20.
2. Marku 1:18.
3. Marku 8:34.
4. Mosia 5:2.
5. Ethëri 12:27; theksimi i shtuar.
6. Gjoni 21:3.
7. Shih Gjoni 21:3–8.
8. Gjoni 21:12.
9. Shih Gjoni 21:15–17.
10. Mateu 4:19; theksimi i shtuar.
11. Shih “Do të Shkoj ku Ti Do që të Shkoj”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 46.
12. Shih Mateu 18:12–14.
13. Lluca 12:7.
14. Doktrina e Besëlidhje 50:24.
15. Doktrina e Besëlidhje 93:9.
16. Lluca 18:22.



Nga Plaku Riçard G. Skot,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Gëzimi i Shëlbimit të të Vdekurve

“Ai do të mbjellë në zemrat e fëmijëve premtimet e bëra etërve dhe zemrat e fëmijëve do të kthehen tek etërit e tyre.”

Zoti i zbuloi Profetit Jozef Smith doktrinën frymëzuese në lidhje me ordinancën e shenjtë të pagëzimit. Ajo dritë erdhi kur kishat e tjera të krishtera jepnin mësim se vdekja përcaktonte në mënyrë të pakthyeshme dhe të përjetshme fatin e shpirtit. Ato jepnin mësim se të pagëzuarit shpërbleheshin me gëzim të pafund ndërsa gjithë të tjerët përballeshin me mundim të përjetshëm, pa shpresë për shëlbim.

Zbulesa e Zotit se, nëpërmjet autoritetit të duhur të priftërisë, pagëzimi mund të kryhej me mëkëmbës për të vdekurit ruajti drejtësinë e deklaramit të Tij: “Kush nuk ka lindur nga uji dhe nga Fryma, nuk mund të hyjë në mbretërinë e Perëndisë”¹. Pagëzimi me mëkëmbës mund ta sigurojë mëshirshëm këtë ordinancë thelbësore për të gjithë të vdekurit e denjë që nuk e morën atë në vdekshmëri.

Kjo doktrinë e lavdishme është një tjetër dëshmi e natyrës gjithëpërfshirëse të Shlyerjes së Jezu Krishtit. Ai e bëri shpëtimin të disponueshëm për çdo shpirt të penduar. Shlyerja e Tij e mposhti vdekjen dhe Ai u lejon të vdekurve të denjë që t’i marrin me mëkëmbës të gjitha ordinancat e shpëtimit.

Në një letër, shkruar më shumë se 150 vite më parë, Jozef Smithi pohoi: “Shenjtoret kanë privilegjin që të pagëzohen për . . . të afërmit e tyre që kanë vdekur, . . . të cilët e kanë marrë Ungjillin në shpirt, nëpërmjet . . . atyre që kanë marrë detyrën që t’u predikojnë atyre.”² Më vonë ai shtoi: “Ata shenjtore që nuk e përfillin atë në emër të të afërmit të tyre të vdekur, e bëjnë këtë duke rrezikuar vetë shpëtimin e tyre”³.

Profeti Elija ia besoi Jozef Smithit çelësat për punën mëkëmbëse në Tempullin e Kirtlandit⁴ për të përmbushur premtimin e Zotit se “ai do të mbjellë në zemrat e fëmijëve premtimet e bëra etërve dhe zemrat e fëmijëve do të kthehen tek etërit e tyre”⁵.

Me anë të zbulesës së mëtejshme ndaj Jozef Smithit dhe profetëve vijues, ka ardhur një kuptueshmëri dhe përgatitja për punën në tempull dhe përpjekjen për historinë familjare që e mbështet atë. Secili profet, që nga Jozef Smithi, ka theksuar nevojën e domosdoshme për të siguruar të gjitha ordinancat për vete dhe për paraardhësit tanë të vdekur.

Tempulli dhe puna për historinë familjare është një punë e ndarë në dy pjesë. Ato janë të lidhura së bashku

ashtu si ordinancat e pagëzimit dhe të dhuratës së Frymës së Shenjtë. Disa anëtarë mund të mos jenë në gjendje që t’i bëjnë të dyja punët për shkak të shëndetit ose të largësisë nga tempujt.

Presidenti Hauard W. Hanter dha mësim:

“Ne duhet ta kryejmë punën e ordinancave të priftërisë në tempull të domosdoshme për vetë ekzaltimin tonë; pastaj duhet ta bëjmë punën e domosdoshme për ata që nuk patën mundësinë ta pranojnë ungjillin në jetë. Kryerja e punës për të tjerët realizohet në dy hapa: së pari, me anë të kërkimit për historinë familjare për të përcaktuar stërgjyshërit tanë; dhe së dyti, duke kryer ordinancat e tempullit për t’u dhënë atyre të njëjtat mundësi që u jepen të gjallëve.

Sidoqoftë, ka shumë anëtarë të Kishës që kanë vetëm qasje të kufizuar për tek tempujt. Ata bëjnë më të mirën që munden. Ata punojnë në kërkimin për historinë familjare dhe bëjnë që puna për ordinancat e tempullit të kryhet nga të tjerë. Anasjelltas, ka disa anëtarë që përfshihen në punën në tempull, por nuk ia dalin të bëjnë kërkime për historinë familjare në vetë linjat e tyre familjare. Edhe pse kryejnë një shërbim hyjnor duke i ndihmuar të tjerët, ata humbasin një bekim duke mos kërkuar farefisën e tyre të vdekur siç janë drejtuar hyjnisht të bëjnë nga profetët e ditëve të mëvonshme. . . .

“Kam mësuar se ata që përfshihen në kërkime për historinë familjare dhe pastaj kryejnë punën për ordinancat e tempullit për ata të cilëve iu kanë gjetur emrat, do të njohin gëzimin e mëtejshëm të marrjes së të dy gjysmave të bekimit.”⁶

Ati në Qiell dëshiron që secili prej nesh të marrë të dy pjesët e bekimit të kësaj pune jetike mëkëmbëse. Ai ka drejtuar të tjerë që të na tregojnë se si të kualifikohemi. Varet prej jush dhe

prej meje që t'i marrim ato bekime.

Çfarëdo pune që bëni në tempull, është kohë e shpenzuar mirë, por marrja e ordinancave si mëkëmbës për një nga vetë paraardhësit tuaj do ta bëjë kohën në tempull më të shenjtë dhe bekime edhe më të mëdha do të merren. Presidenca e Parë ka shpallur: "Detyrimi ynë i lartë është të kërkojmë dhe të identifikojmë paraardhësit *tanë*"⁷.

Ju të rinj, a dëshironi një mënyrë të sigurt për ta larguar ndikimin e kundërshtarit në jetën tuaj? Zhytuni në kërkimin për paraardhësit tuaj, përgatitini emrat e tyre për ordinancat e shenjta mëkëmbëse të disponueshme në tempull dhe pastaj shkoni në tempull për të qëndruar si mëkëmbës për ata për të marrë ordinancat e pagëzimit dhe dhuratën e Frymës së Shenjtë. Ndërsa rriteni, ju do të jeni në gjendje të merrni pjesë edhe në marrjen e ordinancave të tjera. Nuk mundem të mendoj për mbrojtje më të madhe nga ndikimi i kundërshtarit në jetën tuaj.

Në Misionin e Ruisë, Rostov-mbi-Don, rinia mori ftesën që secili të indeksonte 2.000 emra dhe pastaj të përgatiste të paktën një emër nga vetë familja e vet për ordinanca tempulli. Ata që e realizuan këtë synim, morën ftesën që të kryenin një udhëtim të gjatë për në Tempullin e ri të Kievit në Ukrainë. Një i ri tregoi këtë përvojë: "Po harxhoja shumë kohë duke luajtur lojëra në kompjuter. Kur fillova të bëj indeksim, nuk kisha kohë të luaja lojëra. Fillimisht mendova: 'Oh, jo! Si është e mundur kjo!' Kur ky projekt mori fund, unë madje e kisha humbur interesin për lojërat. . . . Puna gjenealogjike është diçka që ne mund ta bëjmë këtu në tokë dhe do të mbetet në qiell."

Shumë shenjtorë besnikë e kanë kryer punën e kërkimit në linjat e tyre familjare dhe po përdorin mundësinë e rezervimit në FamilySearch për t'i lënë në pritje ordinancat për pjesëtarët

e vetë familjeve të tyre, që të shërbejnë si mëkëmbës. Qëllimi i rezervimit të emrave është që t'u japë individëve një periudhë të arsyeshme kohe që të kryejnë ordinanca për paraardhësit dhe farefisnin nga degë të tjera të familjes. Aktualisht ka 12 milionë emra dhe miliona ordinanca korresponduese që janë rezervuar. Shumë emra janë rezervuar prej vitesh. Paraardhësit që janë gjetur, pa dyshim që janë të dëshiruar e të emocionuar kur emrat e tyre autorizohen për kryerjen e ordinancave. Megjithatë, ata mund të mos jenë shumë të lumtur kur u duhet të vazhdojnë të presin që ordinancat e tyre të kryhen.

Ne ju nxisim juve që keni një numër të madh emrash të rezervuar, që t'i ndani ato, në mënyrë që pjesëtarët e familjes suaj të gjerë ose anëtarë të lagjes dhe kunjit të mund t'ju ndihmojnë në kryerjen e asaj pune. Ju mund ta bëni këtë duke iu shpërndarë karta tempulli anëtarëve të lagjes dhe të kunjit që janë të gatshëm të

ndihmojnë, ose duke përdorur sistemin kompjuterik të FamilySearch për t'i paraqitur emrat drejtpërdrejt në tempull. Kjo mundësia e fundit është diçka që Sindi Blevins nga Kasper në Uajoming, ka vite që po e bën.

Motra Blevins u pagëzua kur qe adoleshente dhe ka qenë anëtarja e vetme e familjes së saj që u bashkua me Kishën. Ajo ka përfunduar një sasi të madhe pune gjenealogjike. Por ka së tepërmi emra që t'i përfundojë ajo dhe familja e ngushtë. Si rrjedhim, motra Blevins i ka paraqitur emrat në tempull, të cilët, raporton ajo, shpesh kryhen brenda disa javësh, zakonisht te njëri prej dy tempujve që ndodhet më pranë shtëpisë së saj. Ajo thotë se i pëlqen të mendojë që miqtë e fqinjët në vetë lagjen dhe kunjin e saj mund të jenë mes atyre që ndihmojnë për ta kryer punën për paraardhësit e saj. Ajo e vlerëson që ata e bëjnë këtë.

Gruas sime të dashur, Zhaninës, i pëlqente shumë të bënte kërkime për



historinë familjare. Kur fëmijët tanë ishin të vegjël, ajo dhe mikeshat e saj kujdeseshin për fëmijët e njëra-tjetrës, që ajo të mund të kishte disa orë, një herë në disa javë për të punuar për kërkime në linjat tona familjare. Pasi fëmija ynë më i ri u largua nga shtëpia, ajo shënoi në ditarin e saj personal: “Sapo mora një vendim dhe dëshiroj të ngrihem dhe ta them me zë të lartë. Dhoma e vjetër e gjumit e Majkut është bërë dhoma ime e punës për gjenealogjinë. Është e pajisur mirë për të organizuar dokumentet dhe për të punuar. Jeta ime tani do të përqendrohet në kërkimin jetik familjar dhe paraqitjen e emrave në tempull. Jam kaq e emocionuar dhe e dëshiruar që të vazhdoj.”⁸

Në një tjetër shënim ditari shkruhet: “Mrekullia për mua ndodhi në zyrën e Historisë Familjare të Mel Olsenit, që më paraqiti një kopje të shtypur të të gjitha tabelave të mia gjenealogjike të nxjerra nga përditësimi i regjistrimeve të kompjuterizuara të programit Ancestral File [Dosjet e Paraardhësve] të dërguara në shoqërinë gjenealogjike. Ato vinin kryesisht nga regjistrimet e programit të Kishës të përdorur shumë vite më parë për t’i nxitur të gjithë që të përgatisnin historinë familjare prej katër brezash të paraardhësve të tyre. Isha trullosur nga mendimi i detyrës gjigante që qëndronte meje, që t’i mblidhja të gjitha regjistrimet e kërkimit për paraardhësit e mi nga organizatat familjare, për t’i hedhur të gjitha ato në kompjuter për shpërndarjen e parë të madhe kompjuterike të programit Ancestral File. Dhe ato ishin të gjitha aty, të bukura, të organizuara dhe të shtypura, dhe qëndronin mbi tavolinë para meje. Isha kaq e emocionuar dhe kaq e trullosur sa që thjesht qëndrova atje e shushatur dhe pastaj fillova të qaj se isha kaq e lumtur. . . . Për dikë që ka bërë kërkime me këmbëngulje, me përpikmëri për tridhjetë vjetë, kompjuterizimi i të gjitha këtyre



regjistrimeve është vërtet emocionues. Dhe kur mendoj për qindra mijëra njerëz që tani ose së shpejti do të kompjuterizojnë grupe gjigante regjistrimesh të popullsisë dhe disqeve të kërkimeve private, ... jam kaq e emocionuar. Kjo është vërtet puna e Zotit dhe Ai po e drejton atë.”⁹

Kam shijuar mjaftueshëm nga frytet e kësaj pune frymëzuese sa ta di që çelësat e Elijas rivendosur Jozef Smithit, na ndihmojnë të ndiejmë një lidhje emocionuese dhe të veçantë me paraardhësit tanë që po presin për ndihmën tonë. Nëpërmjet përpjekjeve tona në tempullt e shenjtë këtu në tokë duke përdorur autoritetin e dërguar nga Shpëtimtari, stërgjyshërit tanë marrin ordiancat shpëtuese që u lejojnë atyre të gëzojnë lumturi të përjetshme.

Në të shkuarën, të shtyrë nga një bindje e thellë për shenjtërinë e punës, njerëz të veçantë kanë përballur besnikërisht një sfidë që dukej sikur të përpiqeshe të korrje vetëm të gjithë grurin në Nebraskë. Tani, shumë makina korrëse janë në punë. Së bashku, ne mundemi dhe do ta kryejmë punën e kërkuar.

Unë dëshmoj se Shpirti i Elijas po prek zemrat e shumë fëmijëve të Atit në mbarë botën, duke bërë që puna për të vdekurit të përshpejtohet me një ritëm të pashembullt.

Po ju? A jeni lutur për punën e vetë paraardhësve tuaj? Lërinë mënjane ato gjëra në jetën tuaj që nuk kanë vërtet

rëndësi. Vendosni të bëni diçka që do të ketë pasoja të përjetshme. Ndoshta jeni nxitur të kërkoni paraardhës, por ndieni se nuk jeni ekspert në historinë familjare. A mund ta shihni se nuk ju duhet më të jeni i tillë? Gjithçka fillon me dashuri dhe një dëshirë të sinqertë për t’i ndihmuar ata që janë përtej velit, të cilët nuk mund të ndihmojnë veten. Kontrolloni përreth. Do të jetë dikush në zonën tuaj që mund t’ju ndihmojë të keni sukses.

Kjo punë është një punë shpirtërore, një përpjekje monumentale bashkëpunimi në të dyja anët e velit, ku ndihma jepet në të dy drejtimet. Kudo që të jeni në botë, me lutje, besim, vendosmëri, zell dhe njëfarë sakrifice, ju mund të jepni një kontribut të fuqishëm. Filloni tani. Unë ju premtoj se Zoti do t’ju ndihmojë të gjeni një mënyrë. Dhe do t’ju bëjë të ndiheni shkëlqyeshëm. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Gjoni 3:5.
2. *History of the Church*, 4:231.
3. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2007), f. 504.
4. Shih Doktrina e Besëlidhje 110:13–16.
5. Doktrina e Besëlidhje 2:2; theksimi i shtuar.
6. Howard W. Hunter, “A Temple-Motivated People”, *Liahona*, maj 1995, f. 5–6.
7. Letër e Presidencës së Parë, 29 shkurt 2012; theksimi i shtuar.
8. Jeanene Watkins Scott, ditari personal, prill 1988.
9. Jeanene Watkins Scott, ditari personal, 23 shtator 1989.



Nga Rasëll T. Osguthorp,
President i Përgjithshëm i Shkollës të së Dielës

Një Hap më Pranë Shpëtimtarit

Kthimi në besim është synimi i të gjithë të nxëniet dhe mësimdhënies së ungjillit. Kthimi në besim nuk është një ngjarje që ndodh vetëm njëherë. Të bëhesh më shumë si Shpëtimtari është një synim për të gjithë jetën.

Këtë verë që shkoi, u shfaq te revistat *Liahona* dhe *Ensign* një artikull i shkurtër që e kisha shkruar unë. Im bir më dërgoi një mesazh elektronik ku thuhej: “Babi, mbase do ishte mirë të na njoftoje kur të botohet një artikull”. Iu përgjigja: “Doja të shihja nëse po i lexoni revistat e Kishës”. Ai më shkroi sërish duke shpjeguar se e bija 10-vjeçare e kishte “kaluar provën. Ajo e mori revistën *Ensign* nga kutia postare, u fut në shtëpi dhe e lexoi atë. Pastaj ajo erdhi në dhomën tonë dhe na tregoi artikullin tënd.”

Mbesa ime e lexoi revistën *Ensign* sepse kishte dëshirë të mësonte. Ajo veptoi në mënyrë të pavarur duke ushtruar zgjedhjen e saj të lirë. Presidenca e Parë miratoi së fundi burime të reja të të nxëniet për të rinjtë, që do të mbështesin dëshirën e natyrisht të rinjve për ta mësuar, për ta jetuar dhe për ta ndarë ungjillin. Këto burime të reja janë të disponueshme për t'i shqyrtuar në internet. Në janar do të fillojmë t'i përdorim burimet në orët mësimore. (Mësoni më shumë për burimet e reja të të nxëniet për

rininë në adresën [lds.org/youth/learn](https://www.lds.org/youth/learn).)

Kur jepte mësim Shpëtimtari, liria e zgjedhjes së nxënies kishte epërsi. Ai na tregoi neve jo vetëm se çfarë të japim mësim, por edhe si të japim mësim. Ai përqendrohej te nevojat e nxënies. Ai i ndihmonte individët ta zbulonin vetë të vërtetën.¹ Ai i dëgjonte gjithnjë pyetjet e tyre.²

Këto burime të reja të të nxëniet do të na ndihmojnë të gjithëve të mësojmë dhe të japim mësim në mënyrën e Shpëtimtarit në shtëpitë dhe klasat tona.³ Kur e bëjmë këtë, ne do t'i përgjigjemi ftesës së Tij “eja e më ndiq”⁴ sikurse dha mësim aq bukur Plaku Robert D. Hejls. Teksa po zhvilloheshin këto burime të reja, unë shihja udhëheqës dhe mësues në organizatat ndihmëse dhe në këshillin e seminarit së bashku me prindërit në mënyrë që të përmbushnin nevojat e nxënësve të tyre. Kam parë të reja në orët e tyre mësimore, të rinj në kuorimet e tyre të Priftërisë Aarone dhe të rinj në Shkollën e së Dielës të mësojnë të ushtrojnë lirinë e tyre të

zgjedhjes dhe të vepronë në mënyrë të pavarur.

Një mësuese e rinisë në Shkollën e së Dielës po vriste mendjen se si t'i ndihmonte dy të rinj me autizëm që të ushtronin lirinë e tyre të zgjedhjes dhe të vepronin në mënyrë të pavarur. Kur ajo i ftoi anëtarët e klasës të tregonin atë që kishin mësuar, ajo u shqetësua se këta dy të rinj mund të mos e pranonin ftesën e saj. Por nuk e bënë. Njëri u ngrit në këmbë për të dhënë mësim atë që kishte mësuar dhe më pas e ftoi shokun e tij të klasës me autizëm që ta ndihmonte. Kur i pari niste të kishte vështirësi, shoku i tij i klasës i qëndronte pranë dhe i pëshpëriste në vesh në mënyrë që të ndiente se po ia dilte mbanë. Atë ditë ata po jepnin mësim që të dy. Ata po jepnin mësim atë që dha Shpëtimtari, por ata po jepnin mësim edhe në mënyrën se si e dha Shpëtimtari. Kur Shpëtimtari dha mësim, Ai veptoi prej dashurisë për individin të cilit po i jepte mësim, pikërisht ashtu siç bëri ky shok i klasës për mikun e tij.⁵

Kur e mësojmë dhe e japim mësim fjalën e Tij në mënyrën e Tij, ne e pranojmë ftesën e Tij: “Eja e më ndiq”. Ne e ndjekim Atë hap pas hapi. Me çdo hap, ne afrohemi më shumë me Shpëtimtarin. Ne ndryshojmë. Zoti e dinte se rritja shpirtërore nuk do të ndodhte e gjitha menjëherë. Ajo vjen gradualisht. Sa herë që ne e pranojmë ftesën e Tij dhe zgjedhim ta ndjekim Atë, ne përparojmë drejt shtegut të kthimit të plotë në besim.

Kthimi në besim është synimi i të gjithë të nxëniet dhe mësimdhënies së ungjillit. Kthimi në besim nuk është një ngjarje që ndodh vetëm njëherë. Të bëhesh më shumë si Shpëtimtari është një synim për të gjithë jetën. Plaku Dallin H. Oaks na ka kujtuar se nuk mjafton “të *dish*”. “Të qenit ‘të kthyer në besim’ . . . kërkon prej nesh që të bëjmë dhe të bëhemi.”⁶ Ndaj të

nxënit për kthimin në besim është një proces në vazhdimësi i të diturit, i të njohurit dhe i të bërit. Në të njëjtën mënyrë, mësimdhënia për kthimin në besim kërkon doktrinë kyçe, ftesa për veprim dhe bekime të premtuara.⁷ Kur ne japim mësim doktrinën e vërtetë, ne e ndihmojmë nxënësin të dijë. Kur i ftojme të tjerët për të vepruar, ne i ndihmojmë ata të bëjnë ose ta jetojnë doktrinën. Dhe kur vijmë bekimet që ka premtuar Zoti, ne ndryshohemi. Si Alma, ne mund të bëhemi krijesa të reja.⁸

Burimet e reja të të nxënit për rininë kanë një synim qendror: ta ndihmojnë rininë të kthehet në besim te ungjilli i Jezu Krishtit. Kohët e fundit pashë një të ri në një orë mësimore të rinisë në Shkollën e së Dielës tek e zbulonte vetë të vërtetën. Kur e vura re se ai po haste vështirësi për ta lidhur Shlyerjen me vetë jetën e tij, e pyeta nëse e kishte ndier ndonjëherë faljen. Ai u përgjigj: “Po, si atëherë kur i theva hundën një djali kur po luanim futboll. U ndieva keq për këtë. Pyesja veten se çfarë duhej të bëja që të ndihesha më mirë. Kështu shkova në shtëpinë e tij dhe i kërkova të më falte, por e dija se duhej të bëja më tepër se aq, ndaj u luta dhe më pas ndieva se edhe Ati Qiellor më fali. Kjo është ajo çka do të thotë Shlyerja për mua.”

Kur e ndau këtë përvojë në klasë atë ditë, ai lexoi nga Gjoni 3:16 – “Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin” – dhe më pas dëshmoi për fuqinë e Shlyerjes. Kjo doktrinë nuk qe më një koncept abstrakt për këtë të ri. Ajo u bë pjesë e jetës së tij, sepse ai e bëri vetë pyetjen e tij dhe më pas ushtroi lirinë e vet të zgjedhjes për të vepruar.⁹

Ky i ri po kthehej më shumë në besim dhe po kështu edhe shokët e tij të klasës. Ata u përqendruan te një doktrinë kyç duke studiuar shkrimet



e shenjta. Ata i lidhën ato fjalë të shenjta me vetë jetën e tyre dhe më pas dëshmuar për bekimet që u kishin ardhur si rezultat i të jetuarit të doktrinës. Kur ne e japim mësim ungjillin e Jezu Krishtit, ne përqendrohemi te shkrimet e shenjta dhe te fjalët e profetëve të kohëve të sotme. Ne mbështetemi në tekstin e shenjtë që të na ndihmojë të forcojmë besimin, të ndërtojmë dëshmitë dhe t'i ndihmojmë të gjithë të bëhen plotësisht të kthyer në besim. Burimet e reja të të nxënit për rininë do t'i ndihmojnë të gjithë ata që i përdorin ato për ta kuptuar e për ta jetuar fjalën e Perëndisë.

Ndërkohë që u jepja mësim shenjtorëve në Kosta-Rikë, unë ngrita lart një kopje të manualit *Teaching, No Greater Call [Mësimdhënia, s'Ka Thirrje më të Madhe]* dhe pyeta: “Pra, sa prej jush kanë një kopje të këtij manuali?” Pothuajse të gjithë ngritën dorën. Me një buzëqeshje, thashë: “Dhe vë bast se po e lexoni atë çdo ditë pa përjashtim”. Për habinë time, një motër në rreshtin e parë ngriti

dorën, duke treguar se po e lexonte atë përditë. I kërkova të vinte në podium dhe të shpjegohej. Ajo u përgjigj: “Unë e lexoj Librin e Mormonit çdo mëngjes. Pastaj lexoj diçka te manuali *Teaching, No Greater Call [Mësimdhënia, s'Ka Thirrje më të Madhe]* që të mund t'u mësoj fëmijëve të mi atë që sapo kam mësuar në mënyrën më të mirë të mundshme.”

Ajo dëshironte ta mësonte dhe ta jepte mësim fjalën e Tij në mënyrën e Tij, ndaj e studioje fjalën e Tij në shkrimet e shenjta dhe më pas studioje mënyrën se si ta jepte mësim fjalën e Tij në mënyrë që fëmijët e saj të mund të ktheheshin plotësisht në besim. Modeli i saj i të nxënit dhe i mësimdhënies së ungjillit nuk u krijua i gjithi menjëherë. Ajo mori një vendim për të bërë diçka. Dhe sa më shumë që bënte atë që e dinte se duhej bërë, aq më shumë e forcoi Zoti për të ecur në udhën e Tij.

Ndonjëherë shtegu drejt kthimit në besim mund të jetë i gjatë dhe i vështirë. Kunati im qe pak aktiv në Kishë për 50 vjet. Nuk qe deri në të gjashtëdhjetat e tij që ai nisi ta pranonte ftesën e Shpëtimtarit për t'u kthyer. Shumë njerëz e ndihmuan përgjatë udhës. Një mësues shtëpie i dërgonte një kartolinë çdo muaj për 22 vjet. Por atij iu desh të vendoste se dëshironte të kthehej. Ai duhej të ushtronte lirinë e tij të zgjedhjes. Ai duhej ta ndërmerre atë hap të parë – dhe pastaj një tjetër dhe një tjetër. Tani ai dhe bashkëshortja e tij janë vulosur së bashku dhe ai po shërben në një peshkopatë.

Së fundi ne i treguam atij videot që janë krijuar për t'i ndihmuar udhëheqësit dhe mësuesit që t'i vënë në zbatim burimet e reja të të nxënit. Pasi i pa videot, kunati im u mbështet prapa në karrige dhe më tha: “Ndoshta po t'i kisha pasur ato kur isha i ri, nuk do të isha bërë joaktiv”.



Athinë, Greqi

Disa javë më vonë, takova një të ri që kishte vështirësi. E pyeta nëse ishte anëtar i Kishës. Ai më tha se ishte dyshues për ekzistencën e Perëndisë por që herët në jetën e tij qe njohur me Kishën. Kur i tregova për thirrjen time në Shkollën e së Dielës dhe se do të flisja në konferencën e përgjithshme, ai tha: “Ej, nëse do të flasësh ti, unë do ta shikoj atë sesion”. Shpresoj se ai është duke e parë sot. E di se, nëse po shikon, ai ka mësuar diçka. Kjo qendër konferencash është një vend i pashoq i të nxënit dhe i mësimdhënies për kthimin në besim.

Kur i jetojmë parimet që na i kanë mësuar ata që i mbështesim si profetë, shikues dhe zbulues, ne mësojmë në mënyrën e Shpëtimtarit.¹⁰ Ne hedhim një hap më shumë drejt Tij. Teksa kjo konferencë shkon drejt përfundimit, i ftoj të gjithë që po e dëgjojnë zërin tim që ta hedhin atë hap. Sikurse nefitët

e lashtësisë, ne mund të kthehemi në “shtëpitë [tona] dhe të meditojmë] mbi gjërat që [janë] thënë dhe t'i kërkojmë] Atit, në emrin [e Tij], që të mund të kuptojmë]”.¹¹

Ne dëshirojmë që çdo i ri të kuptojë. Ne dëshirojmë që ata ta mësojnë, ta japin mësim dhe ta jetojnë ungjillin e Jezu Krishtit çdo ditë. Kjo është ajo që Zoti dëshiron për të gjithë fëmijët e Tij. Qoftë nëse jeni një fëmijë, një i ri, apo një i rritur, unë ju ftoj të vini e ta ndiqni në gjurmët e hapave të Tij. Unë dëshmoj që Zoti do të na forcojë në çdo hap që hedhim. Ai do të na ndihmojë të bëjmë pjesën tjetër të udhës. Pastaj, kur të dalin pengesa, ne do të vazhdojmë të ecim. Kur të lindin dyshime, ne do të vazhdojmë të ecim. Ne nuk do të kthehemi kurrë prapa. Ne nuk do të largohemi kurrë.

Unë dëshmoj se Perëndia, Ati, dhe Biri i Tij, Jezu Krishti, jetojnë. Unë

dëshmoj se Shpëtimtari vazhdon të na thërrasë pikërisht ashtu siç bëri në kohët e mëparshme që të vijmë tek Ai. Ne të gjithë mund ta pranojmë ftesën e Tij. Ne të gjithë mund ta mësojmë, ta japim mësim dhe ta jetojmë fjalën e Tij në mënyrën e Tij duke hedhur një hap më shumë drejt Shpëtimtarit. Teksa e bëjmë këtë, ne do të bëhemi vërtet të kthyer në besim. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Gjoni 3:1-7. Në këtë grup vargësh Shpëtimtari iu përgjigj pyetjes që shtroi vetë Nikodemi. Ai dha mësim sipas nevojave të Nikodemit. Ai e lejoi Nikodemin që të ushtronte lirinë e tij të zgjedhjes për të mësuar. Ai e ndihmoi Nikodemin ta zbulonte vetë përgjigjen.
2. Shih Gjoni 3:4; Joseph Smith—Historia 1:18.
3. Shih “Teaching the Gospel in the Savior’s Way,” lds.org/youth/learn/guidebook/teaching.
4. Shih Lluca 18:18-22.
5. Shih 1 Gjonit 4:19.
6. Dallin H. Oaks, “The Challenge to Become,” *Liahona*, janar 2001, f. 41: “Të dëshmosh është të *dish* dhe të *shpallësh*. Ungjilli na sfidon që të jemi ‘të kthyer në besim’, gjë që kërkon prej nesh që të *bëjmë* dhe të *bëhemi*. Nëse ndonjëri prej nesh mbështetet vetëm te njohuria dhe dëshmia jonë për ungjillin, ne jemi në të njëjtën pozitë si Apostujt e bekuar por ende jo të kthyer plotësisht në besim, të cilët Jezusi i sfidoi të ishin ‘të kthyer në besim’. Të gjithë e njohim dikë që ka një dëshmi të fortë por që nuk vepron mbi të në mënyrë që të bëhet i kthyer në besim.”
7. Shih Abrahami 2:11.
8. Shih Mosia 27:24-26; 2 Korintasve 5:17.
9. Shih David A. Bednar, “Duke Ndenjur Zgjuar . . . me Çdo Ngulmim” *Liahona*, maj 2010, f. 43: “Ju dhe unë, a po i ndihmojmë fëmijët tanë të bëhen veprues për veten, që veprojnë dhe kërkojnë të mësojnë me anë të studimit dhe me anë të besimit, apo i kemi trajnuar fëmijët tanë të presin që t’u jepet mësim dhe të pësojnë? Ne si prindër, a po u japim kryesisht fëmijëve tanë të hanë të barasvlerëshmin e peshkut shpirtëror, apo po i ndihmojmë ata vazhdimisht të veprojnë, të mësojnë për vete dhe të qëndrojnë të paepur dhe të palëvizshëm? A po i ndihmojmë fëmijët tanë të përfshihen me zell në pyetjen, kërkimin dhe trokitjen?”
10. Shih Dennis B. Neuschwander, “Living Prophets, Seers, and Revelators,” *Liahona*, janar 2001, f. 49-51.
11. 3 Nefi 17:3.



Nga Plaku Markus B. Nash,
i Të Shtatëdhjetëve

Me Anë të Besimit të Gjitha Gjërat Plotësohen

Besimi do të na ndihmojë t'i ngjitemi të sigurt shtegut të ungjillit, të mposhtim çdo sfidë të vdekshmërisë dhe të kthehemi në praninë madhështore të Atit tonë Qiellor.

J o shumë kohë më parë, disa prej nesh pjesëtarë të familjes Nash, u ngjitëm më këmbë deri në majë të Huajna-Piçut, një majë e lartë që është ngjitur me rrënojat e lashta të inkasve të Maçu-Piçut në malet e Perusë. Është një ngjitje shumë e thepisur me pamje spektakolare dhe pjerrësira të papritura. Trishtueshëm, disa njerëz që i janë ngjitur malit, kanë humbur jetën e tyre duke rënë nga ai shteg i ngushtë e i thepisur. Për të shmangur tragjedi të tilla, kablllo të forta u janë lidhur fort shkëmbinjtë masivë përgjatë shpatës së malit të Huajna-Piçut. Ne u mbajtëm tek ato kablllo ndërsa ngjiteshim lart, dhe ato na mundësuan që ta arrinim majën të sigurt, ku pamja ishte madhështore!

Ashtu si shtegu në Huajna-Piçu, udhëtimi ynë në vdekshmëri është një ngjitje e thepisur dhe e vështirë, një udhëtim që kërkon ndihmën e Atit tonë Qiellor për ta përfunduar me sukses. Për këtë arsye, Ai vendosi parimet dhe ordinancat e ungjillit për të na sjellë te Shpëtimtari dhe fuqia e Tij Shpëtuese.¹ I pari i atyre parimeve, besimi në Zotin Jezu Krisht,² është si kabllot në Huajna Piçu: nëse është i

lidhur fort dhe mirë “me shkëmbin e Shëlbuesit tonë”,³ besimi do të na ndihmojë t'i ngjitemi të sigurt shtegut të ungjillit, të mposhtim çdo sfidë të vdekshmërisë⁴ dhe të kthehemi në praninë madhështore të Atit tonë Qiellor. Me Anë të Besimit të Gjitha Gjërat Plotësohen.⁵

Besimi është parim edhe veprimi edhe fuqie.⁶ Ai “nuk është që të kesh një njohuri të përsosur të gjërave; prandaj, në qoftë se ke[m]li besim [ne] shpresoljmë për gjëra që nuk shihen, të cilat janë të vërteta”.⁷ Është një siguri⁸ e Shpirtit që fitohet nëpërmjet të mësuarit tonë që na bën të veprojme⁹ për të ndjekur shembullin e Shpëtimtarit dhe plot lutje të mbajmë urdhërimet e Tij, madje edhe gjatë kohëve të sakrificës dhe sprovës.¹⁰ Besimi na sjell fuqinë e Zotit, e cila – midis gjërave të tjera – shfaqet me anë të shpresës se gjëra të mira do vijnë,¹¹ mrekullive që pohojnë besimin tonë,¹² dhe mbrojtjes hyjnore në çështje shpirtore dhe të përkohshme.¹³

Jeta e En Raulit, një grua pioniere në ditët e hershme të Kishës, provon se si ushtrimi i besimit ndikon për mirë në jetën tonë. E ve nga Anglia,

motra Rauli ushtroi besimin e saj për t'iu përgjigjur thirrjes së profetit për t'u mbledhur në Sion. Ajo ishte anëtare e kompanisë Uilli të karrocave të dorës që u ndesh me sasi të mëdha dëbore përgjatë udhës, në vjeshtën e vitit 1856. Ata kishin arritur një pikë të tillë në udhëtim ku të shtatë fëmijët e saj vërtet po vuanin urie. Ajo shkroi: “Më lëndon t'i shoh fëmijët e mi të uritur. . . . Nata po vinte dhe nuk kishte ushqim për vaktin e mbrëmjes. Kërkova ndihmën e Perëndisë siç bëja gjithmonë. U ula në gjunjë, duke kujtuar dy galeta të forta që . . . kishin mbetur nga udhëtimi në det. Ato nuk ishin të mëdha dhe ishin kaq të forta sa as nuk mund të copëtoheshin. Sigurisht, ato nuk ishin të mjaftueshme për të ushqyer 8 njerëz, por as 5 bukët dhe 2 peshqit nuk ishin të mjaftueshëm për të ushqyer 5.000 njerëz, por nëpërmjet një mrekullie, Jezusi e bëri atë. Kështu, me ndihmën e Perëndisë, asgjë s'është e pamundur. I gjeta galetat dhe i vendosa në një tenxhere që përdoret për gatim të ngadaltë, dhe i mbulova me ujë, dhe kërkova bekimin e Perëndisë. Më pas, vendosa kapakun mbi tenxhere dhe e vura mbi qymyr. Pak më vonë, kur hoqa kapakun, e gjeta tenxheren të mbushur me ushqim. U gjunjëzova me familjen time dhe e falënderova Perëndinë për mirësinë e Tij. Atë natë familja ime pati ushqim të mjaftueshëm.”¹⁴

En Rauli po e jetonte ungjillin me sakrificë të mëdha personale. Pati nevojë për ndihmë dhe e kërkoi atë në lutje. Për shkak të besimit të saj, ajo u mbush me shpresë dhe u furnizua mrekullisht me ushqim për familjen e saj. Zoti e bekoji atë gjithashtu me aftësinë përjetësisht domethënëse për të “dur[uar] në besim deri në fund”.¹⁵ Pavarësisht nga një e ardhme e pasigurt, ajo nuk kërkoi të dinte se si do t'i ushqente fëmijët e saj ditën tjetër; në vend të kësaj, ajo me

durim “shpresof[i] te Zoti”¹⁶ dhe shkoi përpara me shpresë – ashtu siç thotë himni i bukur:

*Drit’ më drejto përmes territ rrethues;
Ti më drejto!*

*Nata e errët dhe larg shtëpis’
ndodhem; Ti më drejto!*


*Mos më rrëzo; Të shoh nuk po kërkoj
Vendin e larg’t – një hap për mua
mjafton.*¹⁷

Edhe ne mund të ushtrojmë besim të tillë në Zotin, duke besuar dhe mirëbesuar që Perëndia ynë i mirë dhe i pandryshueshëm¹⁸ do të na bekojë me fuqinë e Tij të mrekullueshme, të përshtatshme për rrethanën tonë, sipas kohës së Tij. Kur veprojmë kështu, edhe ne do të shohim dorën e Perëndisë të shfaqet në jetën tonë.

Zoti na urdhëron të marrim “mburojën e besimit, me të cilën mund të shua[im] të gjitha shigjetat e zjarra të të ligut”.¹⁹ Satani do të përdorë gjëra të tilla si dyshim, frikë ose mëkat për të na tunduar ta braktisim besimin dhe të humbasim mbrojtjen që na ofron ai. Le të shqyrtojmë secilën prej këtyre sfidave të besimit një nga një, kështu që të mund të njohim dhe të mos ua vëmë veshin tundimeve të kundërshtarit.²⁰

Së pari, mosbesimi në Zotin apo ungjillin e Tij, do të na bëjë ta kundërshtojmë Shpirtin e Perëndisë.²¹ Kundërhelmi i Zotit për dyshimin është i thjeshtë. Ashtu siç shpalli mbreti Beniamin: “Besoni në Perëndinë; besoni se ai është dhe se ai krijoi të gjitha gjërat, si në qiell ashtu edhe në tokë; besoni se ai ka të gjithë diturinë dhe të gjithë fuqinë, si në qiell ashtu edhe në tokë; besoni se njeriu nuk i kupton të gjitha gjërat që Zoti mund të kuptojë”²².

Nëse, për shkak të mosbesimit apo të dyshimit, ju e shikoni besimin tuaj të lëkundet, kujtoni që edhe Apostujt



e lashtë iu përgjëruan Zotit “[t’u] shtof[inte] besimin”²³. Duke mbajtur në mendje që besimi dhe arsyeja janë shoqërues të nevojshëm, merrni parasysh analogjinë vijuese: besimi dhe arsyeja janë si dy krahët e një aeroplani. Të dy janë të nevojshëm për ta mbajtur në fluturim. Nëse nga këndvështrimi juaj, arsyeja duket sikur bie në kontrast me besimin, ndaloni dhe kujtoni që këndvështrimi ynë është jashtëzakonisht i kufizuar krahasuar me atë të Zotit.²⁴ Mos e flakni besimin ashtu siç nuk do ta shkëpusnit një krah nga aeroplani gjatë fluturimit. Përkundrazi, ushqjeni një pjesëz të besimit dhe lëreni shpresën që ai jep, për të qenë një spirancë për shpirtin tuaj – dhe për arsyen tuaj.²⁵ Ja pse jemi urdhëruar të “kërkojmë” të mësojmë, . . . me anë të studimit *dhe gjithashtu me anë të besimit*.²⁶ Kujtoni, besimi u paraprin dhe bën mrekulli për gjërat që ne nuk kemi një shpjegim të menjëhershëm me njohurinë që kemi fituar përmes vetë përvojave tona, të tillë si një tenxhere plot me ushqim nga dy galeta të vogla ose thjesht durimi me besim kundër të gjitha mundësive.²⁷

Së dyti, frika na heq vëmendjen dhe e dobëson besimin në Shpëtimtarin. Apostulli Pjetër një natë të stuhishme, pa tek Zoti dhe eci mbi ujë – derisa hoqi vështrimin e tij dhe “duke parë erën e fortë, [dhe] kishte frikë” dhe pastaj u fundos në detin e stuhishëm.²⁸ Ai mund të kishte

vazhduar të ecte nëse nuk do të kishte pasur frikë! Në vend që të përqendrohemi dhe të kemi frikë nga era dhe dallgët e forta në jetën tonë, Zoti na fton: “shihni tek unë në çdo mendim; mos dyshoni, mos kini frikë”²⁹.

Së treti, mëkati dobëson praninë e Shpirtit në jetën tonë dhe, pa Frymën e Shenjtë, neve do të na mungojë qëndrueshmëria shpirtërore për t’u mbajtur te besimi dhe për ta ushtruar atë. Më e mira do të ishte ta ushtrojmë besimin tonë që të “mos prek[im] dhuratën e ligë, as gjënë e papastër”³⁰ dhe që të “[lemi] të zellshëm në mbajtjen e të gjitha urdhërimeve . . . , përndryshe . . . besimi [ynë] do të mpaket dhe armiq të [tanë] do të triumfojnë”³¹. Nëse mëkati ka njetosur jetën tuaj, unë ju ftoj për të ushtruar “besim deri në pendim”,³² dhe Shpëtimtari, nëpërmjet Shlyerjes, do ta pastrojë dhe shërojë jetën tuaj.

Vëllezër dhe motra, Zoti, sipas besimit tonë, do t’i përmbushë premtimet e Tij dhe do të punojë me ne për të mposhtur çdo sfidë.³³ Ai e bëri këtë për En Raulin dhe ka bërë kështu për popullin e Tij në të gjitha kombet dhe në çdo periudhë e brez. Për shkak se Ai është një “Perëndi mrekullish” dhe “nuk ndryshon”, Ai po ashtu do ta bekojë secilin prej nesh me shpresën, mbrojtjen dhe fuqinë sipas besimit tonë në Të.³⁴ Besimi i patundur në Zotin Jezu Krisht – si kabllot në shtegun e Huajna-Piçut – do t’ju ankorojë ju dhe të dashurit tuaj “në shkëmbin e Shëlbuesit tonë”³⁵ dhe të fuqisë së Tij të pakrahasueshme për të na shpëtuar.

Presidenti Tomas S. Monson ka thënë: “E ardhmja është po aq e ndritur sa besimi juaj”³⁶. Unë ju dëshmoj për atë të vërtetë madhështore e plot shpresë dhe ftoj secilin prej nesh të shkojë përpara me besim në Zotin, “pa dyshuar”³⁷. E di që Shpëtimtari jeton, që është “autori dhe plotësuesi i besimit

[tonë],³⁸ dhe “shpërblenjësi i atyre që e kërkojnë atë”³⁹. Unë dëshmoj kështu në emër të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:19–21.
2. Shih Nenet e Besimit 1:14.
3. Helamani 5:12.
4. Shih Doktrina e Besëlidhje 76:53.
5. Shih Ethëri 12:3.
6. Shih *Lectures on Faith* (1985), f. 3; shih edhe Jakobi [LiM] 4:6; Ethëri 12:7–22; Hebrejve 11:4–40.
7. Alma 32:21.
8. Shih Joseph Smith Translation, Hebrejve 11:1 (në Hebrejve 11:1, shënimi në fund b).
9. Shih 2 Nefi 25:23; Alma 34:15–17; Ethëri 12:6; Jakobi [Bibël] 2:17–26.
10. Shih Ethëri 12:4–6; *Lectures on Faith*, f. 69.
11. Shih Moroni 7:40–42.
12. Shih Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Besim”; shih edhe Mormoni 9:8–21; Moroni 7:33–37.
13. Shih Doktrina e Besëlidhje 27:17; Alma 57:19–27; 58:10–13.
14. Ann Rowley, në Andrew D. Olsen, *The Price We Paid: The Extraordinary Story of the Willie and Martin Handcart Pioneers* (2006), f. 113.
15. Doktrina e Besëlidhje 20:25.
16. Isaia 40:31.
17. “Lead, Kindly Light” [“Drit, Më Drejto”], *Hymns*, nr. 97.
18. Shih Jakobi [LiM] 4:10; Mormoni 9:9.
19. Doktrina e Besëlidhje 27:17; kursivet shtuar.
20. Shih 1 Nefi 8:33–34; Alma 37:33; Doktrina e Besëlidhje 20:22.
21. Shih Alma 32:28.
22. Mosia 4:9.
23. Lluka 17:5.
24. Shih Mosia 4:9–10; Fjalët e Urta 3:5–7; Isaia 55:8–9.
25. Shih Ethëri 12:4.
26. Doktrina e Besëlidhje 88:118; kursivet shtuar.
27. Shih Moroni 7:33–38; Ethëri 12:19.
28. Shih Mateu 14:25–31.
29. Doktrina e Besëlidhje 6:36.
30. Moroni 10:30.
31. Doktrina e Besëlidhje 136:42.
32. Shih Alma 34:15–17; shih edhe Ethëri 12:3.
33. Shih Ethëri 12:29; Alma 7:27.
34. Shih Mormoni 9:18–21; shih edhe Moroni 7:33–38; Alma 37:16–17.
35. Helamani 5:12.
36. Thomas S. Monson, “Merrni Zemër”, *Liahona*, Maj 2009, f. 92.
37. Shih Jakobi [Bibël] 1:6–8.
38. Moroni 6:4; shih edhe Hebrejve 12:2.
39. Hebrejve 11:6; shih edhe Ethëri 12:41.



Nga Plaku Daniel L. Xhonsón,
i Të Shtatëdhjetëve

Duke u Bërë Dishepull i Vërtetë

Ndërsa u bindemi urdhërimeve të Tij dhe u shërbejmë bashkëgenieve tona, ne bëhemi dishepuj më të mirë të Jezu Krishtit.

A ta prej nesh që kanë hyrë në ujërat e pagëzimit dhe kanë marrë dhuratën e Frymës së Shenjtë, kanë bërë besëlidhje se janë të gatshëm të marrin mbi vete emrin e Jezu Krishtit, ose me fjalë të tjera, ne shpallim se jemi dishepuj të Zotit. Ne e përtërijmë atë besëlidhje çdo javë kur marrim sakramentin dhe e tregojmë atë dishepullim nëpërmjet mënyrës se si jetojmë. Një dishepullim i tillë u demonstrua bukur në ngjarjet e fundit në Meksikë.

Kishte qenë një pranverë e bukur për komunitetet e rritjes së frutave në Meksikën veriore. Pemët frutore patën çelur plotësisht dhe shpresat qenë të larta për një vjelje të bollshme. Planet tashmë qenë duke u bërë për të shlyer huatë, për të zëvendësuar pajisjet e domosdoshme e pemishtet frutore të vjetruara dhe për të plotësuar detyrimet financiare vetjake të tilla si pagesat e shkollës për pjesëtarët e familjes. Madje qenë duke u bërë plane për pushimet me familjen. Kishte një atmosferë të përgjithshme optimizmi. Më pas, një pasdite të hëne, nga fundi i marsit, erdhi një shtërëngatë dimërore dhe filloi të binte borë. Ra borë deri në afro tre të

mëngjesit. Më pas, kur retë u larguan, temperaturat ranë menjëherë. Përgjatë natës dhe në të gdhirë, u bë çdo përpjekje për të shpëtuar të paktën një pjesë të prodhimeve frutore. Nuk mund të bëhej asgjë. Thjesht u bë shumë ftohtë dhe prodhimet ngrinë plotësisht. Nuk do të kishte asnjë frutë që të vilej dhe të shitej këtë vit. Dita e martë zbardhi me humbjen e papëlqyeshme dhe dëshpëruese të të gjithë atyre planeve, shpresave dhe ëndrrave të mrekullueshme të vetëm një dite më parë.

Unë mora një mesazh elektronik në lidhje me atë mëngjes të tmerrshëm të së martës nga Sandra Heç, bashkëshortja e Xhon Heçit, atëherë këshilltar i parë në presidencën e Tempullit të Kolonia-Huarezit të Çiuauas. Po citoj pjesë të atij mesazhi elektronik: “Xhoni u ngrit herët – rreth orës 06:30 të mëngjesit – për të udhëtuar drejt tempullit që të shihte nëse duhet ta anulonim sesionin këtë mëngjes. Ai u kthye duke thënë se vendi i parkimit dhe rruga ishin të pastra nga bora, ndaj vendosëm të vazhdonim. Menduam se ndoshta disa nga punonjësit që nuk kishin pemishte frutore do të vinin, dhe mund t’i përfshinin të gjithë

punonjësit në sesion. . . . Ishte aq frymëzuese t'i shihje njerëzit të hynin, njëri pas tjetrit. Ja tek ishin, pa gjumë fare dhe duke menduar që prodhimet e tyre ishin çuar dëm. . . . Po i vëzhgoja gjatë takimit tonë përgatitor dhe e kishin të vështirë të qëndronin zgjuar. Po në vend që të mendonin se kishin justifikim të mirë për të mos ardhur, ata ishin atje. Dhe kishte 38 njerëz në sesion (një sesion i plotë)! Ishte një mëngjes lartësues për ne dhe falënderuam Atin Qiellor për njerëzit e mirë që e kryejnë detyrën e tyre, pavarësisht se çfarë ndodh. Ndieva një shpirt të veçantë atje këtë mëngjes. Jam e sigurt se Ai ishte i kënaqur të dinte se e duam shtëpinë e Tij dhe e ndiem se ishte një vend i bukur për të shkuar në një mëngjes të tillë të vështirë.”

Historia nuk përfundon këtu dhe faktikisht ende po vazhdon.

Shumica e atyre që humbën prodhimet e tyre frutore, kishin pak tokë të disponueshme në të cilën të mbillnin prodhime të tjera për stinën, si spec djegës apo bathë. Këto prodhime mund të siguronin të paktën pak të ardhura në para, të mjaftueshme për

të mbijetuar deri pas prodhimeve frutore të vitit të ardhshëm. Megjithatë, ishte një vëlla i dashur me një familje të re, që nuk kishte tokë tjetër, dhe po përballonte një vit pa kurrfarë të ardhurash vjetore. Njerëz të tjerë në komunitet, duke parë gjendjen e skajshme të këtij vëllai dhe duke vepruar me nismën dhe shpenzimet e tyre vetjake, i rregulluan një copë tokë, përdorën pajisjet e tyre për ta përgatitur tokën dhe siguruan farat e specave djegës që ai t'i mbillte.

I njoh njerëzit për të cilët sapo kam folur. Ngaqë i njoh, nuk u habita për atë që bënë. Por ata të cilët nuk i njohin me siguri do të jenë duke bërë dy pyetje, të dyja që fillojnë me fjalën *përse*. Përse do të vinin në tempull për të përmbushur detyrat e tyre dhe për të shërbyer pasi kishin qenë zgjuar gjatë gjithë natës, veçse për të arritur në përfundimin se kishin humbur pjesën më të madhe të burimeve të tyre të të ardhurave për të gjithë vitin? Përse do të përdornin ato që tanimë ishin burime të kufizuara dhe tepër të çmuara për të ndihmuar dikë në nevojë të skajshme, kur ata vetë qenë tani në të tilla vështirësi të tmerrshme financiare?

Nëse e kuptoni se çfarë do të thotë të jesh dishepull i Jezu Krishtit, atëherë do ta dini përgjigjen e këtyre dy pyetjeve.

Bërja e besëlidhjes për të qenë dishepull i Krishtit është fillimi i një procesi që zgjat gjithë jetën, dhe udha nuk është gjithnjë e lehtë. Ndërsa pendohemi për mëkatet tona e orvatemi të bëjmë atë që Ai do të donte që të bënim dhe u shërbejmë bashkëqenieve tona sikurse do t'u shërbente Ai, ne pashmangshmërisht do të bëhemi më shumë si Ai. Të bërit si Ai dhe të qenit një me Të është qëllimi dhe synimi përfundimtar – dhe në thelb përkufizimi i përpiktë i dishepullimit të vërtetë.

Ndërsa Shpëtimtari i pyeti dishepujt e Tij kur vizitoi kontinentin amerikan: “Prandaj, çfarë lloj njerëzish duhet të jeni?” Dhe pastaj, duke iu përgjigjur vetë pyetjes së Tij, Ai tha: “Në të vërtetë, unë ju them juve, madje siç jam unë” (3 Nefi 27:27).

Nuk është detyrë e lehtë të bëhesh si Shpëtimtari, veçanërisht në botën në të cilën jetojmë. Ne hasim pengesa dhe vështirësi pothuaj çdo ditë të jetës sonë. Ka një arsye për këtë dhe ajo është një nga qëllimet kryesore të vdekshmërisë. Ashtu si lexojmë tek Abrahami 3:25: “Dhe ne do t'i provojmë me këtë, për të parë nëse ata do t'i bëjnë të gjitha gjërat që Zoti, Perëndia i tyre, do t'i urdhërojë”.

Këto prova apo sprova ndryshojnë për nga natyra dhe fuqia. Por askush nuk do të largohet nga kjo ekzistencë në vdekshmëri pa i provuar ato. Përgjithësisht, ne i përfytyrojmë sprovat të jenë gjëra të tilla si humbje të prodhimeve apo të një vendi pune; vdekja e një të dashuri; sëmundje; paafësi fizike, mendore apo emocionale; varfëri ose humbje e miqve. Megjithatë, edhe arritja e objektivave, në dukje me vlerë, mund të sjellë vetë rreziqet e krenarisë së padobishme, ku ne aspirojmë më shumë për nderet e njerëzve sesa për miratimin e qiellit. Këto mund të përfshijnë popullaritetin e botës, famën publike, aftësitë e mëdha fizike, talentin artistik ose sportiv, të qenit i suksesshëm dhe pasuritë. Lidhur me këto sprova të fundit, disa prej nesh mund të kenë ndjenja të ngjashme me ato të shprehura nga Tevi në *Fiddler on the Roof* [Violinisti mbi Çatit]: Nëse pasuritë janë mallkim, “[Perëndia] më goditë me të. Dhe mos e marrsha veten kurrë!”¹

Por këto lloje të fundit të sprovave mund të jenë edhe më frikësuese e të rrezikshme dhe më të vështira për t'u mposhtur sesa të parat. Dishepullimi ynë do të rritet dhe do të provohet jo



nga llojet e sprovave që hasim, por nga mënyra se si i durojmë ato. Ashtu si jemi mësuar nga Presidenti Henri B. Ajring: “Kështu, prova e madhe e jetës është të shohim nëse ne do t’ia vëmë veshin dhe do t’u bindemi urdhërimeve të Perëndisë në mes të stuhive të jetës. Nuk është që të durojmë stuhitë, por të zgjedhim të drejtën kur ato shtohen. Dhe tragjedia e jetës është të dështosh në këtë provë dhe kështu dështon për t’u kualifikuar për t’u kthyer me lavdi në shtëpinë tonë qiellore” (“Spiritual Preparedness: Start Early and Be Steady”, *Liahona*, nëntor 2005, f. 38, “Përgatitja Shpirtërore: Fillo Herët dhe Ji i Qëndrueshëm”, Konferenca e Përgjithshme, tetor 2005 (nr. art. 00075 101), f. 53).

Jam gjyshi krenar i 23 nipërve dhe mbesave. Ata asnjëherë nuk reshtin së më mahnituri me kuptueshmërinë e tyre për të vërtetat e përgjithshme, edhe në moshën e tyre shumë të hershme dhe delikate. Teksa po përgatitesha për këtë bisedë, i kërkova secilit prej tyre të më dërgonte një përkufizim shumë të shkurtër të asaj se çfarë do të thotë të jesh dishepull ose ndjekës i Jezu Krishtit. Mora përgjigje të mrekullueshme nga të gjithë ata. Por do të doja të ndaja me ju këtë përgjigje nga Beniamini tetë vjeçar: “Të jesh dishepull i Jezu Krishtit do të thotë të jesh shembull. Do të thotë të jesh misionar dhe të përgatitesh për të qenë një misionar. Do të thotë t’u shërbesh të tjerëve. Do të thotë t’i lexosh shkrimet e shenjta dhe të bësh lutje vetjake. Do të thotë që e mban të shenjtë ditën e Shabatit. Do të thotë që ua vëshin nxitjeve të Frymës së Shenjtë. Do të thotë të shkosh në kishë dhe të shkosh në tempull.”

Jam dakord me Beniaminin. Dishepullimi ka të bëjë me gjithçka që bëjmë dhe çfarë po bëhemi. Ndërsa u bindemi urdhërimeve të Tij dhe u



shërbejmë bashkëqenieve tona, ne bëhemi dishepuj më të mirë të Jezu Krishtit. Bindja dhe nënshtimi ndaj vullnetit të Tij do të sjellin shoqërimin e Frymës së Shenjtë, së bashku me ato bekime të paqes, gëzimit dhe sigurisë, që gjithmonë e shoqërojnë këtë anëtar të tretë të Kreut-Perëndi. Ato nuk mund të vijnë në asnjë mënyrë tjetër. Përfundimisht, është nëpërmjet nënshtimit të plotë ndaj vullnetit të Tij që na ndihmon të bëhemi siç është Shpëtimtari ynë. Sërish, të bërit si Ai dhe të qenit një me Të është qëllimi dhe synimi përfundimtar – dhe në thelb përkufizimi i përpiktë i dishepullimit të vërtetë.

Dishepullimi është ajo që pashë të praktikohej në Tempullin e Kolonia-Huarezit dhe në zonat fqinje me të, kur vëllezërit dhe motrat nga Kisha ripohuan zotimet e tyre ndaj Perëndisë dhe njëri-tjetrit pavarësisht fatkeqësisë shpirtcoptuese.

Unë dëshmoj se kur u bindemi urdhërimeve të Tij, u shërbejmë të tjerëve dhe ia nënshtrojmë vullnetin tonë vullnetit të Tij, ne do të bëhemi, me të vërtetë, dishepuj e Tij të vërtetë. Unë dëshmoj për këtë në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

NOTE

1. Shih Joseph Stein, Jerry Bock, Sheldon Harnick, *Fiddler on the Roof* (1964), f. 61.



Nga Plaku Don R. Klark,
i Të Shtatëdhjetëve

Bekimet e Sakramentit

Ne do të bekohemi kur ndiejmë mirënjohje për Shlyerjen e Jezu Krishtit, përtërijmë besëlidhjet tona të pagëzimit, ndiejmë falje dhe marrin frymëzim nga Fryma e Shenjtë.

Urrita në Reksburg të Ajdahos, ku u ndikova dhe u mësova nga një familje, miq, mësues dhe udhëheqës të mrekullueshëm. Në jetën e gjithsecilit prej nesh ka përvoja të veçanta që prekin shpirtat tanë dhe i ndryshojnë gjërat përgjithmonë. Një përvojë e tillë më ndodhi në rini. Kjo përvojë e shndërroi jetën time.

Gjithmonë kam qenë aktiv në Kishë dhe përparova në klasën e Priftërisë Aarone. Kur isha adoleshent, vëllai Xheikobs, mësuesi im, kërkoi që unë të shkruaja në një letër atë që kisha menduar gjatë sakramentit. Mora letrën dhe fillova të shkruaja. E para në listë ishte ndeshja e basketbollit që kishim fituar mbrëmjen e kaluar. Dhe më pas vinte dalja në një takim pas ndeshjes, dhe gjëra të tilla të ngjashme u renditën në letër. Emri i Jezu Krishtit ishte renditur shumë më poshtë dhe pa dyshim jo me shkronja të theksuara.

Çdo të diel plotësonim letrën. Për një mbajtës të ri të Priftërisë Aarone, sakramenti dhe mbledhja e sakramentit tani kishin një kuptim tjetër, të gjerë dhe shpirtëror. Unë i prisja me padurim të dielat dhe mundësinë për të marrë sakramentin, ndërsa kuptimi për Shlyerjen

e Shpëtimtarit po më ndryshonte. Çdo të diel deri sot e kësaj dite, kur marr sakramentin, unë mund të shoh letrën time dhe të shqyrtoj listën time. Gjithmonë në listën time tani, para së gjithash, është Shpëtimtari i njerëzimit.

Te Dhiata e Re lexojmë për kohën kur Shpëtimtari dhe apostujt e Tij u takuan në dhomën e sipërme për festën e Pashkës.

“Pastaj mori bukën, falënderoi, e theu dhe ua dha atyre duke thënë: ‘Ky është trupi im, që është dhënë për ju; *bëni këtë në përkujtimin tim*’.

Po kështu, pas darkës, mori kupën duke thënë: ‘Kjo kupë është besëlidhja e re në gjakun tim, *që është derdhur për ju*’.”¹

Jezusi gjithashtu filloi ordinancën e sakramentit gjatë vizitës së Tij te nefitët.² Kam arritur të di rëndësinë e këtyre dy ngjarjeve.

Presidenti Dejvid O. Mek-Kei tha: “Ndihem i nxitur të theksoj atë që Zoti ka përcaktuar si mbledhjen më të rëndësishme në Kishë, dhe ajo është mbledhja e sakramentit”³. Nëse përgatitemi siç duhet për sakramentin, ne mund ta ndryshojmë jetën tonë. Dëshiroj të sugjeroj pesë parime që mund të bekojnë jetën tonë kur e marrin sakramentin denjësisht.

I. Kini një Ndjenjë Mirënjohjeje për Shlyerjen e Jezu Krishtit

Parimi i parë është të kemi një ndjenjë mirënjohjeje ndaj Atit Qiellor gjatë sakramentit për Shlyerjen e Birit të Tij. Historia në vijim tregohet për shpërndarjen e sakramentit:

“Sakramenti në të vërtetë asnjëherë nuk kishte shumë domethënie për mua deri të dielën që u shugurova dhjak. Atë pasdite unë shpërndava sakramentin për herë të parë. Përpara mbledhjes, një nga dhjakët më paralajmëroi: ‘Kij kujdes vëllanë Shmid. Do të duhet ta zgjosh nga gjumi!’ Më në fund erdhi koha për mua që të merrja pjesë në shpërndarjen e sakramentit. I përballova shumë mirë gjashtë rreshtat e parë. Fëmijët dhe të rriturit e morën bukën pa ndonjë vëmendje apo problem të dukshëm. Më pas mbërrita te rreshti shtatë, rreshti ku ulej gjithnjë vëllai Shmid. Por u befasova. Në vend që të ishte i përgjumur, ai ishte plotësisht syhapur. Ndryshe nga shumë të tjerëve që u kisha shërbyer, ai e mori bukën nga sa u duk me mendim dhe nderim të madh.

Pak minuta më vonë u gjenda sërish duke iu afruar rreshtit shtatë me ujin. Këtë herë miku im kishte të drejtë. Vëllai Shmid që ulur me kokën e përkulur dhe sytë e tij të mëdhenj gjermanë të mbyllur. Dukej sikur po bënte gjumë të thellë. Çfarë mund të bëja apo të thosha? Për një çast pashë ballin e tij, të rrudhosur dhe të veshur nga vite rraskapitjeje dhe mundimi. Ai ishte bashkuar me Kishën që në adoleshencë dhe kishte përjetuar shumë përndjekje në qytetin e tij të vogël gjerman. E kisha dëgjuar historinë shumë herë gjatë mbledhjes së dëshmive. Unë vendosa përfundimisht ta shtyja me butësi shpatullën e tij me shpresën që ta zgjoja. Teksa u zgjata për ta bërë këtë, koka e tij u ngrit ngadalë. Nëpër faqet e tij po rridhnin lot,

dhe kur pashë sytë e tij unë mund të shihja dashuri e gëzim. Ai pa zhurme u zgjat dhe mori ujin. Ndonëse atëherë isha vetëm dymbëdhjetë vjeç, ende mund ta kujtoj qartë ndjenjën që kisha ndërsa pashë këtë burrë të thyer e të rrudhosur të merrte sakramentin. E dija pa mëdyshje se ai po ndiente diçka rreth sakramentit që unë nuk e kisha ndier kurrë. Atëherë vendosa se dëshiroja të ndieja po ato ndjenja.”⁴

Vëllai Schmid kishte komunikuar me qiellin dhe qielli kishte komunikuar me të.



II. Kujtoni se po Përtërijmë Besëlidhjet e Pagëzimit

Parimi i dytë është të kujtoni se, kur marrim sakramentin, po përtërijmë besëlidhjet tona të pagëzimit. Disa prej premtimeve që bëjmë, siç shkruhen në shkrimet e shenjta, përfshijnë:

“Të hyni në grigjën e Perëndisë dhe të quheni populli i tij, . . . të mbani barrat e njëri-tjetrit . . . , të vajtoni me ata që vajtojnë . . . , dhe të qëndroni si dëshmitarë të Perëndisë”⁵.

“[Të] vi[ni] me zemra të thyera e shpirtra të penduar, . . . të gatshëm të m[errni] mbi vete emrin e Jezu Krishtit, duke patur vendosmëri për t’i shërbyer atij deri në fund”⁶ dhe të zbatoni urdhërimet e Tij dhe gjithmonë ta kujtoni Atë”⁷.

Lutjet e sakramentit janë një kujtues i këtyre besëlidhjeve. Kur marrim sakramentin ne përtërijmë zotimin tonë për të jetuar sipas këtyre besëlidhjeve. Unë mendoj se do të ishte me vend të mësonim përmendsh lutjet e sakramentit në mendjen dhe në zemrën tonë. Kjo do të na ndihmojë të përqendrohemi te përtëritja e besëlidhjeve tona të pagëzimit. Qoftë nëse ishim 8 apo 80 vjeç kur u pagëzuam, shpresoj që nuk do ta harrojmë kurrë atë ditë dhe besëlidhjet që bëmë.

III. Gjatë Sakramentit Ne Mund të Ndihemi të Falur për Mëkatet Tona

Së treti, gjatë sakramentit ne mund të ndihemi të falur për mëkatet tona. Nëse përpara mbledhjes së sakramentit kemi kaluar kohë duke u penduar për mëkatet tona, ne mund të largohemi nga mbledhja e sakramentit duke u ndier të pastër dhe të dëlirë. Presidenti Bojd K. Paker tha: “Sakramenti përtërin procesin e faljes. Çdo të diel kur shërbehet sakramenti, ai është një kremtim për të përtërirë procesin e faljes. . . . Çdo të diel ju pastroni vetveten në mënyrë që, në kohën e duhur, kur të ndërroni jetë shpirti juaj do të jetë i pastër”⁸. Marrja e sakramentit me denjësi mund të na ndihmojë të ndihemi si populli i mbretit Benjamin, i cili “u mbush me gëzim, pasi kish[te] marrë një heqje të mëkateve të tyre dhe pasi kish[te] paqe të ndërgjegjes”⁹.

IV. Ne Mund të Marrim Frymëzim për Zgjidhje të Problemeve Tona

Parimi i katërt është se ne mund të marrim frymëzim për zgjidhje të problemeve tona gjatë mbledhjes së sakramentit. Kur isha president misioni në Bolivi, bashkëshortja ime, Meri En dhe unë patëm bekimin që të merrnim pjesë në një seminar për presidentët e misioneve me Presidentin Henri B.

Ajring. Në atë mbledhje ai dha mësim se ka tri mënyra të rëndësishme për t’u përgatitur që të përfitonit nga një mbledhje. Ne duhet të vijmë me problemet tona të përlurur si fëmijë, të gatshëm për të mësuar dhe me dëshirën për të ndihmuar fëmijët e Perëndisë.

Kur vijmë të përlurur në mbledhjen e sakramentit, ne mund të bekohemi për të ndier mbresa për zgjidhje të problemeve tona të përditshme. Ne duhet të vijmë të përgatitur, të jemi të gatshëm të dëgjojmë dhe të mos hutohemi. Në shkrimet e shenjta lexojmë: “Por, vër re, unë të them se ti duhet ta studiosh atë tërësisht në mendjen tënde; më pas ti duhet të më pyesësh nëse është e drejtë dhe nëse është e drejtë, unë do të bëj që kraharori yt do të digjet përbrenda; si rrjedhim, do ta ndiesh që është e drejtë.”¹⁰ Ne mund të dimë se çfarë duhet të bëjmë për të zgjidhur problemet tona.

V. Marrja e Sakramentit Denjësisht do të na Ndihmojë të Mbushemi me Frymën e Shenjtë

Parimi i pestë, marrja e sakramentit denjësisht, do të na ndihmojë të mbushemi me Frymën e Shenjtë. Pas fillimit të sakramentit gjatë vizitës së Tij te nefitët, Jezusi shpalli: “Ai që ha këtë bukë, ha nga trupi im në

shpirtin e tij; dhe ai që pi nga kjo verë, pi nga gjaku im në shpirtin e tij; dhe shpirti i tij nuk do të ketë kurrë uri ose etje, por do të jetë i ngopur”¹¹. Atyre u është premtuar se, nëse janë të uritur dhe të etur për drejtësi, do të ngopen me Frymën e Shenjtë. Lutja e sakramentit gjithashtu premtonte se, nëse jetojmë sipas besëlidhjeve tona, do të kemi gjithmonë Shpirtin e Tij me ne.¹²

Plaku Melvin J. Ballard tha: “Unë jam dëshmitar që ka një shpirt që merr pjesë në administrimin e sakramentit i cili ngroh shpirtin nga koka te këmbët; ju ndieni plagët e shpirtit të shërohen dhe barrën të hiqet. Ngu-shëllimi dhe lumturia i vijnë shpirtit që është i denjë dhe vërtet i dëshiruar të marrë nga ky ushqim shpirtëror.”¹³

Ne do të bekohemi kur ndiejmë mirënjohje për Shlyerjen e Jezu Krishtit, përtërijmë besëlidhjet tona të pagëzimit, ndiejmë falje dhe marrim frymëzim nga Fryma e Shenjtë ndërsa marrim sakramentit çdo javë. Nëse sakramenti është në qendër të adhurimit tonë, do të kemi gjithmonë një mbledhje të mrekullueshme sakramenti. Shpreh mirënjohjen time për Shlyerjen e Jezu Krishtit. E di se Ai jeton. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Lluca 22:19–20; theksimi i shtuar.
2. Shih 3 Nefi 18.
3. David O. McKay, në Conference Report, tetor 1929, f. 11.
4. *Book of Mormon Student Manual* (Church Educational System manual, 1979), f. 417.
5. Mosia 18:8–9.
6. Doktrina e Besëlidhje 20:37.
7. Shih Doktrina e Besëlidhje 20:77.
8. Boyd K. Packer, *Mine Errand from the Lord* (2008), f. 196.
9. Mosia 4:3; theksimi i shtuar.
10. Doktrina e Besëlidhje 9:8; theksimi i shtuar.
11. 3 Nefi 20:8.
12. Shih Doktrina e Besëlidhje 20:77.
13. Melvin J. Ballard, në Bryant S. Hinckley, *Sermons and Missionary Services of Melvin Joseph Ballard* (1949), f. 149.



Nga Plaku Dejvid A. Bednar,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Të Kthyer në Besim te Zoti

Të diturit se ungjilli është i vërtetë është thelbi i një dëshmie. Të qenit vazhdimisht i vërtetë ndaj ungjillit është thelbi i kthimit në besim.

Mesazhi im përqendrohet te marrëdhënia midis marrjes së një dëshmie se Jezusi është Krishti dhe të qenit të kthyer në besim tek Ai dhe ungjilli i Tij. Zakonisht, ne flasim për temat e dëshmisë dhe kthimit në besim veçmas dhe në mënyrë të pavarur. Sidoqoftë, ne marrim largpamësi dhe bindje më të madhe shpirtërore ndërsa i mbajmë parasysht këto dy çështje të rëndësishme së bashku.

Unë lutem që Fryma e Shenjtë do ta udhëzojë dhe lartësojë secilin prej nesh.

Kush thoni se jam unë?

Ne mund të mësojmë shumë rreth dëshmisë dhe kthimit në besim nga shërbesa e Apostullit Pjetër.

Kur Jezusi erdhi në brigjet e Cezaresë së Filipit, Ai u drejtoi këtë pyetje tejpërshkuese dishepujve të Tij: “Kush thoni se jam unë?”

Pjetri u përgjigj menjëherë: “Ti je Krishti, Biri i Perëndisë të gjallë.

Dhe Jezusi duke përgjigjur u tha: ‘I lumur je ti, o Simon, biri i Jonas, sepse këtë nuk ta zbuloi as mishi

as gjaku, por Ati im që është në qiej’” (Mateu 16:15–17).

Sikurse duket në përgjigjen e Pjetrit dhe në udhëzimin e Shpëtimtarit, një dëshmi është njohuri vetjake e të vërtetave shpirtërore të fituara nëpërmjet zbulesës. Një dëshmi është një dhuratë nga Perëndia dhe është e disponueshme për të gjithë fëmijët e Tij. Çdo kërkues i sinqertë i së vërtetës mund të fitojë një dëshmi duke ushtruar “pjesëz[ën] e besimit” të nevojshme si “një provë” (Alma 32:27) dhe “të provolj[ë] virtutit e fjalës” (Alma 31:5), të dëgjojë “thirrjet e Frymës së Shenjtë” (Mosia 3:19) dhe të zgj[ohet] në Perëndi (shih Alma 5:7).

Kërkimi dhe të fituarit e një dëshmie për të vërtetën shpirtërore kërkon pyetje, kërkim dhe trokitje (shih Mateu 7:7; 3 Nefi 14:7) me një zemër të sinqertë, me synim të vërtetë dhe besim te Shpëtimtari (shih Moroni 10:4). Përbërësit bazë të një dëshmie janë dijenia se Ati Qielor jeton dhe na do, se Jezu Krishti është Shpëtimtari ynë dhe se plotësia e ungjillit është rivendosur në tokë në këto ditë të mëvonshme.

Kur të Jesh Kthyer

Kur Shpëtimtari u dha mësim dishepujve të Tij në Darkën e Fundit, Ai i tha Pjetrit:

“Simon, Simon, ja, Satani ka kërkuar t’ju shoshë ashtu siç shoshet gruri:

Por unë jam lutur për ty, që besimi yt të mos mpaket; dhe ti, kur të jesh kthyer, forco vëllezërit e tu” (Lluka 22:31–32).

Është interesante se ky Apostull i madh pati folur dhe pati ecur me Mësuesin, kishte dëshmuar mrekulli të shumta dhe kishte një dëshmi të fortë për hyjnueshmërinë e Shpëtimtarit. Prapëseprapë madje edhe Pjetri kishte nevojë për udhëzim shtesë nga Jezusi rreth kthimit në besim dhe fuqisë shenjtëruese të Frymës së Shenjtë dhe përgjegjësisë së tij për të shërbyer me besnikëri.

Thelbi i ungjillit të Jezu Krishtit përfshin një ndryshim themelor e të qëndrueshëm në vetë natyrën tonë që u bë i mundur përmes Shlyerjes së Shpëtimtarit. Kthimi i vërtetë në besim sjell një ndryshim në bindjet, zemrën dhe jetën e dikujt për të pranuar dhe për t’iu bindur vullnetit të Perëndisë (shih Veprat e Apostujve 3:19; 3 Nefi 9:20) dhe përfshin një zotim të ndërgjegjshëm për t’u bërë një dishepull i Krishtit.

Kthimi në besim është një shtim, thellim dhe zgjerim i bazës themelore të dëshmisë. Ai është rezultat i zbulësës prej Perëndisë, i shoqëruar nga pendimi, bindja dhe zelli. Çdo kërkues i sinqertë i së vërtetës mund të bëhet i kthyer në besim duke përjetuar ndryshimin e madh të zemrës dhe të qenit të lindur shpirtërisht nga Perëndia (shih Alma 5:12–14). Kur i respektojmë ordinancat dhe besëlidhjet e shpëtimit dhe të ekzaltimit (shih DeB 20:25), “shkoljmë] përpara me një vendosmëri në Krisht” (2 Nefi



31:20) dhe durojmë me besim deri në fund (shih DeB 14:7), ne bëhemi krijesa të reja në Krisht (shih 2 Korintasve 5:17). Kthimi në besim është një dhurim i vetvetes, i dashurisë dhe besnikërisë që ne ia bëjmë Perëndisë në mirënjohje për dhuratën e dëshmisë.

Shembuj të Kthimit në Besim në Librin e Mormonit

Libri i Mormonit është plot me tregime frymëzuese të kthimit në besim. Amaleki, një pasardhës i Jakobit, shpalli: “Unë do të doja që ju të vini te Krishti, që është i Shenjti i Izraelit dhe të merrni pjesë në shpëtimin e tij dhe në fuqinë e shlyerjes së tij. Po, ejani tek ai dhe dhuroni tërë shpirtat tuaj si një dhuratë ndaj tij” (Omni 1:26).

Dijenja nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë se Jezusi është Krishti, është e rëndësishme dhe e nevojshme. Por ardhja tek Ai me zell dhe dhurimi i tërë shpirtave tanë si një dhuratë kërkon shumë më tepër se sa thjesht ta dish këtë. Kthimi në besim kërkon gjithë zemrën, fuqinë, mendjen dhe forcën tonë (shih DeB 4:2).

Populli i mbretit Beniamin iu përgjigj mësimëve të tij duke thirrur: “Po, ne i besojmë të gjitha fjalët që ti na ke folur; dhe ne gjithashtu dimë për sigurinë dhe vërtetësinë e tyre, për shkak

të Shpirtit të Zotit të Plotfuqishëm, i cili ka bërë një ndryshim të madh te ne, ose në zemrat tona, që ne nuk kemi më prirje të bëjmë keq, por të bëjmë mirë vazhdimisht” (Mosia 5:2). Pranimi i fjalëve të folura, marrja e një dëshmie për vërtetësinë e tyre dhe ushtrimi i besimit në Krisht, sollën një ndryshim të madh të zemrës dhe një vendosmëri të patundur për t’u përmirësuar e për t’u bërë më të mirë.

Lamanitët e kthyer në besim në librin e Helamanit përshkruhen se ishin “në shtegun e detyrës së tyre dhe ecin me kujdes para Perëndisë dhe përpiqen të zbatojnë urdhërimet e tij dhe statutet dhe gjykimet e tij. . . .

. . . Dhe se po përpiqen me zell të vazhdueshëm, që të mund të sjellin mbetjen e vëllezërve të tyre në njohurinë e së vërtetës” (Helamani 15:5–6).

Ashtu sikurse theksojnë këto shkrime, karakteristikat kyçe të shoqëruara me kthim në besim po përjetojnë një ndryshim të madh në zemrat tona, duke pasur një prirje për të bërë mirë vazhdimisht, duke shkuar përpara në shtegun e detyrës, duke ecur me vigjilencë përpara Perëndisë, duke zbatuar urdhërimet dhe duke shërbyer me zell të pashtershëm. Duket qartë se këta bij shpirtërorë besnikë qenë bërë thellësisht të përkushtuar ndaj Zotit dhe mësimëve të Tij.



Të Kthehesh në Besim

Për shumë prej nesh, kthimi në besim është një proces i vazhdueshëm dhe jo një ngjarje që ndodh vetëm një herë e që vjen si pasojë e një përvoje të fuqishme ose dramatike. Rresht pas rreshti dhe parim pas parimi, gradualisht dhe pothuajse pa u kuptuar, shtysat tona, mendimet tona, fjalët tona dhe veprat tona pajtohen me vullnetin e Perëndisë. Kthimi në besim te Zoti kërkon si këmbëngulje ashtu edhe durim.

Samuel Lamaniti përcaktoi pesë elemente bazë të kthyerjes në besim te Zoti: 1) besimi në mësimet dhe profecitë e profetëve të shenjtë ashtu siç shënohen në shkrimet e shenjtja, 2) ushtrimi i besimit në Zotin Jezu Krisht, 3) pendimi, 4) përjetimi i një ndryshimi të madh të zemrës dhe 5) të bërit “të vendosur dhe të paepur” (shih Helamani 15:7–8). Ky është modeli që të çon drejt kthimit në besim.

Dëshmia dhe Kthimi në Besim

Dëshmia është fillimi dhe një kusht paraprak për vazhdimësinë e kthimit në besim. Dëshmia është një pikë nisjeje; nuk është një pikë mbërritjeje përfundimtare. Dëshmia e fortë është

themeli mbi të cilin ngrihet kthimi në besim.

Vetëm dëshmia nuk është dhe nuk do të jetë e mjaftueshme për të na mbrojtur nga stuhia e ditës së mëvonshme e errësirës dhe e së keqes në të cilën po jetojmë. Dëshmia është e rëndësishme dhe e nevojshme, por e pamjaftueshme për të siguruar forcën shpirtërore dhe mbrojtjen që na duhet. Disa anëtarë të Kishës me dëshmi janë dobësuar shpirtërisht dhe janë larguar. Njohuria shpirtërore dhe zotimi i tyre nuk qenë të mjaftueshme për sfidat që ata përballuan.

Një mësim i rëndësishëm rreth lidhjes mes dëshmisë dhe kthimit në besim është i dukshëm në punët misionare të bijve të Mosias.

“Të gjithë ata që u sollën në njohurinë e së vërtetës, nëpërmjet predikimit të Amonit dhe vëllezërve të tij, sipas shpirtit të zbulesës dhe të profecisë dhe të fuqisë së Perëndisë, që bënë mrekulli në ta—po, . . . sikurse Zoti jeton, po kështu të gjithë Lamanitët që besuan në predikimin e tyre dhe që u kthyen në besim te Zoti, nuk hoqën dorë kurrë nga besimi i tyre.

Pasi ata u bënë një popull i drejtë; ata ulën armët e rebelimit të tyre dhe

nuk luftuan më kundër Perëndisë. . . .

Tani, këta ishin ata që u kthyen në besim te Zoti” (Alma 23:6–8).

Në këto vargje përshkruhen dy elemente kryesore: 1) *njohuria e së vërtetës*, që mund të kuptohet se është një dëshmi, dhe 2) *të kthyerit në besim te Zoti*, që unë e kuptoj se është kthimi në besim te Shpëtimtari dhe ungjilli i Tij. Kështu, kombinimi i fuqishëm i dëshmisë ashtu edhe i kthimit në besim te Zoti solli vendosmërinë e palëkundshmërinë dhe siguroi mbrojtje shpirtërore.

Ata nuk hoqën dorë kurrë nga besimi i tyre dhe u ulën “armët e rebelimit të tyre që ata nuk luftuan më kundër Perëndisë”. Mënjanimi i “armëve” të dashura “të rebelimit” të tilla si egoizmi, krenaria dhe mosbindja kërkon më shumë se sa thjeshtë të besosh e të dish. Bindja e patundur, përlësia, pendimi dhe nënshtrimi u paraprijnë armëve tona të rebelimit. A zotërojmë ende ju dhe unë armë rebelimi që na pengojnë të kthehemi në besim te Zoti? Nëse po, atëherë duhet të pendo kemi tani.

Vini re se lamanitët nuk u kthyen në besim prej misionarëve që u dhanë mësim atyre, ose prej programeve

të shkëlqyera të Kishës. Ata nuk u kthyen në besim prej personalitetit të udhëheqësve të tyre apo prej ruajtjes së një trashëgimie kulturore ose traditave të etërve të tyre. Ata u kthyen në besim te Zoti – tek Ai si Shpëtimtar dhe hyjnueshmëria dhe doktrina e Tij – dhe ata nuk hoqën dorë kurrë nga besimi i tyre.

Një dëshmi është njohuri shpirtërore e së vërtetës fituar nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë. Kthimi i vazhdueshëm në besim është përku-shitim i qëndrueshëm ndaj të vërtetës së zbuluar që kemi marrë – me një zemër të gatshme dhe për arsye të drejta. Të diturit se ungjilli është i vërtetë është thelbi i një dëshmie. Të qenit vazhdimisht i vërtetë ndaj ungjillit është thelbi i kthimit në besim. Ne duhet ta dimë se ungjilli është i vërtetë dhe të jemi të vërtetë ndaj ungjillit.

Dëshmia, Kthimi në Besim dhe Shëmbëlltyra e Dhjetë Virgjërëshave

Tani dëshiroj të përdor një nga shumë interpretimet e mundshme të shëmbëlltyrës së dhjetë virgjërëshave për të theksuar marrëdhënien mes dëshmisë dhe kthimit në besim. Dhjetë virgjërëshat, pesë prej të cilave ishin të mençura dhe pesë budallaçka, i morën llambat e tyre dhe i dolën para

dhëndrit. Ju lutem të mendoni për llambat e përdorura nga virgjërëshat si llamba e dëshmisë. Budallaçkat, i morën llambat e tyre të dëshmisë, por nuk morën me vete vajin. Vajin konsiderojeni si vaji i kthimit në besim.

“Kurse të mençurat, bashkë me llambat, morën edhe vajin [e dëshmisë] në enët e tyre.

Duke qenë se dhëndri po vononte, dremitën të gjitha dhe i zuri gjumi.

Aty nga mesnata u dëgjua një brimë: ‘Ja, po vjen dhëndri, i dilni para!’.

Atëherë të gjitha ato virgjërëshat u zgjuan dhe përgatitën llambat e tyre [të dëshmisë].

Dhe budallaçkat u thanë të mençurave: ‘Na jepni nga vaji juaj [madje vaji i kthimit në besim], sepse llambat tona [të dëshmisë janë të zbehta dhe] po na fiken’.

Por të mençurat duke u përgjigjur thanë: ‘Jo, sepse nuk do të mjaftonte as për ne e as për ju; më mirë shkoni te tregtarët dhe e blini’” (Mateu 25:4–9).

A qenë pesë virgjërëshat egoiste dhe jo të gatshme për të ndarë [vajin], apo po vinin ato në dukje me të drejtë se vaji i kthimit në besim nuk mund të merret hua? A mund t’i jepet një njeriu tjetër forca shpirtërore që vjen si pasojë e bindjes së vazhdueshme ndaj urdhërimeve? A mund t’i kalohet

dikujt që ka nevojë, njohuria e fituar nëpërmjet studimit të zellshëm dhe meditimit mbi shkrimet e shenjta? A mund t’i përçohet një individ që po përjeton fatkeqësi ose sfidë të madhe, paqja që i sjell ungjilli një shenjtori besnik të ditëve të mëvonshme? Përgjigjja e qartë për secilën prej këtyre pyetjeve është jo.

Sikurse e përforcuan siç duhej virgjërëshat e mençura, secili prej nesh duhet “të shkoljë të] blej[ë]”. Këto gra të frymëzuara nuk po përshkruanin një transaksion biznesi; përkundrazi, ato po theksonin përgjegjësinë tonë individuale për ta mbajtur ndezur llambën tonë të dëshmisë dhe për të marrë një furnizim të mjaftueshëm për vajin e kthimit në besim. Vaji i çmuar fitohet pikë pas pike – “rresht pas rreshti [dhe] parim pas parimi” (2 Nefi 28:30), me durim dhe këmbëngulje. Nuk ka asnjë rrugë më të lehtë; nuk është e mundur një përgatitje e beftë në minutën e fundit.

“Si rrjedhim, jini besnikë, gjithmonë duke u lutur, duke i patur llambat tuaja të rregulluara e të ndezura dhe vaj me vete, që të mund të jeni gati për ardhjen e Dhëndrit” (DeB 33:17).

Dëshmia

Unë ju premtoj se, ndërsa vijmë te njohuria e së vërtetës dhe kthehemi në besim te Zoti, ne do të mbetemi të vendosur e të paepur dhe nuk do të heqim dorë kurrë nga besimi ynë. Ne do t’i ulim me padurim armët tona të rebelimit. Ne do të bekohemi me dritë të shkëlqyer nga llambat e dëshmisë dhe një furnizim të mjaftueshëm të vajit të kthimit në besim. Dhe teksa secili prej nesh kthehet më plotësisht në besim, ne do të forcojmë familjet dhe të njohurit tanë. Për këto të vërteta unë dëshmoj, në emrin e shenjtë të Zotit Jezu Krisht, amen. ■





Nga Presidenti Tomas S. Monson

Perëndia me Ju Qoftë kur Prapë të Takohemi

Ndërsa i vendosim në zemrën dhe jetën tonë mesazhet e dy ditëve të fundit, ne do të bekohemi.

Vëllezërit e motrat e mia të dashura, kemi ardhur në mbylljen e një tjetre konference frymëzuese të përgjithshme. Unë personalisht jam ushqyer shpirtërisht e ngritur moralisht dhe e di se edhe ju e keni ndier ndjenjën e veçantë të kësaj konference.

Ne u shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë të gjithë atyre që kanë marrë pjesë në çfarëdo mënyre. Të vërtetat e ungjillit janë dhënë mësim dhe ritheksuar bukur. Ndërsa i vendosim në zemrën dhe jetën tonë mesazhet e dy ditëve të fundit, ne do të bekohemi.

Si gjithmonë, punimet e kësaj konference do të jenë të disponueshme në numrat e ardhshëm të revistave *Ensign* dhe *Liahona*. Unë ju nxis t'i lexoni edhe një herë bisedat dhe të meditoni për mesazhet që përmbahen aty. Kam zbuluar nga vetë jeta ime se përfitoj edhe më shumë nga këto predikime të frymëzuara kur i studioj me thellësi më të madhe.

Kemi pasur një transmetim të pashembullt të konferencës, duke mbërritur te njerëzit kudo nëpër kontinente dhe oqeane. Edhe pse jemi shumë larg prej shumëkujt nga ju, ne e ndiejmë shpirtin tuaj dhe ju dërgojmë

dashurinë dhe vlerësimin tonë.

Vëllezërit tanë që u liruat nga thirrjet në këtë konferencë, më lejoni t'ju shpreh mirënjohjen e përzemërt të të gjithëve ne për vitet tuaja të shumta të shërbimit të përkushtuar. Të panumërt janë ata që janë bekuar nga kontributet tuaja për punën e Zotit.

Vëllezër dhe motra, pikërisht së fundi festova ditëlindjen time të 85-të dhe jam mirënjohës për çdo vit që Zoti më ka dhuruar. Ndërsa meditoj për përvojat e jetës sime, e falënderoj Atë për bekimet e Tij të shumta ndaj meje. Siç e përmenda në mesazhin tim këtë mëngjes, e kam ndier dorën e Tij që t'i drejtojë përpjekjet e mia ndërsa jam përpjekur me zell t'i shërbej Atij dhe t'ju shërbej të gjithëve ju.


Detyra e Presidentit të Kishës është një detyrë kërkuese. Unë jam shumë mirënjohës për dy këshilltarët e mi besnikë, që shërbejnë përkrah meje dhe që janë gjithmonë të gatshëm dhe jashtëzakonisht të aftë që të ndihmojnë në punën që bie mbi Presidencën e Parë. Unë shpreh mirënjohjen time gjithashtu për burrat fisnikë që përbëjnë Kuorumin e Të Dymbëdhjetë Apostujve. Ata punojnë pa u lodhur për kauzën e Mjeshtrit, me anëtarët e

Kuorumeve të Të Shtatëdhjetëve, duke siguruar ndihmë të frymëzuar për ata.

Dëshiroj gjithashtu t'ju përgëzoj ju, vëllezërit e motrat e mia, kudo që jeni në mbarë botën, për gjithçka që bëni në lagjet dhe degët tuaja, në kujnjet dhe distriktet tuaja. Ndërsa ju i përmbushni me gatishmëri thirrjet kur ju kërkohet, ju po ndihmoni për të ndërtuar mbretërinë e Perëndisë në tokë.

U kujdeshim gjithmonë për njëri-tjetrin, duke ndihmuar në kohë nevojë. Le të mos jemi kritikues dhe gjykues, por le të jemi zemërgjerë, duke ndjekur gjithmonë shembullin e shpirtmirisë së përzemërt të Shpëtimtarit. Me këtë ndjenjë, i shërbefshim me gatishmëri njëri-tjetrit. Le të lutemi për frymëzimin që të dimë nevojat e





Nga Linda K. Barton,
Presidente e Përgjithshme e Shoqatës së Ndhmës

njerëzve rreth nesh dhe pastaj, le të shkojmë e të sigurojmë ndihmë.

Le të marrim zemër ndërsa jetojmë jetën tonë. Ndonëse jetojmë në kohë gjithnjë e më të rrezikshme, Zoti na do dhe kujtohet për ne. Ai është gjithmonë pranë nesh kur ne bëjmë çfarë është e drejtë. Ai do të na ndihmojë në kohë nevojë. Vështirësitë vijnë në jetën tonë, probleme që nuk i parashikonim dhe të cilat nuk do t'i dëshironim kurrë. Asnjë prej nesh nuk është i imunizuar. Qëllimi i vdekshmërisë është që të mësojmë e të rritemi për të qenë më shumë si Ati ynë dhe shpesh ndodh pikërisht gjatë kohëve të vështira që ne mësojmë më shumë, pavarësisht sa i dhimbshëm mund të jetë ai mësim. Jeta jonë gjithashtu mund të mbushet me gëzim ndërsa ndjekim mësimet e ungjillit të Jezu Krishtit.

Zoti këshilloi: “Merrni zemër, unë e munda botën!”¹ Çfarë lumturie të madhe duhet të na sjellë kjo njohuri! Ai jetoi për ne dhe Ai vdiq për ne. Ai pagoi çmimin për mëkatet tona. Le ta ndjekim shembullin e Tij. Le ta shfaqim mirënjohjen tonë të madhe ndaj Tij duke e pranuar sakrificën e Tij dhe duke jetuar një jetë që do të na kualifikojë për t'u kthyer e për të jetuar një ditë me Të.

Siç e kam përmendur në konferencat e mëparshme, ju falënderoj për lutjet tuaja në emrin tim. Unë kam nevojë për to; unë i ndiej ato. Ne, si Autoritete të Përgjithshme, gjithashtu ju kujtojmë të gjithëve ju dhe lutemi që bekimet më të zgjedhura të Atit tonë Qiellor të jenë me ju.

Tani, vëllezërit e motrat e mia të dashura, ne i mbyllim punimet për gjashtë muaj. Perëndia me ju qoftë kur prapë të takohemi në atë kohë. Në emrin e Shpëtimtarit dhe Shëlbuesit tonë, madje Jezu Krishtit, Zotit, amen. ■

SHËNIM

1. Gjoni 16:33.

A Është Besimi në Shlyerjen e Jezu Krishtit i Shkruar në Zemrat Tona?

Bërja, mbajtja dhe gëzimi në besëlidhjet tona do të jetë prova se Shlyerja e Jezu Krishtit është shkruar vërtet në zemrat tona.

Motrat e mia të dashura, ju keni qenë në mendjen dhe në zemrën time për muaj, ndërsa kam medituar për këtë përgjegjësi sfiduese. Edhe pse nuk ndihem në lartësinë e përgjegjësisë që më është dhënë, e di se thirrja ka ardhur nga Zoti nëpërmjet profetit të Tij të zgjedhur dhe, tani për tani, kaq mjafton. Shkrimet e shenjta japin mësim se “qoftë nëpërmjet zërit [të Zotit] apo nëpërmjet zërit të shërbëtorëve të [Tij] është njësoj”¹.

Një nga dhuratat e çmuara që e shoqërojnë këtë thirrje, është siguria se Ati Qiellor i do të gjitha bijat e Tij. Unë e kam ndier dashurinë e Tij për secilën prej nesh!

Ashtu si ju, unë i dua shkrimet e shenjta! Në librin e Jeremias gjejmë një shkrim të shenjtë që është shumë i shtrenjtë për zemrën time. Jeremia

jetoi në një kohë dhe vend të vështirë, por Zoti e lejoj atë të parashikonte “një kohë shprese gjatë mbledhjes së ditëve të mëvonshme të Izraelit”² – kohën tonë. Jeremia profetizoi:

“‘Mbas atyre ditëve’, thotë Zoti: ‘Do ta shtie ligjin tim në mendjen e tyre dhe *do ta shkruaj mbi zemrën e tyre*, dhe unë do të jem Zoti i tyre dhe ata do të jenë populli im. . . .

. . . Të gjithë do të më njohin, nga më i vogli e deri te më i madhi’, thotë Zoti. ‘Sepse unë do ta fal paudhësinë e tyre dhe nuk do ta kujtoj më mëkatet e tyre.’”³

Ne jemi populli që pa Jeremia. A e kemi ftuar ne Zotin që ta shkruajë ligjin, apo doktrinën, në zemrat tona? A e besojmë ne se falja e disponueshme nëpërmjet Shlyerjes, për të cilën flet Jeremia, zbatohet për ne personalisht? Disa vite më parë, Plaku Xhefri R.



Holland tregoi ndjenjat e tij për besimin e rënjosur thellë të pionierëve që ngulmuan drejt Luginës së Solt-Lejkut edhe pas vdekjes së fëmijëve të tyre. Ai tha: “Ata nuk e bënë atë për një program, ata nuk e bënë atë për një aktivitet shoqëror, ata e bënë atë sepse besimi i ungjillit të Jezu Krishtit që në shpirtin e tyre, ishte në palcën e kockave të tyre”.

Ai shprehu, me emocion të butë: “Kjo është e vetmja mënyrë se si ato nëna mund të varrosnin [foshnjat e tyre] në një kanistër buke dhe të shkonin më tej duke thënë: ‘Toka e premtuar është atje diku. Do të arrijmë të shkojmë në luginë.’

Ato mundën ta thoshin atë për shkak të besëlidhjeve dhe doktrinës, dhe besimit, dhe zbulësës, dhe Shpirtit.”

Ai përfundoi me këto fjalë që të fusin në mendime: “Nëse mund ta mbajmë këtë qëndrim në familjet tona dhe në Kishë, mbase shumë gjëra të tjera vijnë si pasojë. Ndoshta shumë gjëra të tjera më pak të nevojshme bien nga vagoni. Më kanë thënë se ato karroca dore nuk mund të mbanin shumë gjëra. Pikërisht ashtu si paraardhësve tanë iu desh të zgjidhnin atë që morën me vete, ndoshta shekulli i 21-të do të na çojë të vendosim: ‘Çfarë mund të fusim në këtë karrocë dore?’ Dhe ajo është thelbi i shpirtit tonë; është vetë palca në kockat tona.”⁴ Ose, për ta thënë ndryshe, është ajo çfarë është *shkruar në zemrat tona!*

Si presidencë e re e Shoqatës së

Ndihmës, ne i kemi kërkuar Zotit me zell që të dimë se çfarë gjërash thelbësore do të na bënte Ai t’i vendosnim në karrocën tonë të dorës, të Shoqatës së Ndihmës, që të vazhdojmë ta çojmë përpara punën e Tij. Kemi ndier se Ati Qiellor së pari do të na vinte të ndihmonim bijat e Tij të dashura që të kuptojnë doktrinën e Shlyerjes së Jezu Krishtit. Ndërsa e bëjmë këtë, ne e dimë se besimi ynë do të rritet, ashtu si dëshira jonë për të jetuar me drejtësi. Së dyti, ndërsa kemi marrë parasysh nevojën vendimtare për të forcuar familjet dhe shtëpitë, kemi ndier se Zoti do të na vinte t’i inkurajonim bijat e Tij të dashura që të kapen me gëzim pas besëlidhjeve të tyre. Kur besëlidhjet mbahen, familjet forcohen. Së fundi, ne ndiejmë se Ai do të na vinte të punojmë në unitet me organizatat e tjera ndihmëse dhe me udhëheqësit tanë të priftërisë, duke u përpjekur t’i kërkojmë e t’i ndihmojmë ata në nevojë që të përparojnë përgjatë shtegut. Është lutja jonë e zjarrtë që secila prej nesh do ta hapë zemrën dhe do ta lejojë Zotin të gdhendë në të doktrinën e Shlyerjes, besëlidhjeve dhe unitetit.

Si mund të presim që t’i forcojmë familjet ose t’i ndihmojmë të tjerët po të mos kemi ne të parat, të shkruar në vetë zemrën tonë, një besim të thellë e të qëndrueshëm te Jezu Krishti dhe Shlyerja e Tij e pafundme? Sonte dëshiroj të ndaj tri parime të Shlyerjes që, po të shkruhen në zemrat tona, do ta rrisin besimin tonë te Jezu Krishti. Është shpresa ime që kuptimi i këtyre

parimeve do ta bekojë secilën prej nesh, qoftë nëse jemi të reja në Kishë apo anëtare gjatë gjithë jetës.

Parimi 1: “Gjithçka që është e padrejtë në jetë mund të ndreqet me anë të Shlyerjes së Jezu Krishtit”⁵.

Ne, bashkë me ju, japim dëshmi për Shlyerjen e Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit. Dëshmitë tona, ashtu si tuajat, janë shkruar në zemrat tona sepse kemi hasur shumë sfida e kundërshtime të ndryshme që na kanë bërë të rritemi shpirtërisht. Pa një kuptueshmëri të planit të përkryer të lumturisë të Atit Qiellor dhe të Shlyerjes së Shpëtimtarit si tipari qendror i atij plani, këto sfida mund të dukeshin të padrejta. Ne të gjitha kemi pjesë së bashku në sprovat e jetës. Por në zemrat besnike është shkruar: “Gjithçka që është e padrejtë në jetë, mund të ndreqet me anë të Shlyerjes së Jezu Krishtit”.

Përse Zoti lejon që vuajtja dhe mbrapshtia të na vijnë në këtë jetë? E thënë thjesht, është pjesë e planit për rritjen dhe përparimin tonë! Ne “lëshoni[m] britma gëzimi”⁶ kur morëm vesh se do të kishim mundësinë të vinim në tokë për të përjetuar vdekshmërinë. Plaku Dallin H. Ouks dha mësim: “Kthimet tona të nevojshme në besim shpesh arrihen më lehtë nëpërmjet vuajtjes dhe mbrapshtisë sesa nëpërmjet rehatisë dhe qetësisë”⁷.

Shembulli i një motre pioniere besnike e ilustron këtë të vërtetë. Meri Luis Uolker u martua në moshën 17-vjeçare me Xhon T. Morrisin në Shën-Luis të Misurit. Ata kapërcyen rrafshinat me shenjtoret në vitin 1853, duke hyrë në Luginën e Solt-Lejkut pak pas përvjetorit të tyre të parë. Gjatë udhëtimit të tyre, ata kishin vuajtur mungesat e gjërave primare tipike për shenjtoret e tjerë. Por vuajtjet dhe mbrapshtitë e tyre nuk morën fund

kur arritën në Luginën e Solt-Lejkut. Vitin tjetër, Meri, atëherë 19 vjeçe, shkroi: “Një bir na lindi. . . . Një mbrëmje, kur ai qe dy ose tre muajsh . . . diçka më pëshpëriti: ‘Ti do ta humbasësh atë vogëlush’.”

Gjatë dimrit, shëndeti i foshnjës u përkeqësua. “Ne bëmë gjithçka mundëm, . . . por foshnja u bë gjithnjë e më keq. . . . Më dy shkurt ai ndërroi jetë . . . dhe kështu unë piva kupën e hidhur të ndarjes nga vetë mishi dhe gjaku im.” Por sprovat e saj ende nuk kishin marrë fund. Bashkëshorti i Merit u prek gjithashtu dhe tri javë pasi humbi foshnjën, ai vdiq.

Meri shkroi: “Kështu, ndërsa isha ende adoleshente, m’u grabitën në periudhën e shkurtër prej 20 ditësh, bashkëshorti im dhe fëmija im i vetëm, në një tokë të huaj, qindra kilometra larg të afërmve të mi prej gjakut dhe me një mal vështirësish përpara meje . . . dhe dëshirova që edhe unë, të mund të vdisja e të bashkohesha me të dashurit e mi”.

Meri vazhdon: “Një mbrëmje të diele, po bëja një shëtitje me shogën time. . . . M’u kujtua mungesa [e bashkëshortit tim] dhe vetmia ime e thellë dhe, ndërsa qava me hidhërim, munda të shihja, sikur të ishte një vegim mendor, kodrën e thiktë të jetës që më duhej të ngjisja, dhe e ndieva vërtetësinë e saj me forcë të madhe. Një depresion i thellë zuri vend mbi mua, sepse armiku e di se kur të na sulmojë, por [Shpëtimtari] ynë, [Jezu Krishti] ka fuqinë të na shpëtojë. Njëpërmjet . . . ndihmës së dhënë nga Ati, qeshë ne gjendje të luftoja me të gjithë forcën që dukej se qe rreshtuar kundër meje gjatë kësaj kohe.”⁸

Meri mësoi në moshën e njomë 19-vjeçare se Shlyerja na jep sigurinë se të gjitha gjërat që janë të padrejta në këtë jetë, mund dhe do të ndreqen – madje dhe hidhërimet më të thella.



Parimi 2: Ka fuqi në Shlyerje që të na mundësojë të kapërcejmë burrin apo gruan e natyrshme dhe të bëhemi dishepuj të vërtetë të Jezu Krishtit.⁹

Ka një mënyrë që të na ndihmojë ta dimë se kur e kemi mësuar një doktrinë ose parim të ungjillit. Kjo është kur jemi në gjendje që ta japim mësim doktrinën ose parimin në një mënyrë që një fëmijë të mund ta kuptojë atë. Një burim i vlefshëm për t’u mësuar fëmijëve që ta kuptojnë Shlyerjen, është një analogji që gjendet në një mësim të Fillores. Ndoshta kjo mund të na ndihmojë kur u japim mësim vetë fëmijëve tanë, nipërve e mbesave, ose miqve të besimeve të tjera që dëshirojnë ta kuptojnë këtë doktrinë thelbësore.

“Një [grua] duke ecur përgjatë një rruge, ra në një pus kaq të thellë sa që nuk mund të ngjitej lart. Pavarësisht se ç’mund të bënte, [ajo] nuk mund të

dilte që andej vetë. [Gruaja] thirri për ndihmë dhe u gëzua kur një kalimtar i mëshirshëm e dëgjoji dhe i zbriti një shkallë në pus. Kjo bëri të mundur që [ajo] të ngjitej, të dilte nga pusi dhe të rifitonte lirinë e [saj].

Ne jemi si [gruaja] në pus. Bërja e mëkatit është si rënia në pus dhe ne nuk mund të dalim vetë që andej. Ashtu siç i dëgjoji kalimtari i mëshirshëm lutjet e [gruas] për ndihmë, edhe Ati Qiellor dërgoi Birin e Tij të Vetëmlindur për të na siguruar mënyra shpëtimi. Shlyerja e Jezu Krishtit mund të krahasohet me zbritjen e një shkalle në pus; na jep mënyra për t’u ngjitur lart dhe për të dalë.”¹⁰ Por Shpëtimtari bën më shumë sesa të na zbresë shkallën, Ai “zbrete poshtë në pus dhe e bën të mundur që ne të përdorim shkallën për të shpëtuar”¹¹. “Ashtu si [gruaja] në pus duhej të ngjitej në shkallë, edhe ne duhet të pendohejmë



për mëkatet tona dhe t'u bindemi parimeve të ungjillit dhe ordinancave për të dalë nga pusi ynë dhe për të bërë që Shlyerja të funksionojë në jetën tonë. Si rrjedhim, pasi të kemi bërë gjithçka mundemi, Shlyerja bën të mundur që ne të bëhemi të denjë për t'u kthyer në praninë e Atit Qiellor.”¹²

Kohët e fundit, pata privilegjin të takoja një pioniere të kohëve moderne, një bijë të dashur të Perëndisë dhe një të kthyer kohët e fundit në besim në Kishë në Kili. Ajo është një nënë beqare me dy djem të vegjël. Nëpërmjet fuqisë së Shlyerjes, për atë është bërë e mundur që ta hedhë pas të shkuarën e saj dhe tani po përpiqet fort dhe me zell të bëhet një pasuese e vërtetë e Jezu Krishtit. Kur mendoj për të, një parim i dhënë mësim nga Plaku Dejvid A. Bednar, vjen në mendje: “Kjo është një gjë që të dini se Jezu Krishti erdhi në tokë për të *vdekur* për ne – kjo është një pjesë e rëndësishme e doktrinës së Krishtit. Por gjithashtu ne duhet të vlerësojmë se Zoti dëshiron, me anë të Shlyerjes së Tij dhe nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë, të *jetojë* te ne – jo vetëm për të na drejtuar, por edhe për të na dhënë forcë.”¹³

Ndërsa kjo motër kiliane dhe unë diskutuam për mënyrën se si të qëndrojmë në shtegun që të çon drejt jetës së përjetshme, ajo me entuziazëm më siguroi se ishte e vendosur që të vazhdonte në shteg. Ajo kishte qenë jashtë shtegut shumicën e jetës së saj

dhe deklaroi se nuk kishte asgjë “atje jashtë” shtegut që ajo dëshironte ta kishte sërish në jetën e saj. Fuqia mundësuese e Shlyerjes po jeton brenda saj. Ajo po shkruhet në zemrën e saj.

Ajo fuqi jo vetëm që na mundëson të dalim nga pusi, por gjithashtu na jep fuqinë të vazhdojmë në shtegun e ngushtë dhe të ngushtuar që na kthen në praninë e Atit tonë Qiellor.

Parimi 3: Shlyerja është prova më e madhe që kemi për dashurinë e Atit për fëmijët e Tij.

Do të bënim mirë të meditonim për këtë mendim emocionues nga Plaku Ouks: “Mendoni se sa duhet ta ketë hidhëruar Atin tonë Qiellor që të dërgonte Birin e Tij për të duruar vuajtje të pakuptueshme për mëkatet tona. Kjo është prova më e madhe e dashurisë së Tij për secilin prej nesh!”¹⁴

Ai akt më i lartë dashurie duhet ta çojë secilin prej nesh që të gjunjëzohet në lutje të përlulur për ta falënderuar Atin tonë Qiellor që na do aq sa Ai dërgoi Birin e Tij të Vetëmlindur dhe të përsosur që të vuante për mëkatet tona, pikëllimet tona dhe gjithçka që duket e padrejtë në vetë jetën tonë vetjake.

A ju kujtohet gruaja për të cilën foli kohët e fundit Presidenti Uhtedorf? Ai tha: “Një grua, që kishte kaluar vite mundimesh dhe hidhërimesh, tha mes lotëve të saj: ‘Kam arritur të kuptoj se jam si një kartmonedhë e vjetër 20-dollareshe – e zhubrosur, e grisur, e

pistë, e shpërdoruar dhe me shenja. Por përsëri jam një kartmonedhë 20-dollareshe. Unë vlej diçka. Edhe pse mund të mos dukem si shumë dhe edhe pse më kanë dëmtuar e përdorur, përsëri unë vlej plot 20 dollarë.’”¹⁵

Kjo grua e di se është një bijë e dashur e Atit të saj Qiellor dhe se ajo ishte aq e vlefshme për Atë sa që të dërgonte Birin e Tij për të shlyer për të, veçan. Secila motër në Kishë duhet ta dijë atë që di kjo grua – se ajo është një bijë e dashur e Perëndisë. Në ç’mënyrë njohja e vlerës sonë për Të ndryshon mënyrën se si i mbajmë besëlidhjet tona? Në ç’mënyrë njohja e vlerës sonë për Të ndikon dëshirën tonë për t’u shërbyer të tjerëve? Në ç’mënyrë njohja e vlerës sonë për Të e rrit dëshirën tonë për të ndihmuar njerëzit në nevojë që ta kuptojnë Shlyerjen ashtu si ne – shumë thellë? Kur secila prej nesh e ka doktrinën e Shlyerjes të shkruar thellë në zemrat tona, atëherë ne do të fillojmë të bëhemi ata lloj njerëzish që Zoti dëshiron që të jemi kur Ai të vijë sërish. Ai do të na njohë si dishepujt e Tij të vërtetë.

Shlyerja e Jezu Krishtit shkaktonte që një “ndryshim i madh” të veproje në zemrat tona¹⁶. Ndërsa ndërgjegjësohemi për këtë doktrinë, të shpallur nga një engjell i Perëndisë që të jetë “lajmet e gëzuara të gëzimit të madh”¹⁷, unë ju premtoj se do të ndihemi ashtu si u ndie populli i mbretit Beniamin. Pasi ishin lutur fuqishëm që Shlyerja të mund të zbatohet në jetën e tyre, “ata u mbushën me gëzim”¹⁸ dhe ishin “të gatshëm të hy[nin] në një besëlidhje me Perëndinë . . . , që të bë[nin] vullnetin e tij dhe të [ishin] të bindur ndaj urdhërimeve të tij, në të gjitha gjërat”¹⁹. Bërja, mbajtja dhe gëzimi në besëlidhjet tona do të jetë prova se Shlyerja e Jezu Krishtit është shkruar vërtet në zemrat tona. Ju lutemi mbajini mend këto tri parime, motra:

1. “Gjithçka që është e padrejtë në jetë mund të ndreqet me anë të Shlyerjes së Jezu Krishtit.”²⁰
2. Ka fuqi në Shlyerje që të na mundësojë të kapërcejmë burrin apo gruan e natyrshme dhe të bëhemi dishepuj të vërtetë të Jezu Krishtit.²¹
3. Shlyerja është prova më e madhe që kemi për dashurinë e Atit për fëmijët e Tij.²²

“Mbas atyre ditëve”, thotë Zoti, ‘do ta shtie ligjin tim në mendjen e tyre dhe do ta shkruaj mbi zemrën e tyre, dhe unë do të jem Zoti i tyre dhe ata do të jenë populli im.’²³ Unë ju ftoj që t’i kërkonti Zotit t’i shkruajë këto parime të Shlyerjes në zemrat tona. Unë dëshmoj se ato janë të vërteta. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 1:38.
2. *Old Testament: Gospel Doctrine Teacher’s Manual* (2001), f. 198.
3. Jeremia 31:33–34; theksimi i shtuar.
4. Jeffrey R. Holland, “Roundtable Discussion”, *Worldwide Leadership Training Meeting*, 9 shkurt 2008, f. 28.
5. *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar* (2005), f. 52.
6. Jobit 38:7.
7. Dallin H. Oaks, “The Challenge to Become”, *Liahona*, janar 2001, f. 42.
8. *Autobiography of Mary Lois Walker Morris* (kopje në zotërim të Linda Kjar Burton-it).
9. Shih Dejvid A. Bednar, “Shlyerja dhe Udhëtimi i Vdekshmërisë”, *Liahona*, prill 2012, f. 12–19.
10. *Fillorja 7: Dhiata e Re* (1997), f. 103.
11. Joseph Fielding Smith, *Doctrines of Salvation*, përmb. Bruce R. McConkie, 3 vëll. (1954–1956), 1:123.
12. *Fillorja 7*, f. 104.
13. Dejvid A. Bednar, *Liahona*, prill 2012, f. 14.
14. Dallin H. Ouks, “Dashuria dhe Ligji”, *Liahona*, nëntor 2009, f. 26.
15. Diter F. Uhtdorf, “Ju Jeni Duart e Mia”, *Liahona*, maj 2010, f. 69.
16. Shih Alma 5:12–14.
17. Mosia 3:3.
18. Shih Mosia 4:1–3.
19. Shih Mosia 5:2–5.
20. *Predikoni Ungjillin Tim*, f. 52.
21. Shih Dejvid A. Bednar, *Liahona*, prill 2012, f. 12–19.
22. Dallin H. Ouks, *Liahona*, nëntor 2009, f. 26.
23. Jeremia 31:33; theksimi i shtuar.



Nga Karol M. Stivens,

Këshilltare e Parë në Presidencën e Përgjithshme të Shoqatës së Ndhmës

Plotësisht të Vetëdijshme për Detyrat Tona

Ne duhet të jemi plotësisht të vetëdijshme për detyrat tona dhe të vazhdojmë me besim teksa marrim fuqinë ngushëlluese, forcuese, ndihmuese dhe shëruese të Shlyerjes.

Pas thirrjes sime në presidencën e përgjithshme të Shoqatës së Ndhmës, ndieva dëshirën që të mësoja më shumë rreth grave që kanë shërbyer para meje. Më bënë përshtypje mësimet e Motrës Zina D. Jang, këshilltare e parë në presidencën e dytë të përgjithshme të Shoqatës së Ndhmës. Ajo tha: “Motra, ne duhet të jemi plotësisht të vetëdijshme për detyrat tona”¹. Meditova mbi fjalët të vetëdijshme dhe detyrë dhe bëra disa kërkime shtesë në shkrimet e shenjta.

Në Dhiatën e Re, Pali u mësoi shenjtorëve të kohës së tij:

“Erdhi ora të zgjohemi nga gjumi, sepse shpëtimi ynë është më afër. . . .

Nata u thye dhe dita u afrua; le . . . të veshim armët e dritës.”²

Në Librin e Mormonit, Alma i mësoi popullit të tij detyrat e shenjta të atyre që hyjnë në besëlidhje me Perëndinë:

“Dhe tani, pasi ju dëshironi të hyni në grigjën e Perëndisë dhe të quheni populli i tij dhe jeni të gatshëm të mbani barrët e njëri-tjetrit, që ato të mund të jenë të lehta -

Po, dhe jeni të gatshëm të vajtoni me ata që vajtojnë; po, dhe të

ngushëlloni ata që kanë nevojë të ngushëllohen dhe të qëndroni si dëshmitarë të Perëndisë në të gjitha kohërat dhe në të gjitha gjërat dhe në të gjitha vendet. . . .

Tani unë ju them, në qoftë se kjo është dëshira e zemrave tuaja, çfarë keni kundër pagëzimit në emrin e Zotit, si një dëshmi para tij që ju keni hyrë në një besëlidhje me të, se ju do t’i shërbeni atij dhe do të zbatoni urdhërimet e tij, që ai të mund të derdhë mbi ju Shpirtin e tij më me shumicë?

Dhe tani, kur njerëzit kishin dëgjuar këto fjalë, ata përplasën duart e tyre nga gëzimi dhe thirrën: Kjo është dëshira e zemrave tona.”³

Thënia e motrës Jang dhe këto shkrime të shenjta më bënë të mendoj “detyrat” për të cilat duhet të jemi plotësisht të vetëdijshme në kohën tonë.

Kur pagëzohemi, ne hyjmë në një besëlidhje. Plaku Robert D. Hejls dha mësim: “Kur bëjmë dhe mbajmë besëlidhjet, ne shkëputemi nga bota dhe hyjmë në mbretërinë e Perëndisë”⁴.

Ne ndryshohemi. Ne dukemi ndryshe dhe veprojmë ndryshe. Gjërat që dëgjojmë e lexojmë e themi

janë ndryshe, dhe ajo që veshim është ndryshe pasi bëhemi bija të Perëndisë të lidhura me Të përmes besëlidhjes.

Kur konfirmohemi, ne marrim dhuratën e Frymës së Shenjtë, të drejtën për të pasur ndikimin e vazhdueshëm të një anëtarit të Kreut-Perëndi që të na drejtojë, ngushëllojë e mbrojë. Ai na paralajmëron kur tundohemi që të shpërfillim besëlidhjet tona e të kthehemi në botë. Presidenti Bojd K. Paker jep mësim se asnjëri prej nesh “nuk do të bëjë një gabim të rëndë pa u paralajmëruar më parë nga nxitjet e Frymës së Shenjtë”⁵.

Që të marrim këtë dhuratë dhe që ta kemi gjithmonë Shpirtin me vete, ne duhet të jemi të denja dhe vigjilente në shqyrtimin e gjendjes së zemrës sonë. A është e butë zemra jonë? A kemi një zemër të përlulur, zemër që pranon mësim, një zemër të urtë? Apo mos është bërë zemra jonë dalëngadalë e ngurtësuar ndërsa kemi lejuar që shumë nga zhurma e botës të na heqë vëmendjen nga

nxitjet e buta që me siguri kanë ardhur prej Shpirtit?

Kur u pagëzuam, zemra jonë u ndryshua dhe u zgjua drejt Perëndisë. Gjatë udhëtimit tonë në vdekshmëri, ne vazhdimisht duhet ta pyesim veten: “Në qoftë se ke[m]i provuar një ndryshim të zemrës, . . . a ndihe[m]i kështu tani?”⁶ Dhe nëse jo, atëherë përse jo?

Shumë nga shenjtoret e hershëm e “provua[n] këtë ndryshim të madh në zemrat [e tyre]”⁷. Kjo i përgatiti për të marrë bekimet e tempullit që i forcoi në detyrat e tyre. Shenjtoret e hershëm në Navu shkonin “në tempull gjithë ditën dhe deri vonë natën”⁸ për të marrë ordinancat dhe për të bërë besëlidhjet përpara se të fillonin udhëtimin e tyre drejt përdimit për në Juta.

Sara Riç, një motër e Shoqatës së Ndihmës në Navu, tha këtë: “Ne kemi marrë shumë bekime në shtëpinë e Zotit, që na kanë sjellë gëzim dhe ngushëllim në mes të të gjitha hidhërimëve tona dhe bënë të mundur që ne të kemi besim në Perëndi, duke e ditur

se Ai do të na drejtonte dhe do të na mbështeste në rrugëtimin e panjohur që shtrihej përpara nesh”⁹.

Me zemrat e ndryshuara nga besimi në Shpëtimtarin, ata u mbështetën te fuqia e Shlyerjes së Tij. Ata u zgjuan në veprim. Ata e dinin thellë në zemrën e tyre se kishte një njeri – Shpëtimtari – që i kuptonte sprovat e tyre vetjake pasi Ai i kishte vuajtur ato për ta në Kopshtin e Gjetsemanit dhe në kryq. Ai ndieu frikën e tyre, dyshimin e tyre, dhembjen e tyre dhe vetminë e tyre. Ai vuajti dhembjet e tyre, përndjekjen e tyre, urinë e tyre, lodhjen e tyre dhe humbjet e tyre. Dhe për shkak se i vuajti të gjitha këto gjëra, Ai mundi t’u thoshte atyre: “Ejani tek unë, o ju të gjithë të munduar dhe të rënduar, dhe unë do t’ju jap çlodhje”¹⁰.

Dhe ata erdhën [në Juta]. Ata e mirëbesuan dhe e ndoqën profetin. E dinin se udhëtimi do të ishte i gjatë dhe detyra e tyre [për të ndjekur profetin] e vështirë. E dinin se do të kërkoreshin sakrifica, por të mbështetur nga besimi i tyre dhe duke u kapur pas besëlidhjeve të tyre, ata qenë të përgatitur shpirtërisht.

Para largimit nga Navuja, një grup shenjtorësh shkruan një mesazh në sallën e mbledhjes në tempullin që qenë të detyruar ta braktisnin. Ai thoshte: “Zoti e ka vënë re sakrificën tonë: ndiqni shembullin tonë”¹¹.

Kohët e fundit mora pjesë në një udhëtim pionierësh me të rinjtë dhe të rejat e lagjes sonë. Çdo mëngjes pyesja veten: “Cila është sakrifica ime? Si ta ndjek shembullin e tyre?”

Ditën e dytë të udhëtimit, i kishim tërhequr karrocet tona të dorës për tetë milje (13 km) kur arritëm drejt një vendi të shtegut të quajtur “tërheqja e gruas”. Burrat dhe gratë u ndanë, dhe burrat u dërguan përpara sipër kodrës. Kur filluam t’i tërhiqnim



karrocat tona të dorë, ngrita sytë për të parë vëllezërit tanë të priftërisë, të rinj e të vjetër, të rreshtuar në të dyja anët e shtegut, me kapelat hequr në respekt të grave.

Në fillim rruga qe e lehtë, por shpejt arritëm në ranishte të vështirë dhe kodra u bë e pjerrët. Kisha ulur kokën dhe po shtyja me të gjithë forcën time kur ndieva një lehtësim të karrocës nga një tërheqje dhe ngrita sytë e pashë Leksin, një prej të rejave tona dhe njëkohësisht fqinje e imja. Ajo e kishte tërhequr karrocën e saj të dorës deri në majë dhe, duke parë nevojën tonë për ndihmë, qe kthyer me vrap. Kur arritëm në majë, dëshiroja aq shumë të kthehesha vrapimthi për të ndihmuar të tjerat që kishin mbetur pas, por po merrja frymë me vështirësi dhe zemra po më rrihte aq fort sa fjalët *infarkt zemre* më erdhën në mendje më se një herë! Pashë me mirënjohje teksa të reja të tjera i lëshuan karrocat e tyre të dorës në majë dhe vrapuan të ndihmonin.

Kur gjithsecila arriti në majë, harxhuam pak kohë për të shkruar ndjenjat në ditarët tanë. Unë shkrova: “Nuk u përgatita aq mirë fizikisht kështu që nuk pata forcë të ndihmoja ato që ishin pas meje. Mund të mos më duhet më kurrë të tërheq një karrocë dore, por kurrë nuk dua t’i lëshoj shpirtërisht në baltë motrat, kurrë!”

Qe një përvojë e shenjtë që më bëri shpirtërisht të vetëdijshme për detyrat e mia ndaj familjes sime dhe të tjerëve. Gjatë gjithë udhëtimit tonë, meditova mbi atë që kisha mësuar.

Së pari, mendova rreth motrave të mia, atyre që i *patën* tërhequr dhe atyre që, *sot, vazhdojnë* t’i tërheqin karrocat e tyre të dorës vetëm. Afro 20 përqind e grave në ato kompani të hershme karrocash dore qenë të vetme, të paktën për një pjesë të rrugës. Ato ishin gra që nuk ishin



martuar, që ishin ndarë, ose qenë të veja. Shumë gra qenë nëna beqare¹². Ato të gjitha punuan së bashku – bija të besëlidhjes, të reja e të vjetra, në rrethana të ndryshme të jetës, nëpër të njëjtin shteg, me të njëjtin qëllim.

Ato që vrapuan të ndihmonin motrat e tyre në nevojë më kujtuan shpëtuesit, të vënë re apo të pavënë re, që janë të shpejtë të dallojnë, të shohin një nevojë dhe të veprojnë.

Mendova rreth fjalëve të Zotit: “Unë do të shkoj përpara fytyrës suaj. Unë do të jem në të djathtën e në të majtën tuaj dhe Shpirti im do të jetë në zemrat tuaja e engjëjt e mi përreth jush, për t’ju ngritur lart.”¹³

Të rreshtuar në të dy anët e shtegut qenë burra besnikë e të bindur, që i mbanin besëlidhjet. Fuqia e tyre e priftërisë – fuqia që Perëndia përdor për të bekuar të gjithë fëmijët e Tij – na frymëzoi, forcoi e mbështeti. Ata qenë një kujtues që ne nuk jemi kurrë vetëm. Ne mund ta kemi gjithmonë këtë fuqi me vete ndërsa i mbajmë besëlidhjet tona.

Mendova për burrat që gjatë udhëtimit qenë ndarë nga familjet, duke i lënë që t’i tërhiqnin vetëm karrocat e dorës. Shumë burra vdiqën gjatë udhëtimit. Disa bij mbetën pas për të shërbyer në misione në vendet e tyre të lindjes. Burra të tjerë kishin mërguar më përpara për të bërë përgatitjet për mbërritjen e familjeve të tyre në luginën e Solt-Lejkut. Disa burra munguan

për shkak të zgjedhjes së tyre, pasi kishin zgjedhur të mos i mbanin besëlidhjet e tyre.

Njësoj si ata që jetuan më parë, shumë njerëz sot jetojnë në rrethana që nuk janë ideale. Ne vazhdojmë të japim mësim dhe të përpiqemi për idealin pasi e dimë se përpjekja e vazhdueshme do të na bëjë të vazhdojmë të përparojmë përgjatë shtegut dhe do të na përgatisë për mundësitë për të marrë të gjitha bekimet e premtuara ndërsa “shpresojmë te Zoti”¹⁴.

Secila prej nesh ka pasur dhe do të vazhdojë të ketë vështirësi në jetën e vet. Kjo jetë në vdekshmëri është kohë prove dhe ne do të vazhdojmë të kemi mundësi që të përdorim lirinë tonë të zgjedhjes për të përzgjedhur atë që do të mësojmë nga vështirësitë që me siguri do të vijnë.

Si bija të Perëndisë, ne vazhdojmë në shtegun e besimit pasi ne e pranojmë, siç dha mësim Presidenti Tomas S. Monson, që: “Ordinancat shpëtuese të marra në tempull, që na lejojnë të kthehemi një ditë tek Ati ynë Qiellor në një marrëdhënie familjare të përjetshme dhe të na jepen bekime dhe fuqi që nga lart, ia vlejnjë çdo sakrificë dhe çdo përpjekje”¹⁵.

Nuk është e mjaftueshme thjesht të jesh në rrugëtim; ne duhet të jemi plotësisht të vetëdijshme për detyrat tona dhe të vazhdojmë me besim teksa marrim fuqinë ngushëlluese, forcuese,

ndihmuese dhe shëruese të Shlyerjes.

Motra, unë ju dua. Unë nuk i njoh personalisht shumë nga ju, por e di vërtet se *kush* jeni! Ne jemi bija në mbretërinë e Tij që i mbajmë besëlidhjet dhe, me fuqinë e dhuruar përmes besëlidhjeve tona, ne jemi të përgatitura që të bëjmë detyrën tonë.

Shoqata e Ndhmës i përgatit gratë për bekimet e jetës së përjetshme duke na bërë shpirtërisht të vetëdijshme që të rritemi në besim dhe drejtësi vetjake. Le të fillojmë nga vetja. Le të fillojmë nga aty ku jemi. Le të fillojmë sot. Kur jemi shpirtërisht të vetëdijshme, ne do të jemi në gjendje të forcojmë më mirë familjet e shtëpitë dhe të ndihmojmë të tjerët.

Kjo është puna e shpëtimit, dhe fuqia forcuese e ndihmuese e Shlyerjes e bën të mundur atë. Jini të vetëdijshme mbi atë se *kush* jeni. Jini të vetëdijshme për detyrën tonë. Ne jemi bija të Atit tonë Qiellor, i cili na do. Për këtë unë dëshmoj, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Zina D. Young, në *Woman's Exponent*, 15 tetor 1877, f. 74.
2. Romakëve 13:11-12.
3. Mosia 18:8-11.
4. Robert D. Hales, "Modesty: Reverence for the Lord", *Liahona*, gusht 2008, f. 21.
5. Boyd K. Paker, "How to Survive in Enemy Territory", *Liahona*, tetor 2012, f. 35; Boyd K. Paker, "Si të Mbijetosh në Territor Armik", Seminary Centennial Broadcast [Transmetimi i 100-Vjetorit të Seminarit], 22 janar 2012, www.lds.org/broadcasts.
6. Alma 5:26.
7. Alma 5:14.
8. *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society* (2011), f. 29.
9. Sarah Rich, në *Daughters in My Kingdom*, f. 30.
10. Mateu 11:28.
11. Në *Daughters in My Kingdom*, f. 30.
12. Studim nga historitë dhe regjistrat e kompanisë i drejtuar prej Jolene S. Allphin; shih *Tell My Story, Too*, bot. i 8-të (2012).
13. Doktrina e Besëlidhje 84:88.
14. Isaia 40:31.
15. Tomas S. Monson, "Tempulli i Shenjtë – Një Fener për Botën", *Liahona*, maj 2011, f. 92.



Nga Linda S. Rivs,

Këshilltare e Dytë në Presidencën e Përgjithshme të Shoqatës së Ndhmës

Zoti nuk Ju ka Harruar Juve

Ati ynë Qiellor dhe Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti, na njohin dhe na duan. . . . Ne mund ta ndiejmë dashurinë dhe dhembshurinë e Tyre gjatë vuajtjes sonë.

Kur takojmë motrat anembanë botës, mahnitemi nga forca e dëshmimeve tuaja. Kaq shumë prej jush janë anëtare të brezit të parë ose të dytë të Kishës. Ne shohim shumë motra duke shërbyer në thirrje të shumta, duke përkrahur distanca të gjata për të marrë pjesë në kishë dhe duke sakrifikuar për të bërë e mbajtur besëlidhjet e shenjta të tempullit. Ne ju nderojmë. Ju jeni pionieret e Zotit të kohës së sotme!

Kohët e fundit bashkëshorti im, Meli, dhe unë takuam një cicerone vullnetare të quajtur Mollie Lenthel ndërsa vizituam një muze në Australi. Ne mësuam se Mollie, një grua e dashur rreth të 70-ave, nuk kishte fëmijë dhe nuk ishte martuar asnjëherë. Ajo ishte fëmijë i vetëm dhe prindërit e saj kishin ndërruar jetë para shumë vitesh. Njerëzit e saj më të afërt janë dy kushërinj, të cilët jetojnë në një kontinent tjetër. Papritmas, u pshitova nga Shpirti që më dëshmonte, thujse sikur Ati Qiellor po fliste: "Mollie nuk është vetëm! Mollie është bija ime! Unë jam i Ati! Ajo është një bijë shumë e rëndësishme në familjen time dhe nuk është asnjëherë vetëm!"

Një ndër historitë e mia të parapëlqyera nga jeta e Shpëtimtarit, është

ajo e Lllazarit. Shkrimet e shenjta na tregojnë se "Jezusi e donte Martën, motrën e saj [Marian] dhe [vëllanë e tyre] Lllazarin"¹. Jezusit i çuan fjalë se Lllazari qe shumë sëmure, por Jezusi nuk shkoi fill; Ai qëndroi larg edhe dy ditë të tjera, duke shpallur se "kjo sëmurdje . . . është . . . për lavdinë e Perëndisë, që nëpërmjet saj të përlevdohet Biri i Perëndisë"².

Me të dëgjuar se po vinte Jezusi, Marta "i doli përpara"³, duke i treguar Atij se çka kishte ndodhur. Lllazari "ishte që prej katër ditësh në varr"⁴. Marta, e pikëlluar, vrapoi drejt shtëpisë për t'i treguar Marias se Zoti kishte ardhur.⁵ Maria, e rënduar nga hidhërimi, vrapoi drejt Jezusit, i ra ndër këmbë dhe qau.⁶

Ne na është thënë se "Jezusi, kur pa se [Maria] . . . po qan[te], [i] psherëtiu në frymë dhe u trondit", dhe pyeti se ku e kishin vënë.

Ata i thanë: "Zot, eja e shih!"⁷.

Më pas, lexojmë disa nga fjalët më të dhembshura e të dashura në shkrimin e shenjtë: "Jezusi qau"⁸.

Apostulli Xhejms E. Talmeixh shkroi: "Të shikuarit e dy grave shumë të mposhtura nga pikëllimi . . . bëri që Jezusi të vajtonte [me to], saqë



Ai psherëtiu në frymë dhe u trondit thellësisht⁹. Kjo përvojë dëshmon për dhembshurinë, ndjeshmërinë dhe dashurinë që Shpëtimtari ynë dhe Ati ynë Qiellor ndiejnë për çdonjërin prej nesh çdo herë që ne rëndohemi nga vuajtja, mëkati, fatkeqësia dhe dhembjet e jetës.

Motra të dashura, Ati ynë Qiellor dhe Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti, na njohin dhe na duan. Ata e dinë se kur jemi në dhembje apo vuajtje të çfarëdo lloji. Ata nuk thonë: "S'ka problem që po kalon dhembje pikërisht tani sepse shpejt çdo gjë do të shkojë mirë. Ti do të shërohesh, ose bashkëshorti yt do të gjejë një punë apo fëmija juaj i larguar do të kthehet sërish." Ata e ndiejnë thellësinë e vuajtjes sonë dhe ne mund ta ndiejmë dashurinë dhe dhembshurinë e Tyre gjatë vuajtjes sonë.

Alma dëshmoi:

"Dhe ai do të shkojë përpara, duke vuajtur dhimbje dhe hidhërimi dhe tundime të çdo lloji; dhe kjo, që të plotësohet fjala që thotë se ai do të marrë përsipër dhembjet dhe sëmudjet e popullit të tij.

Dhe ai do të marrë përsipër . . .

dobësitë e tyre, që zemra e tij të mund të mbushet me mëshirë, . . . që ai të mund të dijë, . . . sesi të ndihmojë popullin e tij sipas dobësive të tyre."¹⁰

Kur ne pyesim veten *nëse* Shpëtimtari ynë dhe Ati ynë në Qiell na njohin ose *se sa mirë* na njohin ne personalisht, ne duhet të kujtojmë fjalët e Shpëtimtarit drejtuar Oliver Kaudrit:

"Në qoftë se ti dëshiron dëshmi të mëtejshme, sill ndër mend natën kur më bërtite në zemrën tënde, që të mund të dije lidhur me të vërtetën e këtyre gjërave"¹¹.

Më përpara Shpëtimtari i shpalli atij: "S'ka asnjë tjetër, përveç Perëndisë, që i di mendimet e tua dhe qëllimet e zemrës tënde"¹².

Shpëtimtari e kujtoi Oliverin se Ai e dinte çdo hollësi të asaj lutjeje përgjyruese – dhe e mbante mend kohën e saktë, natën.

Shumë vite më parë, bashkëshorti im u sëmur rëndë nga një sëmundje e rrallë. Ndërsa javët kalonin dhe sëmurej më tepër, u binda akoma dhe më shumë se ai po vdiste. Nuk i tregoja askujt për frikën time. Ne

kishim një familje të madhe e të re dhe një martesë të lumtur e të përjetshme, dhe mendimi se do humbisja bashkëshortin tim dhe se do t'i rrisja fëmijët e vetme më mbushi me vetmi, dëshpërim dhe madje zemërim. Më vjen turp të them se u largova nga Ati im Qiellor. Për ditë të tëra pushova së luturi; rreshta së shpresuari; qava. Përfundimisht arrita të kuptoj se nuk mund ta bëja këtë e vetme.

Për herë të parë pas shumë ditësh, u gjunjëzova dhe i zbraza zemrën në lutje Atit tim në Qiell, duke iu përgjyruar për falje pasi isha larguar prej Tij, duke i treguar Atij gjithë ndjenjat e mia më të thella dhe përfundimisht duke i thënë se nëse kjo që ajo që Ai vërtet donte që unë të bëja, unë do ta bëja. Unë e dija se Ai duhet të ketë një plan për jetën tonë.

Ndërsa vazhdova e gjunjëzuar të zbraza zemrën time në lutje, më pushtoi ndjenja më e ëmbël, më e paqte dhe e dashur. Ishte sikur po më mbulonte një batanije dashurie. Ishte sikur unë mund ta ndieja Atin Qiellor duke thënë: "Kjo që e gjitha që Unë kisha



nevojë të dija”. Vendosa që asnjëherë nuk do të largohesha sërish prej Tij. Gradualisht dhe mrekullisht, bashkëshorti im filloi ta merrte veten derisa u shërua plotësisht.

Vite më vonë, bashkëshorti im dhe unë u gjuhëzuan në krahë të vajzës sonë 17-vjeçare dhe u lutëm që jeta e saj të kursehej. Këtë herë përgjigja që “jo”, por po e njëjta ndjenjë dashurie dhe paqeje që Shpëtimtari ynë kishte premtuar ishte po aq e fuqishme dhe ne e dinim se, ndonëse Ati Qiellor po e thërriste atë në shtëpi, çdo gjë do të shkonte mirë. Ne kemi arritur të dimë se çfarë do të thotë të hedhim mbi Zotin barrat tona, të dimë se Ai na do dhe ndien dhembshuri për ne gjatë pikëllimeve dhe vuajtjeve tona.

Një nga çastet më të këndshme babë e bir në Librin e Mormonit është dëshmia e Alma të Riut kundrejt birit të tij Helamanit. Alma përshkroi “tmerr[im] e papërshkrueshëm” që ai ndieua ndërsa përfytyroi daljen në praninë e Perëndisë për t’u gjykuar për shkeljet e tij të shumta. Pasi ndieua dhembjen e të gjitha mëkateve të tij për tri ditë e

tri netë, ai u pendua dhe iu përgjërua Shpëtimtarit që të kishte mëshirë për të. Ai i përshkroi Helamanit gëzimin “kaq të mrekulluesh[ëm] dhe kaq të ëmbël” të moskujtimit “më” të dhembjeve të tij. Në vend të ndjenjës së “tmerr[im] të papërshkrueshëm” gjatë mendimit të daljes përpara fronit të Perëndisë, Alma pa një vegim të “Perëndi[s]” që të ulur në fronin e tij” dhe shpalli: “Shpirti im donte që të ishte aty”¹³.

A nuk është kjo mënyra se si ndihemi, motra të mia të dashura, tekta pendohemi dhe mendojmë për dashurinë, mëshirën dhe mirënjohjen që ndiejmë për Atin tonë Qiellor dhe Shpëtimtarin tonë – saqë edhe ne “[duam] që të [jemi] aty”, për t’u përqaftuar edhe një herë nga krahët e Tyre të dashur?

Ashtu sikurse Zoti më ka dëshmuar mua që Ai nuk e ka harruar bijën e Tij të çmuar Molli Lenthëlin, unë dëshmoj se Ai nuk *ju ka harruar juve!* Çfarëdo lloj mëkati ose dobësie apo dhembjeje ose lufte ose sprove që po kaloni, Ai i njeh dhe i kupton pikërisht ato çaste. Ai ju do! Dhe Ai do t’ju ndihmojë gjatë atyre çasteve, sikurse veprroi me Marian

dhe Martën. Ai e ka përjetuar vuajtjen tonë nëpërmjet Shlyerjes, që Ai të mund të dijë se si t’ju ndihmojë. Hidhini mbi Të barrat tuaja. Tregojini Atit tuaj Qiellor se si ndiheni. Tregojini Atij rreth dhembjes e vuajtjeve dhe më pas kalojani ato Atij. Studiojini shkrimet e shenja *çdo ditë*. Atje gjithashtu do të gjeni ngushëllim dhe ndihmë të madhe.

Shpëtimtari ynë pyeti:

“Sepse, a mund të harrojë një grua foshnjën e gjirit, që ajo të mos ketë mëshirë për birin e barkut të saj? Po, ata mund të harrojnë, por unë nuk do të harroj. . . .

. . . Unë të kam gdhendur në pëllëmbët e duarve të mia.”¹⁴

“Kam urdhëruar që *askush* prej jush nuk duhet të largohet, por në vend të kësaj kam urdhëruar që ju të vini tek unë, që të mund të ndieni dhe të shihni; kështu madje, do të bëni ndaj botës.”¹⁵

Kjo është detyra jonë. Ne duhet të ndiejmë dhe të shohim për veten tonë, dhe më pas t’i ndihmojmë të gjithë fëmijët e Atit Qiellor të ndiejnë dhe të shohin e të dinë se Shpëtimtari ynë ka marrë mbi Vete jo vetëm të gjitha mëkatet tona por edhe dhembjet, vuajtjet dhe hidhërimet tona në mënyrë që Ai të mund të dijë se çfarë ndiejmë dhe se si të na ngushëllojë. Unë dëshmoj për Të, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Gjoni 11:5.
2. Gjoni 11:4.
3. Gjoni 11:20.
4. Gjoni 11:17.
5. Shih Gjoni 11:28.
6. Shih Gjoni 11:32.
7. Gjoni 11:33–34.
8. Gjoni 11:35.
9. James E. Talmage, *Jesus the Christ*, botimi i 3-të (1916), f. 493.
10. Alma 7:11–12.
11. Doktrina e Besëlidhje 6:22.
12. Doktrina e Besëlidhje 6:16.
13. Shih Alma 36:14–22; theksimi i shtuar.
14. 1 Nefi 21:15–16.
15. 3 Nefi 18:25; theksimi i shtuar.



Nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

Kujdestarja

Ju do të forcoheni dhe madje do të frymëzoheni për të ditur shkallën e aftësisë suaj për të shërbyer.

Jam mirënjohës që ndodhem në praninë tuaj sonte. Gratë e Kishës së Jezu Krishtit kanë përparuar drejt të qenit ajo shoqatë motrash të cilën nëna e Profetit Jozef Smith, Lusi Mek Smith, e përshkroi me këto fjalë: “Ne duhet ta duam fort njëra-tjetrën, ta mbrojmë njëra-tjetrën, ta ngushëlojmë njëra-tjetrën dhe të marrim udhëzim, që të mund të qëndrojmë të gjitha në qiell së bashku”¹.

Ka tri pjesë të atij përshkrimi të mrekullueshëm të kushteve për t’u shoqëruar në një gjendje lumturie me Perëndinë. Njëra është që të kujdesemi për njëri-tjetrin. Tjetra është për të dhënë dhe për të marrë mësim nga njëri-tjetri. Dhe e treta është të qëndrojmë së bashku me Perëndinë.

Qëllimi im sonte është t’ju ndihmoj të ndieni miratimin dhe vlerësimin e Perëndisë për atë që keni bërë tashmë, për të ndihmuar njëra-tjetrën që ta arrini atë synim fisnik. Dhe qëllimi i dytë është t’ju përshkruaj pak prej asaj që ende nuk ka ndodhur në shërbimin tuaj të bashkuar.

Njësoj si motrat që jetuan në një kohë më të hershme, ju i jeni përgjigjur thirrjes së Zotit për të shkuar e për t’i ndihmuar të tjerët. Në 1856-ën, profeti Brigam Jang u kërkoi shenjtoreve t’iu vinin në ndihmë pionierëve të karrocave të dorës të bllokuar në

malet me dëborë. Ai u tha anëtarëve në atë kohë nevojë në konferencën e përgjithshme: “Besimi, feja dhe shfaqja e besimit tuaj, nuk do të shpëtojnë asnjë shpirt prej jush në mbretërinë çelestiale të Perëndisë sonë, veç nëse veproni sipas pikërisht këtyre parimeve që po ju mësoj tani. Shkoni dhe sillini ata njerëz tani në rrafshina [në Juta] dhe kujdesuni tërësisht për ato gjëra që i quajmë materiale, . . . përndryshe besimi juaj do të jetë i kotë.”²

[Kësaj] thirrjeje iu përgjigjen qindra gra në Juta. Megjithëse ishin të varfra, ato i mbushën vagonat me gjithçka që mundën të kursenin, dhe gjithçka që mundën të merrnin nga të tjerët për të ngushëlluar njerëzit në fatkeqësi. Një nga ato motra trime shkroi: “Unë nuk kam ndier kurrë më shumë përmbushje dhe mund të them, kënaqësi, nga asnjë punë që kam bërë ndonjëherë në jetën time, për shkak të harmonisë së ndjenjës që mbizotëronte”³.

Kur operacioni i shpëtimit përfundoi dhe dëborat u shkri, po e njëjta motër shënoi pyetjen e zemrës së saj besnike: “Çfarë ka për të bërë pas kësaj nga ata që janë të gatshëm të veprojnë?”⁴

Në kohën tonë, grupe motrash të guximshme përfaqësojnë botën e kanë kthyer besimin e tyre në veprim në qindra vende. Dhe në zemrat dhe

lutjet e tyre ato bëjnë të njëjtën pyetje rreth të ardhmes së jetës së tyre në shërbim.

Secila prej jush është në një situatë të pasqyruar në udhëtimin e saj për në jetën e përjetshme. Disa kanë vite përvojë dhe të tjera janë të reja në dishepullimin e tyre në vdekshmëri. Secila është e pasqyruar në historinë dhe sfidat e saj vetjake. Por që të gjitha ju jeni motra dhe bija të dashura të Atit tonë Qiellor, i cili e njeh dhe e mbulon çdonjërin prej jush.

Ajo që keni bërë mahnitshëm mirë së bashku, është se e keni dashur, e keni mbrojtur dhe e keni ngushëlluar njëra-tjetrën. Unë qeshë dëshmitar i asaj mrekullie tripalëshe vetëm një muaj më parë kur pashë shërbimin tuaj ndaj një motre. Si babai i saj, ju falënderoj dhe e falënderoj Perëndinë i cili udhëhoqi një mësuese vizitore.

Bija jonë, Elizabeta, e cila jeton në një shtet dhe një zonë me orare të ndryshme nga ne, ishte në shtëpi me të bijën trivjeçare. Fëmija tjetër i saj ishte në javën e parë të kopshtit. Elizabeta që gjashtë muajshe shtatzënë, duke pritur lindjen e fëmijës së saj të tretë, për të cilën mjekët thanë se do të ishte sërish vajzë. I shoqi, Xhoshua, ishte larg me punë.

Kur pa se po humbiste gjak dhe se gjakderdhja po shtoej, ajo i telefonoi të shoqit. Ai i tha asaj t’i telefononte ambulancës dhe se do të takohej me të në spital, që ishte 25 minuta larg shtëpisë së saj. Përpara se ta bënte telefonatën, ajo dëgjoi një trokitje në derën kryesore.

U habit kur pa në derë shoqen me të cilën bënte vizitat mësimore të Shoqatës së Ndihmës. Ato nuk kishin asnjë takim për atë mëngjes. Shoqja e saj e vizitave mësimore thjesht kishte ndier se duhej të vinte ta shihte Elizabetën.

Ajo e ndihmoi atë të futej në



vetjake, unë mund t'ju them diçka që ju pret në të ardhmen. Ndërsa vazhdoni të jeni besnike, ju do ta gjeni veten të ftuar nga Zoti shpesh për t'i shërbyer dikujt në nevojë kur nuk do të duket e volitshme. Mund të duket një detyrë e papëlqyeshme dhe ndofta edhe e pamundur. Kur vjen thirrja, mund t'ju duket se nuk ka nevojë për ju ose që dikush tjetër mund ta japë ndihmën.

Kujtoni se kur Zoti na lejon të ndeshim dikë në fatkeqësi, ne e respektojmë Samaritanin e mirë për atë që nuk bëri ashtu sikurse edhe për atë që bëri. Ai nuk kaloi nga ana tjetër megjithëse udhëtari i rrahur në rrugë që një i huaj dhe ndofta një armik. Ai bëri atë që mundi për burrin e rrahur dhe pastaj vuri në veprim një plan të posaçëm që të tjerët të bënin më tepër. Ai e bëri atë sepse e kuptoi se për të ndihmuar mund të nevojitet më shumë se ajo çka mund të bëjë një njeri.

Mësimet në historinë e Samaritanit të mirë mund t'ju udhëzojnë pavarësisht nga ajo që ju pret në të ardhmen. Po të njëjtat mësimet qenë të gjindshme në fëmijërinë tuaj dhe në përvojat e kohëve të fundit.

Së paku njëherë, dhe ndoshta shpesh, ju jeni befasuar kur jeni ndeshur me dikë në nevojë për përkujdesje. Mund të ketë qenë një prind, një gjysh, një motër ose një fëmijë, një vëlla apo motër e goditur nga sëmundja ose paaftësia. Ndjenjat tuaja të dhembshurisë mbizotëruan mbi dëshirat tuaja njerëzore. Ndaj, ju filluat të jepnit ndihmë.

Sikurse udhëtari në historinë e shkrimit të shenjtë për Samaritanin e mirë, ka gjasa që ndihma e nevojshme të jetë kthyer në një përkujdesje me afat më të gjatë sesa mund ta jepni të vetme. Samaritanit iu desh ta kalonte udhëtarin nën kujdesin e hanxhiut. Puna në grup për t'u shërbyer

makinë. Ato arritën në spital disa minuta përpara se të mbërrinte Xhoshua nga puna. Mjekët vendosën në më pak se 20 minuta për ta nxjerrë foshnjën nëpërmjet ndërhyrjes kirurgjikale që të shpëtonin Elizabetën dhe foshnjën e saj. Kështu erdhi në botë një vajzë e vockël, duke qarë fort, 15 javë përpara parashikimit. Ajo peshonte 765 gram. Por ajo ishte gjallë dhe po kështu edhe Elizabeta.

Një pjesë e fjalëve të Lusi Mek Smithit u përmbush atë ditë. Një anëtare besnike e Shoqatës së Ndhmës, e nxitur nga Fryma e Shenjtë, e mbrojti, tregoi dashuri dhe e ngushëlloi motrën e saj në mbretërinë e Perëndisë. Ajo dhe dhjetëra mijëra të tjera që kanë dhënë shërbim kaq të frymëzuar përgjatë brezave, kanë jo vetëm falënderimin e atyre që kanë ndihmuar dhe të njerëzve të tyre të dashur, por edhe të Zotit.

Ju i mbani mend fjalët e Tij vlerësuese ndaj atyre që marrin pak vlerësim për mirëdashjen e tyre: "Dhe Mbreti duke iu përgjigjur do t'u thotë: 'Në të vërtetë po ju them: sa herë ia keni bërë këtë ndonjërit prej këtyre vëllezërve të mi më të vegjël, këtë ma bëtë mua'"⁵.

Por mrekullia e një motre të Shoqatës së Ndhmës që mbërrin pikërisht në kohë për të ndihmuar, shumëfishohet përmes fuqisë së një shoqate të bashkuar motrash. Këtu është një pjesë e mesazhit që peshkopi

i Elizabetës i dërgoi asaj dhe Xhoshuas në spital disa orë pasi kishte lindur foshnja: "Presidentja e Shoqatës së Ndhmës ka gjithçka nën kontroll. Ne tashmë jemi duke hartuar një plan të ardhshëm për të ndihmuar vajzat tuaja në mënyrë që Elizabeta të shkojë e të vijë në spital ndërkohë që foshnja e bukur dhe pa emër qëndron atje. Ne i kemi ndihmuar të tjerët në situata të ngjashme më parë, për periudha të gjata kohe, dhe njerëzit [tanë] e mirëpresin këtë mundësi".

Peshkopi vazhdonte të thoshte në letër, duke folur në emrin e vet dhe të lagjes: "Ne madje kemi ardhur në spital dhe jemi ulur me fëmijët në dhomën e lojërave kur nënat nuk dëshironin t'i linin ata diku tjetër".

Dhe më pas: "Ne sigurisht që nuk do ta zbatojmë planin tonë pa bashkërendim dhe miratim prej teje. Thjesht dëshironim të të vinim në dijeni që të mos shqetësohesh për gjërat që ne mund dhe [do të] bëjmë."

Ajo që ato bëjnë për bijën time, bëri të mundur që ajo të kishte një çast të çmuar me vajzën e saj të vockël, kur e mbajti atë për herë të parë në krahë.

Dhe më pas peshkopi e mbylli mesazhin e tij për Xhoshuan dhe Elizabetën me një mesazh që motrat dërgojnë me zotimin e tyre anekënd botës për t'i shërbyer njëra-tjetrës për Mësuesin: "Vazhdo të besosh".

Me gjithë ndryshimet në rrethanat dhe në përvojat tuaja të kaluara

njerëzve të tjerë në nevojë është pjesë e planit të Zotit.

Peshkopët dhe presidentet e Shoqatës së Ndhmës i ftojnë gjithnjë pjesëtarët e familjes që ta ndihmojnë njëri-tjetrin kur ka një nevojë. Ka shumë arsye për atë parim. Arsyeja më kryesore është që t'u sigurojë më shumë njerëzve bekimin e dashurisë së madhe që vjen nga shërbimi ndaj njëri-tjetrit.

Ju e keni vëzhguar dhe e keni ndier atë bekim. Kurdoherë që jeni kujdesur për dikë, edhe për një kohë të shkurtër, ju keni ndier dashuri për njeriun të cilit i shërbyet. Kur koha për të dhënë përkujdesje zgjatet, ndjenjat e dashurisë janë të prirura të shtohen.

Duke qenë se ne jemi të vdekshëm, ai shtim i dashurisë mund të ndërpritet nga ndjenjat e acarimit dhe lodhjes. Kjo është një arsye tjetër përse Zoti na lejon që t'i ndihmojmë të tjerët në shërbimin tonë ndaj atyre në nevojë. Kjo është arsyeja përse Zoti ka krijuar shoqata kujdestaresh.

Pak javë më parë, isha i pranishëm kur një grua e re u ngrit për t'u mbështetur në mbledhjen e sakramentit si ndihmësbashkërenduesja e vizitave mësimore. Pyeta veten nëse ajo e dinte se çfarë nderi po i bënte Zoti. Për shkak të një fëmije të zhurmshëm, asaj iu desh të largohej nga mbledhja përpara se të mundesha t'i thoja se sa do ta donte dhe do ta vlerësonte Zoti atë për ndihmën e bashkërendimit të përpjekjeve të dishepujve të Tij.

Përkujdesja për njerëzit në nevojë kërkon një grup, një shoqatë të dashur e të bashkuar. Kjo është ajo që Zoti po ndërton në mesin tuaj. Ai ju do për çdo rol që luani.

Një fakt i vlerësimit të Tij është se Perëndia ju lejon të ndieni gjithnjë e më shumë dashuri për ata të cilëve u shërbeni. Kjo është një arsye përse ju qani në vdekjen e dikujt që i keni

shërbyer për një kohë të gjatë. Humbja e mundësisë për t'u kujdesur për ata mund të duket si një humbje madje më e madhe seç duket ndarja e përkohshme. Kohët e fundit, dëgjova një grua, javën kur i vdiq i shoqi, tek jepte një dëshmi mirënjohjeje për mundësinë që pati për t'i shërbyer atij deri në fund të jetës. Lotët nuk i dukeshin, por dukej buzëqeshja e saj e lumtur.

Megjithëse shërbimi i zgatur dhe i dhembshur ndaj njerëzve shpërblehet bujarisht, ju keni mësuar se ka kufij fizikë, emocionalë dhe financiarë për atë që është e mundur. Njeriu që kujdeset, mund të bëhet pas disa kohësh njeriu që ka nevojë për përkujdesje.

Zoti, që është Ndhmësi Mjeshtër i njerëzve në nevojë, u dha kujdestarëve të lodhur këshillë të frymëzuar me këto fjalë të shënuara në Librin e Mormonit: "Për hirin e ruajtjes së një heqjeje të mëkateve tuaja . . . unë do të doja që ju t'u jepni nga pasuria juaj të varfërve, çdo njeri sipas asaj që ka, në mënyrë që të ushqehen të uriturit, të vishen të zhveshurit, të vizitohen të sëmurët dhe t'u jepni ndihmë atyre qoftë shpirtërisht, ashtu edhe



materialisht, sipas nevojave të tyre"⁶.

Por më pas Ai vazhdon t'i paralajmërojë ata prej jush që mund të mos reagojnë përpara faktit se ju jeni duke tejkaluar dhe duke e zgatur më tepër seç duhet shërbimin tuaj me dashuri: "Dhe shikoni, që të gjitha këto gjëra të jenë bërë në urtësi dhe rregull; pasi nuk është e nevojshme që një njeri duhet të vrapojë më shpejt sesa ai ka fuqi. Dhe përsëri, është e domosdoshme që ai duhet të jetë i zellshëm, që kështu të mund të fitojë çmimin; prandaj të gjitha gjërat duhet të bëhen në rregull."⁷

Ajo këshillë mund të jetë e vështirë për t'u zbatuar kur duket se zgjedhja po baraspeshon një dëshirë për të bërë gjithçka mundeni për t'i ndihmuar të tjerët, me urtësinë për të qenë të matur në plotësimin e nevojave tuaja vetjake që të mund të keni ende fuqi për të shërbyer. Ju mund t'i keni parë të tjerët duke u munduar me zgjedhje të tilla të vështira. Një shembull është zgjedhja për t'u kujdesur për një njeri në prag të fundit të jetës në shtëpi ose në një godinë përkujdesjeje kur mund të jeni pranë rraskapitjes.

Ajo që dini rreth planit të shpëtimit, mund të jetë udhërrëfyese juaj në zgjedhje të tilla zemërcopëtuese. Kjo është një nga arsyet përse Lusi Mek Smith tha me urtësi se motrat duhet të "marri[n] udhëzim".

Kjo ndihmon për të pasur një bindje të sigurt për qëllimin e Zotit për çdo fëmijë të Perëndisë gjatë përvojës të mundimshme të jetës në vdekshmëri. Ai ia mësoi Profetit Jozef Smith thelbin e planit të shpëtimit në këtë mënyrë, ndërsa ai përpiqej t'i kuptonte sprovat e tij në dukje të pafundme: "Dhe atëherë, në qoftë se i duron mirë ato, Perëndia do të të lartësojë nga lart"⁸.

Zgjedhja jonë për ta ndihmuar më së miri një njeri atëherë bëhet: "Çfarë



drejtimi duhet të ndjek që ta ndihmoj më së miri njeriun që dua që ai të 'duroj[ë] mirë?' Qëllimi ynë është që të bëjmë [shërbimin] më të mundur që ata të mund të ushtrojnë besim tek Krishti, të mbajnë një shpresë të shndritshme për jetën e përjetshme dhe të vënë në veprim dashurinë hyjnore, dashurinë e pastër të Krishtit, deri në fund të jetës së tyre.

Kam parë motra në mbretëri që përqendrohen te Shpëtimtari dhe te qëllimi i Tij. Mendoni për ato kohë kur keni hyrë në dhomën ku janë mbledhur Shoqata e Ndihmës, Fillorja ose Të Rejat.

Një figurë e Shpëtimtarit dhe e Fjalëve të Tij mund të mos jetë e dukshme, por ju e dini se në atë orë është ndier një dëshmi për vërtetësinë dhe vlerat e Shlyerjes së Tij. Atje mund të mos ketë një figurë të një tempulli të shenjtë me fjalët "Familjet Mund të Jenë Përgjithmonë", por ju e shihni shpresën në buzëqeshjet e tyre.

Dhe ju e keni parë, siç e kam parë unë, një mësuese të mençur vizitore t'i japë një motre që përpiket, sigurinë se shërbimi i saj ndaj dikujt tjetër është ende i nevojshëm dhe me vlerë. Presidentet e shkëlqyera të Shoqatës

së Ndihmës i gjejnë mënyrat për t'i lejuar ato që kanë nevojë për përkujdesje, që të ndihmojnë në kujdesin ndaj të tjerëve. Ato u krijojnë mundësi motrave që t'i durojnë mirë sprovat e tyre ndërsa kujdesen për njëra-tjetrën në dashurinë e pastër të Krishtit. Kjo mund të përfshijë nxitjen e qetë të kujdestares së lodhur që të pushojë e të pranojë ndihmën e të tjerëve.

Motrat e bëjnë këtë të mundur duke qenë të ngadalta në gjykimin e atyre që po kalojnë prova. Shumica e njerëzve që mbajnë barra të rënda, fillojnë ta vënë veten dhe vlerën e tyre në dyshim. Ne i lehtësojmë barrat e tyre ndërsa jemi të duruar me dobësitë e tyre dhe kremtojmë çfarëdo të mire që mund të shohim tek ata. Këtë bën Zoti. Dhe ne mund ta ndjekim shembullin e Tij – Ai, ndihmësi më i madh i të gjithëve.

Ne flasim shpesh për forcën e grupit të motrave në Kishën e Jezu Krishtit. Ne duhet të mësojmë të dallojmë se Shpëtimtari është përherë në grup kur ne e ftojme Atë.

Ne do të shohim gjithnjë e më tepër bija të Perëndisë që ftojnë motra në grup me to. Kur motrat të hyjnë në një mbledhje dhe të

kërkojnë një karrige, ato do të dëgjojnë të thuhet butësisht fjalët: "Të lutem, eja ulu me mua".

Ne do t'i dëgjojmë ato fjalë në atë ditë të ardhshme që Lusi Mek Smith parashikoi se motrat do të "qëndrojnë në qiell së bashku". Ne nuk përgatitemi për atë ditë në një çast të vetëm. Ajo do të vijë nga ditë dhe vite përkujdesjeje për njëri-tjetrin dhe depërtimi i fjalëve të jetës së përjetshme thellë në zemrat tona.

Lutja ime është që shumë prej nesh do të jenë së bashku në të ardhmen e lavdishme që shtrihet para nesh. Unë ju jap dëshminë time se shpresa juaj për ato ditë do të jetë e justifikuar. Zoti Jezu Krisht e bëri të mundur këtë për secilën prej jush nëpërmjet Shlyerjes së Tij të pafundme. Ati Qiellor i dëgjon dhe u përgjigjet lutjeve tuaja me besim për drejtim dhe për ndihmë që të duroni në shërbimin tuaj.

Juve dhe atyre të cilëve u shërbeni me gjithë zemër ju është dërguar Fryma e Shenjtë. Ju do të forcoheni dhe madje do të frymëzoheni për të ditur shkallën e aftësisë suaj për të shërbyer. Shpirti do t'ju ngushëllojë kur të pyesni veten: "A bëra aq sa duhej?"

Unë dëshmoj se Zoti do të jetë me ju dhe se udha juaj do të përgatitet dhe do të shënohet për ju nga Ai, kur ju shërbeni në nevojat dhe sprovat e atyre njerëzve që Ai i do. Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Lucy Mack Smith, në *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society* (2011), f. 25.
2. Brigham Young, në *Daughters in My Kingdom*, f. 36.
3. Lucy Meserve Smith, në *Daughters in My Kingdom*, f. 37.
4. Lucy Meserve Smith, në *Daughters in My Kingdom*, f. 37.
5. Mateu 25:40.
6. Mosia 4:26.
7. Mosia 4:27.
8. Doktrina e Besëlidhje 121:8.

Treguesi i Ngjarjeve në Konferencë

Lista vijuese e përvojave të përzgjedhura nga fjalimet në konferencën e përgjithshme mund të përdoret për studim vetjak, mbrëmje familjare dhe mësimdhënie tjetër. Folësit janë radhitur sipas rendit alfabetik dhe numri tregon faqen e parë të bisedës.

FOLËSI	NGJARJA
Nil L. Andersen	(39) Besimi i një familjeje nuk lëkundet pas vdekjes së bijës së tyre.
Shein M. Bouen	(15) Shein M. Bouen dhe shoku i tij misionar i mësojnë një familjeje se fëmijët e vegjël nuk kanë nevojë për pagëzim.
Linda K. Barton	(78) Një grua e ndihmon Linda K. Bartonin gjatë vizitës së saj të dytë në tempull si e sapomartuar. (111) Pionierja Meri Luis Uolker humbet bashkëshortin e saj dhe një fëmijë ndërsa kalon rrafshinat.
Krejg C. Kristensen	(12) Gjashtëvjeçari Ben Kristensen ndien Frymën e Shenjtë ndërsa viziton një shtëpi të hapur tempulli.
D. Tod Kristoferson	(47) Një djalosh në Indi punon shumë për të ndihmuar familjen e tij dhe për t'u arsimuar.
Kuentin L. Kuk	(6) Olimpisti britanik Erik Lidell nuk pranon të vrapojë në një garë të dielën.
En M. Dib	(10) Një e re vesh me besim në vetvete një bluzë që shpall anëtarësinë e saj në Kishë.
Leri Eko Houk	(32) Instruktori i stërvitjes së Leri Eko Houkut zbulon kopjen e tij të Librit të Mormonit.
Henri B. Ajring	(60) Henri B. Ajring gdhend një tabelë për secilin prej bijve të tij për të përfaqësuar dhuratat e tij të veçanta. (72) Mbesa e Henri B. Ajringut kërkon Jezusin në një shtëpi të hapur tempulli. (72) Henri B. Ajring largohet nga Universiteti i Stenfordit për t'u punësuar në kolegjin "Riks". (72) Nusja e [njërit prej bijve të] Henri B. Ajringut lutet në plazh dhe ia kushton kohën e saj Zotit.
Robert C. Gei	(34) Babai i Robert C. Geit e pyet atë nëse do ta shiste shpirtin e vet për një monedhë pesëqindarkëshe. (34) Robert C. Gei ndjek një nxitje për të ndihmuar një djalë që po qante me dënësë në anë të rrugës.
Daniel L. Xhonsen	(101) Shenjtorë të ditëve të mëvonshme frekuentojnë tempullin pasi një shtrëngatë shkatërron prodhimet e tyre frutore.
Tomas S. Monson	(68) N. Eldon Taneri befasohet kur sheh katër burra që përparojnë në priftëri. (68) Tomas S. Monsoni merr frymëzim për të thirrur presidentë dege. (68) Xhon H. Grobergu jep dëshminë e tij para mbretit të Tongas. (86) Tomas S. Monsoni ndjek një nxitje që të japë sugjerime për punën misionare. (86) Tomas S. Monson ndjek një nxitje për të vizituar një shok në spital. (86) Tomas S. Monsoni nxit një të ri që të shërbejë në një mision. (86) Një lutje nga rinia në një festim kulturor për tempullin, merr përgjigje.
Rasëll M. Nelson	(18) Një burrë i përgjigjet një nxitjeje për të "ndal[uar] djemtë mbi biçikleta".
Rasëll T. Osguthorp	(96) Të rinj që marrin pjesë në Shkollën e së Dielës ndihmojnë dy anëtarë të klasës me autizëm që të tregojnë atë çfarë kanë mësuar.
Bojd K. Paker	(75) Anija e Bojd K. Pakerit goditet nga një stuhi e rreptë oqeanike në Samoan Perëndimore.
Linda S. Rivs	(118) Linda S. Rivs i drejtohet Perëndisë pasi bashkëshorti i saj sëmuret.
Riçard G. Skot	(93) Të rinj në Rusi indeksojnë 2.000 emra secili dhe paraqesin emrin e një paraardhësi për punë në tempull.
Karol M. Stivens	(115) Të rejtat vijjnë në ndihmë të njëra-tjetrës gjatë një ripërshkimi të udhëtimit të pionierëve.
Geri E. Stivenson	(51) Një student universiteti largohet nga një festë në Japoni pasi refuzon cigare me marihuanë.
Skot D. Uaiting	(37) Kontraktuesit e tempullit rregullojnë dy cene të vogla në Tempullin e Laiet në Havai.

Ulet Nivelit i Moshës së Kërkuar për Shërbim Misionar

Nga Hithër Uaitëll Rigli

Lajme dhe Ngjarje të Kishës

Gjatë fillimit të Konferencës së Përgjithshme Gjysmëvjetore të 182-të, Presidenti Tomas S. Monson njoftoi se, duke hyrë në fuqi menjëherë, meshkujt mund të fillojnë të shërbejnë në misione në moshën 18 vjeç dhe femrat në moshën 19 vjeçe.

Më vonë, në një konferencë për shtyp, Plaku Rasëll M. Nelson, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, theksoi se ndryshimi është një mundësi: “Të rinjtë dhe të rejat nuk duhet ta fillojnë shërbimin e tyre përpara se të jenë të përgatitur shpirtërisht dhe materialisht”, tha ai. Gjëra të tilla si arsimi, rrethanat familjare dhe shëndeti ende

vazhdojnë të jenë faktorë të rëndësishëm për kohën e shërbimit misionar.

Plaku Xhefri R. Holland, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, shpjegoi se misionarët e ardhshëm mund të rekomandohen nga peshkopi dhe presidenti i tyre i kunjit për shërbim me kohë të plotë 120 ditë përpara ditëlindjes së tyre të 18-të ose datës kur ata janë të disponueshëm. Të rinjtë mund të hyjnë në qendrën e trajnimit të misionarëve (QTM) pasi të kenë marrë diplomën e shkollës së mesme ose të barasvlershmen e saj dhe kur të mbushin 18 vjeç. Femrat mund të hyjnë pasi të kenë mbushur 19 vjeçe.

Të rinjtë dhe të rejat tani mund të fillojnë të shërbejnë në misione përkatësisht nga moshat 18 dhe 19 vjeç, në varësi të rrethanave individuale dhe të përcaktimit nga udhëheqësit vendorë të priftërisë.

Misionarëve të ardhshëm po u kërkohet ta shtojnë përgatitjen e tyre para misionit, përpara kohës së tyre në QTM.

“Perëndia po e shpejton punën e Tij”, tha Plaku Holland. “Dhe Ai ka nevojë për gjithnjë e më shumë misionarë të gatshëm e të denjë që të përhapin dritën e së vërtetës dhe shpresën e shpëtimit të ungjillit të Jezu Krishtit në një botë shpesh të errët e të frikshme.”

Plaku Holland tha se ka gjasë që do të krijohen misione të tjera.

Për të ndihmuar që të përshtatet rritja e parashikuar e misionarëve në misionet anekënd botës, koha e kaluar në QTM do të zvogëlohet me një të tretën për të gjithë misionarët. Një kurs trajnimi 12-javor i krijuar së fundi, i mbajtur në terrenin e misionit, do të ndihmojë për t'i përgatitur më tej misionarët. ■

Lexoni më shumë duke kërkuar “missionary age requirement” [“mosha e kërkuar për mision”] në news.lds.org.

Mësime për Kohën Tonë

Nga tetori i 2012-ës deri në mars të 2013-ës, mësimet e Priftërisë Melkizedeke dhe të Shoqatës së Ndhmës për të dielën e katërt duhet të përgatiten nga një ose më shumë biseda të dhëna në konferencën e përgjithshme të tetorit 2012. Në prill 2013, bisedat mund të përzgjidhen ose nga konferenca e tetorit 2012 ose konferenca e prillit 2013. Presidentët e kunjëve dhe të distrikteve duhet të zgjedhin se cilat biseda do të përdoren në zonat e tyre.

Mësoni më shumë duke shqyrtuar seksionin “Mësime për Kohën Tonë” të revistës *Liahona* maj 2012 (lds.org/liahona). ■





Ejani, më Ndiqni është një program i ri mësimor që do t'i ndihmojë mësuesit të japin mësim sipas mënyrës së Shpëtimtarit dhe do t'i ndihmojë të rinjtë të bëhen më të kthyer në besim në ungjill.

Kisha Njofton Programin e Ri Mësimor për Rininë, për vitin 2013

Kisha ka njoftuar një program të ri mësimor – *Ejani, më Ndiqni: Burime Mësimdhënieje për Rininë* – për klasat e kuorumeve të Priftërisë Aarone, të Të Rejave dhe ato të Shkollës të së Dielës për rininë, për vitin 2013.

Një nga qëllimet madhore të programit *Ejani, më Ndiqni* është t'i ndihmojë mësuesit – në kishë dhe në shtëpi – të japin mësim siç dha Shpëtimtari, duke i bërë mësimet më shumë si bashkëbisedime që kanë në qendër ungjillin. Rinia do të ftohet të luajë një rol më të madh në mësimdhënie dhe të nxënit.

“Fokusi është në forcimin dhe ndërtimin e besimit, kthimin në besim dhe dëshminë, duke përdorur mësimet më të fundit të Autoriteteve të Përgjithshme dhe të presidencave të përgjithshme të organizatave ndihmëse”, thuhet në letrën e 12 shtatorit 2012 nga Presidenca e Parë.

Ejani, më Ndiqni është e organizuar në njësi, që përqendrohen në një temë doktrinale çdo muaj dhe ndahen nëpër klasat e Shkollës të së Dielës, të Të Rejave dhe Priftërisë Aarone.

Në secilën njësi ka më shumë mësim sesa mund të jepen gjatë një muaji, ndaj mësuesit dhe udhëheqësit

ftohen që të kërkojnë frymëzim dhe të bashkëveprojnë për të vendosur se cilat pjesë nga programi mësimor të përdorin.

Një libër i ri udhëzues, *Mësimdhënia sipas Mënyrës së Shpëtimtarit*, do t'i ndihmojë udhëheqësit dhe mësuesit të kuptojnë më mirë si t'i përshtasin mësimet me nevojat e veçanta të rinjve të tyre dhe si ta ndihmojnë rininë të mësojë ungjillin.

Të gjitha mësimet janë të shtypshme nga interneti. Versionet e shtypura të *Ejani, më Ndiqni* do të jenë të disponueshme më vonë. Nga fundi i vitit 2012 të gjitha pjesët e programit mësimor do të jenë të disponueshme në 23 gjuhë.

Anëtarët, udhëheqësit dhe mësuesit mund ta shqyrtojnë programin e ri mësimor në internet në **lds.org/youth/learn**.

Udhëheqësit zonalë dhe vendorë do të sigurojnë trajnim për udhëheqësit dhe mësuesit përpara fundit të vitit 2012. ■

Mësoni më shumë në news.lds.org. Gjithashtu shihni faqen 96 të këtij botimi.

Mjetet e Reja u Vijnë në Ndhmë Anëtarëve që të Përgatisin Emrat e Familjes

Në një letër që daton më 8 tetor 2012, Presidenca e Parë i ftoi anëtarët – rininë dhe të rinjtë në moshë madhore beqarë në veçanti – që të marrin bekimet e plota të tempullit duke përgatitur emrat e vetë familjeve të tyre për t'i çuar në tempull.

Për më tepër, ata me “numër të madh emrash të rezervuar të familjeve [nxiten] t'i dorëzojnë këta emra shpejt në mënyrë që të kryhen ordinancat e nevojshme”.

Për t'i ndihmuar anëtarët që t'i përgjigjen thirrjes së Presidencës së Parë, Kisha po zhvillon burime dhe përvoja të reja, që mund të gjenden në 10 gjuhë në adresën familysearch.org.

Për shembull, një përmirësim i fundit në adresën new.familysearch.org, i quajtur Family Tree [Trungu Familjar], siguron një qasje të gjerë për historinë tonë familjare duke i lejuar përdoruesit 1) të lidhen dhe të bashkëpunojnë me linjat e për-bashkëta familjare, 2) t'i ndryshojnë dhe t'i fshijnë të dhënat e gabuara dhe 3) t'i vendosin lehtësisht në sistem emrat e paraardhësve për ordinancat e tempullit. Përdoruesit mund edhe të gjejnë video për “Assigning Names to the Temple” [“Paraqitjen e Emrave në Tempull”] dhe trajnime të tjera te adresa familysearch.org/treetraining. ■



Plaku Krejg C. Kristensen,

i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve

Plaku Krejg C. Kristensen filloi të shërbente si anëtar i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve më 1 gusht 2012, pas thirrjes së tij për atë pozicion në prill të 2012-ës.

I lindur në Solt-Lejk-Siti të Jutas, SHBA, nga Sheron dhe Kollen Kristensen, në mars 1956, Plaku Kristensen u rrit në Kaliforninë veriore në “një familje shdm aktive dhe të ushqyer me besim”. Ai theksoi se gjithmonë ka besuar se ungjilli është i vërtetë, por prapëseprapë, dëshmia iu forcua gjatë shërbimit të tij misionar në Kili.

“Si një misionar, dëshira ime për të ndier Frymën e Shenjtë u bë e vazhdueshme, dhe dëshmia ime për ungjillin u thellua dhe u bë edhe më shumë reale për mua”, tha ai. Në misionin e tij ai ndieua një dashuri për Librin e Mormonit, që vazhdon në mësimet e tij sot.


Plaku Kristensen ka qenë anëtar i Kuorumit të Parë dhe të Dytë të Të Shtatëdhjetëve që nga viti 2002. Më së fundi, ai shërbeu si Drejtor Ekzekutiv i Departamentit të Priftërisë. Thirrjet e mëparshme përfshijnë: president i Misionit të Zonës së Meksikës së Jugut, president i Misionit të Meksiko-Sitit Lindor, peshkop, këshilltar i lartë dhe president i misionit të kunjtit.

Plaku Kristensen ka diplomë universitare të shkallës së parë për kontabilitet nga Universiteti “Brigam Jang” dhe master për administrim biznesi nga Universiteti i Uashingtonit. Ai ka zotëruar dhe drejtuar aktivitete në industrinë për zhvillimin e automobilave me pakicë dhe ato të pasurive të patundshme, dhe ka qenë pedagog i jashtëm në disa universitete.


Plaku Kristensen u martua me Debora Xhonsin më 28 mars 1978. Ata jetojnë në Hollëdei, Juta, dhe kanë katër fëmijë dhe pesë nipër e mbesa. ■

Presidencat e Përgjithshme të Organizatave Ndihmëse


SHOQATA E NDIHMËS



Karol M. Stevens
Këshilltare e Parë



Linda K. Barton
Presidente



Linda S. Rivs
Këshilltare e Dytë


TË REJAT



Meri N. Kuk
Këshilltare e Parë




Elen S. Dalton
Presidente



En M. Dib
Këshilltare e Dytë


FILLORJA



Xhin A. Stevens
Këshilltare e Parë



Rozmari M. Uiksom
Presidente



Sheryl A. Esplin
Këshilltare e Dytë

TË RINJTË



Leri M. Gibson
Këshilltar i Parë



Dejvid L. Bek
President



Adrián Oçoa
Këshilltar i Dytë

SHKOLLA E SË DIELËS




Dejvid M. Mek-Konki
Këshilltar i Parë



Rasëll T. Osguthorp
President



Methju O. Riçardson
Këshilltar i Dytë



*A Step of Faith
[Një Hap Besimi],
nga Michael T. Malm*

*“Dishepujt duke parë
[Jezusin] që po ecte mbi
det, u trembën. . . .*

*Por menjëherë Jezusi
u foli atyre duke thënë:
‘Qetësohuni; jam unë,
mos kini frikë!’*

*Dhe Pjetri, duke u
përgjigjur tha: ‘Zot, nëse
je ti, më urdhëro të vij
te ti mbi ujëra’.*

*Ai tha: ‘Eja!’ Dhe
Pjetri zbriti nga barka
dhe eci mbi ujëra, për
të shkuar te Jezusi”
(Mateu 14:26–29).*



“Kam kënaqësinë të njoftoj se, duke hyrë në fuqi menjëherë, të gjithë të rinjtë e denjë e të aftë, që kanë marrë diplomën e shkollës së mesme ose të barasvlershmen e saj, pavarësisht vendit ku jetojnë, do të kenë mundësinë të rekomandohen për shërbim misionar duke filluar nga mosha 18 vjeç në vend të moshës 19 vjeç”, njoftoi Presidenti Tomas S. Monson gjatë sesionit të hapjes së Konferencës së Përgjithshme Gjysmëvjetore të 182-të të Kishës. Ai tha gjithashtu: “Sot, kam kënaqësinë të njoftoj se të rejat e afta e të denja, që kanë dëshirë të shërbejnë, mund të rekomandohen për shërbim misionar duke filluar nga mosha 19 vjeçe në vend të moshës 21 vjeçe”.